

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

PËR

SHOQËRITË TREGTARE

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Korrik, 2010

© të gjitha të drejtat e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

ISBN: 978 – 9928 - 01 - 011 - 7

PËRMBAJTJA

I. PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE

Ligj nr.9901 datë 14.4.2008	Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare	7
Ligj nr. 9723 datë 3.5.2007	Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit <i>Ndryshuar</i> - me ligjin nr.9916, datë 12.5.2008	75
Vendim i KM nr.537, datë 1.8.2007	Për rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare	97
Ligj nr. 9754 datë 14.6.2007	Për përgjegjësinë penale të personave juridikë Këto akte nënligjore nuk janë shfuqizuar me akte nënligjore të reja, prandaj janë përfshirë si akte që duhen zbatuar për aq sa nuk bien ndesh me ligjin e ri “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”	101
Vendim i KM nr.93, datë 28.2.1994	Për bashkimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare me ortakë të tjerë <i>Ndryshuar</i> - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.466, datë 3.10.1994 - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.130, datë 20.3.1995 - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.288, datë 5.6.1995	108
Vendim i KM nr.288, datë 5.6.1995	Për privatizimin e së drejtës shtetërore në shoqëritë tregtare me kapital të përbashkët	110
Vendim i KM nr.23, datë 21.1.1999	Për shpërblimin e punonjësve të shoqërive tregtare, që privatizohen	111
Vendim i KM nr.150, datë 31.3.2000	Për miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël, të autorizuar <i>Ndryshuar</i> - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001	111
Vendim i KM nr.855, datë 17.12.2004	Për administrimin e të ardhurave nga shitja e aktiveve të qëndrueshme, të trupëzuara të shoqërive anonime me kapital themeltar tërësisht shtetëror	133
Udhëzim i METE nr.114, datë 1.11.2005	Për shoqëritë anonime “në likuidim e sipër” me kapital tërësisht shtetëror	134

II. FALIMENTIMI (PROCEDURAT)

Ligj nr.8901 datë 23.5.2002	Për falimentimin <i>Ndryshuar</i> me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008	136
Vendim i KM nr.197, datë 13.4.2007	Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit	207
Udhëzim i MF & MD nr.22, datë 29.7.2008	Për caktimin e administratorëve të përkohshëm të falimentimit	208

III. NDËRMARRJE SHTETËRORE (TRANSFORMIMI NË SHOQËRI, TREGTARE)

Ligj nr.7926 datë 20.4.1995	Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare <i>Ndryshuar</i> - me dekretin nr.1195, datë 14.8.1995 - me ligjin nr.8067, datë 15.2.1996 - me ligjin nr.8099, datë 28.3.1996 - me dekretin nr.1615, datë 20.9.1996 - me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996 - miratuar me ligjin nr.8158, datë 7.11.1996 - me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997 - me ligjin nr.8333, datë 23.4.1998 - me ligjin nr.8482, datë 10.5.1999 - me aktin normativ nr.3, datë 4.4.2002 - me ligjin nr.8885, datë 22.4.2002 - me ligjin nr.10 264, datë 8.4.2010	209
Vendim i KM nr.194, datë 20.3.1998	Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare	213
Vendim i KM nr. 271, datë 9.5.1998	Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore <i>Ndryshuar</i> - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.526, datë 21.8.1998	215
Vendim i KM nr.553, datë 28.8.1998	Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore	220
Vendim i KM nr.642, datë 11.10.2005	Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore	221

IV. NDËRMARRJE SHTETËRORE

Ligj nr.7582 datë 13.7.1992	Për ndërmarrjet shtetërore <i>Ndryshuar</i> - me ligjin nr.7670, datë 9.2.1993 - me ligjin nr.7743, datë 26.7.1993 <i>Në fuqi deri në transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri</i>	223
Ligj nr.350 datë 10.8.1992	Për mënyrën e klasifikimit të ndërmarrjeve shtetërore në kombëtare dhe lokale	229
Udhëzim i KM nr.6, datë 3.9.1992	Për zbatimin e ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore"	229
Vendim i KM nr.153, datë 3.4.1993	Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore <i>Ndryshuar</i> - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.454, datë 16.9.1993 - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 29.12.1993	232
Vendim i KM nr.198, datë 4.5.1993	Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave <i>Ndryshuar</i> - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.40, datë 26.1.2001 - me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.724, datë 5.11.2004	233
Vendim i KM nr.206, datë 16.4.1993	Për kushtet dhe afatet e kredive tregtare të kontraktuara nga ndërmarrjet shtetërore	235

Vendim i KM nr.244, datë 27.5.1993	Për sponsorizimin nga ndërmarrjet shtetërore të subjekteve të ndryshme	236
Vendim i KM nr.290, datë 14.6.1993	Për limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore	237
Vendim i KM nr.364, datë 21.7.1993	Për përdorimin e fitimit të ndërmarrjeve jobuxhetore për financim në fushën e ndërtimeve publike	237
Vendim i KM nr.840, datë 17.12.2004	Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik	238
V. NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME		
Ligj nr.8957 datë 17.10.2002	Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme <i>Ndryshuar me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008</i>	239
Ligj nr.9497 datë 20.3.2006	Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve	247
Vendim i KM nr.509, datë 19.7.2006	Për përbërjen e këshillit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve dhe për mënyrën e masën e shpërblimit të anëtarëve të tij	249
Vendim i KM nr.514, datë 26.7.2006	Për miratimin e Statutit të Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve	250

LIGJ
Nr.9901, datë 14.4.2008

PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

TITULLI I

DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR TREGTARIN
DHE SHOQËRITË TREGTARE

Neni 1

Objekti i ligjit, përkufizime, regjistrime të detyrueshme

1. Ky ligj rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Shoqëritë tregtare janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare.

2. Tregtarët dhe shoqëritë tregtare regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

3. Tregtarët dhe shoqëritë tregtare mbajnë libra kontabël, hartojnë e publikojnë të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

4. Nëse nuk parashikohet ndryshe, gjykata e përmendur në këtë ligj është seksioni tregtar i gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës, sipas dispozitave të neneve 334 deri në 336 të Kodit të Procedurës Civile.

5. Dispozitat, që kërkojnë dhënie informacioni në faqen e shoqërisë në internet, mund të zbatohen nëpërmjet krijimit të një lidhjeje informatike të drejtpërdrejtë me faqen në internet, ku Qendra Kombëtare e Regjistrimit publikon informacionin për tregtarin apo shoqërinë përkatëse.

6. Në kuptim të këtij ligji, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës e anasjelltas, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezultojnë ndryshe. Përemri vetor “ai” përfshin edhe përemrin vetor “ajo” dhe përemri vetor “atë” i nënkupton të dyja gjinitë, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezultojnë ndryshe.

Neni 2

Tregtari

1. Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm.

2. Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status.

3. Personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agrobiznes).

4. Personi fizik, veprimtaria ekonomike e të cilit, për shkak të vëllimit të tij, nuk kërkon një organizim të zakonshëm tregtar (tregtar i vogël), nuk vlerësohet tregtar e nuk i nënshtrohet këtij ligji. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për ekonominë, me urdhër të përbashkët, miratojnë pragjet e vëllimit të veprimtarisë, në bazë të të cilave lind detyrimi i regjistrimit si tregtar.

5. Tregtari regjistrohet sipas neneve 28 pika 1 dhe 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse tregtari ka krijuar një faqe në internet, të gjitha të dhënat e njoftuara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit publikohen në këtë faqe.

6. Tregtari është i detyruar të ndjekë parimet e ndershmërisë profesionale, të zbatueshme në mjedisin tregtar, ku ai vepron. Tregtari, për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara, përgjigjet personalisht me të gjithë pasurinë e të drejtat e tij të tashme dhe të ardhshme, përfshirë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, pronësitë industriale e intelektuale, kreditë ndaj të tretëve e çdo të drejtë apo pasuri tjetër, vlera e të cilave mund të shprehet në para.

7. Tregtari e humbet statusin e tij kur pushon ushtrimin e veprimtarisë ose kur është i detyruar ta pushojë atë. Në një rast të tillë ai rregjistrohet nga regjistri, në përputhje me nenet 48 deri në 53 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 3 **Shoqëritë tregtare**

1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.

3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.

Neni 4 **Emrat e regjistruar dhe emërtimet tregtare**

1. Tregtari dhe shoqëritë tregtare e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën emrin e regjistruar. Emri i tregtarit është emri i tij, sipas nenit 5 të Kodit Civil, i regjistruar në përputhje me nenin 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Emri i shoqërisë tregtare duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 23 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Tregtari dhe shoqëritë tregtare mund të përdorin dhe emërtime tregtare, si dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë dhe i regjistrojnë këto në përputhje me nenin 44 pika 1 shkronja “a” të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Emri i tregtarit ndiqet nga shtojca “tregtar i regjistruar” ose shkurtimi përkatës “TR”. Emri i shoqërisë kolektive duhet të ndiqet nga shtojca “shoqëri kolektive” ose shkurtimin “SHK”. Emri i shoqërisë komandite duhet të ndiqet nga shtojca “shoqëri komandite” ose shkurtimin “SHKM”. Emrat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe të shoqërive aksionare përmbajnë shkurtimet, të cilat tregojnë se janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “SHPK” ose shoqëri aksionare “SHA”.

Neni 5

Transferimi i emrave dhe i përgjegjësisë

1. Personi, të cilit i transferohet veprimtaria e një tregtari ose e një shoqërie tregtare, mund të vijojë të përdorë emrin e regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë, me ose pa një shtesë, që tregon ndërrimin e pronësisë, nëse titullari i mëparshëm i veprimtarisë apo trashëgimtarët e tij e miratojnë këtë përdorim.

2. Nëse emri i regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë vijnë të përdoren, titullari i ri i veprimtarisë trashëgon të gjitha detyrimet tregtare të titullarit të mëparshëm. Marrëveshjet, që përcaktojnë ndryshe nga sa më sipër, nuk mund t'i kundrejtohen palëve të treta, edhe nëse janë bërë publike, me përjashtim të rastit kur tregtari ose shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për marrëveshjen, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

TITULLI II

THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

Neni 6

Statuti

Statuti i shoqërisë tregtare përmban të dhënat e përcaktuara në nenet 32 deri në 36 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Paragrafi i katërt i nenit 28 të ligjit të sipërpërmendur mbetet i zbatueshëm.

Neni 7

Objekti i ligjshëm

Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohet me ligj.

Neni 8

Zyra qendrore

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në statut, zyra qendrore e shoqërisë tregtare është vendi, ku zhvillohet pjesa kryesore e veprimtarisë së saj tregtare.

2. Nëse zyra qendrore ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, shoqëritë tregtare u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Neni 9

Degët dhe zyrat e përfaqësimit

1. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.

2. Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.

3. Zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Zyrat e përfaqësimit nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Këto zyra mund të lidhin marrëveshje në emër e për llogari të saj.

4. Nëse degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare krijojnë faqe interneti, ato duhet të publikojnë numrin unik të identifikimit të shoqërisë në këtë faqe interneti.

5. Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen sipas kërkesave të neneve 26 pika 4, 28 pika 5 dhe 37 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

6. Dega vepron nën emrin e regjistruar të shoqërisë tregtare, si dhe nën emrin e saj.

Neni 10

Përgjegjësia e themeluesve

1. Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë.

2. Themeluesit japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave e afateve të parashikuara në statut dhe kryejnë formalitetet e themelimit sipas kërkesave të këtij ligji dhe të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Themeluesit përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

3. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë mund të ngrejë padi në gjykatën përkatëse për dëmin e shkaktuar nga mospërbushjet e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni. Në rast mosveprimi të përfaqësuesit ligjor brenda 90 ditëve nga marrja dijani e mospërbushjes, padia mund të ngrihet përkatësisht nga një ortak i shoqërisë kolektive ose komandite, nga një numër ortakësh të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar apo aksionarësh të një shoqërie aksionare, të cilët zotërojnë jo më pak se 5 për qind të tërësisë së votave në asamblenë e shoqërisë. Padia mund të ngrihet, gjithashtu, nga çdo kreditor i shoqërisë tregtare. Ortakët, aksionarët ose kreditorët duhet të respektojnë procedurat e neneve 91, 92, 150 e 151 të këtij ligji. Padi të duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas regjistrimit të shoqërisë tregtare.

Neni 11

Të dhënat në korrespondencat dhe dokumentet e tjera të veprimitarisë

1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit;
- b) formën ligjore të shoqërisë;
- c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
- ç) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim.

Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty. Edhe në këtë rast zbatohet pika 5 e nenit 1 të këtij ligji.

2. Shoqëria përgjigjet për vërtetësinë e të dhënave të deklaruara sipas pikës 1 të këtij neni. Nxjerrja e shkresave, formularëve e urdhrave apo e çdo dokumenti tjetër korrespondence, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë. Kur kundërvajtja administrative e parashikuar në këtë pikë konstatohet gjatë një kontrolli të organizuar nga administrata tatimore, sanksioni ekzekutohet nga kjo administratë.

TITULLI III PËRFAQËSIMI

Neni 12

Përfaqësuesit ligjorë

1. Shoqëritë tregtare përfaqësohen sipas rregullave të përcaktuara nga ky ligj dhe dispozitave të statutit. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.

2. Përfaqësuesit ligjorë zbatojnë të gjitha kufizimet e tagrave të përfaqësimit, të përcaktuara në statut apo të miratuara nga organet përkatëse të shoqërisë. Me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për kufizimin, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të, kufizimi i kompetencave nuk mund t'i kundrejtohet palëve të treta, edhe nëse këto kufizime janë bërë publike në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Publikimi i kufizimit nëpërmjet publikimit të vendimeve të organit përkatës të shoqërisë apo statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky kufizim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3. Veprimet e kryera nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Çdo parregullsi në emërimin e përfaqësuesit ligjor nuk përjashton apo kufizon përgjegjësinë e shoqërisë ndaj palëve të treta, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për parregullsinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 13

Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur

1. Personat, që janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të parashikuara në kreun III të pjesës së posaçme të Kodit Penal, për një afat deri në 5 vjet nga data e këtij dënimi, nuk mund të mbajnë funksionet e përfaqësuesit ligjor të një shoqërie tregtare, nuk mund të jenë anëtarë të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës dhe as përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

2. Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse kjo nuk deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të tij e veprimi nuk autorizohet, paraprakisht, prej:

a) të gjithë ortakëve të tjerë, në rastin e një shoqërie kolektive apo komandite;

b) të gjithë ortakëve ose të gjithë ortakëve të tjerë, në rastin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar;

c) këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, në rastin e administratorëve të shoqërive aksionare;

ç) këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës, në rastin e anëtarëve të këshillit të administrimit ose këshillit mbikëqyrës në shoqëritë aksionare.

Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3. Miratimi i parashikuar në pikën 2 të këtij neni jepet, gjithashtu, për çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë, apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipërm janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë:

a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit/ bashkëshortes;

b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;

c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuar, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;

ç) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.

4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorum.

5. Aksionarët njoftohen për miratimin e dhënë sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, si dhe për kushtet e veprimit e natyrën e objektin e interesit. Brenda 6 muajve nga njoftimi, asambleja mund t'i kërkojë gjykatës të shpallë veprimin juridik si të pavlefshëm, në rastet kur miratimi është dhënë me shkelje të rëndë të ligjit apo statutit. Dispozitat e nenit 151 të këtij ligji mbeten të zbatueshme.

6. Çdo veprim që kërkon miratim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecures së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë.

7. Një person, i cili është, njëkohësisht, administrator dhe ortak apo aksionar i vetëm i shoqërisë, nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë. Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë. Mospërbushja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative dhe administratori dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë. Kur kundërvajtja administrative e parashikuar në këtë pikë konstatohet gjatë një kontrolli të organizuar nga administrata tatimore, sanksioni ekzekutohet nga kjo administratë.

TITULLI IV PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

Neni 14

Parimet

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët dhe aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj ose nga statuti, në rrethana të njëjta, ortakët dhe aksionarët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

Neni 15

E drejta e informimit

1. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët apo aksionarët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e vendosur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke informuar për këtë personat, të cilët e bëjnë kërkesën. Në të kundërt, këto dokumente duhet të vihen në dispozicion, për shqyrtim, pranë zyrës qendrore të shoqërisë tregtare.

2. Çdo dispozitë e statutit, që ndalon ose kufizon ushtrimin e të drejtave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, është e pavlefshme.

3. Nëse personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk japin informacionin e kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni, ortakët, anëtarët ose aksionarët e interesuar, brenda 30 ditëve pas refuzimit, mund t'i kërkojnë gjykatës kompetente të urdhërojnë përmbaruesit gjyqësorë të

ekzekutojnë kërkesën e ortakut apo aksionarit, duke i dorëzuar këtyre të fundit informacionin dhe dokumentet që personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk kanë dhënë. Mosdhënia e informacioneve të kërkuara, sipas këtij neni, brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni për kërkesën, vlerësohet refuzim.

Neni 16

Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë

1. Ortakët, aksionarët e shoqërisë tregtare, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë pagueuse të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

2. Palët e treta nuk mund të ngrenë padi për përmbushjen e detyrimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse shoqëria provon se i treti kishte pasur dijeni për abuzimin apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Padia duhet të ngrihet brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes.

Neni 17

Ndalimi i konkurrencës

1. Ortakët e shoqërisë kolektive, ortakët e pakufizuar të shoqërisë komandite, ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit të një shoqërie aksionare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

2. Statuti mund të parashikojë që ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët, sipas dispozitave të nenit 36 të këtij ligji, apo nga asambleja e përgjithshme me tre të katërtat e votave, sipas dispozitave të neneve 87 apo 145 të këtij ligji.

3. Statuti mund të parashikojë, gjithashtu, se ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, të mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:

- a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
- c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

Neni 18
Sekreti tregtar

1. Sekreti tregtar është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument, që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili, nëse do t'u përhapej personave të paaautorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë.

2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

3. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës, anëtarët e këshillit të punëmarrësve, si dhe përfaqësuesit e punëmarrësve përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

4. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë duhet të ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

TITULLI V
PJESËMARRJA E PUNËMARRËSVE

Neni 19
Këshilli i punëmarrësve

Punëmarrësit e një shoqërie tregtare, e cila ka më shumë se 50 punëmarrës, krijojnë këshillin e punëmarrësve, me mandat maksimal prej 5 viteve . Funksionet e një shoqërie tregtare, e cila ka mbi 20 punëmarrës, por më pak se 50, kryhen nga një përfaqësues, për çdo 10 punëmarrës, i cili zgjidhet me votim të fshehtë nga asambleja e punëmarrësve të shoqërisë. Asambleja e punëmarrësve zgjedh një përfaqësues të ri, për çdo 20 punëmarrës shtesë të shoqërisë. Në çdo rast, këshilli i punëmarrësve nuk mund të ketë më shumë se 30 anëtarë. Këshilli mund të nxjerrë rregullore të brendshme, për të organizuar procedurat e veta.

Neni 20
Të drejtat dhe detyrimet e këshillit të punëmarrësve

1. Këshilli i punëmarrësve monitoron zbatimin e ligjeve, të kontratave kolektive dhe dispozitave të statutit dhe përfaqëson interesat e punëmarrësve të shoqërisë. Këshilli merr pjesë në vendimmarrjen për shfrytëzimin e fondeve të posaçme dhe të aktiveve të tjera të shoqërisë, të parashikuara në kontratat kolektive dhe në statut, si dhe për shpërndarjen e pjesës së fitimeve, që asambleja e përgjithshme vendos t'ia shpërndajë punëmarrësve.

2. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë e mban këshillin e punëmarrësve të informuar për veprimtaritë dhe ecurinë e shoqërisë tregtare e në mënyrë të veçantë për efektet e politikave të shoqërisë për kushtet e punës, pagat, sigurinë në punë, ndarjen e mundshme të fitimeve, ndryshimin e statusit, sistemin e pensioneve të shoqërisë, ristrukturimin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë në shoqëri të tjera. Përfaqësuesi ligjor, me kërkesën e këshillit të punëmarrësve, paraqet gjendjen e llogarive, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e këshillit mbikëqyrës apo të ekspertëve kontabël të autorizuar. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e shpallur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke e informuar për këtë këshillin e punëmarrësve. Në të kundërt, mund të kërkohej që përgjigjet të jenë me shkrim, duke përdorur edhe mjete të komunikimit elektronik.

3. Këshilli i punëmarrësve, gjithashtu, mund të informojë veten drejtpërdrejt për performancën e shoqërisë tregtare dhe të këqyrë librat e dokumentet e shoqërisë, duke u dhënë mendime dhe sugjerime organeve drejtuese për çështjet e përmendura në pikën 2 të këtij neni. Përfaqësuesi ligjor e informon këshillin e punëmarrësve për arsyet e mospranimit të mendimeve dhe të sugjerimeve të këtij këshilli.

4. Statuti nuk mund ta pengojë apo kufizojë ushtrimin e të drejtave të përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe këshillit të punëmarrësve për një sistem ekuivalent informimi. Nëse përfaqësuesi ligjor nuk pranon të japë informacionet, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, këshilli i punëmarrësve, brenda 2 javëve pas refuzimit, mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të marrë një vendim detyrues për informimin.

5. Këshilli i punëmarrësve i raporton asamblesë së punëmarrësve të shoqërisë për veprimtaritë e veta të paktën dy herë në vit ose sa herë e kërkon shumica e punëmarrësve.

6. Kostot e zgjedhjes dhe të funksionimit të këshillit mbulohen nga shoqëria tregtare.

Neni 21

Pjesëmarrja e punëmarrësve në administrimin e shoqërive aksionare

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë tregtare dhe këshilli i punëmarrësve mund të bien dakord që ky të emërojë persona për të përfaqësuar punëmarrësit në nivelin e administrimit.

PJESA II SHOQËRITË KOLEKTIVE

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 22

Përkufizimi

Një shoqëri është shoqëri kolektive nëse regjistrohet si e tillë, e kryen veprimtarinë tregtare nën një emër të përbashkët dhe përgjegjësia e ortakëve përpara kreditorëve është e pakufizuar.

Neni 23

Regjistrimi

1. Shoqëria kolektive regjistrohet në përputhje me nenet 26, 28, 32 e 33 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Nëse shoqëria kolektive ka krijuar një faqe interneti, të dhënat, të cilat i raportohen Qendrës Tregtare të Regjistrimit, publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

TITULLI II MARRËDHËNIET NDËRMJET ORTAKËVE

Neni 24

Liria kontraktore

Marrëdhëniet ndërmjet ortakëve rregullohen nga statuti. Nenet 25 deri në 36 të këtij ligji zbatohen vetëm në rastin kur në statut nuk parashikohet ndryshe.

Neni 25
Kontributet

1. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, të drejta, krah pune dhe shërbime). Kontributet e ortakëve janë të barabarta.

2. Ortakët e shoqërisë kolektive i vlerësojnë kontributet në natyrë, duke i shprehur vlerat e tyre në para, me anë të një marrëveshjeje të ndërsjellë me njëri-tjetrin. Nëse nuk arrihet marrëveshja, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të caktuar, me një vendim detyrues, një ekspert vlerësues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit së bashku me të dhënat e tjera, të kërkuara për regjistrim.

Neni 26
Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar

Gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre, ortakët përgjigjen ndaj shoqërisë kolektive për të gjitha dëmet e shkaktuara me dashje ose me pakujdesi të rëndë.

Neni 27
Rimbursimi i shpenzimeve

Të gjithë ortakët kanë të drejtë t'i kërkojnë shoqërisë kolektive rimbursimin e shpenzimeve, që kanë bërë gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, të cilat janë të nevojshme, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë.

Neni 28
Vonesa në pagimin e kontributeve

Ortakët, të cilët:

- a) nuk i paguajnë shoqërisë kontributin në para ose në natyrë brenda afatit të përcaktuar në statut;
- b) nuk i kalojnë në kohën e duhur shoqërisë paratë e arkëtuara në emër të saj;
- c) marrin para nga shoqëria pa qenë të autorizuar;
- d) detyrohen të paguajnë interes mbi vlerat që detyrohen, duke nisur nga data kur duhet të kishin derdhur kontributin, të kishin bërë kalimin ose nga data, në të cilën kanë marrë paratë.

Neni 29
Rritja ose zvogëlimi i vlerës së kontributit

1. Ortaku nuk është i detyruar ta rrisë vlerën e kontributit të vet mbi shumën, për të cilën është rënë dakord, ose ta shtojë atë, nëse ky kontribut është zvogëluar nga humbjet.

2. Ortaku nuk mund ta zvogëlojë vlerën e kontributit të vet, pa miratimin e ortakëve të tjerë.

Neni 30
Disponimi i pjesëve

1. Ortaku nuk mund të heqë dorë, të transferojë apo të vendosë barrë mbi të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut (pjesa) në shoqëri, pa miratimin e ortakëve të tjerë.

2. Të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut (pjesa) në shoqërinë kolektive, mund t'u transferohen, pa asnjë kufizim, ortakëve të tjerë.

Neni 31
Administrimi

1. Të gjithë ortakët kanë të drejtë ta administrojnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë kolektive, duke vepruar si administratorë.

2. Nëse, në mbështetje të statutit, i është ngarkuar administrimi një apo disa prej ortakëve, ortakët e tjerë përjashtohen nga administrimi.

Neni 32
Administrimi nga më shumë se një ortak

1. Nëse e drejta për administrimin u është dhënë të gjithë ortakëve ose vetëm disave prej tyre, secili prej administratorëve ka të drejtë të veprojë në mënyrë të pavarur, me përjashtim të rasteve kur veprimet e tyre kundërshtohen nga administratorët e tjerë.

2. Nëse statuti parashikon që administratorët mund të veprojnë vetëm në mënyrë të përbashkët, atëherë për çdo veprim kërkohet miratimi i të gjithë administratorëve, me përjashtim të rasteve kur vonesa në kryerjen e veprimit mund t'i shkaktojë dëm shoqërisë.

3. Nëse statuti parashikon që një administrator është i detyruar t'u bindet udhëzimeve të një administratori tjetër, kur këto udhëzime konsiderohen të papërshtatshme, ai njofton administratorët e tjerë për të marrë një vendim të përbashkët për kryerjen e veprimit, me përjashtim të rasteve kur vonesa në kryerjen e veprimit mund t'i shkaktojë dëm shoqërisë.

Neni 33
Objekti i administrimit

1. E drejta për administrim përfshin kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për ushtrimin e zakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë.

2. Veprimet, të cilat tejkalojnë objektin e kompetencës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, kërkojnë miratimin e të gjithë ortakëve.

Neni 34
Kalimi i të drejtave të administrimit

Ortaku, me miratimin e gjithë ortakëve të tjerë, mund t'i kalojë një palë të tretë të drejtat e administrimit të shoqërisë.

Neni 35
Njoftimi i dorëheqjes dhe heqja e të drejtave për administrim

1. Administratori mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij, për shkaqe të arsyeshme, duke bërë njoftim paraprak, në një kohë të përshtatshme, për të mundësuar vazhdimin e veprimeve nga administratorët e tjerë, me përjashtim të rasteve kur dorëheqja e menjëhershme vlerësohet e justifikuar për një arsye të rëndësishme.

2. E drejta për administrim mund t'i hiqet ortakut me vendim të gjykatës përkatëse, me kërkesë të ortakëve të tjerë, nëse kjo justifikohet nga shkaqe të arsyeshme, përfshirë shkeljen e rëndë të detyrave të administratorit ose paaftësinë për t'i përmbushur ato në mënyrë të rregullt.

Neni 36
Marrja e vendimeve nga ortakët

1. Nëse vendimet duhet të merren nga ortakë nominalisht të përcaktuar, atëherë është i nevojshëm miratimi i të gjithëve, me përjashtim të rasteve kur ndonjëri prej tyre është në konflikt interesi me çështjen në shqyrtim.

2. Kur statuti lejon marrjen e vendimeve me shumicë votash, kjo shumicë duhet të jetë një shumicë e thjeshtë.

Neni 37

Humbja dhe fitimi

1. Në fund të çdo viti financiar, shoqëria përgatit pasqyrat vjetore financiare, ku përcaktohen fitimi dhe humbja, si dhe pjesa që i përket në to secilit ortak.

2. Secili ortak ka të drejtë të përfitojë pjesë të barabartë të fitimeve dhe është i detyruar të marrë pjesë, në mënyrë të barabartë, në mbulimin e humbjeve që rrjedhin nga veprimtaria.

TITULLI III

MARRËDHËNIET NDËRMJET ORTAKËVE DHE TË TRETËVE

Neni 38

Përfaqësimi i shoqërisë kolektive

1. Secili ortak ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut.

2. Nëse ortakët e përfaqësojnë shoqërinë bashkërisht, deklaratat, të cilat i drejtohen shoqërisë, mund t'i adresohen njërit prej ortakëve, me të drejtë përfaqësimi. Administratorët, të cilët kanë të drejtë ta përfaqësojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve apo kategorive të caktuara veprimesh.

3. Çdo përjashtim i ortakëve nga e drejta e përfaqësimit, çdo vendim për përfaqësim të përbashkët apo çdo ndryshim në të drejtat e një ortaku për përfaqësim njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 39

Njoftimi i dorëheqjes dhe heqja e të drejtave për përfaqësim

1. Përfaqësuesi i shoqërisë mund të japë dorëheqjen nga detyrat e tij, nëpërmjet një njoftimi paraprak, dhënë në një kohë të përshtatshme dhe duke pasur parasysh mundësitë e përfaqësuesve të tjerë, për të vijuar veprimet e ndërmarra nga përfaqësuesi i dorëhequr.

2. Ortakut mund t'i hiqet tagri i përfaqësimit me vendim të gjykatës përkatëse, me kërkesë të ortakëve të tjerë, veçanërisht në rastet e shkeljes së rëndë të detyrave të përfaqësimit apo të paafëtisë, për t'i përmbushur ato në mënyrë të rregullt.

Neni 40

Përgjegjësia personale e ortakëve

1. Ortakët përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë me të gjitha pasuritë e tyre. Çdo marrëveshje, në kundërshtim me këtë dispozitë, nuk prodhon efekte ndaj palëve të treta.

2. Kreditori personal i ortaku mund të ekzekutojë kreditë, që ka ndaj këtij të fundit, duke ekzekutuar kreditë që ortaku ka ndaj shoqërisë, si dhe pjesën që ky ortak zotëron në shoqëri. Kreditori mund të kërkojë ekzekutimin e kredive, në përputhje me nenet 581 deri në 588 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 41

Prapësimet

Nëse një kreditor ngre padi ndaj një ortaku për detyrimet e shoqërisë, atëherë ortaku mund të mbrohet duke ngritur ndaj kreditorit prapësime, që i përkasin personalisht ortaku, si dhe ato që i përkasin shoqërisë.

Neni 42
Përgjegjësia e ortakut të ri

Personi, që fiton cilësinë e ortakut në një shoqëri kolektive ekzistuese, merr përsipër detyrimet e shoqërisë, përfshirë këtu edhe detyrimet që ekzistonin përpara se ai ta fitonte këtë cilësi. Çdo marrëveshje në kundërshtim me këtë dispozitë nuk prodhon efekte ndaj palëve të treta.

TITULLI IV
PRISHJA E SHOQËRISË KOLEKTIVE
DHE LARGIMI I ORTAKËVE

Neni 43
Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria kolektive priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me vendim të ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) me vendim gjykatë;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk ka njoftuar pezullimin e veprimtarisë, sipas pikës 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut.

Neni 44
Largimi i ortakut

Përveç rastit kur statuti parashikon ndryshe, ngjarjet e mëposhtme nuk kanë si pasojë prishjen e shoqërisë, por largimin e ortakut:

- a) vdekja e një ortaku;
- b) hapja e procedurave të falimentimit ndaj një ortaku;
- c) njoftimi i ortakut për largim nga shoqëria;
- ç) njoftimi i kreditorit personal të ortakut në rrethanat e përshkruara në nenin 46 të këtij ligji;
- d) vendim i ortakëve të tjerë;
- dh) raste të tjera të parashikuara në statut.

Neni 45
Njoftimi i ortakut për largim nga shoqëria

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, nëse shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të papërcaktuar, secili ortak mund të largohet nga shoqëria, duke njoftuar me shkrim ortakët e tjerë 6 muaj përpara. Në raste të justifikuara mund të zbatohet një njoftim me afat më të shkurtër.

Neni 46
Njoftimi nga kreditori personal i ortakut

Nëse kreditori personal i ortakut nuk ka arritur të ekzekutojë kreditë e tij ndaj këtij të fundit, në bazë të një vendimi gjyqësor, atëherë, brenda 6 muajve nga kërkesa, kreditori ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e pjesës që zotëron ortaku në shoqëri. Dispozitat e pikës 2 të nenit 40 të këtij ligji mbeten të zbatueshme edhe në këtë rast.

Neni 47

Prishja e shoqërisë me vendim gjykate

Shoqëria mund të prishet me vendim gjykate për shkaqe të arsyeshme, në bazë të padisë së ngritur nga një ortak e, në mënyrë të veçantë, nëse njëri prej ortakëve, me dashje ose si pasojë e pakujdesisë së rëndë, nuk ka kryer detyrat e caktuara në statut, apo nëse kryerja e këtyre detyrave është bërë e pamundur.

Neni 48

Përfundimi i ortakut

Në rrethanat e parashikuara në nenin 47 të këtij ligji, gjykata, në bazë të padisë të ngritur nga një ortak, mund të vendosë të përfundojë ortakun përgjegjës dhe të mos vendosë prishjen e shoqërisë.

Neni 49

Ndarja e pjesës së ortakut që ikën

1. Pjesa e secilit ortak, që largohet nga shoqëria kolektive, ndahet në mënyrë proporcionale ndërmjet ortakëve të mbetur, me përfundim të rasteve kur largimi është pasojë e falimentimit, njoftimit të kreditorit apo për raste të tjera të parashikuara në statut. Ortakët e mbetur janë të detyruar t'i paguajnë ortakut të larguar, kreditorëve apo trashëgimtarëve të tij, në përputhje me rregullat e trashëgimisë, vlerën që ai do të kishte përfutur nëse shoqëria do të ishte prishur në çastin e daljes së tij, duke pasur parasysh edhe veprimet ende të papërfunduara.

2. Nëse vlera e aktiveve të shoqërisë nuk është e mjaftueshme për të përballuar të gjitha detyrimet e saj, ortakut që largohet apo trashëgimtarët e tij, në përputhje me rregullat e trashëgimisë, përgjigjet për diferencën, në përpjesëtim me pjesën e humbjeve të shoqërisë, që i takojnë.

3. Në rast përfundimi, sipas nenit 48 të këtij ligji, ortakët mund të zbresin nga shuma e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vlerën e dëmit të mundshëm, që shoqëria ka pësuar nga mospërbushjet e ortakut.

Neni 50

Procedura për rastet kur mbetet vetëm një ortak

1. Kur, për çfarëdo arsye, shoqëria kolektive mbetet me një ortak të vetëm, atëherë ai është i detyruar që, brenda 6 muajve nga ngjarja e këtij fakti, të marrë masat e nevojshme për ta përshtatur shoqërinë me kërkesat e këtij ligji, apo në mënyrë alternative t'i kalojë veprimtarinë e saj një shoqërie të themeluar rishtazi, që pranon ekzistencën e një ortakut të vetëm ose të vazhdojë ushtrimin e veprimtarisë duke u regjistruar si tregtar.

2. Nëse brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ortakut i mbetur nuk regjistron një prej veprimeve si më sipër në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, shoqëria kolektive vlerësohet e prishur dhe likuidohet sipas dispozitave të këtij ligji. Çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

Neni 51

Vazhdimi i shoqërisë nga trashëgimtarët

1. Shoqëria kolektive vazhdon ta ushtrojë veprimtarinë me trashëgimtarët e ortakut të vdekur, nëse lejohet në statut dhe pranohet nga trashëgimtarët.

2. Trashëgimtarët mund të ushtrojnë të drejtën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga data, në të cilën gjykata përkatëse, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, lëshon dëshminë e trashëgimisë.

Neni 52

Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

Të gjithë ortakët janë të detyruar të njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, për aktet, faktet e prishjes dhe largimit të ortakëve.

Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, sipas nenit 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

TITULLI V

LIKUIDIMI I SHOQËRISË KOLEKTIVE

Neni 53

Likuidimi i shoqërisë kolektive në gjendjen e aftësisë paguese

Prishja e shoqërisë kolektive në gjendjen e aftësisë paguese ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit, sipas neneve 190 deri 205 të këtij ligji.

Neni 54

Parashkrimi i padive ndaj një ortaku

1. Me përjashtim të rasteve kur padia ndaj shoqërisë kolektive ka një afat parashkrimi më të shkurtër, paditë ndaj një ortaku për detyrimet e shoqërisë kolektive ngrihen brenda 3 vjetëve pas prishjes së saj.

2. Parashkrimi nis në datën kur është regjistruar prishja e shoqërisë.

3. Nëse detyrimi ndaj shoqërisë kolektive bëhet i kërkueshëm pas regjistrimit të prishjes, parashkrimi nis në datën kur detyrimi bëhet i kërkueshëm.

4. Ndërprerja e parashkrimit për detyrimet e shoqërisë kolektive zbatohet edhe ndaj personave, që kanë pasur cilësinë e ortakut në çastin e prishjes.

Neni 55

Parashkrimi në rastin e largimit të ortakut

Ortaku i larguar nga shoqëria përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që kanë lindur përpara largimit të tij, nëse këto detyrime kanë lindur përpara 3 viteve nga data e këtij largimi. Parashkrimi nis në datën e regjistrimit të largimit të ortakut.

PJESA III

SHOQËRIA KOMANDITE

Neni 56

Përkufizimi

1. Shoqëri komandite është shoqëria, në të cilën përgjegjësia e të paktën njërit prej ortakëve është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, ndërsa përgjegjësia e ortakëve të tjerë nuk është e kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit nuk është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i pakufizuar. Ortaku i pakufizuar ka statusin e ortakut të shoqërisë kolektive.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, dispozitat që rregullojnë shoqërinë kolektive janë të zbatueshme edhe për shoqërinë komandite.

Neni 57
Regjistrimi

1. Shoqëria komandite regjistrohet sipas neneve 26, 28, 32 e 34 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Nëse shoqëria komandite ka krijuar faqe të saj në internet, të dhënat që i njoftohen për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

Neni 58
Marrëdhëniet ndërmjet ortakëve

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve rregullohen nga nenet 59 deri 61 të këtij ligji. Statuti mund të parashikojë ndalimin e konkurrencës, sipas nenit 17 të këtij ligji, edhe për ortakët e kufizuar.

Neni 59
Administrimi

1. Veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite administrohet nga një ose më shumë ortakë të pakufizuar. Ortakët e kufizuar nuk kryejnë veprime administrimi.

2. Një ortak i kufizuar nuk mund të kundërshtojë veprimet e administrimit të ortakut të pakufizuar, me përjashtim të rasteve kur ai kryen një veprim, që shkon përtej veprimtarisë të zakonshme të shoqërisë.

Neni 60
Përballimi i humbjeve

Ortaku i kufizuar përballon humbjet e shoqërisë deri në vlerën e pjesës së tij në kapital dhe vlerën e kontributeve ende të pashlyera.

Neni 61
Ndalimi i përfaqësimit ligjor

Ortaku i kufizuar nuk mund të veprojë si përfaqësues ligjor i shoqërisë komandite.

Neni 62
Përgjegjësia e ortakëve të kufizuar

1. Ortaku i kufizuar përgjigjet personalisht ndaj kreditorëve të shoqërisë kolektive deri në vlerën e kontributeve të pashlyera. Ortaku i kufizuar nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, në rastin kur ka shlyer të gjitha kontributet e tij.

2. Rritja e paregjistruar e një kontributi të regjistruar prodhon efekte ndaj kreditorëve, vetëm nëse shoqëria ka njoftuar kreditorin për këtë rritje, ose nëse rritja është publikuar në mënyrë të zakonshme.

3. Marrëveshjet ndërmjet ortakëve, që përjashtojnë ortakun e kufizuar nga detyrimi për të shlyer kontributet, apo që shtyjnë afatin e shlyerjes së këtyre kontributeve, nuk prodhojnë efekte ndaj kreditorëve.

4. Zvogëlimi i kontributeve nuk prodhon efekte ndaj kreditorëve, për sa kohë ky zvogëlim nuk është regjistruar, me përjashtim të rastit kur kreditori kishte dijeni për këtë zvogëlim. Zvogëlimi i kontributeve, edhe nëse është i regjistruar, nuk prodhon efekte ndaj kreditorëve, detyrimet e të cilëve kishin lindur përpara regjistrimit të këtij zvogëlimi.

5. Nëse shoqëria i kthen ortakut të kufizuar kontributet e dhëna, ortakut i kufizuar përgjigjet ndaj kreditorëve sikur kontributi të mos ishte paguar ndonjëherë. I njëjti parim zbatohet edhe në rastet kur ortakut i kufizuar tërheq një pjesë të fitimit dhe pjesa e tij në shoqëri bëhet më e vogël se kontributi i marrë përsipër.

6. Ortaku i kufizuar nuk është i detyruar t'i kthejë fitimet, të cilat i ka marrë në mirëbesim, në bazë të pasqyrave financiare, të përgatitura në mirëbesim.

Neni 63

Regjistrimi i ndryshimeve të kontributit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

Ortakët duhet t'i njoftojnë për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të gjitha rritjet ose zvogëlimet e kontributit të një ortakut të kufizuar, sipas pikës 1 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 64

Përgjegjësia nga perceptimi i cilësive ligjore

1. Ortaku i kufizuar përgjigjet si ortak i pakufizuar, nëse emri i tij është përfshirë, me pëlqimin e tij, në emrin e regjistruar të shoqërisë.

2. Ortaku i kufizuar, që ka lidhur me një palë të tretë një marrëveshje në cilësinë e agjentit të autorizuar të shoqërisë, por pa u cilësuar si i tillë, përgjigjet për këtë veprim si të ishte ortak i pakufizuar, me përjashtim të rastit kur provon se i treti kishte dijeni për faktin se ortakut vepronte si agjent i autorizuar apo në bazë të rrethanave të qarta nuk kishte si të mos ishte në dijeni.

3. Ortaku i kufizuar përgjigjet për detyrimet e shoqërisë si të ishte ortak i pakufizuar, nëse ai vepron në kundërshtim me parashikimin e fjalisë së dytë të pikës 1 të nenit 59 të këtij ligji.

Neni 65

Përgjegjësia përpara regjistrimit

Kur themeluesit e shoqërisë komandite marrin përsipër detyrime për veprimtarinë tregtare të shoqërisë, përpara se shoqëria të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ortakut i kufizuar, që pranon të marrë përsipër këto detyrime, përgjigjet si të ishte ortak i pakufizuar, me përjashtim të rastit kur provon se pala e tretë kishte dijeni për kufizimet e përgjegjësive të tij, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk kishte si të mos ishte në dijeni.

Neni 66

Përgjegjësia e një ortakut të ri të kufizuar

Ortakut i kufizuar, i cili fiton këtë cilësi në një shoqëri komandite ekzistuese, përgjigjet sipas dispozitave të nenit 62 të këtij ligji, për detyrimet e shoqërisë, që kanë lindur përpara fitimit të kësaj cilësie.

Neni 67

Largimi i ortakëve

1. Shoqëria komandite nuk prishet për shkak të vdekjes apo të prishjes së një ose më shumë prej ortakëve të kufizuar.

2. Nëse të gjithë ortakët e pakufizuar largohen nga shoqëria, atëherë shoqëria kolektive prishet dhe likuidohet sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Nëse largohen të gjithë ortakët e kufizuar, atëherë veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite mund të vazhdojë të ushtrohet në formën e një shoqërie kolektive apo, nëse mbetet vetëm një ortak i pakufizuar, veprimtaria mund të ushtrohet me statusin e tregtarit.

4. Ndryshimet e përmendura në pikat 1 e 3 të këtij neni duhet t'i njoftohen për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

5. Prishja e shoqërisë komandite në gjendjen e aftësisë pagueuse ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit, sipas neneve 190 deri 205 të këtij ligji.

PJESA IV SHOQËRITË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 68 **Përkufizimi**

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

2. Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

3. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë.

4. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve mund të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

5. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve.

6. Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

Neni 69 **Regjistrimi**

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar regjistrohet sipas neneve 26, 28, 32 e 35 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2. Nëse shoqëria tregtare ka krijuar një faqe të saj në internet, të dhënat që i njoftohen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

Neni 70 **Kapitali minimal**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë.

Neni 71 **Shoqëria me ortak të vetëm**

1. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë

detyrim, atëherë ai përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër.

2. Nga çasti i regjistrimit të ndryshimit, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqëria tregtare vijon si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm.

TITULLI II KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

Neni 72 **Zotërimi i kuotave**

1. Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

2. Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

3. Personat që zotërojnë një kuotë të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo kuotë. Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo.

4. Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

5. Shoqëria tregtare mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

6. Nëse personat që zotërojnë një kuotë nuk arrijnë një marrëveshje, sipas pikës 3 të këtij neni, atëherë zbatohen dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë.

Neni 73 **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Neni 74 **Pasojat e kalimit të kuotave**

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Neni 75

Pjesëtimi i kuotave dhe transferimi i tyre

1. Me përjashtim të rasteve kur kjo është e ndaluar nga statuti, kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

2. Dispozitat e nenit 73 të këtij ligji për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.

TITULLI III

MARRËDHËNIET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

Neni 76

Shpërndarja e fitimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Neni 77

Kufizimet e shpërndarjeve, certifikata e aftësisë paguese

1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

3. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Neni 78

Përgjegjësia personale për shpërndarjet e ndaluara

1. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 77 të këtij ligji, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

2. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, sipas pikës 1 të nenit 77 të këtij ligji, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

Neni 79

Rikthimi i shpërndarjeve të ndaluara

1. Paditë e shoqërisë, siç parashikohet në nenin 78 të këtij ligji, mund të ngrihen edhe sipas pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

2. Parashkrimi i padive, sipas pikës 1 të këtij neni, nis në datën kur është kryer shpërndarja e ndaluar.

Neni 80

Anulimi i kuotave nga shoqëria

1. Statuti mund të parashikojë të drejtën e shoqërisë për të anuluar një kuotë. Në këto raste statuti duhet të parashikojë shkaqet e procedurat për anulimin e likuidimin e kuotës.

2. Kuota mund të anulohet në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga statuti.

3. Të drejtat e detyrimit, që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhet me anulimin e saj.

TITULLI IV

ORGANET E SHOQËRISË

KREU I

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 81

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 82

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 83

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 84

Kërkesa nga ortakët e pakicës

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

Neni 85

Përfaqësimi në asamble

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 86

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 87

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statudit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 88
E drejta e votës

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 89
Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 90
Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 91

Hetimet e posaçme

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.

4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.

5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

6. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 92

Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.

2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, ose një vlerë më të vogël të parashikuar në statut, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

3. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

4. Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.

6. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në

pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

7. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të këtij ligji zbatohet edhe për këto padi.

Neni 93

Të drejtat e lidhura me kuotën

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 94

Ndalimi i kufizimeve

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.

2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të këtij ligji.

KREU II ADMINISTRATORËT

Neni 95

Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 96

Përfaqësimi

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.

2. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 97

Shpërblimi

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 98

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

- d) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

TITULLI V PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

KREU I PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 99

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Neni 100

Regjistrimi i shpërbërjes

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

KREU II
LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Neni 101

Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijëni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Neni 102

Përrjashtimi i ortakut

1. Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përrjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përrjashtim.

2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përrjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;

b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;

c) përrfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose

ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

3. Gjatë procedurës së përrjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohe të përrjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përrjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përrjashtimin.

5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përrjashtim nuk është e bazuar.

6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përrjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Neni 103

Pasojat e largimit dhe përrjashtimit

1. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhën në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përrjashtimin.

2. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

Neni 104

Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

PJESA V

SHOQËRITË AKSIONARE

TITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE THEMELIMI

Neni 105

Përkufizimi dhe llojet

1. Shoqëria aksionare është një shoqëri tregtare, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit. Themeluesit janë persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë e që mbulojnë humbjet e saj vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara.

2. Shoqëritë aksionare mund të jenë shoqëri me ofertë, private apo publike, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

Neni 106

Regjistrimi

1. Shoqëritë aksionare regjistrohen sipas neneve 26, 28, 32 e 36 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2. Nëse shoqëria krijon një faqe të saj në internet, të dhënat, të cilat regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, publikohen në këtë faqe dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

Neni 107

Kapitali minimal

1. Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 2 000 000 lekë.

2. Shoqëria aksionare me ofertë publike nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 10 000 000 lekë.

Neni 108

Llojet e kontributeve

Kontributet e aksionarëve mund të jenë në para apo në natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme ose në të drejta të vlerësueshme në para). Kontributet e aksionarëve nuk mund të jenë në punë apo në shërbime.

Neni 109

Vlera nominale dhe emetimi i aksioneve

1. Çdo aksion ka të njëjtën vlerë nominale.
2. Aksionet nuk mund të emetohen përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Aksionet e emetuara më parë janë të pavlefshme. Themeluesit përgjigjen në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara ndaj zotëruesve të aksioneve, me emetim të parakohshëm.
3. Të drejtat e lidhura me aksionet nuk mund të transferohen përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 110

Vlera e aksioneve të emetuara

1. Vlera e përgjithshme nominale e aksioneve të emetuara nuk mund të jetë më e vogël se kapitali i regjistruar i shoqërisë. Rrjedhimisht, shoqëria nuk mund të emetojë e të ofrojë për nënshkrim aksione me çmim nën vlerën e tyre nominale.
2. Shoqëria mund të emetojë e të ofrojë për nënshkrim aksione me çmim më të lartë se vlera e tyre nominale.

Neni 111

Kostot e themelimit

1. Themeluesit mund t'i kërkojnë shoqërisë rimbursimin e kostove të themelimit, deri në vlerën më të lartë, të parashikuar në statut.
2. Kostot e themelimit u paguhen themeluesve nga fitimet, që realizon shoqëria. Përveç se kur parashikohet ndryshe në statut, aksionarët mund të vendosin që rimbursimi i kostove të themelimit të këtë përparësi gjatë shpërndarjes së fitimeve.

Neni 112

Kontributet në natyrë

1. Kur aksionarët japin kontribute në natyrë, këto kontribute duhet të vlerësohen përpara regjistrimit të shoqërisë nga një apo disa ekspertë të caktuar nga gjykata përkatëse. Këta ekspertë janë persona fizikë apo juridikë, të licencuar sipas dispozitave të posaçme, me kompetenca teknike të nevojshme për kryerjen e këtyre vlerësimeve.
2. Raporti i vlerësimit të ekspertëve duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur, sipas kësaj metode, i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primin më të lartë të emimit të aksionit.
3. Aktivitet, kuotat apo aksionet e një shoqërie ekzistuese mund të jepen si kontribut në një shoqëri aksionare, vetëm nëse shoqëria, që jep kontributin, ka të paktën 2 vite që është e regjistruar. Në këtë rast, së bashku me raportin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, paraqiten edhe pasqyrat financiare të dy viteve të fundit të shoqërisë në fjalë, si edhe dokumentet për vlerësimin e saj.
4. Raporti i vlerësimit, i përmendur në paragrafët e mësipërm të këtij neni e sipas rastit dhe dokumentet e tjera dorëzohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit së bashku me aplikimin për regjistrim.
5. Dispozitat e mësipërme zbatohen, gjithashtu, edhe kur shoqëria, brenda 2 vjetëve pas themelimit blen pasuri ose të drejta nga një prej themeluesve.

Neni 113

Shlyerja dhe kalimi i kontributeve përpara regjistrimit

1. Aksionet e nënshkuara me kontribut në para duhet të shlyhen përpara regjistrimit të shoqërisë, të paktën në një të katërtën e vlerës së tyre nominale. Shumat që mbeten shlyhen në një ose më shumë këste, sipas vendimit të organeve të administrimit të shoqërisë. Vlerat më të larta, sipas pikës 2 të nenit 110 të këtij ligji, duhet të shlyhen plotësisht.

2. Aksionet e nënshkuara me kontribut në natyrë duhet të kalohen tërësisht përpara regjistrimit.

3. Themeluesit, të cilët nuk shlyejnë apo kalojnë kontributet e tyre brenda afateve të përcaktuara më sipër, përgjigjen ndaj shoqërisë, në përputhje me përcaktimet e neneve 10 pikat 2 e 3 dhe 124 të këtij ligji.

Neni 114

Dispozitat e posaçme për shoqëritë me aksionar të vetëm

1. Nëse përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit themeluesi i vetëm nuk ka shlyer apo kaluar tërësisht kontributet e tij në para ose natyrë, atëherë ai duhet garantojë shlyerjen e kontributit, nëpërmjet një garancie bankare, me vlerë të njëjtë me kontributin e nënshkuar me afat vlefshmërie jo më shumë se njëvjeçar e t'ia paraqesë këtë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit së bashku me aplikimin për regjistrim. Nëse në përfundim të afatit njëvjeçar të garancisë bankare aksionari nuk i deklaron bankës shlyerjen tërësisht të kontributit të parashikuar në statut, shuma e garancisë bankare kalon automatikisht për llogari të shoqërisë për shlyerjen e kapitalit.

2. Kur numri i aksionarëve bie në një, aksionari i vetëm duhet t'i njoftojë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit zvogëlimin e numrit të aksionarëve, si dhe emrin e tij. Nëse aksionari i vetëm nuk e përmbush këtë detyrim, ai përgjigjet personalisht, në mënyrë të pakufizuar, për detyrimet që shoqëria ndërkohë ka marrë përsipër.

Neni 115

Procedura e themelimit

1. Shoqëritë aksionare, pas miratimit të statutit nga themeluesit, themelohen në përputhje me dispozitat e nenit 106 të këtij ligji. Në statut përcaktohen administratorët e parë dhe anëtarët e parë të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës. Detyra e këtyre personave përfundon në datën e mbledhjes së parë të asamblesë së përgjithshme.

2. Kontributet në para, sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, shlyhen në një llogari bankare, të përcaktuar sipas parashikimeve të statutit. Shoqëria, së bashku me aplikimin për regjistrim, depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dokumentin bankar, që vërteton shlyerjen e kontributit në para.

3. Përfaqësuesi i shoqërisë mund të tërheqë fondet e mbledhura nga kontributet në para vetëm pas regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

TITULLI II AKSIONET

Neni 116

Llojet dhe kategoritë e aksioneve

1. Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport

me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet me përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj apo në statut.

2. Shënimi në statut i përparësive, që rrjedhin nga zotërimi i këtyre aksioneve, prezumohet shterues.

3. Aksionet, që japin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me të drejtë vote dhe aksione pa të drejtë vote).

Neni 117

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve

1. Aksionet e një shoqërie aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të këtij ligji.

Neni 118

Akti i emetimit të aksioneve

1. Akti i emetimit të aksioneve hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Në rastin e ofertës private apo publike të aksioneve, akti i emetimit të aksioneve duhet të ndjekë, gjithashtu, procedurat e përcaktuara në ligjin për titujt.

3. Shoqëria lëshon certifikatën e aksionit me shpenzimet e aksionarit që e kërkon atë. Vendimi për lëshimin e certifikatës merret nga themeluesit apo nga asambleja.

Neni 119

Regjistrimi i aksioneve

1. Shoqëritë aksionare mbajnë një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.

2. Personat e regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni, prezumohen si aksionarë të shoqërisë me të drejta të plota si për marrëdhëniet me shoqërinë, ashtu dhe ndaj të tretëve.

3. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin on-line të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Dispozitat e seksioneve IV, VII e VIII të kreut III të pjesës së posaçme të Kodit Penal zbatohen për parregullsitë e emetimit të aksioneve, si dhe për parregullsitë e kryerjes së regjistrimeve e të mbajtjes së regjistrit të aksioneve.

5. Përcaktimet e pikave 1, 2 e 3 të këtij neni nuk cenojnë detyrimin e shoqërisë për njoftimin e listës së aksionarëve, në përputhje me pikën 4 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe detyrimin për të regjistruar aksionet, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

Neni 120

Kushtet për kalimin e aksioneve

Statuti mund të parashikojë që kalimi i aksioneve të kushtëzohet nga pëlqimi i organeve drejtuesve të shoqërisë dhe/ose nga e drejta e parablerjes, në favor të aksionarëve të tjerë.

Neni 121

Zotërimi i përbashkët i aksioneve

1. Një aksion i shoqërisë mund të zotërohet nga një apo më shumë persona. Personat që zotërojnë në mënyrë të përbashkët një aksion, në marrëdhënie me shoqërinë, ushtrojnë të drejtat e aksionarit, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët.

2. Personat që zotërojnë një aksion në mënyrë të përbashkët, përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet, që rrjedhin nga zotërimi i aksionit.

3. Personat që zotërojnë një aksion, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga ky aksion. Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo.

4. Veprimet e shoqërisë ndaj aksionit të zotëruar nga më shumë persona krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të tij, edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

5. Dispozitat e Kodit Civil mbi bashkëpronësinë janë të zbatueshme kur nuk parashikohet ndryshe në marrëveshjen e lidhur, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

Neni 122

Të drejtat e votës

1. Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

2. Aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote. Në këtë rast, aksionet me përparësi nuk mund të përfaqësojnë më shumë se 49 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

3. Ndalohet emetimi i aksioneve, të cilat i japin zotëruesit të tyre më shumë të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit, që aksioni përfaqëson.

TITULLI III

MARRËDHËNIET LIGJORE NDËRMJET SHOQËRISË DHE AKSIONARËVE

Neni 123

Detyrimi për të paguar kontributet

Aksionarët shlyejnë vlerën nominale të aksionit apo çmimin më të lartë të emetimit në llogarinë e shoqërisë dhe kalojnë kontributin në natyrë, në përputhje me specifikat e vetë kontributit apo me mënyrat e parashikuara në statut. Dispozitat e neneve 112 e 113 të këtij ligji zbatohen edhe për detyrimet e themeluesve.

Neni 124

Pasojat e vonesës së shlyerjes

1. Aksionari detyrohet t'i paguajë shoqërisë një kamatëvonesë prej 4 për qind në vit të shumës së pashlyer të kontributit në para, duke nisur nga data kur detyrimi bëhet i kërkueshëm, sipas këtij ligji apo sipas statutit. Shoqëria mund të kërkojë dëmshpërblim shtesë të shkaktuar nga

vonesa në shlyerjen e kontributit në para. Statuti mund të parashikojë pagesa të mëtejshme, nëse ky detyrim nuk përmbushet në afat.

2. Shoqëria mund të caktojë një afat 30-ditor për shlyerjen e kontributit për aksionarët, që nuk e kanë kryer pagesën brenda afateve të parashikuara, sipas këtij ligji apo sipas statutit. Nëse këta aksionarë nuk përmbushin detyrimin e shlyerjes së kontributit brenda këtij afati, atëherë ata humbasin të drejtën e pjesëmarrjes në asamblenë e përgjithshme dhe aksionet e zotëruara prej tyre nuk merren parasysh në llogaritjen e kuorumit. E drejta për të përfituar dividendë, si dhe çdo e drejtë tjetër e lidhur me aksionin pezullohet.

3. Nëse aksionari nuk shlyen kontributet në para, brenda 3 muajve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin për vlerën e kontributit të pashlyer e të anulojë aksionin, sipas nenit 186 të këtij ligji.

Neni 125

Ndalimi i faljes së detyrimit mbi kontributet

1. Shoqëria nuk mund t'i falë detyrimin për të shlyer kontributet në para apo kalimin e kontributeve në natyrë të nënshkruara nga aksionarët, si dhe detyrimet e tjera, që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimit për shlyerje apo kalim të kontributit.

2. Aksionarët nuk mund të kompensojnë të drejtat, që mund të kenë ndaj shoqërisë me detyrimin për shlyerjen apo kalimin e kontributit të nënshkruar, si dhe nuk mund t'i japin shoqërisë një kontribut të rënduar me barrë.

3. Shoqëria mund të çlirojë aksionarët nga detyrimi për të shlyer kontributet në para apo kalimi i kontributeve në natyrë vetëm nëpërmjet zvogëlimit të zakonshëm të kapitalit, në përputhje me nenet 181, 182, 183 e 184 të këtij ligji, në përpjesëtim me vlerën, me të cilën kapitali zvogëlohet. Çlirimi nga këto detyrime mund të kryhet edhe nëpërmjet anulimit të aksioneve, në përputhje me nenin 186 të këtij ligji.

Neni 126

Ndalimi i kthimit të kontributeve

Me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj, kontributet nuk mund t'u kthehen aksionarëve.

Neni 127

Rezerva ligjore dhe rezervat e tjera

1. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut.

2. Statuti mund të parashikojë krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore.

3. Shoqëria llogarit e ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni.

Neni 128

Deklarimi i dividendit

1. Dividendi është pjesa që i takon secilit aksionar nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

2. Fitimet vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara nga ligji nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

3. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon ndryshe, dividendi shpërndahet mes aksionarëve, në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë.

4. Në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme mund të vendosë që shoqëria të mos shpërndajë dividendë ose që fitimi vjetor të mos u paguhet aksionarëve, që zotërojnë aksione të kategorive të veçanta, por këto shuma të përdoren për qëllime të tjera. Të drejtat e aksionarëve, sipas parashikimeve të statutit, mund të ndryshohen vetëm nëpërmjet një vendimi të marrë me tre të katërtat e votave, sipas përcaktimit të nenit 145 të këtij ligji.

Neni 129

Rikthimi i pagesave të paligjshme

Aksionarët detyrohen t'i kthejnë shoqërisë të gjitha shumat e përfituara nga ajo në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Këtu përfshihet dividendi, nëse aksionari kishte dijeni apo nuk kishte si të mos ishte në dijeni që dividendi apo përparësitë e tjera ishin marrë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Padia për rikthimin e përfitimeve, sipas këtij neni, parashkruhet brenda 3 vjetëve nga data e kryerjes së pagesës së parregullt.

Neni 130

Shpërblimi për transaksionet ndërmjet shoqërisë dhe aksionarëve

Me përjashtim të veprimeve, që lidhen me kontributin në kapital, shpërblimi i përfituar nga aksionari, në bazë të një veprimi ekonomik të kryer me shoqërinë, nuk mund të jetë më i lartë se vlera normale, që ka tregu në atë çast për veprime ekonomike të ngjashme.

Neni 131

Mosshlyerja e kredisë

1. Kur aksionari i jep hua shoqërisë, duke zbatuar kushte më pak të favorshme nga kushtet normale të tregut dhe nëse shoqëria është në gjendjen e paaftësisë pagueuse, atëherë aksionari nuk ka të drejtë të kërkojë rikthimin e huasë, kur ky veprim do të kishte si pasojë reduktimin e kapitaleve të veta të shoqërisë, nën vlerën e kapitalit të saj minimal.

2. Nëse një i tretë i ka dhënë shoqërisë hua, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni dhe rikthimi i huasë është garantuar nga aksionari, atëherë i treti, në rastet kur shoqëria është në gjendjen e paaftësisë pagueuse, mund t'i kërkojë shoqërisë vetëm rikthimin e shumës, që nuk ka mundur ta ekzekutojë nga garancia e aksionarit.

3. Pikat 1 e 2 të këtij neni zbatohen edhe për veprimet e tjera të aksionarit apo palëve të treta, nëse, nga pikëpamja ekonomike, janë të ngjashme me marrëveshjet e huasë, të parashikuara në këto pika.

Neni 132

Përgjegjësia për kreditë e shlyera

1. Kur në rastet e përmendura në nenin 131 të këtij ligji, shoqëria, gjatë një periudhe 1-vjeçare përpara datës së hapjes së procedurave të falimentimit, i ka kthyer aksionarit huanë, atëherë aksionari, të cilit i është rikthyer huaja, apo i cili ka dhënë garanci duhet t'i rikthejë shoqërisë shumat e huasë, që janë paguar prej saj. Aksionari përgjigjet deri në vlerën e garancisë, në çastin kur huaja është kthyer. Aksionari nuk përgjigjet për këto shuma, kur kolaterali i dhënë si garanci, i kalohet shoqërisë për pagesën e huasë.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për veprimet e tjera të aksionarit apo të palëve të treta, nëse nga pikëpamja ekonomike janë të ngjashme me marrëveshjet e huasë, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 133

Ndalimi i nënshkrimit e blerjes së aksioneve

1. Shoqëria nuk mund të nënshkruajë aksionet e veta. Blerja e aksioneve të veta nga shoqëria lejohet vetëm në rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Një shoqëri e kontrolluar nuk mund të nënshkruajë ose të blejë aksionet e shoqërisë mëmë.

3. Nëse gjatë procedurës së themelimit apo të rritjes së kapitalit, një i tretë, në kundërshtim nga sa më sipër, ka nënshkruar ose ka blerë aksionet për llogari të një shoqërie, apo të një shoqërie të kontrolluar, sipas pikës 2 të këtij neni, atëherë ai vlerësohet se i ka nënshkruar apo blerë ato për llogari të tij.

4. Aksionet e fituara, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda një viti nga data e fitimit, duhet të shiten nga shoqëria ose të anulohen, sipas nenit 186 të këtij ligji dhe çregjistrohen nga regjistri i aksioneve.

5. Shoqëria nuk mund të ushtrojë, për aksionet e veta, të drejtat që sipas ligjit rrjedhin nga zotërimi i tyre.

TITULLI IV

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 134

Organet dhe publikimi

1. Organet e shoqërive aksionare janë:

a) asambleja e përgjithshme;

dhe, në varësi të dispozitave të statutit,

b) këshilli i administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimtarisë së shoqërisë (sistemi me një nivel);

c) këshilli mbikëqyrës dhe një apo më shumë administratorë, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre 2 organeve (sistemi me dy nivele).

Në këtë rast, sipas parashikimeve të statutit, administratorët mund të caktohen e shkarkohen nga asambleja e përgjithshme apo nga këshilli mbikëqyrës.

2. Shoqëritë aksionare, në raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore duhet të përshijnë një dokument shpjegues, ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e miradministrimit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë dhe praktikat, që ndiqen prej saj, në zbatim të dispozitave të këtij ligji. Deklarata e miradministrimit të shoqërisë duhet të përmbajë një profil të administratorëve dhe të anëtarëve të këshillave, si dhe të shpjegojë elementet e faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat, që i janë caktuar nga shoqëria. Kjo deklaratë vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

KREU I

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 135

Të drejtat dhe detyrimet

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, e në veçanti nga dispozitat e nenit 148 të këtij ligji, të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e

funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a) përcaktimin e politikave tregtare;

b) ndryshime të statutit;

c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës e, kur parashikohet në statut, emërimin dhe revokimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” e “ç” të kësaj pike;

dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;

gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;

h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

4. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;

c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;

ç) vendimet për investime;

d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 136

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe, në rastet e parashikuara nga ky ligj, nga anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

4. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Pika 4 e nenit 13 të këtij ligji zbatohet në rastin kur

veprimet sipas kësaj pike do të kryhen me personat e përmendur në pikat 2 dhe 3 të nenit 13 të këtij ligji.

5. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.

7. Dispozita e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohet nëse blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, kryhen në bursë apo janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarinë e organeve administrative.

Neni 137

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:

a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;

b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:

i) të drejtat e aksionarëve, sipas nenit 139 të këtij ligji;

ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;

iii) procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;

c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 138 të këtij ligji;

ç) adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

3. 21 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, përfshirë këtu ditën e mbledhjes, shoqëria duhet t'u vërë në dispozicion aksionarëve në faqen e saj në internet, të paktën informacionin vijues:

a) informacionin sipas pikave 1 e 2 të këtij neni;

b) numrin total të aksioneve dhe të drejtave të votës që u përkasin këtyre aksioneve në datën e njoftimit të thirrjes së mbledhjes, përfshirë shumat totale për çdo kategori aksionesh, kur kapitali i shoqërisë ndahet në dy apo më shumë kategori aksionesh;

c) çdo dokument që do t'i vihet në dispozicion asamblesë së përgjithshme.

4. Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë se përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.

Neni 138

Rendi i ditës

1. Rendi i ditës, që njoftohet sipas nenit 137 të këtij ligji, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.

2. Nëse asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

3. Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të këtij neni dhe të nenit 137 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 139

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme dhe rendi i ditës, i kërkuar nga aksionarët e pakicës

1. Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të këtij ligji.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

Neni 140

Përfaqësimi në asamble

1. Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

Neni 141

Pjesëmarrja në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme

1. Statuti apo asambleja e përgjithshme mund të përcaktojë rregulla për procedurat e mbajtjes dhe pjesëmarrjen në asamble. Këto rregulla miratohen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e tre të katërtave të kapitalit, të përfaqësuar në mbledhje, sipas nenit 145 të këtij ligji.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut apo në rregullat e miratuara më sipër, asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.

3. Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre.

4. Aksionarët, nëpërmjet një marrëveshjeje unanime me shkrim, mund të vendosin që çdo vendim, që ata kanë të drejtë të marrin sipas këtij ligji apo statutit të shoqërisë, të merret në mënyrë unanime.

Neni 142

Pjesëmarrja me mjete komunikimi elektronike

1. Statuti mund të parashikojë për aksionarët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

2. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;

b) komunikimin e ndërsjellë, i cili u mundëson ortakëve të shprehen në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme në kohë reale, nga një vendndodhje tjetër;

c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

3. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar aksionarëve marrjen pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kusht që të merren masat teknike, të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 143

Procesverbalet e mbledhjeve të asamblesë

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.

2. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të aksionarëve, që janë shprehur kundër.

3. Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

5. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, administratorët janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 144

Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në

votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbliidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbliidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 145 **Marrja e vendimeve**

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 144 të këtij ligji, në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 135 të këtij ligji, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj, në statut apo në vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

Neni 146 **Mënyra e votimit**

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ky ligj ose nga statuti, asambleja e përgjithshme merr vendimet, nëpërmjet votimit të hapur.

2. Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit ose, sipas rastit, të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Neni 147 **E drejta e votës**

Në përputhje me dispozitat e pikës 1 të nenit 122 të këtij ligji, çdo aksion mbart të drejtën e një vote.

Neni 148 **Përjashtimi nga votimi**

1. Aksionari nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës, nëse asambleja e përgjithshme duhet të marrë vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Në rastet kur aksionari përfaqësohet me autorizim, ky ndalim zbatohet edhe për personin e autorizuar.

Neni 149

Aksionet me përparësi, pa të drejtë vote

1. Aksionet me përparësi, pa të drejtë vote, gëzojnë të gjitha të drejtat e tjera, që rrjedhin prej zotërimit të tyre, sipas këtij ligji.

2. Efektet e vendimit të asamblesë së përgjithshme për anulimin, kufizimin ose cenimin e të drejtave të përparësisë së këtyre aksioneve kushtëzohen nga pëlqimi i aksionarëve, që i zotërojnë ato.

3. Miratimi, sipas pikës 2 të këtij neni, merret gjatë një mbledhjeje të posaçme, vlefshmëria e së cilës kushtëzohet nga prania e aksionarëve, të cilët zotërojnë më shumë se 1/2 e pjesës së kapitalit të shoqërisë, që përfaqësohet nga aksione me përparësi. Vendimi i posaçëm për këto çështje merret me miratimin e 3/4 të aksionarëve, që zotërojnë aksionet me përparësi, të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje. Statuti nuk mund të ndryshojë këtë shumicë, apo të caktojë kushte ose procedura të tjera, të detyrueshme për t'u ndjekur për këtë çështje.

4. Nëse përparësia anulohet, atëherë këto aksione rifitojnë të drejtën e votës.

Neni 150

Hetimet e posaçme

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të nisë një hetim të posaçëm për parregullsitë në veprimet e themelimit të shoqërisë dhe të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

2. Aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Aksionarët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e aksionarëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm, aksionarët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e ekspertit, kur ekzistojnë dyshime të bazuara se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur.

4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.

5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

6. Kreditorët që, në keqbesim, paraqesin kërkesa, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjen në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 151

Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve të administratorëve e, sipas rastit, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës, kur këto vlerësohen si shkelje të rënda të ligjit ose të statutit.

2. Aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë apo një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët

pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Aksionarët apo kreditorët e shoqërisë, të përcaktuar me sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës përkatëse për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e aksionarëve apo e kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

3. Në varësi të organit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, vendimi i të cilit paditet për shfuqizim, asambleja e përgjithshme merr pjesë në gjykim me anë të administratorëve, me anë të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës. Shoqëria mund të marrë pjesë në gjykim edhe nëpërmjet një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

4. Aksionarët e pakicës ose kreditorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, që nuk bën pjesë në organet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, kur ekzistojnë dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të ankimuar, nëse organi, që ka nxjerrë aktin e paditur, nuk merret vesh me pajtim me personin, që përfaqëson shoqërinë, sipas pikave 3 ose 4 të këtij neni, për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të këtij ligji.

6. Aksionarët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen e padisë ndaj administratorëve apo anëtarëve të këshillave, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si pasojë e vendimit të paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera, që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve ose anëtarëve të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës.

7. Dispozita e pikës 6 të nenit 150 të këtij ligji zbatohet edhe për paditë e parashikuara në këtë nen.

Neni 152

Të drejtat e lidhura me aksionin

Aksionari, që pengohet të ushtrojë të drejtat, të cilat rrjedhin nga zotërimi i aksionit të shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo të kërkojë dëmshpërblim. Padia duhet ngritur brenda 3 vjetëve pas pengimit të ushtrimit të së drejtës.

Neni 153

Ndalimi i kufizimeve

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e aksionarëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të përmendura në nenet 150, 151 e 152 të këtij ligji, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve, të përcaktuara në këto nene.

2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e aksionarëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 150, 151 e 152 të këtij ligji.

KREU II
KËSHILLI I ADMINISTRIMIT. SISTEMI ME NJË NIVEL

Neni 154
Të drejtat dhe detyrimet

1. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
- a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
 - c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
 - ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
 - d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
 - ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
 - f) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;
 - g) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
 - gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
 - k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
 - i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, këshilli i administrimit duhet të thërrasë menjëherë asamblesë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Neni 155
Numri, emërimi dhe përbërja e këshillit të administrimit

1. Këshilli i administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.
2. Anëtarët e këshillit të administrimit zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në pikën 2 të nenit 145 të këtij ligji, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të rizgjidhen.
3. Statuti mund të parashikojë që aksionarët, të cilët zotërojnë së bashku një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind ose një vlerë më të vogël të kapitalit të regjistruar, të kenë të drejtën të emërojnë një anëtar të këshillit të administrimit me një vendim të posaçëm.

Anëtarët e zgjedhur në këtë mënyrë nuk mund ta rrisin numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit mbi numrin maksimal prej 21 anëtarësh.

4. Anëtarë të pavarur të këshillit të administrimit vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.

Neni 156

Zgjedhshmëria e kufizuar

1. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve dhe punëmarrësve të shoqërisë tregtare, si edhe nga radhët e individëve të tjerë, jashtë shoqërisë.

2. Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i këshillit të administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është:

a) anëtar i këshillit të administrimit ose i këshillit mbikëqyrës në 2 shoqëri të tjera, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;

b) është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë;

c) është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të këshillit të administrimit një anëtar të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së parë.

3. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me pikën 2 të këtij neni, është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e palëve të treta mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.

4. Anëtarësimi në këshillin mbikëqyrës apo këshillin e administrimit të shoqërive të tjera të një grupi vlerësohet si anëtarësim vetëm në një bord.

5. Individët, që kandidojnë për t'u emëruar si anëtarë të këshillit të administrimit detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.

Neni 157

Shkarkimi

1. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Anëtar i këshillit të administrimit, i cili është zgjedhur në përputhje me pikën 3 të nenit 155 të këtij ligji, mund të shkarkohet me vendim të aksionarëve të pakicës, që e ka zgjedhur. Kur kushtet e parashikuara në statut për këtë emërim të veçantë nuk janë më në fuqi, asambleja e përgjithshme mund ta shkarkojë anëtarin në fjalë me shumicë të thjeshtë votash.

3. Këshilli i administrimit, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse të shkarkojë një anëtar, nëse ai ka shkëlur detyrat e parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të këtij ligji.

Neni 158

Administratorët

1. Këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin.

2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të

administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.

3. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;

b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;

d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;

dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;

e) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve.

5. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, administratorët duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit të administrimit.

6. Nëse shoqëria emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët. Statuti ose rregulloret, të miratuara nga këshilli i administrimit, mund të parashikojnë ndryshe.

7. Këshilli i administrimit mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 159 **Përfaqësimi**

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve mund t'u kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.

2. Administratorët, të cilët kanë të drejtë ta përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme dhe detyruese për shoqërinë.

3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 160 **Shpërblimi**

1. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë. Paga e administratorëve mund të shtohet me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga këshilli i administrimit dhe miratohet nga asambleja e përgjithshme.

2. Në përputhje me skemën e përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe me gjendjen financiare të shoqërisë, shpërblimet individuale përcaktohen nga këshilli i administrimit dhe duhet të

pasqyrojnë, në mënyrë përshtatshme, ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve, që mbajnë detyrën e administratorëve dhe anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë.

3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin, në masën e përshtatshme, të shpërblimeve, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Skema e shpërblimeve, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, shpërblimet individuale, që u jepen administratorëve e anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë, së bashku me një raport për efektin vjetor të këtyre skemave mbi pasurinë e shoqërisë, publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore, sipas shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji.

Neni 161

Rregulloret, kryetari dhe komitetet e posaçme

1. Statuti ose këshilli i administrimit mund të përcaktojë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e këshillit të administrimit për këto rregullore merren në mënyrë unanime.

2. Këshilli i administrimit duhet ta zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij, në përputhje me dispozitat e statutit. Nënkryetari ushtron tagrat e kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t'i kryer ato personalisht. Një administrator nuk mund të zgjidhet kryetar i këshillit të administrimit.

3. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit të administrimit regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

4. Këshilli i administrimit mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e vet, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë.

Neni 162

Marrja e vendimeve

1. Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

2. Vendimet e këshillit të administrimit mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo të rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje.

3. Përjashtimet nga e drejta e votës, sipas nenit 148 të këtij ligji, zbatohen edhe për anëtarët e këshillit të administrimit.

Neni 163

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa parashikohet në nenet 14, 15, 16, 17 e 18 të këtij ligji për detyrimin e besnikërisë, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat, që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve, sipas pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Administratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit kanë barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator dhe/ose anëtar i këshillit të administrimit, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë aksionarëve kontributet;

b) u paguajnë aksionarëve interesa apo dividendë;

c) nënshkruajnë, blejnë, pranojnë si garanci apo anulojnë aksionet e shoqërisë;

ç) emetojnë aksione përpara kalimit të kontributit në natyrë apo shlyerjes së vlerës nominale ose me çmim më të lartë;

d) shpërndajnë aktivet e shoqërisë;

dh) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të ishte parashikuar se shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese, për të shlyer detyrimet;

e) në rast të zmadhimit të kapitalit, emetojnë aksione përpara përmbushjes së kushteve apo kur kontributi nuk është kaluar sipas kërkesave të nenit 123 të këtij ligji;

ë) kryejnë pagesa në favor të anëtarëve të këshillit të administrimit apo administratorëve;

f) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 151 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga pikat 3 e 4 të këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo zbulimi i saj.

Neni 164

Përgjegjësia solidare e këshillit të administrimit dhe e administratorëve

Anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratorët përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së organizimit të shoqërisë, si ato vijuese, por pa u kufizuar në to, informacionin për sistemin e menaxhimit të riskut të shoqërisë, prospektet e veprimtarisë, planet e investimeve, burimet teknike, organizative dhe burimet, strukturat e praktikave të miradministrimit të shoqërisë. Pikat 3 e 5 të nenit 163 të këtij ligji zbatohen edhe për parashikimet e këtij neni.

Neni 165

Kërkesa për mbikëqyrje të veçantë

1. Aksionarët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit bazë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, apo kreditorët e shoqërisë, pretendimet e të cilëve ndaj saj janë të paktën sa 5 për qind e kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë këshillit të administrimit të kryejë mbikëqyrje të veçantë për çështje të posaçme, sidomos kur merret në shqyrtim ligjshmëria e veprimeve të administratorëve.

2. Nëse këshilli i administrimit nuk e përmbush kërkesën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve, aksionarët dhe kreditorët në fjalë mund të nisnin procedurën e parashikuar në nenin 150 të këtij ligji.

KREU III

ADMINISTRATORËT DHE KËSHILLI MBIKËQYRËS, SISTEMI ME DY NIVELE

Neni 166

Dispozita në zbatim

1. Në sistemin e administrimit me dy nivele, administratorët drejtojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa këshilli mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.

2. Në përputhje me rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, sipas pikës 1 të këtij neni, dispozitat e neneve 154 deri në 165 të këtij ligji gjejnë zbatim edhe për marrëdhëniet ndërmjet administratorëve dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, ku funksionet e këtij këshilli, në përputhje me nenin 167 të këtij ligji, u korrespondojnë funksioneve mbikëqyrëse të këshillit të administrimit.

Neni 167

Përbërja, të drejtat e detyrimet e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët

1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1, shkronjat "b" deri në "g" e "i" dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji.

2. Në bazë të parashikimeve të statutit, administratorët mund të emërohen dhe shkarkohen, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 158 të këtij ligji, nga asambleja e përgjithshme apo nga këshilli mbikëqyrës. Së bashku me funksionet e pikave 3, 4 e 5 të nenit 158 të këtij ligji, administratorët kanë të drejtë e duhet të kryejnë edhe funksionet e përcaktuara në shkronjat "a", "gj", "h" e "i" të pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji. Me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 13 dhe nga shkronja "e" e pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji, veprimet e administratorëve u nënshtrohen miratimit nga këshilli mbikëqyrës vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht në statut.

3. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të këshillit mbikëqyrës administratorët e shoqërisë administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.

4. Parashikimet e neneve 155 e 157 të këtij ligji zbatohen edhe për numrin e anëtarëve, emërimin, përbërjen dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, me përjashtimet vijuese:

a) anëtarët e këshillit nuk duhet të kryejnë funksione administrimi dhe shumica e tyre duhet të jenë të pavarur;

b) statuti mund të parashikojë që disa prej tyre mund të zgjidhen dhe/ose shkarkohen nga punëmarrësit e shoqërisë.

5. Nenet 160, 161 dhe 162 të këtij ligji zbatohen edhe për shpërblimin, organizimin e brendshëm dhe marrjen e vendimeve nga këshilli mbikëqyrës.

6. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe standardit të kujdesit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 163 të këtij ligji. Për shkeljet e kryera nga administratorët, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 163 të këtij ligji, anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë përgjegjës, kur nuk njoftojnë asamblenë e përgjithshme, edhe pse kanë dijeni për këto shkelje, apo kur nuk i kanë zbuluar ngaqë funksioni i mbikëqyrjes, sipas kërkesave të këtij ligji, nuk është kryer në mënyrë korrekte e sipas standardeve të kërkuara.

TITULLI V ZMADHIMI I KAPITALIT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 168

Kushtet për të gjitha format e zmadhimit të kapitalit

1. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 176 të këtij ligji, zmadhimi i kapitalit kryhet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me pikën 1 të nenit 145 të këtij ligji.

2. Kur zmadhimi i kapitalit ndryshon të drejtat, që rrjedhin nga zotërimi i një kategorie aksionesh, vlefshmëria e vendimit të asamblesë së përgjithshme i nënshtrohet pëlqimit të aksionarëve të prekur, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

3. Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.

4. Dispozitat e këtij ligji për nënshkrimin, shlyerjen e kalimin e kontributeve për aksionet, e, në veçanti, nenet 107 deri në 114 dhe 123 deri në 133 zbatohen edhe për rastin e zmadhimit të kapitalit.

Neni 169

Regjistrimi dhe publikimi i rritjes së kapitalit

1. Administratorët detyrohen të njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare.

2. Aplikimi për regjistrimin e vendimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni shoqërohet me raportin e ekspertit të autorizuar, ku verifikohet vlera e kontributeve në natyrë, sipas nenit 113 të këtij ligji.

3. Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit, administratorët i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit realizimin e këtij veprimi. Informacioni shoqërues duhet të përfshijë listën e personave, që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumat e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga administratorët.

4. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 170

Ndalimi i emetimit të aksioneve

Përpara se zmadhimi i kapitalit të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, aksionet e reja nuk mund të emetohen dhe të drejtat e lidhura me to nuk mund të transferohen. Aksionet e emetuara në kundërshtim me këtë dispozitë janë të pavlefshme. Personat, që kryejnë

shkeljen, përgjigjen ndaj nënshkruesve në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga një emetim i pavlefshëm.

Neni 171

Fillimi i pjesëmarrjes në ndarjen e fitimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin e emetimit, aksionet e reja marrin pjesë në fitimet e të gjithë vitit financiar, në të cilin është marrë vendimi për këtë zmadhim.

2. Vendimi për zmadhimin e kapitalit mund të parashikojë, që aksionet e reja të marrin pjesë nga fitimet e vitit financiar, që i paraprin vitit, në të cilin është marrë vendimi për këtë zmadhim.

Neni 172

Zmadhimi i kapitalit dhe shoqëria me aksionar të vetëm

Shoqëria me aksionar të vetëm mund t'ua ofrojë aksionet e reja personave të tretë e të kthehet në një shoqëri me shumë aksionarë. Ky ndryshim i njoftohet për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

ZMADHIMI I KAPITALIT ME EMETIM TË AKSIONEVE TË REJA

Neni 173

Kushtet

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.

Neni 174

E drejta e parablerjes

1. Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për aksionet e emetuara rishtazi, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar, që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet jo më vonë se 20 ditë pas publikimit të parashikuar në nenin 169 të këtij ligji.

2. Të drejtat e përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të kufizohen ose të përjashtohen nga vendimi i asamblesë së përgjithshme për zmadhimin e kapitalit. Administratorët duhet t'i paraqesin asamblesë së përgjithshme një raport, ku të jepen arsyet për kufizimin ose përjashtimin e këtyre të drejtave dhe ku të justifikohet çmimi i emetimit të propozuar. Ky vendim mund të merret vetëm nëse kufizimi ose përjashtimi i të drejtave është publikuar më parë në hapësirën në internet të shoqërisë dhe njoftuar për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

KREU III

ZMADHIMI I KUFIZUAR I KAPITALIT

Neni 175

Kushtet për zmadhimin e kufizuar të kapitalit

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.

2. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.

KREU IV
ZMADHIMI I AUTORIZUAR

Neni 176

Kushtet për zmadhimin e autorizuar të kapitalit

1. Statuti ose një vendim i asamblesë së përgjithshme për ndryshime në statut mund t'u japë administratorëve të drejtën për të kryer, brenda një afati 5-vjeçar nga regjistrimi i shoqërisë, zmadhim të kapitalit me emetim të aksioneve të reja, për një vlerë maksimale të përcaktuar (kapital i autorizuar). Vlera e zmadhimeve të autorizuar nuk mund të jetë më e madhe se gjysma e kapitalit të regjistruar të shoqërisë në datën në të cilën merret vendimi për zmadhimin e autorizuar.

2. Në statut mund të parashikohen kushte të tjera e, në veçanti, kushti që nëse administratorët vënë në zbatim autorizimin e zmadhimit, të gjitha ose disa nga aksionet e emetuara mund ose duhet t'u jepen punëmarrësve të shoqërisë apo punëmarrësve të shoqërive të tjera, pjesë të një grupi.

KREU V
ZMADHIMI I KAPITALIT ME AKTIVE TË SHOQËRISË

Neni 177

Kushtet

1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

2. Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar ose përtej një vlere më të lartë të rezervës së përcaktuar në statut, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.

3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

Neni 178

Regjistrimi dhe publikimi i zmadhimit të kapitalit me aktivet e shoqërisë

1. Regjistrimi i vendimit për zmadhimin e kapitalit, sipas nenit 177 të këtij ligji, duhet të shoqërohet nga bilanci, në bazë të të cilit është zmadhuar kapitali, nga konfirmimi i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyra e fundit e të ardhurave dhe e shpenzimeve. Aplikimi duhet të përfshijë edhe një deklaratë të administratorëve, sipas së cilës vërtetohet se gjendja e aktiveve të shoqërisë është e tillë që, nëse vendimi për zmadhim do të ishte marrë në datën e aplikimit për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, zmadhimi do të ishte ende i mundur.

2. Njoftimi për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit duhet të përcaktojë se zmadhimi i kapitalit është kryer me kalimin e rezervave të shoqërisë ose me fitimin e pashpërndarë.

Neni 179

Shpërndarja proporcionale e aksioneve të emetuara rishtazi

Aksionarët kanë të drejtë të zotërojnë aksionet e emetuara rishtazi në përpjesëtim me aksionet e tyre, përpara rritjes së kapitalit. Çdo vendim i asamblesë së përgjithshme, që bie ndesh me këtë dispozitë, është i pavlefshëm.

KREU VI
OBLIGACIONET E KONVERTUESHME DHE ATO
ME PJESËMARRJE NË FITIM

Neni 180

Obligacionet e konvertueshme dhe ato me pjesëmarrje në fitim

1. Asambleja e përgjithshme mund të emetojë obligacione, që u garantojnë zotëruesve të tyre të drejtën për t'i konvertuar në aksione apo të drejtën e parablerjes së aksioneve, të cilat quhen obligacione të konvertueshme, si dhe obligacionet, që u japin zotëruesve të drejtën e marrjes pjesë në fitim, të cilat quhen obligacione me pjesëmarrje në fitim.

2. Asambleja e përgjithshme mund të autorizojë këshillin e administrimit (në sistemin me një nivel) apo administratorët (në sistemin me dy nivele), që brenda një periudhe prej 5 vitesh dhe sipas kushteve përkatëse, të emetojnë obligacionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni. Organi administrativ përkatës i njofton Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, për regjistrim dhe publikim, vendimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Obligacionet me pjesëmarrje në fitim mund të ofrojnë përparësi në shpërndarjen e fitimeve, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 116 të këtij ligji, për aksionet me përparësi.

4. Aksionarët gëzojnë për obligacionet e konvertueshme dhe ato me pjesëmarrje në fitim të njëjtat të drejta, që ky ligj u njeht atyre për parablerjen në rastin e emetimit të aksioneve të reja.

TITULLI VI
ZVOGËLIMI I KAPITALIT

KREU I
ZVOGËLIMI I ZAKONSHËM I KAPITALIT

Neni 181

Kushtet

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të këtij ligji.

2. Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

3. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve.

4. Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në nenin 107 të këtij ligji, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

Neni 182

Regjistrimi dhe publikimi i vendimit

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Ky vendim duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 183

Mbrojtja e të drejtave të kreditorëve

1. Kreditorët, pretendimet e të cilëve janë ngritur përpara datës së publikimit të vendimit për zvogëlimin e kapitalit, kanë të drejtë të marrin garanci të mjaftueshme nga shoqëria për kreditë, që nuk ishin bërë të kërkueshme përpara datës së publikimit të vendimit. Kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm nëse kreditorët kërkojnë garancinë brenda 90 ditëve, pas datës së publikimit.

2. Përpara përfundimit të afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe përpara se kreditorët përkatës të jenë shlyer apo të kenë marrë garanci të mjaftueshme, shoqëria nuk mund të kryejë pagesa në favor të aksionarëve ose falje të detyrimeve për të shlyer kontributet, si pasojë e zvogëlimit të kapitalit.

Neni 184

Regjistrimi dhe publikimi i zvogëlimit të kapitalit

1. Administratorët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për zvogëlimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Kapitali quhet i zvogëluar, duke filluar nga çasti i regjistrimit të vendimit.

KREU II

ZVOGËLIMI I THJESHTËZUAR I KAPITALIT

Neni 185

Kushtet

1. Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve, si dhe transferimi i fondeve të rezervat kryhen nëpërmjet një procedure të thjeshtuar.

2. Nenet 181, 182 e 184 të këtij ligji janë të zbatueshme edhe për rastin e zvogëlimit të thjeshtuar të kapitalit.

KREU III

ZVOGËLIMI I KAPITALIT ME ANULIM AKSIONESH

Neni 186

Kushtet

1. Kapitali mund të zvogëlohet edhe nëpërmjet anulimit të aksioneve.

2. Anulimi i aksioneve lejohet vetëm:

a) kur ky veprim është i pranuar nga statuti apo nga një vendim, që ndryshon statutin, i cili është marrë përpara nënshkrimit të aksioneve, që do t'i nënshtrohen anulimit;

b) në përputhje me nenin 133 të këtij ligji;

c) nëse aksionarët, që i zotërojnë këto aksione, pranojnë anulimin.

Parashikimi i statutit nuk është i nevojshëm nëse aksionarët përkatës japin pëlqimin.

3. Anulimi i aksioneve duhet të përmbushë kërkesat e zvogëlimit të zakonshëm të kapitalit. Në këtë rast, vendimi i asamblesë zëvendësohet me vendimin e administratorëve.

4. Pagesa e vlerës së aksioneve të anuluar, në favor të aksionarëve, kryhet në përputhje me dispozitat e nenit 183 të këtij ligji.

5. Dispozitat për zvogëlimin e zakonshëm të kapitalit nuk janë të zbatueshme, nëse aksionet, kontributet e të cilave janë shlyer tërësisht, i kalohen shoqërisë pa kundërshtim.

6. Vendimi i zvogëlimit të kapitalit i njoftohet për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Kapitali zvogëlohet, duke filluar nga çasti i regjistrimit të vendimit.

TITULLI VII PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 187

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

1. Shoqëria aksionare priset:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - d) me vendim gjykate;
 - dh) për arsye të tjera të parashikuara në statut.
2. Zotërimi i të gjitha aksioneve në një dorë të vetme nuk ka si pasojë prishjen e shoqërisë. Në këtë rast janë të zbatueshme dispozitat e pikës 2 të nenit 114 të këtij ligji.

Neni 188

Regjistrimi i prishjes së shoqërisë

1. Administratorët janë të detyruar të regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
2. Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata regjistron vendimin e prishjes ex officio.

Neni 189

Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë aksionare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

PJESA VI LIKUIDIMI NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE

TITULLI I LIKUIDIMI I ZAKONSHËM NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE

Neni 190

Dispozita të përgjithshme

1. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë titull, dispozitat e zbatueshme për shoqëritë, që nuk janë prishur, zbatohen edhe për shoqëritë në likuidim e sipër.
3. Nenet 191 deri në 203 të këtij ligji parashikojnë rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese për të gjitha llojet e shoqërive. Këto shoqëri likuidohen me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të këtij ligji.

Neni 191

Emërimi i likuiduesve

1. Në shoqëritë kolektive dhe komandite, likuidimi kryhet nga të gjithë ortakët apo nga një likuidues i emëruar në mënyrë unanime prej tyre. Në rastin kur një ortak ka më shumë se një trashëgimtar, trashëgimtarët emërojnë një përfaqësues të përbashkët. Nëse ortakët nuk i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit faktin se të gjithë ortakët do të jenë likuidues apo nuk emërojnë likuiduesin brenda 30 ditëve nga data e prishjes, atëherë çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

2. Në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare, likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Dispozitat e pikës 6 të nenit 91 të këtij ligji janë të zbatueshme edhe për këtë rast.

3. Çdo person i interesuar, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, në përputhje me pikën 1 të këtij neni apo të asamblesë, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Neni 192

Emërimi i likuiduesve nga gjykata

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate.

Neni 193

Shkarkimi i likuiduesve

1. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

2. Paditë, që lidhen me shpërblimin e likuiduesit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 194

Regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

1. Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi "në likuidim".

Neni 195

Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

Neni 196
Administrimi nga likuiduesit

1. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.
2. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata vepronë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.
3. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji.
4. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakëve të tjerë, asamblesë së përgjithshme, këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës.
5. Për likuiduesit nuk zbatohet neni 17 i këtij ligji.

Neni 197
Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të këtij ligji, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
4. Në shoqërinë kolektive e komandite, ortakët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, në përputhje me përgjegjësitë, që ky ligj i cakton secilit, për mbulimin e humbjeve. Nëse një ortak nuk shlyen pjesën e humbjeve që i takon, atëherë ortakët e tjerë detyrohen të paguajnë pjesën e tij në raport me pjesët që secili zotëronte në shoqëri. Ortakët, që kanë shlyer pjesën e ortakut mospërbushës, kanë ndaj tij të drejtën e regresit.

Neni 198
Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 199
Mbrojtja e kreditorëve

1. Likuiduesit nuk mund të shpërndajnë aktivet e mbetura përpara përfundimit të afatit 3-mujor nga publikimi i thirrjes së dytë, drejtuar kreditorëve, për të depozituar pretendimet e tyre.
2. Nëse një kreditor i shoqërisë, për të cilin likuiduesi është në dijeni, nuk kërkon të drejtat e veta, shumat përkatëse depozitohen pranë gjykatës, ndërsa mallrat depozitohen në një magazinë me shpenzimet e kreditorit. Rregullat e përgjithshme për kontratën e depozitës janë të zbatueshme.
3. Nëse një detyrim nuk mund të shlyhet menjëherë ose nëse është i debatueshëm, aktivet mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i është dhënë garanci e përshtatshme.

Neni 200

Raporti i likuiduesit, shpërblimi dhe shkarkimi

1. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, aktivet e mbetura u shpërndahen ortakëve ose aksionarëve.

2. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesit u paraqesin ortakëve të tjerë të shoqërisë kolektive e komandite apo asamblesë së përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit, për detyrimet e shlyera dhe për shpërblimin e tij.

3. Nëse ortakët e tjerë në shoqërinë kolektive e komandite apo asambleja e përgjithshme miratojnë raportin, likuiduesit lirohen nga detyra dhe përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport.

4. Nëse raporti nuk miratohet, likuiduesit mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për ta shkarkuar nga detyra, si pasojë e përmbushjes në mënyrën e duhur të detyrave.

5. Pas shkarkimit të likuiduesit nga gjykata, ai ka të drejtë të përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport.

Neni 201

Shpërndarja e aktiveve

1. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.

2. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Ortakët apo aksionarët nuk kanë të drejtën e dëmshpërblimit në rast shkatërrimi, dëmtimi apo uljeje të vlerës së pasurisë, nëse kjo nuk varet nga veprimi apo mosveprimi i shoqërisë ose i personave, që kanë vepruar në emër të saj.

Neni 202

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 203

Përgjegjësia e likuiduesit

1. Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

2. Likuiduesit përgjigjen ndaj kreditorëve për dëmet e shkaktuara gjatë procedurës së likuidimit, në përputhje me dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë e administratorëve. Nëse ka disa likuidues, ata përgjigjen në mënyrë solidare. Krahas likuiduesve, ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionarët përgjigjen ndaj kreditorëve të shoqërisë në mënyrë solidare deri në vlerën që u është shpërndarë. Kreditorët, të cilët nuk kanë depozituar pretendimet e tyre në afat, sipas nenit 194 të këtij ligji, apo kreditorët, për të cilët likuiduesi nuk ka qenë dhe nuk mund të kishte qenë në dijeni, nuk kanë të drejtë të ngrenë padi, sipas fjalisë së parë dhe të dytë të kësaj pike.

3. Paditë e përmendura në pikën 2 të këtij neni duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

TITULLI II LIKUIDIMI I THJESHTËZUAR

Neni 204

Kushtet dhe procedura

1. Shoqëria tregtare mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përsheptuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

2. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

3. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

4. Paditë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga data e çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Neni 205

Fshirja pas likuidimit të shkurtuar

Dispozitat e parashikuara në nenin 202 të këtij ligji zbatohen edhe në rastin e përfundimit të likuidimit të thjeshtëzuar.

PJESA VII GRUPIMI I SHOQËRIVE

Neni 206

Detyrimi për informim

Sa herë që një person fiton ose kalon aksione të një shoqërie aksionare e, si pasojë e këtij veprimi, numri përgjithshëm i votave të zotëruara në asamblenë e përgjithshme bëhet, përkatësisht, më i madh apo më i vogël se 3 për qind, 5 për qind, 10 për qind, 15 për qind, 20 për qind, 25 për qind, 30 për qind, 50 për qind ose 75 për qind, ky person, brenda 15 ditëve nga kryerja e veprimit, është i detyruar t’ia njoftojë këtë veprim me shkrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 207

Mëma dhe shoqëritë e kontrolluara

1. Vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, kur një shoqëri tregtare sillet e vepron rregullisht, sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër. Ky kontroll quhet grup kontrollues.

2. Kur një shoqëri, në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, atëherë kjo shoqëri vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, ndërsa shoqëria tjetër vlerësohet shoqëri e kontrolluar. Ky kontroll quhet grup influencues.

3. Të drejtat e mëmës mbi shoqërinë e kontrolluar, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, vlerësohen të tilla edhe në rastin kur këto të drejta ushtrohen nëpërmjet një shoqërie tjetër, të kontrolluar nga mëma apo nga një person i tretë, që vepron për llogari të kësaj shoqërie tjetër apo për llogari të vetë shoqërisë mëmë.

4. I treti prezumohet se vepron për llogari të shoqërisë mëmë, nëse ai përfshihet në përcaktimet e pikave 2 e 3 të nenit 13 të këtij ligji.

Neni 208

Pasojat e ekzistencës së grupit kontrollues

1. Nëse ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, sipas përkufizimit të pikës 1 të nenit 207 të këtij ligji, shoqëria mëmë detyrohet të mbulojë humbjet vjetore të shoqërisë së kontrolluar.

2. Ortakët apo aksionarët e shoqërisë së kontrolluar kanë të drejtë t'i kërkojnë në çdo çast mëmës t'u blejë kuotat, aksionet apo obligacionet e zotëruara prej tyre në shoqëri.

3. Kreditorët e shoqërisë së kontrolluar kanë të drejtë t'i kërkojnë në çdo çast mëmës t'i ofrojë garancitë e mjaftueshme për kreditë e tyre shoqërisë së kontrolluar.

4. Kreditorë të shoqërisë së kontrolluar vlerësohen personat, që kanë pësuar dëme nga veprimet e shoqërisë së kontrolluar, pavarësisht vendit të regjistrimit të kësaj të fundit.

Neni 209

Detyrimi i besnikërisë në grupin influencues

1. Nëse ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, sipas përcaktimit të pikës 2 të neni 207 të këtij ligji, përfaqësuesit e mëmës duhet të veprojnë, duke marrë parasysh:

a) çdo detyrim të shoqërisë mëmë, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 të këtij ligji, apo në rastin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, sipas nenit 98 të këtij ligji dhe në rastin e një shoqërie aksionare, sipas nenit 163 të këtij ligji;

b) pasojat dhe përfitimet që një vendimmarrje ka për grupin në tërësi;

c) interesin e shoqërisë së kontrolluar.

2. Përfaqësuesit e shoqërisë mëmë vlerësohen se kanë shkelur detyrimin e besnikërisë, nëse administratorët e pavarur, duke pasur parasysh sa më sipër, nuk do të kishin marrë atë vendim.

3. Përfaqësuesit e shoqërisë mëmë detyrohen të veprojnë në përputhje me dispozitat, që rregullojnë detyrimin e besnikërisë ndaj shoqërisë së kontrolluar, përfshirë detyrimin për të vepruar në interesin më të mirë të kësaj të fundit.

Neni 210

Përgjegjësia për dëmin

1. Kur përfaqësuesi i shoqërisë mëmë ka shkelur detyrimin e besnikërisë, sipas nenit 209 të këtij ligji, kjo shoqëri, në emër të së cilës përfaqësuesi ka vepruar, detyrohet të shpërblejë dëmin që ka shkaktuar në këtë rast.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, anëtarët e organeve administrative të mëmës janë përgjegjës, në mënyrë solidare, për dëmin e shkaktuar.

3. Anëtarët e organeve administrative të shoqërisë së kontrolluar, që shkelin detyrimin e besnikërisë, përgjigjen në mënyrë solidare, së bashku me personat e përcaktuar më sipër.

Neni 211

Padia për shpërblimin e dëmit

1. Nëse shoqëria e kontrolluar nuk ka nisur procedurat e nevojshme për shpërblimin e dëmit brenda 90 ditëve, pasi dëmi i përmendur në pikën 1 të nenit 209 është bërë i dukshëm, padia e shoqërisë së kontrolluar mund të ngrihet kur:

a) shoqëria e kontrolluar është shoqëri, kolektive apo komandite, nga secili ortak;

b) shoqëria e kontrolluar është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nga ortakët, që zotërojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme apo një vlerë më të vogël, të përcaktuar në statut, si dhe çdo kreditor i shoqërisë. Në këtë rast zbatohen dispozitat e pikës 6 të nenit 91 të këtij ligji;

c) shoqëria e kontrolluar është shoqëri aksionare, nga aksionarët që zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar ose një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut, dhe/ose kreditorët e saj, të cilët pretendojnë ndaj shoqërisë detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar.

2. Paditë si më sipër duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga data kur është vënë re dëmi.

3. Kreditorë të shoqërisë së kontrolluar vlerësohen edhe ata persona, që kanë pësuar dëme nga veprimet e shoqërisë së kontrolluar, pavarësisht vendit të regjistrimit të kësaj të fundit.

Neni 212

E drejta e shitjes

Nëse mëma zotëron 90 për qind ose më shumë të pjesëve, aksioneve apo kuotave të shoqërisë së kontrolluar, zotëruesit e pjesëve, aksioneve apo kuotave të mbetura kanë të drejtë t'i kërkojnë mëmës t'ua blejë këto me çmimin e tregut, brenda 6 muajve nga kërkesa.

PJESA VIII

SHOQËRIA SHTETËRORE

Neni 213

Dispozitat e zbatueshme

1. Shoqëria shtetërore është një shoqëri tregtare, e cila zhvillon veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, aksionet e së cilës zotërohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga pushteti qendror, pushteti vendor apo nga shoqëri, ku këto pushtete veprojnë si mëmë, sipas përkufizimit të nenit 207 të këtij ligji.

2. Themelimi, organizimi e funksionimi i shoqërisë shtetërore u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

PJESA IX

RIORGANIZIMI I SHOQËRIVE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR DHE I SHOQËRIVE ANONIME

Neni 214

Dispozita të përgjithshme

1. Dispozitat e kësaj pjese janë të zbatueshme vetëm për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

2. Një shoqëri mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

3. Shoqëritë mund të riorganizohen vetëm pasi kanë qenë të regjistruara për të paktën një vit.

4. Bashkimi i shoqërive kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës.

TITULLI I

BASHKIMI

Neni 215

Përkufizimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të

aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

KREU I BASHKIMI ME PËRTHITHJE

Neni 216

Marrëveshja dhe raporti i bashkimit

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, të cilat marrin pjesë në bashkim, hartojnë një projekt marrëveshje me shkrim, ku përcaktohen të paktën:

- a) emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive, që marrin pjesë në bashkim;
- b) pranimi i palëve për kalimin e pasurive të secilës shoqëri që përthithet, në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë përthithëse;
- c) raporti i këmbimit të aksioneve apo kuotave dhe çdo shumë e pagueshme në para;
- ç) kushtet e ndarjes së aksioneve apo kuotave në shoqërinë përthithëse;
- d) të drejtat, që rrjedhin nga aksionet e shoqërisë përthithëse;
- dh) të drejtat, që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta të shoqërive të përthithura apo çdo mase tjetër në favor të tyre;
- e) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ë) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.

2. Përfaqësuesit ligjorë të secilës prej shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta. Në raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.

3. Çdo shoqëri, që merr pjesë në bashkim, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për vendimin e përcaktuar në nenin 218 të këtij ligji, depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikon në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, projekt marrëveshjen dhe raportin e bashkimit, sipas pikës 2 të këtij neni, ndërsa pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundit.

4. Shoqëritë që përmbushin kërkesën e pikës 3 të nenit 214 të këtij ligji, por që kanë qenë të regjistruara për më pak se tre vjet, paraqesin dokumentacionin, sipas pikës 3 të këtij neni, vetëm për vitet që kanë qenë të regjistruara.

Neni 217

Raporti i ekspertëve

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, caktojnë ekspertë të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së bashkimit. Ekspertët mund të caktohen për secilën shoqëri ose në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, që marrin pjesë në bashkim. Ata caktohen nga gjykata përkatëse, nëse kjo kërkohet nga përfaqësuesit ligjorë.

2. Ekspertët hartojnë një raport me shkrim, ku duhet të deklarojnë, ndër të tjera, nëse, sipas mendimit të tyre, raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave është i drejtë dhe i arsyeshëm. Në deklaratë ekspertët duhet të shprehin, në veçanti:

a) për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;

b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metodë, për të arritur në vlerën e vendosur;

c) për vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur.

3. Ekspertët kanë të drejtë të marrin nga shoqëritë që bashkohen të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse, si dhe të kryejnë të gjitha hetimet e nevojshme.

4. Raporti i ekspertëve depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikohet në faqen e internetit, nëse ka, të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, të paktën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, në lidhje me vendimin e përcaktuar në nenin 218 të këtij ligji.

5. Përfshirja e ekspertëve, sipas pikave 1, 2, 3 e 4 të këtij neni, mund të përjashtohet nëse të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërive që bashkohen japin miratimin.

Neni 218

Miratimi i marrëveshjes së bashkimit

1. Projekt marrëveshja e bashkimit prodhon efekte vetëm pasi të jetë miratuar nga ortakët apo aksionarët e të gjitha shoqërive, që marrin pjesë në bashkim. Projekt marrëveshja e bashkimit miratohet, përkatësisht, në përputhje me shumicën e parashikuar në pikën 1 të nenit 87 dhe pikën 1 të nenit 145 të këtij ligji.

2. Kur nga projekt marrëveshja e bashkimit preken të drejtat e aksionarëve/ortakëve të veçantë apo të drejtat, që rrjedhin nga aksione të kategorive të veçanta, atëherë projekt marrëveshja i nënshtrohet, sipas rastit, miratimit të ortakëve apo aksionarëve të prekur, ose një votimi të veçantë, i cili merret me shumicën e tre të katërtave të votave të secilës kategori aksionesh të prekura.

3. Secili aksionar apo ortak i shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, ka të drejtë të shqyrtojë dokumentet, në bazë të të cilave kryhet bashkimi, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji. Aksionarët apo ortakët mund të kërkojnë informacione për bashkimin gjatë takimit të asamblesë së përgjithshme.

Neni 219

Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë përthithëse, që kryhet në kuadër të bashkimit, nuk u nënshtrohet parashikimeve që lidhen me:

a) ndalimin e zmadhimit derisa të kryhen pagesat e pashlyera për kuotat/aksionet e nënshkruara më parë;

b) kushtet për nënshkrimin e kuotave/aksioneve të reja;

c) të drejtat e parablerjes nga aksionarët/ortakët të aksioneve/kuotave të reja.

Neni 220

Regjistrimi, publikimi dhe pasojat

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, njoftojnë bashkimin për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me marrëveshjen e bashkimit, procesverbalin e asamblesë për miratimin e bashkimit, si dhe procesverbalin për miratimin e ortakëve/aksionarëve të veçantë. Sipas rastit, informacioni i lartpërmendur publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërive, nëse ka.

2. Nëse kapitali i regjistruar i shoqërisë përthithëse rritet, në kuadër të bashkimit, vlera e zmadhimit njoftohet së bashku me bashkimin.

3. Regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit:

a) ka pasojë kalimin te shoqëria përthithëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që përthithet. Ky transferim ka pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe te palët e treta;

b) bën që aksionarët apo ortakët e shoqërisë së përthithur të bëhen aksionarë apo ortakë të shoqërisë përthithëse;

c) bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pa kaluar në procesin e likuidimit.

Neni 221

Mbrojtja e kreditorëve

1. Nëse kreditorët e një shoqërie, që merr pjesë në një bashkim, brenda 6 muajve nga publikimi i projekt marrëveshjes së bashkimit, sipas nenit 220 të këtij ligji, paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve të tyre, shoqëria duhet t’u japë garanci të mjaftueshme për kreditë e tyre. Garanci e mjaftueshme për kreditorët vlerësohet deklarata me shkrim, e dhënë nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, ku pranohet se pasuritë e shoqërive do të administrohen në mënyrë të veçuar deri në përmbushjen e detyrimeve të të gjithë kreditorëve. Nëse kjo garanci nuk jepet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, kreditorët mund t’i kërkojnë gjykatës të urdhërojë lëshimin e garancive të mjaftueshme apo anulimin e vendimit të bashkimit.

2. Kreditorët e siguruar të procedurës së falimentit nuk kanë të drejtë të kërkojnë garancinë e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që bashkohen, përgjigjen në mënyrë solidare për të gjitha dëmet e shkaktuara kreditorëve, si pasojë e pasaktësisë së deklaratës së përmendur në fjalinë e dytë të pikës 1 të këtij neni.

Neni 222

Mbrojtja e zotëruesve të të drejtave të veçanta

Shoqëria përthithëse detyrohet t’u garantojë zotëruesve të obligacioneve të konvertueshme e të aksioneve me përparësi të njëjtat të drejta, që këta gëzonin në shoqërinë e përthithur.

Neni 223

Mbrojtja e të drejtave të ortakëve dhe aksionarëve

1. Kur aksionarët apo ortakët e shoqërive që bashkohen nuk kanë dhënë pëlqimin për bashkim, atëherë këta kanë të drejtë të kërkojnë nga shoqëria blerjen me vlerë tregu të aksioneve apo kuotave të zotëruara të tyre nga shoqëria që rezulton nga bashkimi, apo në rast mosmarrëveshjes, me çmimin e përcaktuar nga një ekspert vlerësues i pavarur, i emëruar nga gjykata me kërkesë të këtyre aksionarëve apo ortakëve. Në mënyrë alternative, aksionarët mund të kërkojnë që shoqëria përthithëse të këmbejë aksionet e tyre me përparësi pa të drejtë vote, me aksione me të drejtë vote. Janë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për kundërshtimet e palëve gjatë procesit të ekspertimit.

2. Të drejtat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni duhet të ushtrohen brenda 60 ditëve nga data e publikimit të bashkimit për shoqërinë përthithëse, sipas nenit 220 të këtij ligji.

Neni 224

Përgjegjësia e organeve të administrimit, të organeve mbikëqyrëse dhe ekspertëve

1. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës të shoqërisë përthithëse përgjigjen solidarisht, bashkë me shoqërinë përthithëse, për dëmet që ortakët, aksionarët dhe kreditorët e shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, kanë pësuar nga ky veprim, me përjashtim të rasteve kur ata provojnë se i kanë përmbushur rregullisht detyrimet ligjore, të lidhura me vlerësimin e pasurive të shoqërive dhe me procedurat e përsosjes së marrëveshjes së bashkimit.

2. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së përthithur, si dhe ekspertët e pavarur të licencuar, të angazhuar në vlerësimin e bashkimit, përgjigjen për të njëjtat shkaqe e me të njëjtat kushte, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Në të dyja rastet, paditë si më sipër duhen ngritur brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të bashkimit të shoqërisë përkatëse.

Neni 225

Bashkimi me përthithje në raste të veçanta

1. Kur të paktën 90 për qind e kapitalit të regjistruar të një shoqërie aksionare kontrollohet nga mëma, bashkimi me përthithje ndërmjet këtyre shoqërive mund të kryhet pa miratimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë mëmë, me përjashtim të rasteve kur aksionarët ose ortakët e shoqërisë mëmë, që zotërojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të saj, të regjistruar, apo të numrit të përgjithshëm të votave, kërkojnë thirrjen e asamblesë së përgjithshme për miratimin e bashkimit.

2. Kur mëma zotëron 100 për qind të aksioneve, shoqëria mëmë përthithëse nuk detyrohet të përmbushë kushtet e përcaktuara në nenet 216 pika 1 shkronjat “b”, “c” e “ç”, e 2 dhe 217 të këtij ligji. Gjithashtu, në këtë rast nuk zbatohen as dispozitat e nenit 224 të këtij ligji.

3. Dispozitat e neneve 206 deri në 212 të këtij ligji zbatohen edhe ndaj bashkimeve, sipas parashikimeve të këtij neni.

KREU II

BASHKIMI ME KRIJIMIN E NJË SHOQËRIE TË RE

Neni 226

Dispozitat e zbatueshme

1. Dispozitat e neneve 216 deri në 225 të këtij ligji zbatohen edhe në rastin e bashkimit me themelim të një shoqërie të re. Shoqëria e themeluar rishtazi vlerësohet si shoqëri përthithëse.

2. Shoqëria e krijuar rishtazi nga bashkimi u nënshtrohet dispozitave të këtij ligji për themelimin e shoqërisë.

TITULLI II

NDARJA

Neni 227

Përkufizimi, dispozitat e zbatueshme

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të asamblesë së përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të këtij ligji.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasoje:

a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

TITULLI III SHNDËRRIMI

Neni 228

Dispozita të përgjithshme

1. Një shoqëri tregtare mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit, si më poshtë:

a) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shndërrohet në shoqëri aksionare dhe anasjelltas;

b) një shoqëri aksionare e me ofertë private mund të shndërrohet në një shoqëri aksionare me ofertë publike dhe anasjelltas, nëse përmbushen kërkesat e këtij ligji të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe të ligjit për titujt.

2. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 229

Procedura

1. Administratorët e shoqërisë, që shndërrohet, hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohen bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar. Në raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe efektin, që do të ketë shndërrimi te punëmarrësit e shoqërisë.

2. Vendimi për shndërrimin e shoqërisë duhet të merret nga asambleja e përgjithshme, me një shumicë prej tre të katërtave. Nëse shndërrimi ka si pasojë ndryshimin e të drejtave dhe të detyrimeve të veçanta të aksionarëve apo ortakëve, atëherë vlefshmëria e vendimit për shndërrim i nënshtrohet miratimit të aksionarëve apo ortakëve të prekur. Pika 2 e nenit 218 të këtij ligji është e zbatueshme.

3. Administratorët thërrasin të gjithë aksionarët apo ortakët, që nuk ishin të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhjen e asamblesë, që ka vendosur shndërrimin, duke u kërkuar të deklarojnë me shkrim nëse e pranojnë apo jo shndërrimin e shoqërisë, sipas vendimit përkatës. Thirrja e aksionarëve apo ortakëve bëhet me shpallje, e cila publikohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, dy herë, me interval të ndërmjetëm prej jo më pak se 15 ditëve dhe jo më shumë se 30 ditësh. Aksionarët/ortakët e thirrur duhet të depozitojnë në selinë e shoqërisë deklaratën me shkrim brenda 60 ditëve nga publikimi i fundit i thirrjes.

4. Publikimi i shpalljes së përmendur në pikën 3 të këtij neni nuk është i detyrueshëm, kur në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme kanë qenë të pranishëm ose të përfaqësuar të gjithë aksionarët/ortakët apo kur mbledhja e asamblesë së përgjithshme u ishte njoftuar individualisht aksionarëve/ortakëve në mungesë. Në rastin e fundit, afati 60-ditor nis nga data e marrjes së njoftimit të mbledhjes. Miratimi i shndërrimit vlerësohet i dhënë nëse aksionarët/ortakët nuk e deklarojnë qëndrimin e tyre me shkrim brenda afatit të caktuar.

5. Për mbrojtjen e kreditorëve, zotëruesve të të drejtave të veçanta dhe titullarëve të interesave, të cilët e kundërshtojnë shndërrimin, zbatohen përkatësisht nenet 221, 222 e 223 të këtij ligji.

6. Për përgjegjësitë ligjore të përfaqësuesve ligjorë dhe të anëtarëve të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë në shndërrim për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre, gjatë kryerjes së shndërrimit, zbatohen, përkatësisht, dispozitat e nenit 224 të këtij ligji.

7. Shndërrimi njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me vendimin e shndërrimit, procesverbalin e asamblesë së përgjithshme për vendimin e shndërrimit, dokumentet e vendimit të aksionarëve të veçantë dhe të aksionarëve, të cilët nuk kanë qenë të

pranishëm në mbledhjen e asamblesë. Sipas rastit, informacioni i lartpërmendur vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

8. Regjistrimi i shndërrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që:

a) shoqëria që shndërrohet, të vazhdojë të ekzistojë në formën ligjore, të përcaktuar në vendimin e shndërrimit;

b) aksionarët/ortakët e shoqërisë që shndërrohet, të marrin pjesë në shoqëri, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, për formën e re të shoqërisë;

c) të drejtat e personave të tretë për aksionet e shoqërisë që transformohet, të vazhdojnë të zbatohen edhe për aksionet e shoqërisë së shndërruar.

PJESA X DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 230

Vijimi i funksionimit dhe detyrimi për përshtatje

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shoqëritë tregtare ekzistuese do të vazhdojnë funksionimin, sipas mënyrës dhe kushteve, që kanë qenë të vlefshme në çastin e regjistrimit të tyre.

2. Shoqëritë tregtare, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 3 vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi.

3. Shoqëritë tregtare, të cilat nuk përshtaten me dispozitat e këtij ligji, sipas pikës 2 të këtij neni, vlerësohen të prishura dhe çregjistrohen nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit pas përfundimit të procedurës së zbatueshme të likuidimit.

Neni 231

Zbatimi i këtij ligji dhe procedurat në vijim

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për procedurat e themelimit ose të ndryshimit të një themeluesi, aksionari apo ortaku të shoqërisë, për procedurat e zgjedhjes së organeve, të miratimit të rregulloreve apo statutit dhe për procedura të tjera organizative, të nisura në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 232

Shfuqizime

Ligjet nr.7632, datë 4.11.1992 “Për pjesën e përgjithshme të Kodit Tregtar”, nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 233

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ligj nr.9901, datë 14.4.2008 shpallur me dekretin nr.5694, datë 5.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, faqe 2631

LIGJ
Nr.9723, datë 3.5.2007

PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

(Ndryshuar me ligjin nr.9916, datë 12.5.2008)

I përditësuar

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, administrimin e regjistrit tregtar, përcakton subjektet që regjistrohen dhe procedurat e regjistrimit.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e tregtisë.
2. “Ministri” është ministri që mbulon çështjet e tregtisë.
3. “Regjistri” është regjistri tregtar.
4. “Regjistrim fillestar” është regjistrimi për herë të parë në regjistër.
5. “Regjistrim tjetër” është çdo ndryshim, shtesë apo fshirje të dhënash në regjistër.
6. “Regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe çregjistrimin e subjektit nga regjistri.
7. “Të dhëna” janë faktet, aktet dhe informacionet që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistër.
8. “Të dhënat e identifikimit për personin juridik” janë forma, emri, numri e vendi i regjistrimit dhe selia.
9. “Dokumentet shoqëruese” janë dokumente, të cilat provojnë të dhënat që regjistrohen.
10. “Aplikim” është kërkesa që i drejtohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për kryerjen e veprimeve në regjistër, sipas këtij ligji.
11. “Aplikant” është subjekti, të cilit i përkasin të dhënat që regjistrohen, njoftohen ose depozitohen në regjistër, apo personat e tjerë që, sipas këtij ligji, kanë të drejtë të kërkojnë kryerjen e veprimeve në regjistër.

KREU II
KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

Neni 3

Krijimi dhe statusi

1. Krijohet Qendra Kombëtare e Regjistrimit, që më poshtë do të quhet QKR.
2. QKR-ja është institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit që mbulon çështjet e tregtisë.
3. QKR-ja e ka selinë në Tiranë.
4. QKR-ja financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta.
5. QKR-ja ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për funksionet e veta, të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 4

Funksionet e QKR-së

QKR-ja ka këto funksione:

- a) mban regjistrin tregtar;
- b) kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- c) kryen regjistrimin e subjekteve, të përcaktuara në këtë ligj, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe inspektimit të marrëdhënieve të punës;
- ç) lëshon certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve, të depozituara sipas përcaktimit të këtij ligji;
- d) publikon të dhënat e regjistrit të mbajtur, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to;
- dh) pranon kërkesat për licenca, leje dhe autorizime administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ia dorëzon ato aplikantit pas miratimit nga organet përkatëse;
- e) informon dhe këshillon për procedurat e regjistrimit dhe të licencimit.

Neni 5

Organizimi

1. QKR-ja ushtron juridiksionin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është institucioni i vetëm që ofron shërbim ndaj publikut, në mënyrë të drejtpërdrejtë, në sportelet e saj, në qendër dhe në bashki e komunë.

2. Shërbimi i sportelit në bashki e komunë kryhet si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

Neni 5/1

Sportelet në dhomat e tregtisë dhe industrisë
(Shtuar me ligjin nr.9916, datë 12.5.2008, neni 1)

1. QKR-ja ofron shërbimin ndaj publikut edhe nëpërmjet sporteleve në Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe në dhomat e tregtisë dhe industrisë në qarqe, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Të gjitha shpenzimet për hapjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sporteleve mbulohen nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe dhomat e tregtisë dhe industrisë në qarqe.

Neni 6
Drejtimi i QKR-së

1. Veprimtaria e QKR-së drejtohet nga titullari.
2. Titullari është përgjegjës për administrimin teknik, organizativ, financiar e të burimeve njerëzore të QKR-së.
3. Titullari përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët.
4. Titullari i QKR-së ushtron udhëheqjen metodologjike dhe nxjerr urdhra e udhëzime të detyrueshme për nëpunësit e QKR-së, si dhe për nëpunësit e sporteve të shërbimit në bashki e komunë, për ushtrimin e funksionit të deleguar.

Neni 7
Numri i punonjësve dhe struktura

1. Numri i punonjësve të QKR-së miratohet nga Këshilli i Ministrave si zë më vete, në përputhje me ligjin për Buxhetin vjetor të Shtetit.
2. Struktura dhe organika e QKR-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8
Statusi i titullarit

1. Titullari i QKR-së emërohet nga ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Titullari i QKR-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të ketë arsim të lartë në shkencat juridike apo ekonomike dhe përvojë në fushën e këtij ligji.
3. Titullari i QKR-së lirohet nga detyra për shkaqet dhe sipas procedurave të parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
4. Titullari i QKR-së u nënshtrohet dispozitave që rregullojnë masat, procedurat disiplinore dhe vlerësimin e punës, sipas parashikimeve në legjislacionin e nëpunësit civil. Ministri është eprori direkt, në kuptimin e këtyre dispozitave.
5. Kundër vendimit të ministrit, për aktet e nxjerra në bazë të pikave 1 deri në 4 të këtij neni, ankimi bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 9
Nëpunësit dhe punonjësit

1. Për nëpunësit e QKR-së zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil, të cilat rregullojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin, rekrutimin, ngritjen në detyrë, vlerësimin e punëve, disiplinën dhe lirin nga detyra. Titullari i QKR-së është eprori direkt, në përputhje me këto dispozita.
2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të QKR-së, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, u nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.
3. Ankimi ndaj akteve të titullarit, të nxjerra në bazë të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 10
Nëpunësit e sporteve në bashki dhe komuna

1. Nëpunësit e sporteve të shërbimit në bashki e komuna janë nëpunës të njësive vendore përkatëse.

2. Titullari i QKR-së përcakton kriteret e posaçme profesionale, që duhet të plotësojnë këta nëpunës dhe siguron trajnimin profesional të tyre, për kryerjen e funksionit të deleguar, sipas këtij ligji.

3. Bashkia e komuna përkatëse cakton nëpunësin e sportelit pas miratimit paraprak të titullarit të QKR-së. Miratimi paraprak jepet jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e propozimeve nga njësitë e pushtetit vendor.

4. Titullari i QKR-së kërkon zëvendësimin e nëpunësit, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën sipas treguesve të cilësisë së QKR-së. Në këtë rast, bashkia e komuna përkatëse është e detyruar të zëvendësojë nëpunësin e sportelit menjëherë pas kërkesës së titullarit të QKR-së.

Neni 11

Pagat

1. Struktura, nivelet e pagave dhe të shpërblimit të QKR-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Niveli i pagave dhe i shpërblimit, si dhe numri i nëpunësve në sportelet e shërbimit në bashki e komuna përcaktohen nga këshillat përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Buxheti

1. Buxheti i QKR-së është zë më vete në Buxhetin e Shtetit.

2. Projektbuxheti vjetor dhe afatmesëm i QKR-së, pasi përgatitet nga titullari i saj, miratohet nga ministri.

3. Buxheti përbëhet nga të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e QKR-së, përfshirë fondet për shpenzime operative dhe kapitale për sportelet e shërbimit në bashki e komuna, si dhe të ardhurat që krijohen në këto sportele.

4. Fondet për shpenzime operative për çdo sportel në bashki e komunë janë fonde të kushtëzuara. Ato përcaktohen në buxhetin e QKR-së, bazuar në kriteret e drejta e objektive, në përputhje me vlerësimin paraprak të ngarkesës operative të çdo sporteli dhe të treguesve të cilësisë së shërbimit dhe i jepen bashkisë ose komunës përkatëse në formën e një shume totale.

5. Shpenzimet kapitale për pajisjet në sportelet e shërbimit në bashki e komuna kryhen nga QKR-ja.

6. Bashkia ose komuna, në përputhje me objektivin e vet, mund të parashikojë dhe të kryejë shpenzime operative ose kapitale shtesë për përmirësimin e shërbimeve në sportel.

Neni 13

Shërbimet e tarifat

1. QKR-ja realizon të ardhura nga kryerja e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj dhe nga ofrimi i shërbimeve të tjera, në mbështetje të këtyre funksioneve.

2. Ministri përcakton shërbimet e tjera, që ofrohen nga QKR-ja, tarifatat e të cilave miratohen me propozimin e tij nga Ministri i Financave.

3. Tarifa dhe vlera përkatëse për shërbimet, që lidhen me kryerjen e detyrave funksionale, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

4. Të gjitha tarifatat shpallen në çdo sportel shërbimi dhe në faqen e internetit të QKR-së.

Neni 14

Përdorimi i të ardhurave të veta

1. Të ardhurat e mbledhura nga tarifatat për kryerjen e funksioneve, sipas këtij ligji, përfshirë edhe ato të krijuara në sportelet e bashkive e komunave, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

2. Të ardhurat nga tarifat për shërbimet e tjera, të krijuara nga QKR-ja ose nga sportelet e shërbimit në bashki e komuna, derdhen vetëm në masën 10 për qind në Buxhetin e Shtetit, 90 për qind përdoret nga QKR-ja për përmirësimin e funksionimit e të shërbimit të QKR-së.

3. QKR-ja mban llogaritë në thesar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Auditi

Veprimtaria financiare e QKR-së auditohet nga strukturat e ministrisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Raportimi dhe përgjegjshmëria

1. Ministri miraton objektivat specifike të punës dhe treguesit e cilësisë së shërbimeve që kryen QKR-ja dhe mbikëqyr arritjen e tyre.

2. QKR-ja i raporton ministrit për menaxhimin administrativ, financiar dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve sa herë që i kërkohet, por jo më pak se një herë në vit.

Neni 17

Statuti i QKR-së

Në përputhje me parimet e këtij ligji, me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton statutin e QKR-së, që përfshin rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e saj, ndarjen dhe organizimin e punës, si dhe mënyrën e raportimit.

KREU III

REGJISTRI TREGTAR

SEKSIONI I

REGJISTRI TREGTAR DHE EFEKTET E REGJISTRIMIT DHE TË PUBLIKIMIT

Neni 18

Përcaktimi i regjistrit tregtar

1. Regjistri tregtar është një bazë të dhënash unike e subjekteve që, sipas legjislacionit shqiptar, kryejnë veprimtari ekonomike tregtare.

2. Regjistri tregtar mbahet në format elektronik. QKR-ja ruan dhe arkivon aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura nga aplikantët në format shkresor.

3. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave, të njoftuara dhe të depozituara në regjistër, kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar.

4. Pjesë përbërëse e regjistrit tregtar janë edhe dokumentet e depozituara në anekset e tij, sipas këtij ligji.

Neni 19

Të dhënat që regjistrohen

Regjistri duhet të përmbajë të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit tregtar, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj.

Neni 20

Mënyra e regjistrimit

1. Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKR-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.

2. Aplikimi për regjistrim mund të kryhet edhe në mënyrë elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik.

3. Ministri, me propozimin e titullarit të QKR-së, miraton formularët e aplikimit, përmbajtjen e rubrikave të tyre dhe listën e dokumenteve shoqëruese për çdo regjistrim, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 21

Efektet e regjistrimit dhe të publikimit

1. Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin tregtar, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur dhe mund t'u kundrejtohet të tretëve nga dita e publikimit, sipas nenit 61 të këtij ligji.

2. Në çdo rast, të tretëve nuk mund t'u kundrejtohen të dhënat e regjistruara dhe të publikuara në regjistrin tregtar, për transaksione të kryera me subjektin tregtar brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e publikimit, kur i treti provon se e kishte të pamundur të merrte dijeni, duke treguar të gjithë kujdesin e zakonshëm.

3. Subjekti nuk mund t'u kundrejtojë të tretëve të dhëna, që janë regjistruar dhe/ose publikuar në mënyrë të pasaktë në regjistrin tregtar. Gjithsesi, i treti mund t'i kundrejtojë subjektit tregtar të dhënat e regjistruara e të publikuara, edhe nëse këto të dhëna janë të pasakta, përveç rastit kur subjekti provon se i treti kishte dijeni për pasaktësinë e të dhënave të publikuara ose për të dhëna të tjera të papublikuara.

4. I treti mund t'i kundrejtojë subjektit tregtar të dhëna ende të papublikuara kur, pavarësisht mospublikimit, i treti kishte dijeni për këto të dhëna, me përjashtim të rastit kur, sipas ligjit, mospublikimi nuk sjell pasoja.

5. Regjistrimet e regjistrit tregtar vlerësohen gjithnjë të njohura dhe përbëjnë akt zyrtar për autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

SEKSIONI II

DETYRIMI PËR REGJISTRIM, RREGULLAT E EMËRIMIT, PERSONAT E AUTORIZUAR DHE FORMA E AKTEVE SHOQËRUESE

Neni 22

Detyrimi për regjistrim

1. Subjektet që detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtar janë:

- a) personat fizikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike tregtare;
- b) shoqëritë e thjeshta sipas dispozitave të Kodit Civil;
- c) shoqëritë tregtare;
- ç) degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja;
- d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;
- dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
- e) çdo subjekt tjetër, për të cilin parashikohet detyrimi për regjistrim, në bazë të legjislacionit shqiptar.

2. Subjektet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, aplikojnë për regjistrim fillestar brenda një afati 15-ditor, i cili llogaritet:

a) për personat fizikë, shoqëritë e thjeshta dhe degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja nga data e nisjes së veprimtarisë;

b) për personat juridikë nga data e themelimit.

3. Për regjistrimet e tjera të detyrueshme, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e formimit të aktit të detyrueshëm për t'u regjistruar.

Neni 23

Rregullat e emërimit

1. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar i subjekteve me emra të njëjtë ose të ngjashëm, me emra në trajtën e shquar apo shkurtimet përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra, që janë në kundërshtim me rendin e moralin publik apo me dispozitat urdhëruese të ligjit.

2. Regjistrimi i emrit kryhet në bazë të parimit të përparësisë së paraqitjes së aplikimit.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare.

Neni 24

Rezervimi i emrit

1. Çdo individ, duke paguar tarifën përkatëse, ka të drejtë të rezervojë pranë regjistrat tregtar, për llogari të tij apo të të tretëve, një apo më shumë emra të caktuar për regjistrimin.

2. QKR-ja lëshon një certifikatë për rezervimin e emrit brenda një dite nga dorëzimi i aplikimit.

3. Nuk mund të rezervohen emra, të cilët vijnë në kundërshtim me parashikimet e nenit 23 të këtij ligji.

4. Rezervimi i emrit, gjatë afatit të vlefshmërisë së parashikuar në këtë ligj, pengon të tretët të rezervojnë emra të njëjtë ose të ngjashëm, apo të regjistrojnë subjekte me të njëjtin emër ose emra të ngjashëm.

5. Rezervimi i emrit është i vlefshëm për një afat prej 30 ditësh, duke nisur nga data e rezervimit. Afati i rezervimit të emrit nuk mund të zgjatet. Rezervimi rishtazi nga i njëjti person i të njëjtit emër të rezervuar më parë vlerësohet si rezervim i ri dhe kryhet sipas rregullave të përgjithshme për rezervimin e emrit, të parashikuar sipas këtij ligji.

Neni 25

Transferimi i emrit të rezervuar

Gjatë afatit të vlefshmërisë, emri i rezervuar mund t'u transferohet lirisht të tretëve, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, nëpërmjet depozitimit pranë QKR-së të formularit përkatës. Në këtë rast, QKR-ja bën shënimin përkatës në certifikatën për rezervimin e emrit.

Neni 26

Personat e autorizuar për të bërë regjistrimin

1. Aplikimi për regjistrim fillestar dhe regjistrimet e tjera të personave fizikë bëhet nga vetë personi që regjistrohet apo nga çdo person i autorizuar prej tij.

2. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta bëhet nga të gjithë anëtarët apo nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.

3. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet nga të gjithë ortakët e një shoqërie kolektive, të gjithë ortakët "e pakufizuar" të një shoqërie komandite, të gjithë

administratorët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të gjithë anëtarët e drejtorisë së një shoqërie anonime apo nga çdo person i autorizuar nga personat e përmendur më sipër. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortaku apo aksioneri, të cilit këto i përkasin.

4. Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja bëhet nga përfaqësuesi ligjor i degës apo zyrës së përfaqësimit, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë së huaj apo nga çdo person i autorizuar nga njëri prej personave të përmendur më sipër.

5. Aplikimi për regjistrimin fillestar e regjistrimet e tjera të shoqërive dhe unioneve të kursim-kredive bëhet nga kryetari i bordit drejtues apo nga çdo person i autorizuar prej tij.

6. Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të shoqërive të ndihmës e bashkëpunimit të ndërsjellë bëhet nga kryetari i këshillit administrativ ose nga çdo person i autorizuar prej tij.

7. Për subjektet e tjera, që regjistrohen në regjistrin tregtar, sipas ligjeve të veçanta, aplikimi bëhet nga përfaqësuesit ligjorë, sipas përcaktimit të ligjeve përkatëse ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.

8. Janë të autorizuar të aplikojnë për regjistrim personat e tjerë, që u njihet kjo e drejtë me ligj të veçantë.

Neni 27

Aplikimi dhe forma e dokumenteve shoqëruese

1. Regjistrimi kryhet me dorëzimin e aplikimit përkatës, të cilit i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen.

2. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dhe të jenë hartuar në formën e përcaktuar nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji.

3. Dokumentet shoqëruese nuk duhet të përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe përmbajtja e tyre duhet të duket qartë, të jetë e lexueshme dhe të lejojë marrjen e imazhit elektronik të dokumentit.

4. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

5. Në rast mospërputhjeje të dokumentit shoqërues në gjuhën shqipe me atë në gjuhë të huaj, ky i fundit nuk mund t'u kundrejtohet palëve të treta. Gjithsesi, palët e treta mund t'i kundrejtojnë subjektit të dhënat e përmbajtura në dokumentin në gjuhë të huaj, përveç rastit kur subjekti provon se i treti kishte dijeni për përmbajtjen e dokumentit në gjuhën shqipe.

SEKSIONI III

REGJISTRIMI FILLESTAR

Neni 28

Mënyra e aplikimit për regjistrimin fillestar

1. Personat fizikë regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, si dhe një kopje të dokumentit të identifikimit.

2. Shoqëritë e thjeshta regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, sipas këtij ligji, kontratën përkatëse, sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe kopje të dokumenteve të identifikimit të anëtarëve. Në rast se palët

nuk kanë lidhur kontratë me shkrim, regjistrimi i shoqërisë së thjeshtë mund të kryhet duke depozituar vetëm aplikimin, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, kopje të dokumenteve të identifikimit dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë së thjeshtë.

3. Shoqëritë tregtare regjistrohen në regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen, gjithashtu, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të shoqërisë që regjistrohet. Në këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklarata e mësipërme, e nënshkruar sipas rastit nga ortakët, anëtarët ose nga personat e autorizuar të veprojnë në emër e për llogari të tyre, zëvendëson aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

5. Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji si dhe:

a) aktin e themelimit e statutin e shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme;

b) dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj;

c) dokumentacionin, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;

ç) bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria e huaj ka pasur veprimtari për më shumë se një vit;

d) vendimin ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit. Aktet e kësaj pike zëvendësohen nga aplikimi për regjistrim në rastin kur personi, që kërkon regjistrimin, është njëkohësisht organi përgjegjës për të vepruar i vetëm, në emër të shoqërisë së huaj.

6. Shoqëritë dhe unionet e kursim-kredisë, si dhe shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë regjistrohen duke depozituar në regjistrin tregtar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, si dhe çdo dokument tjetër, të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 29

Subjektet e huaja

Në rastet e regjistrimit të personave juridikë ose shoqërive të thjeshta me ortak, aksioner ose anëtar një person juridik të huaj, përveç dokumenteve të kërkuara sipas llojit të subjektit, aplikimit për regjistrim fillestar i bashkëngjiten edhe dokumentet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 5 të nenit 28 të këtij ligji, për personin juridik të huaj.

Neni 30

Të dhënat e detyrueshme për personat fizikë

Për regjistrimin fillestar të personave fizikë janë të detyrueshme këto të dhëna:

a) të dhënat e identifikimit;

b) vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;

- c) fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
- ç) specimeni i nënshkrimit (firmës) të personit fizik.

Neni 31

Të dhënat e detyrueshme për shoqëritë e thjeshta

Për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- b) fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
- c) vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
- ç) të dhënat e identifikimit të anëtarëve;
- d) vlera dhe lloji i kontributeve të anëtarëve;
- dh) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;
- e) specimetet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

Neni 32

Të dhënat e detyrueshme për shoqëritë tregtare

Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) emri;
- b) forma;
- c) data e themelimit;
- ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- d) selia;
- dh) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
- e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
- ë) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.
- f) specimetet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

Neni 33

Të dhënat shtesë për shoqëritë kolektive

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë kolektive, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, është i detyrueshëm edhe njoftimi i llojit e vlerës së kontributeve të të gjithë ortakëve, si dhe pjesëmarrja e tyre në kapital.

Neni 34

Të dhënat shtesë për shoqëritë komandite

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë komandite, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, është i detyrueshëm njoftimi i shumës ose vlerës së kontributeve të të gjithë ortakëve, pjesa në këtë shumë ose në këtë vlerë e çdo ortaku, “të pakufizuar” ose “të kufizuar”, si dhe pjesa e përgjithshme e ortakëve “të pakufizuar” dhe pjesa e çdo ortaku “të kufizuar”, në shpërndarjen e fitimeve dhe në shumën që mbetet pas likuidimit të shoqërisë.

Neni 35

Të dhënat shtesë për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, është i detyrueshëm edhe njoftimi i vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar,

numri i pjesëve të kapitalit, vlera nominale e secilës pjesë, pjesëmarrja në kapital, vlera dhe lloji i kontributeve të secilit ortak, si dhe informacioni nëse kapitali fillestar i nënshkruar është paguar ose jo.

Neni 36

Të dhënat shtesë për shoqëritë anonime

1. Për regjistrimin fillestar të shoqërisë anonime, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, janë të detyrueshme edhe këto të dhëna:

- a) vlera e kapitalit themeltar të nënshkruar dhe pjesa e paguar;
- b) numri dhe forma e aksioneve të nënshkruara;
- c) vlera nominale e secilit aksion;
- ç) numri i aksioneve të nënshkruara nga secili aksioner;
- d) vlera dhe lloji i kontributit të secilit aksioner, si dhe pjesa e paguar prej secilit;
- dh) kushtet e veçanta, që kufizojnë transferimin e aksioneve (nëse ka);
- e) nëse ka kategori të ndryshme aksionesh, njoftohen të dhënat e shkronjave “c” e “dh” të këtij neni për secilën kategori aksionesh, si dhe të drejtat që lidhen me to;
- ë) procedurat për konvertimin e formës së aksioneve, nëse parashikohet në statut;
- f) vlera totale ose një parashikim i kostove të veçanta në ngarkim të shoqërisë për procedurat e themelimit;
- g) përparësitë që u njihen personave, që kanë marrë pjesë në themelimin e shoqërisë apo në transaksione të veçanta, që lidhen me fillimin e veprimtarisë ekonomike (nëse ka);
- gj) të dhënat e identifikimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre;
- h) numri i anëtarëve të organeve drejtuese;
- i) procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse ndryshojnë nga parashikimet ligjore.

2. Shoqëritë anonime me ofertë publike, përpara regjistrimit fillestar, duhet të regjistrojnë edhe të dhënat e identifikimit të themeluesve, projektstatutin, si dhe të kryejnë njoftimet e mëposhme, sipas dispozitave përkatëse ligjore.

3. Të dhënat e përcaktuara në shkronjat “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “i” të pikës 1 të këtij neni mund të njoftohen nëpërmjet referencës në aplikim të nenit përkatës të statutit ose aktit të themelimit apo të dokumenteve shoqëruese të depozituara.

Neni 37

Të dhënat për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja

Për regjistrimin fillestar të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë” të nenit 32 të këtij ligji për shoqëritë e huaja, përfshirë numrin dhe vendin e regjistrimit;
- b) kapitalin e shoqërisë së huaj;
- c) emrin e degës ose të zyrës së përfaqësimit, nëse është i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj;
- ç) kohëzgjatjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
- d) fushën e veprimtarisë së degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
- dh) selinë e degës ose të zyrës së përfaqësimit;
- e) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës ose zyrës së përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;

ë) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën ose zyrën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët.

Neni 38

Të dhënat për shoqëritë dhe unionet e kursim-kredive

Për regjistrimin e shoqërive dhe të unioneve të kursim-kredive, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, për shoqëritë tregtare janë të detyrueshme të njoftohen edhe lloji dhe vlera e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, fakti nëse kapitali i nënshkruar është i paguar, si dhe pjesa e paguar, të dhënat e identifikimit të anëtarëve të organit mbikëqyrës, ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre.

Neni 39

Të dhënat për shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë

Për regjistrimin e shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë, përveç sa parashikohet në nenin 32 të këtij ligji, për shoqëritë tregtare njoftohet edhe lloji dhe vlera e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, fakti nëse kapitali i nënshkruar është i paguar, si dhe pjesa e paguar, përcaktimi i territorit të veprimtarisë dhe të dhënat e identifikimit të anëtarëve të organit mbikëqyrës, të ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre.

Neni 40

Përrjashtimi

Në rastin kur me ligjet e posaçme parashikohen mënyra të ndryshme të organizimit të subjekteve, atëherë të dhënat që njoftohen duhet të jenë në përputhje me këto dispozita.

Neni 41

Pagesa e kapitalit

Vërtetimi i shlyerjes së kapitalit themeltar nuk përbën kusht për regjistrimin fillestar në regjistrin tregtar të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, me përrjashtim të rastit kur në ligje të posaçme parashikohet ndryshe.

Neni 42

Pasojat e regjistrimit fillestar

1. Subjektet, që regjistrohen si persona juridikë, e fitojnë personalitetin juridik me regjistrimin në regjistrin tregtar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligje të posaçme.

2. Regjistrimi në regjistrin tregtar për personat fizikë, degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, shoqëritë e thjeshta, sipas Kodit Civil dhe subjektet e tjera që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk fitojnë personalitet juridik nëpërmjet këtij regjistrimi, ka vetëm efekt deklarativ.

SEKSIONI IV

REGJISTRIMET E TJERA

Neni 43

Regjistrimet e tjera të detyrueshme

1. Çdo subjekt, që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, sipas seksionit III.

2. Në rast ndryshimi të aktit të themelimit, statutit ose ndryshimit të kontratës së shoqërisë së thjeshtë (kur është në formë të shkruar), depozitohet edhe teksti i plotë i tyre, që pasqyron

ndryshimet e mëposhme. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja depozitohet statuti dhe akti i themelimit të shoqërisë së huaj apo dokumenti ekuivalent i krijimit, sipas legjislacionit të huaj, me tekstin e plotë, që pasqyron ndryshimet e bëra.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

a) bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas dispozitave të legjislacionit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme; për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja depozitohet edhe bilanci vjetor i shoqërisë së huaj, i mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj;

b) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabël të autorizuar, në rastet kur emërimi është i detyrueshëm, numrin e licencës profesionale, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;

c) emërimin e likuiduesve, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;

ç) pushimin e veprimtarisë ekonomike tregtare, aktet e prishjes, mbylljes apo shpërndarjes, aktet e transformimit, bashkimit, ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen edhe aktet e transformimit, të bashkimit, ndarjes, hapjes dhe mbylljes së procedurave të likuidimit ose falimentimit të shoqërisë së huaj;

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

dh) dokumentet, që vërtetojnë vënien e pengjeve ose garancitë e tjera për pjesëmarrjet në kapitalin e subjektit;

e) çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Pavarësisht nga sa më sipër, shoqëria anonime nuk detyrohet të njoftojë çdo transferim të aksioneve. Shoqëria, së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, njofton listën e plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj.

Neni 44

Regjistrimet e tjera vullnetare

Subjektet mund të regjistrojnë çdo të dhënë tjetër, të ndryshme nga të dhënat e përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e tyre ekonomike tregtare. Këto të dhëna shtesë përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) emërtimin ose shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë (nëse është/janë i/të ndryshëm nga emri i regjistruar i subjektit);

b) çdo transferim të aksioneve nominative për shoqëritë anonime që, përveç personave të autorizuar, mund të regjistrohet edhe me aplikimin e çdo aksioneri të interesuar;

c) web-site, e-mail, telefon dhe faks;

ç) vendimet e organeve drejtuese të subjektit, të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim;

d) të dhëna të tjera, të lidhura me veprimtarinë ekonomike tregtare të subjektit.

Neni 45

Regjistrimet me vendim të autoritetit publik

1. QKR-ja regjistron në regjistrin tregtar dhe publikon, kryesisht ose me aplikim nga çdo person i interesuar, vendimet gjyqësore ose të autoriteteve të tjera publike për të dhënat e regjistruara ose veprimtarinë e subjektit tregtar. Aplikimit i bashkëlidhet vendimi përkatës.

2. Regjistrimi kryhet brenda afatit njëditor, nga dita kur QKR-së i njoftohet vendimi përkatës, ose nga data e paraqitjes së kërkesës së palës.

Neni 46

Kalimi në statusin pasiv

1. Çdo subjekt, i cili nuk paraqet për 2 vite me radhë bilancin kontabël vjetor, sipas parashikimit të nenit 43 të këtij ligji, njoftohet me shkrim nga QKR-ja brenda 30 ditëve nga plotësimi i këtij afati.

2. Në rast se subjekti nuk plotëson detyrimin brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, por jo më vonë se 60 ditë nga plotësimi i afatit për paraqitjen e bilancit, subjekti kalohet kryesisht nga QKR-ja në statusin pasiv, me shënimin "PASIV" në të gjitha dokumentet që lëshohen nga regjistri.

3. Dispozitat e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për subjektet, që kanë njoftuar pezullimin e veprimtarisë, sipas nenit 43 të këtij ligji.

Neni 47

Heqja e statusit pasiv

Subjekti hiqet nga statusi pasiv me kërkesë të personit të autorizuar, pasi plotëson detyrimin e paraqitjes së bilanceve dhe paguan sanksionet përkatëse.

SEKSIONI V ÇREGJISTRIMI

Neni 48

Çregjistrimi i subjektit tregtar

1. Subjektet çregjistrohen nga regjistri tregtar në rastet e parashikuara nga legjisllacioni në fuqi, për prishjen dhe pavlefshmërinë e personave juridikë, shpërndarjen e shoqërisë së thjeshtë, në rastet e përfundimit të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare të personit fizik, si dhe në çdo rast tjetër, të parashikuar nga legjisllacioni në fuqi.

2. Çregjistrimi bëhet:

- a) në mënyrë vullnetare nga subjekti;
- b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- c) sipas parashikimit të ligjeve të posaçme.

Neni 49

Çregjistrimi vullnetar

1. Për personat fizikë çregjistrimi në mënyrë vullnetare kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim, i cili mund të bëhet së bashku me njoftimin e pushimit të veprimtarisë ekonomike e tregtare ose në një çast të dytë.

2. Çregjistrimi në mënyrë vullnetare për personat juridikë, degët dhe zyrat përfaqësimit të shoqërive të huaja dhe për shoqëritë e thjeshta kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim dhe depozitimit të akteve përkatëse, që vërtetojnë kryerjen dhe mbylljen e procedurave të likuidimit, sipas legjisllacionit në fuqi. Çregjistrimi nuk kryhet nëse aktet e ndërmjetme të procesit të likuidimit, sipas legjisllacionit në fuqi, nuk janë njoftuar dhe depozituar pranë regjistrimit tregtar. Këto akte depozitohen në formën e kërkuar nga ky ligj dhe/ose nga dispozita të tjera ligjore në fuqi.

Neni 50

Çregjistrimi në rast vdekjeje

Në rast vdekjeje të personit fizik, çregjistrimi mund të kryhet me kërkesë të çdo pale të interesuar dhe me depozitimin e dokumenteve përkatëse. Gjithashtu, çdo palë e interesuar mund të kërkojë çregjistrimin e personit fizik nga regjistri tregtar, duke depozituar vendimin e gjykatës, me të cilin një person është shpallur i vdekur.

Neni 51

Çregjistrimi me vendim të autoriteteve të tjera

1.Çregjistrimi nga regjistri tregtar kryhet në bazë të një vendimi gjyqësor të paankimueshëm apo të vendimit përfundimtar të një autoriteti tjetër publik, kur parashikohet nga ligje të posaçme, në rastet e pavlefshmërisë së personave juridikë pas mbylljes së likuidimit në rrugë gjyqësore, të falimentimit apo në raste të tjera, të parashikuara nga ligji.

2.QKR-ja çregjistron kryesisht subjektin brenda 1 dite nga data e marrjes së vendimit përkatës.

Neni 52

Të dhënat e subjekteve të çregjistruara

1.Të dhënat e subjekteve të çregjistruara mbahen në regjistrin tregtar, duke vënë shënimin “i çregjistruar”, si dhe numrin e datën e vendimit gjyqësor ose të autoritetit tjetër publik, sipas ligjeve të posaçme, që ka vendosur çregjistrimin nga regjistri tregtar, ose në rastin e çregjistrimit vullnetar, të dhënat e aktit dhe të aplikimit, nëpërmjet të cilit është kryer çregjistrimi. Këto të dhëna ruhen nga QKR-ja në format elektronik dhe janë gjithnjë të aksesueshme për publikun.

2.Emri i subjektit tregtar do të vlerësohet i zënë dhe nuk mund të regjistrohet nga asnjë subjekt tjetër për një afat prej 6 muaj nga data e çregjistrimit.

Neni 53

Pasojat e çregjistrimit

1.Çregjistrimi i personave juridikë nga regjistri tregtar ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik të subjekteve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme.

2.Çregjistrimi nga regjistri tregtar i personave fizikë, degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja, shoqërive të thjeshta, sipas Kodit Civil, si dhe të subjekteve të tjera që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit, ka vetëm efekt deklarativ.

3.Subjektet e çregjistruara përgjigjen për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV

VENDIMARRJA DHE PUBLIKIMI

SEKSIONI I

SHQYRTIMI DHE VENDIMARRJA

Neni 54

Shqyrtimi i aplikimit

1.QKR-ja asiston aplikantin në plotësimin e aplikimit dhe verifikon:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;

b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;

c) paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;

ç) faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë formularin;

d) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e

palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik;

dh) nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet;

e) pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim;

ë) faktin nëse aplikanti ka shlyer sanksionet administrative të dhëna, sipas nenit 74 të këtij ligji.

2. QKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim.

3. QKR-ja lëshon një konfirmim me shkrim, sipas një formati të miratuar, për çdo aplikim të dorëzuar.

4. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë kohën e dorëzimit, numrin rendor të paraqitjes së aplikimit, objektin e aplikimit, listën e dokumenteve të dorëzuara dhe shumën e tarifës së paguar.

5. QKR-ja merr në shqyrtim aplikimet për regjistrim, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

6. QKR-ja është e detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse aplikimi është i paplotë, apo dokumentet shoqëruese të pasakta. Në çdo rast QKR-ja përgjigjet me shkrim.

Neni 55

Pranimi i regjistrimit

1. QKR-ja, pasi kryen verifikimet përkatëse, sipas nenit 54 të këtij ligji dhe vëren përmbushjen e kushteve për regjistrim, kryen regjistrimin në regjistër dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda një afati prej një dite nga data e paraqitjes së aplikimit.

2. QKR-ja nuk mund të refuzojë regjistrimin, nëse aplikimi është dorëzuar sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 56

Pezullimi i aplikimit

1. Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifatat përkatëse të regjistrimit apo ka sanksione administrative të papaguara, QKR-ja pezullon aplikimin dhe e njofton aplikantin me shkrim për shkakun e saktë të pezullimit, duke i dhënë një afat 15-ditor për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard të QKR-së.

2. Nëse aplikanti plotëson ose ndreq elementet që pengojnë regjistrimin, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, QKR-ja është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda një afati 1-ditor nga data e plotësimit ose ndreqjes së dokumentacionit. Në këtë rast, regjistrimi mban datën e paraqitjes së aplikimit të parë.

Neni 57

Refuzimi i regjistrimit

1. Regjistrimi refuzohet vetëm në rastet kur:

a) aplikimi nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe aplikanti nuk plotëson ose ndreq elementet, që pengojnë regjistrimin brenda afatit;

b) të dhënat, që kërkohen të regjistrohen, janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Refuzimi i njoftohet aplikantit me shkrim, sipas formularit standard, në të cilin jepet edhe shkaku i këtij refuzimi.

3. Riparaqitja e aplikimit pas refuzimit trajtohet si aplikim i ri.

Neni 58

Miratimi i heshtur

1. Në rastin kur QKR-ja, brenda afatit njëditor, sipas neneve të mësipërme, nuk kryen regjistrimin, nuk njofton pezullimin e aplikimit apo nuk njofton refuzimin, atëherë aplikimi për regjistrim quhet i pranuar menjëherë.
2. QKR-ja detyrohet të kryejë publikimin e të dhënave të regjistruara.

SEKSIONI II

REGJISTRIMI I NJËKOHSHËM, NUMRI UNIK I IDENTIFIKIMIT, PUBLIKIMI DHE LËSHIMI I CERTIFIKATAVE

Neni 59

Regjistrimi i njëkohshëm

1. Regjistrimi i subjekteve në regjistrin tregtar përbën, gjithashtu, regjistrimin e njëkohshëm të tyre pranë autoriteteve tatimore në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pranë inspektoratit të punës.
2. Subjektet, për qëllimet e regjistrimit e të pajisjes me certifikatën e regjistrimit fillestar, deklarojnë, gjithashtu, të dhënat e detyrueshme, sipas legjislacionit tatimor, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave, sipas formularëve përkatës.

Neni 60

Numri unik i identifikimit të subjektit

1. Me regjistrimin në regjistër, subjekteve u jepet numri i identifikimit, i cili gjenerohet në mënyrë elektronike nga QKR-ja dhe është unik për çdo subjekt të regjistruar.
2. Numri unik i identifikimit të subjektit është i vlefshëm për identifikimin e subjekteve, për qëllimet e regjistrimit në regjistër, për qëllimet e regjistrimit si person i tatuashëm pranë autoriteteve fiskale, qendrore dhe vendore, për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës, si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues.
3. Numri unik i identifikimit të subjektit jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet subjekteve të tjera edhe pas çregjistrimit.
4. Subjektet e regjistruara janë të detyruara të shënojnë numrin unik të identifikimit të subjektit në çdo korrespondencë të tyre.

Neni 61

Publikimi elektronik

1. Çdo e dhënë e regjistruar në regjistër nga QKR-ja publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet nga QKR-ja në format elektronik dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit.
2. QKR-ja kryen publikimin në buletin brenda një dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qartë data, në të cilën është regjistruar e dhëna e publikuar.
3. QKR-ja për çdo ditë pune publikon në buletin të gjitha regjistrimet e kryera gjatë ditës së mëparshme.
4. Publikimi në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit përbën publikim zyrtar të regjistrimeve, të kryera në kuptim të nenit 21 të këtij ligji.
5. Me vendim të ministrit mund të parashikohen botime të tjera ndihmëse për njoftimin e regjistrimeve. Në çdo rast, këto botime nuk cenojnë efektet e publikimit sipas pikave 1 deri në 3 të këtij neni.

Neni 62

Certifikatat e regjistrimit fillestar

1. QKR-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj për regjistrimin fillestar, i lëshon subjektit të regjistruar certifikatën e regjistrimit, e cila përmban emrin, formën, numrin unik të identifikimit, datën e regjistrimit fillestar dhe selinë ose adresën e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë.

2. Në rast se subjekti i regjistruar ushtron veprimtarinë në më shumë se një vend, QKR-ja lëshon nga një certifikatë regjistrimi për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë, gjithashtu, emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe numrin unik të identifikimit të subjektit.

3. Në rastet kur subjekti ndryshon emrin, formën, selinë apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, QKR-ja zëvendëson certifikatat e lëshuara më parë me një certifikatë të re për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë, gjithashtu, emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe numrin unik të identifikimit të subjektit.

4. Certifikata e regjistrimit lëshohet në një kopje origjinale për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Në rast humbjeje apo dëmtimi të certifikatës së regjistrimit, ajo zëvendësohet me një dublikatë të lëshuar nga QKR-ja.

5. Subjekti detyrohet të afishojë certifikatën përkatëse në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 63

Vërtetime për regjistrimet

Pas regjistrimit, sipas dispozitave të këtij ligji, QKR-ja i lëshon subjektit një vërtetim regjistrimi, ku përcaktohen qartë veprimi i kryer dhe data e këtij regjistrimi.

Neni 64

Formati dhe përmbajtja

Ministri, me propozimin e titullarit të QKR-së, miraton formatin dhe përmbajtjen e certifikatave, vërtetimeve dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, sipas këtij ligji.

Neni 65

Korrigjimi i gabimeve

1. Pasaktësitë, gabimet e shtypit ose gabimet e tjera të dukshme të këtij lloji, të bëra gjatë regjistrimeve, të cilat rezultojnë qartë nga dokumentacioni i depozituar dhe nuk cenojnë vlefshmërinë e regjistrimit, mund të korrigjohen nga QKR-ja kryesisht apo me kërkesë të personave të interesuar.

2. Ndryshimi i të dhënave të pasakta, të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një aplikimi të ri apo në bazë të një vendimi gjyqësor.

3. Ndreqja e pasaktësive apo gabimeve publikohet, sipas dispozitave të nenit 61 të këtij ligji.

4. Aplikimi për ndreqje të gabimeve kryhet pa pagesë.

KREU V

AKSESI PUBLIK DHE EKSTRAKTET

Neni 66

Kërkimet në bazën e të dhënave

1. Çdo e dhënë e regjistruar në regjistër, si dhe imazhi i plotë elektronik i çdo dokumenti shoqërues është lirisht i aksesueshëm për publikun në faqen zyrtare të internetit të QKR-së, përveç

adresës së banimit të individëve që, në përputhje me këtë ligj, e kanë njoftuar këtë të dhënë.

2. QKR-ja mundëson kryerjen e kërkimeve në bazën elektronike të të dhënave pranë çdo sporteli shërbimi.

Neni 67

Ekstraktet e regjistrit

1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë lëshimin e ekstrakteve për një pjesë apo të gjitha të dhënat e regjistruara dhe kopje të vërtetuara të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistrë, pranë çdo sporteli shërbimi të QKR-së.

2. Ekstraktet mund të lëshohen për të dhëna të caktuara të subjekteve dhe/ose për historikun e veprimeve të kryera nga një subjekt.

3. Të dhënat për adresën e banimit të individëve, sipas pikës 1 të nenit 66 të këtij ligji, janë të aksesueshme nga çdo person i interesuar, vetëm në bazë të një kërkesë, ku shënohet identiteti i kërkuarit.

4. Ministri, me propozimin e titullarit të QKR-së, miraton formatin e ekstrakteve dhe të kërkesës për lëshimin tyre.

Neni 68

Vlera ligjore e ekstrakteve

1. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese, të lëshuara nga QKR-ja, kanë vlerën e kopjeve të vërtetuara të të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse.

2. Ekstraktet dhe kopjet e akteve, të lëshuara në format elektronik, nëpërmjet aksesit online, në bazën e të dhënave të regjistrit, kanë vlerën ligjore, të përcaktuar në legjislationin për dokumentet elektronike.

Neni 69

Komunikimi elektronik me autoritete të tjera publike

QKR-ja, për të garantuar lehtësimin e procedurave të regjistrimit dhe ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë, në favor të subjekteve të interesuara, në përputhje me legjislationin në fuqi, bashkëpunon me autoritete të tjera publike dhe mundëson ndërlidhjen dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave, të regjistruara në bazën e saj elektronike, me regjistra apo baza të dhënash elektronike të autoriteteve të tjera publike, si brenda, ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU VI

LICENCIMET

Neni 70

Funksionet për licencimin

1. QKR-ja informon dhe këshillon publikun për licencat, lejet dhe autorizimet administrative për kryerjen e veprimtarisë, kushtet dhe procedurën për përfitimin e tyre.

2. QKR-ja kryen funksionin e sportelit pritës për aplikim për licenca, leje dhe autorizime administrative dhe tërheqjen e tyre nga aplikantët.

3. Këshilli i Ministrave përcakton, me akte nënligjore, llojet e licencave, të lejeve dhe autorizimeve administrative, si dhe procedurat përkatëse, për të cilat QKR-ja ofron shërbimin e këshillimit dhe të sportelit pritës për aplikim dhe tërheqje.

KREU VII
ANKIMI DHE KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 71
Ankimi administrativ

1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj veprimeve apo mosveprimeve të QKR-së për regjistrimet dhe publikimet, sipas dispozitave të këtij ligji. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftimin për pranimin apo refuzimin e regjistrimit, sipas këtij ligji, ose nga data kur regjistrimi është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit.

2. Në rastet kur ky ligj parashikon miratimin e heshtur dhe QKR-ja nuk lëshon certifikatat apo nuk kryen publikimet përkatëse brenda afatit të parashikuar, subjekti ka të drejtë të ankohet, në çdo kohë, në rrugë administrative, duke kërkuar lëshimin e certifikatës së regjistrimit fillestar apo të certifikatës, që vërteton regjistrimet e tjera të kryera, si dhe publikimin e këtyre të dhënave sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative kur QKR-ja nuk lëshon ekstraktet apo kopjet e vërtetuara të akteve, sipas dispozitave të këtij ligji. Afati 30-ditor për paraqitjen e ankimit fillon pas 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës për lëshimin e ekstraktit apo kopjes së aktit të kërkuar.

Neni 72
Organi kompetent për ankimin

1. Ankimi administrativ, sipas nenit 71 të këtij ligji, i drejtohet titullarit të QKR-së dhe paraqitet, sipas formave e procedurave të përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative, në selinë qendrore të QKR-së ose në çdo sportel shërbimi të saj.

2. Titullari i QKR-së shqyrton ankimin, merr vendim dhe ia njofton palës së interesuar brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

3. Ndaj aktit të titullarit të QKR-së apo mosveprimit të tij mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatë, sipas nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 73
Përgjegjësia jashtëkontraktore

QKR-ja, në përputhje me ligjin për dëmin jashtëkontraktor të administratës publike, përgjigjet për dëmet e shkaktuara nga mosveprimi ose nga veprimi në kundërshtim me ligjin.

Neni 74
Kundërvajtjet administrative

1. Subjekti përgjigjet, sipas ligjeve në fuqi, për vërtetësinë e fakteve, të të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistër.

2. Deklarimi në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

3. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

4. Mosveprimi i subjektit, i cili sjell si pasojë kalimin në statusin pasiv, sipas nenit 46 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

5. Gjoha aplikohet nga titullari i QKR-së, vendimi i të cilit ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë.

KREU VIII
DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 75

Procedurat e regjistrimit të subjekteve ekzistuese

1. Regjistri i shoqërive tregtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistri i personave fizikë tregtarë pranë gjykatave përkatëse të rretheve, regjistri i shoqërive dhe i unioneve të kursim-kreditit, regjistri i shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, transferohen në administrim të QKR-së në format material dhe elektronik brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Organet tatimore, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i japin QKR-së të gjitha të dhënat, që ato kanë për subjektet e regjistruara në regjistrat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, për aq sa ato janë të domosdoshme për të shënuar numrin unik të identifikimit të subjektit.

3. Të gjitha të dhënat e regjistrave dhe dokumentet shoqëruese, që transferohen pranë QKR-së, regjistrohen dhe publikohen, kryesisht, nga QKR-ja pa pagesë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

4. Të gjitha subjektet dhe regjistrimet përkatëse në këta regjistra vlerësohen automatikisht të reregjistruara në regjistrin tregtar, që nga data e regjistrimit të parë.

5. Në qoftë se nga procesi i reregjistrimit evidentohen subjekte me emra të njëjtë ose të ngjashëm, QKR-ja publikon, në një seksion të veçantë të faqes zyrtare të internetit, një listë të plotë të këtyre subjekteve, duke saktësuar datat e regjistrimit të secilit në gjykatë.

6. Subjektet, që janë regjistruar më parë në regjistrat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe nuk kanë kryer regjistrim tek organet tatimore, publikohen në një seksion të veçantë të faqes së internetit të QKR-së. Në rast se këto subjekte nuk njoftojnë fillimin e veprimtarisë tregtare brenda një afati prej 6 muajsh nga data e këtij publikimi, QKR-ja kryen kryesisht çregjistrimin e tyre nga regjistri.

7. Subjektet që, megjithëse kanë kryer regjistrimin pranë organeve tatimore, kanë regjistrime të pasakta apo të paplota, publikohen në një seksion të veçantë të faqes së internetit të QKR-së, duke përcaktuar të dhënat e pasakta apo të paplota, si dhe veprimin që duhet të ndërmerret apo dokumentin shoqërues që duhet të depozitohet. Në rast se këto subjekte nuk njoftojnë, saktësojnë regjistrimet ose depozitojnë dokumentet shoqëruese përkatëse brenda një afati prej 6 muajsh nga data e këtij publikimi, kalohen kryesisht nga QKR-ja në statusin “pasiv”.

8. Gjykatat përkatëse vazhdojnë të pranojnë kërkesa për kryerjen e veprimeve të regjistrimit deri në datën e fillimit të regjistrimeve nga QKR-ja, sipas afateve të parashikuara në pikën 2 të nenit 77 të këtij ligji. Aplikimet e regjistrimeve në proces dhe të papërfunduara në këtë datë kryhen nga gjykatat përkatëse, në përputhje me procedurën e zbatuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur aplikanti tërheq aplikimin dhe vendos ta paraqesë atë pranë QKR-së. Të gjitha regjistrimet e kryera dhe dokumentacioni shoqërues, i depozituar gjatë kësaj periudhe, i kalojnë menjëherë QKR-së nga gjykata përkatëse.

9. Ankimet ndaj regjistrimeve të kryera nga gjykatat deri në afatin e parashikuar në pikën 8 të këtij neni, shqyrtohen sipas procedurës së parashikuar nga ligji i mëparshëm.

10. Ministri i Drejtësisë dhe ministri që mbulon çështjet e tregtisë ngarkohen të përcaktojnë me urdhër të përbashkët procedurën e transferimit pranë QKR-së të regjistrave të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

11. Në rastet e parashikuara në pikën 7 të këtij neni, subjekti hiqet nga statusi pasiv me njoftimin, saktësimin e regjistrimit ose me depozitimin e dokumenteve shoqëruese. Në këto raste nuk aplikohet sanksion administrativ.

12. Subjektet që reregjistrohen, sipas këtij neni, pajisen nga QKR-ja me certifikata regjistrimi, në përputhje me dispozitat e nenit 62 të këtij ligji, në çastin kur aplikojnë për kryerjen e një veprimi në regjistrë. Deri në këtë çast, certifikatat e regjistrimit pranë organeve tatimore janë të vlefshme.

Neni 76

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë procedurat e hollësishme të shqyrtimit, miratimit, pezullimit, refuzimit të aplikimit dhe publikimit për regjistrim fillestar, për regjistrimet e tjera dhe çregjistrimin e subjekteve, si dhe procedurën e hollësishme të ndreqjes së gabimeve në regjistrim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë procedurat e hollësishme për deklarimin, trajtimin dhe shkëmbimin e të dhënave të detyrueshme, sipas legjislacionit tatimor të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të punës dhe atij të statistikave, sipas nenit 59 të këtij ligji, si dhe të miratojë procedurën e lëshimit të numrit unik të identifikimit të subjektit.

3. Ministri, me propozimin e titullarit të QKR-së, përcakton formën dhe përmbajtjen e dokumenteve që lëshohen nga QKR-ja dhe formatet e kthimit të përgjigjes për çdo veprim të kryer.

4. Ngarkohet ministri të miratojë procedurat e hollësishme për mbrojtjen dhe sigurinë e bazës të së dhënave elektronike të regjistrimit.

5. Këshilli i Ministrave dhe ministrat e ngarkuar sipas këtij ligji për nxjerrjen e akteve nënligjore të plotësojnë këtë detyrim brenda një afati prej 2 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 77

Fillimi i efekteve

1. Pjesët e këtij ligji, që përcaktojnë qëllimin, organizimin dhe funksionimin e QKR-së i shtrijnë efektet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. QKR-ja fillon regjistrimin e subjekteve, në përputhje me këtë ligj, brenda 5 muajve nga hyrja në fuqi e tij, por jo më vonë se data 1.9.2007.

3. Në çastin e fillimit të regjistrimit, QKR-ja do të ketë jo më pak se 29 sportele on-line në njësitë e qeverisjes vendore. Numri i sporteleve on-line do të dyfishohet, të paktën, deri më 1 korrik 2008.

4. Dispozitat e këtij ligji, që i referohen komunikimit, aplikimit elektronik dhe legjislacionit për dokumentet elektronike, nuk zbatohen për sa kohë nuk është miratuar legjislacioni përkatës.

Neni 78

Ndryshime dhe shfuqizime

1. Në çdo ligj ose akt nënligjor në fuqi, ku përmendet emri gjykatë, për qëllime të regjistrimit të subjekteve të këtij ligji, do të zëvendësohet me QKR-ja.

2. Ligji nr.7667, datë 28.1.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet, që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 79

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ligj nr.9723, datë 3.5.2007 shpallur me dekretin nr.5319, datë 21.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, faqe 1604

Ligj nr.9916, datë 12.5.2008 shpallur me dekretin nr.5740, datë 26.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, faqe 3355

VENDIM
Nr.537, datë 1.8.2007

PËR RREGULLAT PËR EMRAT DHE EMËRTIMET TREGTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 23 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:
 - a) “Emri i personit juridik” është emri me të cilin personi juridik (përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja) është regjistruar në regjistrin tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (në vijim QKR).
 - b) “Emërtimi i personit juridik” është emërtimi tregtar i personit juridik (përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja), që përdoret në kursin e tregut, e që mund të jetë i ndryshëm nga emri me të cilin është regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, që mund të jetë pjesë ose akronim i emrit të regjistruar, i njoftuar vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
 - c) “Emri i personit fizik” është emri me të cilin individi është regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, në kuptim të nenit 5 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - ç) “Emërtimi i personit fizik” është emërtimi tregtar i personit fizik, regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKR-së, (sipas kërkesave të nenit 9 të ligjit nr.7632, datë 4.11.1992), që përdoret prej tij në kursin e tregut, i njoftuar vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në.
 - d) “Emërtimi i shoqërisë së thjeshtë” është emërtimi tregtar, që përdoret nga shoqëria e thjeshtë në kursin e tregut, e regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i njoftuar vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në.
 - dh) “Shenjat dalluese të veprimtarisë” janë shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë së subjektit, të regjistruara në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, që njoftohen vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në. Shembuj të këtyre shenjave dalluese janë: (i) markat e paregjistruara, tabelat (përfshi këtu elementet figurative, që dallojnë një veprimtari franchising); (ii) domain name (emri i domain-it në internet); (iii) logoja e simbolet e tjera, të përdorura gjatë ushtrimit të një veprimtarie ekonomike tregtare nga një subjekt i regjistruar e që dallojnë mallrat, shërbimet ose vendin e ushtrimit të kësaj veprimtarie.
 - e) “Markë e regjistruar” është marka tregtare ose e shërbimit, në kuptim të dispozitave të ligjit nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, e regjistruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
 - ë) “Karakter dallues”, është elementi grafik, gjuhësor apo i një natyre tjetër, që dallon mjaftueshëm emrin e personit juridik, emërtimin e tij, emërtimin e personit fizik, të shoqërisë së thjeshtë, markën e regjistruar ose çdo shenjë tjetër dalluese të veprimtarisë (sipas përcaktimeve të këtij neni) të një subjekti të regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, alternativisht në krahasim me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë së një subjekti tjetër. Karakteri dallues mungon kur përdorimi i një emri, emërtimi apo i një shenje tjetër dalluese mund të sjellë paqartësi për publikun.
 - f) “Emër i njëjtë” është emri i një personi, juridik apo fizik, të regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKR-së, i cili është i njëjtë me emrin e një subjekti tjetër, të regjistruar.
 - g) “Emër i ngjashëm” është emri i një personi, juridik apo fizik, të regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKR-së, i cili nuk ka karakter dallues, në krahasim me emrin e një subjekti tjetër, të regjistruar.

gj) “Emërtim i njëjtë” është emërtimi i një personi juridik, i një personi fizik e i një shoqërie të thjeshtë (që njoftohet vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në), i cili është i njëjtë me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të një subjekti tjetër, të regjistruar.

h) “Emërtim i ngjashëm” është emërtimi i një personi juridik, i një personi fizik e i një shoqërie të thjeshtë (që njoftohet vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në), i cili nuk ka karakter dallues në krahasim me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të një subjekti tjetër, të regjistruar.

i) “Shenjë dalluese e njëjtë” është shenja dalluese, sipas përcaktimit të kësaj pike, që njoftohet vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në, e cila është e njëjtë me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të një subjekti tjetër, të regjistruar.

j) “Shenjë dalluese e ngjashme” është shenja dalluese, sipas përcaktimit të këtij neni, që njoftohet vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në, e cila nuk ka karakter dallues në krahasim me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të një subjekti tjetër, të regjistruar.

2. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, të njëjtë apo të ngjashëm, me emrin e regjistruar apo të rezervuar më parë nga një subjekt tjetër.

I njëjti ndalim zbatohet edhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo të rezervimit të emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.

3. Ndalimi, i parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi, nuk zbatohet në rastin kur titullari i ligjshëm i emrit të regjistruar apo të rezervuar më parë autorizon me shkrim, regjistrimin e emrit, që kërkohet të regjistrohet. Në këtë rast, emrit i shtohet një element me karakter dallues.

4. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, që mund të cenojë apo që është në kundërshtim me rendin publik, të tillë si emra që mund të nxisin apo përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, dhunën, emra që mund të prishin ekuilibrin shoqëror, që garanton dhe mbron tërësinë e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, drejtësinë shoqërore, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar, trashëgiminë kombëtare, bashkëjetesën fetare e etnike, si dhe emra që bien në kundërshtim me rendin publik, në çdo kuptim tjetër, që mund t’i jepet këtij termi nga legjislativi në fuqi.

I njëjti ndalim zbatohet edhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo të rezervimit të emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.

5. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, që mund të cenojë apo që është në kundërshtim me moralin publik, kuptuar si tërësia e vlerave morale e shoqërore të popullit shqiptar, të respektit ndaj dinjitetit njerëzor e familjes, emra me karakter fytes e të turpshëm, si dhe emra, që bien në kundërshtim me moralin publik, në çdo kuptim tjetër, që mund t’i jepet këtij termi nga legjislativi në fuqi.

I njëjti ndalim zbatohet edhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo të rezervimit të emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.

6. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar, për efekt regjistrimi, emra në trajtën e shquar apo akronimet përkatëse, të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare apo institucioneve të pushtetit, qendror a vendor, pa shtesa me karakter dallues.

7. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, që, shprehimisht, ndalohet nga një dispozitë urdhëruese e ligjit.

8. Ndalimet e përcaktuara në pikat 6 e 7 të këtij vendimi, zbatohen dhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo për rezervimin e emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.

9. Ndalimet, e përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, nuk zbatohen në rastin kur titullari i institucionit ka dhënë me shkrim, miratimin për përdorimin e emrit dhe emrit, që kërkohet të regjistrohet, i është shtuar një element me karakter dallues.

10. Personi fizik regjistrohet në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, me emrin dhe mbiemrin e plotë, që rezultojnë nga dokumentet e identifikimit.

11. Për miratimin e aplikimit për regjistrim, ndryshim apo rezervim të emrit të personit juridik, nëpunësi i autorizuar i QKR-së:

a) verifikon, në bazën e të dhënave elektronike të QKR-së, nëse emri, që kërkohet të regjistrohet apo rezervohet, është i njëjtë apo i ngjashëm me emrat e regjistruar apo të rezervuar më parë nga një subjekt tjetër dhe vlerëson, në bazë të rezultatit të kërkimit, karakterin dallues të emrit, që kërkohet të regjistrohet apo të rezervohet;

b) verifikon nëse emri i personit juridik, që kërkohet të regjistrohet apo rezervohet, bie në kundërshtim me ndalimet e përmendura në pikat 4 deri 9 të këtij vendimi.

12. Nëse pas verifikimeve, nëpunësi i autorizuar i QKR-së vëren se emri i personit juridik, që kërkohet të regjistrohet ose rezervohet, është i njëjtë me emrin e një personi fizik, të regjistruar më parë, është i njëjtë apo pa karakter dallues me emrin e një personi juridik, të regjistruar apo rezervuar më parë, ose bie në kundërshtim me ndalimet e përcaktuara në pikat 4 deri 9 të këtij vendimi, brenda afatit të parashikuar në nenin 55 të ligjit për QKR-në, vendos që emri të mos regjistrohet apo rezervohet dhe vepron në përputhje me vendimin nr.506, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit dhe të publikimit në QKR”. Nëse këto vërehen gjatë shqyrtimit të aplikimit për rezervim emri, QKR-ja refuzon menjëherë regjistrimin.

13. Kur emri i personit juridik, që kërkohet të regjistrohet ose rezervohet, është i njëjtë me emrin e një personi fizik, të regjistruar më parë, QKR-ja pranon regjistrimin kur personi fizik i interesuar ka dhënë me shkrim, miratimin për përdorimin e emrit. Në këtë rast, emrit të personit juridik, që kërkohet të regjistrohet, i shtohet një element me karakter dallues. Autorizimi me shkrim nuk nevojitet, kur regjistrimi apo rezervimi i emrit kryhet nga vetë personi fizik, i interesuar.

14. Ndaj vendimit të QKR-së, subjekti, të cilit i është refuzuar regjistrimi i emrit, ka të drejtë të ankohet, në rrugë administrative, brenda afateve ligjore, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ndaj vendimit përfundimtar të ankimit në rrugë administrative, ky subjekt, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile e brenda afateve ligjore, mund të ankohet në rrugë gjyqësore.

15. Çdo person i interesuar, në përputhje me ligjin për QKR-në dhe Kodin e Procedurave Administrative, ka të drejtë, brenda afateve ligjore, të ankohet, në rrugë administrative ndaj vendimit të QKR-së, për regjistrimin e emrit të personit juridik në shkelje të dispozitave të pikave 2 deri 9 të këtij vendimi.

Ndaj vendimit përfundimtar të ankimit në rrugë administrative, personi i interesuar, brenda afateve, mund të ankohet në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

16. Ndalohen njoftimi dhe botimi nga regjistri tregtar i emërtimeve apo shenjave të tjera dalluese të veprimtarisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të cilat mund të cenojnë apo të jenë në kundërshtim me rendin publik, të tilla si emërtime apo shenja, që mund të nxisin a përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, dhunën, emërtime apo shenja, që mund të prishin ekuilibrin shoqëror, që garanton dhe mbron tërësinë e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, drejtësinë shoqërore, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar, trashëgiminë kombëtare, bashkëjetesën fetare e etnike, si dhe emërtime apo shenja, që bien në kundërshtim me rendin publik, në çdo kuptim tjetër, që mund t'i jepet këtij termi nga legjislacioni në fuqi.

17. Ndalohen njoftimi dhe botimi nga regjistri tregtar, pranë QKR-së, i emërtimeve apo shenjave të tjera dalluese të veprimtarisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të cilat mund të

cenojnë apo mund të jenë në kundërshtim me moralin publik, kuptuar si tërësia e vlerave, morale e shoqërore, të popullit shqiptar, të respektit ndaj dinjitetit njerëzor e të familjes, emra me karakter fyes e të turpshëm, ose çdo kuptim tjetër, që mund t'i jepet këtij termi nga legjislacioni në fuqi.

18. Ndalohen njoftimi dhe botimi nga regjistri tregtar, pranë QKR-së, i emërtimeve apo shenjave të tjera dalluese të veprimtarisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të cilat ndalohen, shprehimisht, nga një dispozitë urdhëruese e ligjit.

19. QKR-ja, për pranimin e aplikimit për publikim të emërtimeve apo shenjave dalluese, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në, verifikon nëse emërtimi apo shenjat dalluese bien në kundërshtim të dukshëm me ndalimet e përcaktuara në pikat 16 deri 18 të këtij vendimi.

20. Nëse nëpunësi i autorizuar, pas verifikimeve të sipërpërmendura, vëren se emërtimi apo shenjat dalluese bien në kundërshtim me rregullat e parashikuara në pikat 16 deri 18 të këtij vendimi, QKR-ja refuzon publikimin.

21. Subjekti, të cilit i është refuzuar publikimi i emërtimeve apo i shenjave, ka të drejtë, që, brenda afateve ligjore, të ankohet në rrugë administrative ndaj vendimit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në dhe të Kodit të Procedurave Administrative.

Ndaj vendimit përfundimtar të ankimit në rrugë administrative, subjekti, brenda afateve ligjore, mund të ankohet në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

22. Çdo person i interesuar, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në dhe të Kodit të Procedurave Administrative, ka të drejtë të ankohet, brenda afateve ligjore, në rrugë administrative, ndaj vendimit të QKR-së për publikimin e emërtimeve apo të shenjave dalluese, në shkelje të dispozitave të pikave 16 deri 18 të këtij vendimi, si dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, mund të ankohet, brenda afateve ligjore, në rrugë gjyqësore ndaj vendimit përfundimtar të ankimit në rrugë administrative.

23. Gjatë përcaktimit të përputhshmërisë së emrit, emërtimeve apo shenjave dalluese, QKR-ja kryen vlerësimin e përputhshmërisë së emrit, emërtimeve apo shenjave, duke marrë parasysh tërësinë e tyre.

24. Regjistrimi i emrit të personit juridik i jep subjektit të drejtën ta përdorë atë në kursin e tregut, si dhe të pengojë përdorimin e tij, në mënyrë të padrejtë, nga të tretët.

25. Regjistrimi i emrit të personit juridik nuk përbën pengesë për regjistrimin nga të tretët të një shenje të ngjashme apo të njëjtë me të, si markë tregtare apo shërbimi, përveç rastit kur, në përputhje me legjislacionin për pronësinë industriale, përdorimi i emrit në kursin e tregut ka efekt pengues ndaj këtij regjistrimi.

26. Çdo person i interesuar mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cenon të drejtën e emrit, sipas nenit 5 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

27. Çdo person i interesuar mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cenon një të drejtë, sipas legjislacionit për të drejtën e autorit.

28. Çdo person i interesuar, në bazë të nenit 638 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë e të dispozitave, që rregullojnë pronësinë industriale, mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cenon një markë të regjistruar më parë apo emrat, emërtimeve tregtare e shenjat dalluese të përdorura ligjërisht më parë nga të tretët (pavarësisht publikimit të tyre në regjistrin tregtar, sipas ligjit për QKR-në).

29. Çdo person i interesuar mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai, sipas legjislacionit në fuqi, cenon një të drejtë tjetër të të tretëve.

30. Publikimi i emërtimeve apo i shenjave dalluese të veprimtarisë, të njoftuar vullnetarisht, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në, ka efekt deklarativ.

31. Çdo person i interesuar, në përputhje me nenin 638 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, me dispozitat, që rregullojnë pronësinë industriale dhe të drejtën e autorit, e në rastet e

parashikuara prej këtyre dispozitave a dispozitave të tjera ligjore, ka të drejtë të ankohet, në rrugë gjyqësore, ndaj përdorimit të paligjshëm në kursin e tregut të emërtimit apo të shenjave dalluese të veprimtarisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, faqe 3327

LIGJ
Nr.9754, datë 14.6.2007

PËR PËRGJEGJËSINË PENALE TË PERSONAVE JURIDIKË

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për përgjegjësinë, procedimin penal dhe llojet e masave ndëshkuese, që merren ndaj personave juridikë, për kryerjen e veprës penale.

Neni 2
Zbatimi i ligjit penal

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave juridikë për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në Kodin Penal, në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozita të tjera penale. Në rast se nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj, ndaj personave juridikë zbatohen, gjithashtu, dispozitat e legjislacionit civilo-tregtar.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj personave juridikë të huaj, që kanë fituar personalitet juridik, sipas legjislacionit shqiptar.

3. Ky ligj nuk pengon vendosjen dhe ekzekutimin e masave të ndëshkimeve administrative nga organet tatimore dhe organet e tjera të administratës publike, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU II
BAZAT E PËRGJEGJËSISË SË PERSONAVE JURIDIKË QË KRYEJNË VEPRA PENALE

Neni 3
Përgjegjësia e personit juridik për kryerjen e veprës penale

Personi juridik ka përgjegjësi për vepra penale të kryera:

a) në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij;

b) në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik;

c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik.

Neni 4

Organe dhe përfaqësues që vepron në emër ose në dobi të personit juridik

Në kuptim të nenit 3 shkronja “a” të këtij ligji, organ dhe përfaqësues i personit juridik, që vepron në emër ose në dobi të personit juridik, është çdo person fizik, i cili, sipas ligjit ose akteve të personit juridik, është ngarkuar për përfaqësimin, drejtimin, administrimin ose kontrollin e fushës së veprimtarisë së personit juridik dhe të strukturave të tij.

Neni 5

Shndërrimi i personit juridik

Në rastin e ndryshimit të statusit ligjor, formës ose shndërrimit të personit juridik, në çdo fazë të procedimit penal, hetimet zhvillohen dhe dënimet jepen ndaj personit të ri juridik edhe për veprat penale të kryera përpara datës së shndërrimit.

Neni 6

Bashkimi i personave juridikë

Në rastin e bashkimit të personave juridikë edhe nëpërmjet përthithjes, përpara dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit nga gjykata, hetimet zhvillohen dhe dënimet jepen ndaj personit të ri juridik edhe për vepra penale të kryera përpara datës së bashkimit të tyre.

Neni 7

Ndarja e personit juridik

Në rastin e ndarjes së personit juridik përpara dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit nga gjykata, hetimet zhvillohen dhe dënimet jepen ndaj personave juridikë, që krijohen nga ndarja, edhe për vepra penale të kryera përpara datës së ndarjes së tij.

KREU III

MASAT NDËSHKUESE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË

Neni 8

Llojet e masave ndëshkuese ndaj personave juridikë

Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, jepen këto masa ndëshkuese:

- a) dënime kryesore;
- b) dënime plotësuese.

Neni 9

Dënimet kryesore

1. Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, jepen këto dënime kryesore:

- a) gjobë;
- b) mbarim i personit juridik.

2. Dënimi kryesor, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet për njësitë e qeverisjes vendore, për personat juridikë publikë dhe për partitë politike e sindikatat.

Neni 10 **Dënimet plotësuese**

1. Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, bashkë me dënimin kryesor mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese:

- a) mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik;
- b) vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar;
- c) ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike;
- ç) heqja e së drejtës së marrjes ose përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve;
- d) ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe burime financiare;
- dh) heqja e së drejtës së ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive ose operacioneve;
- e) detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.

2. Dënimet plotësuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të këtij neni, nuk zbatohen për njësitë e qeverisjes vendore, personat juridikë publikë, partitë politike dhe sindikatat.

3. Dënimet plotësuese ekzekutohen së bashku me dënimin kryesor.

4. Gjykata, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 36 të Kodit Penal, vendos, në çdo rast, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe të produkteve të veprës penale.

Neni 11 **Dënimi me gjobë**

1. Dënimi me gjobë, në kuptim të nenit 9 të këtij ligji, konsiston në pagimin, në favor të shtetit, të një shume të hollash, brenda kufijve të parashikuar në këtë ligj.

2. Shlyerja e dënimin me gjobë bëhet nga pasuritë e personit juridik të dënuar, sipas mënyrës dhe afateve që caktohen nga gjykata.

3. Në rast pamundësie apo pengese në shlyerjen e dënimin me gjobë, gjykata, me kërkesë të prokurorit, vendos ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të dënimin. Nëse personi juridik nuk disponon fonde dhe pasuri për shlyerjen e dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësojë atë me dënimin kryesor, mbarimin e personit juridik.

4. Në varësi të llojit të veprës penale zbatohen dënimet me gjobë, si më poshtë:

a) për krimet që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose burgim i përjetshëm, personi juridik dënohet me gjobë nga 25 milionë lekë deri në 50 milionë lekë;

b) për krime që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se shtatë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim, personi juridik dënohet me gjobë nga 5 milionë lekë deri në 25 milionë lekë;

c) për krime që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, maksimumi, më pak se shtatë vjet, personi juridik dënohet me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 5 milionë lekë.

5. Në rastin e përgjegjësisë së personit juridik për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, personi juridik dënohet me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 1 milion lekë.

Neni 12 **Mbarimi i personit juridik**

1. Mbarimi i personit juridik, për shkak të përgjegjësisë për kryerjen e veprës penale, jepet kur ekziston njëra nga shkaqet e mëposhtme:

- a) është themeluar me qëllim kryerjen e veprës penale;

b) ka përdorur në një masë të rëndësishme fushën e veprimtarisë së tij për t'i shërbyer kryerjes së veprës penale;

c) kanë ardhur pasoja të rënda nga kryerja e veprës penale.

2. Mbarimi i personit juridik, për shkak të përgjegjësisë për kryerjen e veprës penale, mund të jepet edhe në rastet e kryerjes së veprës penale më shumë se një herë dhe për rrethana të tjera rënduese, sipas Kodit Penal dhe dispozitave të tjera penale.

3. Vendimi për mbarimin e personit juridik realizohet nëpërmjet procedurave për likuidimin e detyruar të tij nga organet kompetente, sipas ligjit. Pjesa e të ardhurave dhe e pasurive që, në përfundim të procedurës së likuidimit të detyruar të personit juridik, rezultojnë të jenë mjete apo produkte të veprës penale konfiskohen.

Neni 13

Mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik

1. Mbyllja përgjithmonë e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik jepet, kur ato janë përdorur në kryerjen e një krimi, që ka sjellë pasoja të rënda dhe çmohet se mbajtja e tyre nuk pajtohet me natyrën e veprës penale të kryer.

2. Mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik mund të jepet për një kohë nga një deri në pesë vjet.

Neni 14

Vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar

1. Vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar jepet për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se një masë e tillë ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar mund të jepet nëse:

a) personi juridik ofron shërbime dhe kryen veprimtari në interes publik;

b) për shkak të rrethanave ekonomike dhe shoqërore, që lidhen me llojin, përmasat dhe vendin ku zhvillohet veprimtaria e personit juridik, çmohet se zbatimi i dënimeve të parashikuara në nenet 12 e 13 të këtij ligji sjell pasoja të rënda në punësim, në zhvillimin ekonomik e shoqëror dhe në mbrojtjen e mjedisit.

3. Me vendosjen e personit juridik në administrim të kontrolluar, gjykata përcakton administratorin apo administratorët, detyrat dhe kompetencat e të cilëve lidhen vetëm me ato fusha të veprimtarisë, që janë themeluar ose përdorur për kryerjen e veprave penale.

4. Brenda kompetencave të përcaktuara nga gjykata, administratori kujdeset edhe për zbatimin dhe përmbushjen me sukses të modeleve të organizimit dhe kontrollit efektiv për parandalimin e veprës penale.

5. Administratorët, të paktën një herë në katër muaj, i paraqesin gjykatës një informacion të hollësishëm, me shkrim, për mënyrën e përmbushjes së detyrave dhe të kompetencave të tyre. Një kopje e informacionit i dërgohet edhe prokurorit.

6. Gjkata, me kërkesën e personave të interesuar apo të prokurorit, pas shqyrtimit të informacionit dhe shpjegimeve të administratorit, mund të vendosë heqjen e masës së administrimit të kontrolluar ose zëvendësimin e tij me një dënim të ri, kryesor ose plotësues.

Neni 15

Ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike

1. Ndalimi për të përfituar ose për të marrë pjesë drejtpërdrejt ose jo në transaksione dhe shpërndarje të fondeve publike, në marrëdhënie kontraktore dhe procedura të prokurimit të fondeve publike me institucione shtetërore, qendrore apo vendore, persona të tjerë juridikë publikë ose të

kontrolluar nga ata, jepet për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji, dënimi jepet për një afat jo më pak se katër vjet dhe, kur kanë ardhur pasoja të rënda, gjykata mund të vendosë ndalimin e përhershëm.

Neni 16

Heqja e së drejtës së marrjes ose e përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve

1. Heqja e së drejtës së marrjes ose e përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve dhe subvencioneve nga institucione shtetërore, qendrore apo vendore, persona të tjerë juridikë publikë ose të kontrolluar nga ata, jepet për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji, dënimi jepet për një afat jo më pak se tre vjet dhe, kur kanë ardhur pasoja të rënda, gjykata mund të vendosë që kjo e drejtë të mos ushtrohet përgjithmonë.

Neni 17

Ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe për të reklamuar veprimtarinë

1. Ndalimi i personit juridik për të kërkuar publikisht fonde, burime financiare dhe garanci, për t’iu drejtuar për këtë qëllim bankave, institucioneve financiare dhe tregut të kapitaleve, ose për të reklamuar veprimtaritë e tij, jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në tre vjet, kur çmohet se ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji, dënimi jepet për një afat jo më pak se dy vjet.

Neni 18

Ndalimi i ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive

1. Ndalimi i ushtrimit drejtpërdrejt ose jo të një ose më shumë veprimtarive jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në katër vjet, kur gjatë ushtrimit apo për shkak të këtyre veprimtarive është kryer vepra penale, ose kur çmohet se personi juridik i ka shpërdoruar ato.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji, dënimi jepet për një afat jo më pak se tre vjet.

Neni 19

Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor

1. Publikimi i vendimit gjyqësor ose i njoftimit rreth përmbajtjes së tij, nëpërmjet shtypit të shkruar, llojeve të tjera të organeve të informimit publik, shpalljeve në vende të caktuara dhe mënyrave të tjera të informimit urdhërohet nga gjykata, kur çmohet se njohja e tij publikisht ka interes për personat fizikë dhe juridikë.

2. Publikimi i pjesshëm ose tërësor i vendimit gjyqësor, mënyrat, organet e shtypit, ditët dhe kohëzgjatja e publikimit caktohen nga gjykata. Shpenzimet e publikimit të vendimit gjyqësor janë në ngarkim të personit juridik të dënuar.

3. Organet e shtypit dhe të radiotelevizionit janë të detyruara të bëjnë publikimin e vendimit gjyqësor të dërguar nga gjykata.

4. Publikimi i vendimit gjyqësor nuk bëhet kur cenohet jeta private e viktimave të veprës penale dhe e personave të tjerë, përveç rasteve kur ata japin pëlqimin, kur preket morali shoqëror ose kur rrezikohet përhapja e sekretit shtetëror.

KREU IV
RREGULLA PËR CAKTIMIN E DËNIMIT DHE REHABILITIMI

Neni 20

Rrethana lehtësuese për personat juridikë

Përveç sa parashikohet në kreun VI pjesa e përgjithshme e Kodit Penal, dënimi i personave juridikë lehtësohet kur:

- a) personi juridik ka shlyer plotësisht dëmin dhe ka eliminuar pasojat e dëmshme ose të rrezikshme të veprës penale;
- b) personi juridik ka eliminuar mangësitë organizative, që kanë sjellë si pasojë veprën penale, nëpërmjet zbatimit të modeleve organizative, të përshtatshme për parandalimin e veprës penale;
- c) personi juridik ka vënë në dispozicion të ardhurat për qëllime konfiskimi.

Neni 21

Kryerja më shumë se një herë e veprës penale

Në rastin kur gjykata vendos për përgjegjësinë e personit juridik për kryerjen e një vepre të re penale brenda pesë vjetëve nga data e kryerjes së veprës së mëparshme penale, masa e gjobës dhe koha e vuajtjes së dënimeve plotësuese, që caktohen për veprën e re penale, shtohen dy deri në tre herë, në varësi të faktit nëse veprat penale të kryera janë kundërvajtje penale ose krime.

Neni 22

Shlyerja e dënimit në rastin e ndarjes së personit juridik

1. Në rastin e ndarjes, personat juridikë që krijohen detyrohen solidarisht për shlyerjen e dënimit me gjobë, të dhënë ndaj personit juridik të ndarë, për vepra penale të kryera përpara datës së ndarjes. Detyrimi i personave juridikë caktohet në varësi të raportit të vlerës efektive të pasurisë neto, që u është transferuar nga personi juridik i ndarë, të kalimit të veprimtarive apo strukturave, që janë përdorur e që për shkak të të cilave është kryer vepra penale.

2. Dënimi për mbarimin e personit juridik dhe dënimet plotësuese zbatohen ndaj personit ose personave juridikë, që kanë trashëguar veprimtarinë ose strukturën e personit juridik të ndarë, që është përdorur apo për shkak të të cilave është kryer vepra penale.

Neni 23

Caktimi i dënimit me gjobë në rastin e bashkimit ose të ndarjes

Nëse bashkimi ose ndarja ndodhin përpara përfundimit të gjykimit, gjykata, në caktimin e dënimit me gjobë, mban parasysh kushtet ekonomike e pasurore të personit juridik, i cili është fillimisht përgjegjës.

Neni 24

Rehabilitimi

Personi juridik quhet i padënuar nëse nuk ka kryer një vepër tjetër penale brenda afateve të mëposhtme:

- a) gjatë pesë vjetëve nga data e shlyerjes së plotë të gjobës, në rastin e dënimit me gjobë;
- b) gjatë tre vjetëve nga data e ekzekutimit të tyre, në rastin e dënimeve të tjera.

KREU V
DISPOZITA PROCEDURALE

Neni 25
Personi juridik në procedimin penal

Ndaj personit juridik, që ka përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat procedurale penale për personin në hetim dhe të pandehurin.

Neni 26
Përfaqësimi i personit juridik

1. Personi juridik, që procedohet penalisht, përfaqësohet nga organi i personit juridik ose avokati i emëruar prej tij.

2. Përfaqësuesi në procedimin penal caktohet brenda 10 ditëve nga njoftimi i prokurorit, nga organet e personit juridik që, sipas ligjit dhe akteve të shoqërisë, kanë të drejtën e vendimmarrjes dhe të përfaqësimit të tij tek të tretët.

3. Përfaqësuesi i personit juridik nuk mund të jetë personi, që thirret në cilësinë e dëshmitarit ose procedohet penalisht për të njëjtën vepër penale.

4. Nëse personi juridik nuk cakton përfaqësuesin e vet brenda afatit të caktuar në pikën 2 të këtij neni, ai caktohet nga organi procedues ose gjykata.

Neni 27
Bashkimi i procedimeve

Për veprën penale të kryer nga personi juridik dhe organet apo përfaqësuesit e tij zbatohen rregullat procedurale të bashkimit të procedimeve të lidhura.

Neni 28
Veprime procedurale në fazën e gjykimit të çështjes

1. Në rastin e bashkimit të procedimeve, në fazën e gjykimit të çështjes, i pari që ka të drejtën e paraqitjes së kërtimeve është organi ose përfaqësuesi i personit juridik që ndiqet penalisht.

2. Paraqitja e provave në procedimin penal caktohet duke u mbështetur në kërkimet e organit të personit juridik ose përfaqësuesit të tij që ndiqet penalisht, pavarësisht nga ato të përfaqësuesit të personit juridik. Personi i parë që pyetet nga gjykata është organi i personit juridik ose përfaqësuesi i tij që ndiqet penalisht për të njëjtën vepër penale.

3. Në diskutimin përfundimtar, të drejtën e fjalës së fundit e ka organi i personit juridik ose përfaqësuesi i tij që ndiqet penalisht për të njëjtën vepër penale.

Neni 29
Elementet e vendimit

Në vendimin e dënimit të personit juridik, përveç elementeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, duhet të përcaktohen edhe:

- a) selia qendrore;
- b) forma e shoqërisë dhe emërtimi;
- c) numri i vendimit të regjistrimit si person juridik;
- ç) gjenealogjitetet e përfaqësuesit të tij.

Neni 30

Gjendja gjyqësore e personave juridikë

1. Dispozitat e titullit IX kreu III të Kodit të Procedurës Penale zbatohen edhe për personat juridikë të dënuar penalisht, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Kopjet e vendimeve të dhëna ndaj personave juridikë për kryerjen e veprave penale dërgohen pranë regjistrit përkatës të personave juridikë, ku ata janë të regjistruar, duke bërë edhe shënimet përkatëse, sipas ligjit.

Neni 31

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2007.

Ligj nr.9754, datë 14.6.2007 shpallur me dekretin nr.5372, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.77, faqe 2319

VENDIM

Nr.93, datë 28.2.1994

PËR BASHKIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRITË TREGTARE ME ORTAKË TË TJERË

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.466, datë 3.10.1994, nr.130, datë 20.3.1995 dhe nr.288, datë 5.6.1995)

(I përditësuar)

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë dhe të Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet, institucionet ose njësitë e tjera shtetërore, buxhetore ose jobuxhetore, që në vijim të këtij vendimi do të emërtohen “ndërmarrje”, të cilat kanë propozuar të bashkohen në një shoqëri tregtare me ortakë të tjerë, duhet të paraqesin në organin nga varen, përkatësisht në ministrinë ose institucionin tjetër qendror, ARN, bashkësinë ekonomike dhe organet e pushtetit lokal, këto dokumente:

- studim tekniko-ekonomik;
- projektkontratë;
- projektstatut;
- identiteti i ortakëve;
- kredibiliteti bankar i ortakëve;
- dokumentet e plota të vlerësimit të kontributeve.

Organet nga varet ndërmarrja duhet të paraqesin, së bashku me mendimin e tyre, dokumentet e parashikuara më sipër në Bordin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, i cili është i vetmi organ që jep miratimin për bashkimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare me ortakë të tjerë.

Ndërmarrjet mund të bashkohen vetëm në ato shoqëri tregtare ku shteti si ortak përballon humbjet deri në kurifin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

2. Në rastet kur ndërmarrjet kryejnë veprimtarinë degë me rëndësi të veçantë për ekonominë kombëtare, ministria, institucioni tjetër qendror, ARN-ja, bashkësia ekonomike, ose organet e pushtetit lokal, ia përcjellin mendimin e tyre për miratim Këshillit të Ministrave.

Degë me rëndësi të veçantë të ekonomisë kombëtare janë ato që përcaktohen në nenin 3 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

2/a Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike miraton bashkimin e ndërmarrjeve dhe bashkësive ekonomike të sistemit të saj në shoqëri tregtare në rastet e mëposhtme:

a) Për mineralet e grupit të dytë, të tretë (përveç qymyreve dhe bitumeve) dhe të katërt të përcaktuara në tabelën shoqëruese të ligjit mineral të Shqipërisë nr.7796, datë 17.2.1994.

b) Për të gjitha veprimtaritë në sektorin e naftës e të gazit, me përjashtim të rasteve kur bashkësia ekonomike Albpetrol merr pjesë në një shoqëri tregtare:

- për kërkimin dhe zbulimin e vendburimeve të naftës e të gazit;
- për nxjerrjen e naftës e të gazit, si dhe rehabilitimin e vendburimeve ekzistuese të naftës e të gazit;

- për përpunimin e naftës;

- për bashkëpunimin në fushën e gjeologjisë për kërkimin e naftës.

3. Organet nga varen ndërmarrjet, para se të vendosin bashkimin e tyre në një shoqëri tregtare me ortakë të tjerë, marrin mendimin e ministrive ose institucioneve të tjera qendrore të interesuara e të organeve të specializuara për identitetin a kredibilitetin bankar të ortakëve, si dhe për çështje të tjera të krijimit të shoqërisë tregtare. Organet shtetërore, të cilave u është kërkuar mendimi për çështjet e mësipërme, janë të detyruara të përgjigjen jo më vonë se 15 ditë nga marrja e kërkesës, pavarësisht se cili është mendimi i tyre, përfshirë edhe pamundësinë për të dhënë mendim.

4. Organi përkatës që ka vendosur për bashkimin e ndërmarrjes në shoqërinë tregtare me ortakë të tjerë, ka atributet e ortakut në këtë shoqëri në kuptimin e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, dhe në vijim të këtij vendimi do të emërtohet “ortaku shtetëror shqiptar”. Ortakët, përfaqësuesit e tyre, shoqëria tregtare etj. duhet të zbatojnë edhe sa vijon:

- Përfaqësuesi i ortakut shtetëror shqiptar emërtohet nga ky i fundit, i cili ka edhe të drejtën e shkarkimit me një vendim të motivuar. Ata mund të riemërohen.

- Ortaku shtetëror shqiptar duhet që për çdo shoqëri tregtare të caktojë ekspertë kontabël të autorizuar, në marrëveshje me ortakët e tjerë.

- Përfaqësuesi i ortakut shtetëror shqiptar duhet t’i paraqesë ortakut, periodikisht dhe detyrimisht në mbyllje të çdo viti, raport për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, të verifikuar e kontrolluar nga ekspertët kontabël të autorizuar si më sipër.

- Shteti nuk financon humbjet e shoqërive tregtare me ortak shtetëror shqiptar, përveçse me ligj, me përjashtim të rasteve të veçanta që kanë të bëjnë me subvencionimin e çmimeve të kontrolluara sipas miratimit të Këshillit të Ministrave.

- Shteti nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare me pjesëmarrjen e ortakut shtetëror shqiptar, ndaj të tretëve.

Çdo kontratë e marrëveshje ndërmjet shoqërisë tregtare me ortakun shtetëror shqiptar, nga njëra anë, dhe ortakëve e punonjësve të tjera të së njëjtës shoqëri tregtare është e ndaluar, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj ose akte nënligjore, si dhe kur ortakut shtetëror shqiptar bie dakord.

- Përfaqësuesi i ortakut shtetëror shqiptar është përgjegjës individualisht ndaj shtetit, ndaj shoqërisë tregtare dhe ndaj çdo personi të tretë për çdo shkelje që ai i bën legjislacionit në fuqi, si dhe për dëmet që mund t’i sjellë shoqërisë tregtare si pasojë e veprimtarisë së tij.

5. Dividenti që rezulton nga shoqëritë tregtare me ortak shtetëror shqiptar, ndahet mes ortakëve të shoqërisë në përputhje me përcaktimin në aktet e themelimit të saj, sipas kontributeve në kapitalin themeltar e çdo formë tjetër.

Dividenti që i takon ortakut shtetëror shqiptar, derdhet në buxhetin e shtetit.

6. Shfuqizuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.288, datë 5.6.1995.

7. Kërkesat dhe rregullat e përcaktuara në këtë vendim janë të detyrueshme të përfshihen në aktet e themelimit të shoqërive tregtare, që do të krijohen me bashkim me ndërmarrjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Të gjitha aktet nënligjore dhe dispozitat e tjera që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, faqe 277

VENDIM
Nr.288, datë 5.6.1995

PËR PRIVATIZIMIN E SË DREJTËS SHTETËRORE NË SHOQËRITË TREGTARE ME KAPITAL TË PËRBASHKËT

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Privatizimi i së drejtës shtetërore në shoqëritë tregtare me kapital të përbashkët kryhet duke u mbështetur në Kodin Civil, ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe në aktet e themelimit të shoqërive tregtare.

2. Përcaktimi i vlerës së kapitalit shtetëror gjatë procesit të privatizimit të kuotës që zotëron shteti në shoqërinë tregtare bëhet nëpërmjet ankandit.

Vlera minimale e shitjes së kuotave nuk do të jetë më e vogël se vlera e kontributeve të palës shtetërore të vendosura në momentin e themelimit të shoqërisë dhe më pas.

3. Privatizimi i së drejtës shtetërore për çdo shoqëri tregtare me kapital të përbashkët kryhet me miratim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të Ministrisë së Financave. Procedurat për realizimin e shitjes të së drejtës shtetërore kryhen nga AKP, pas marrjes së miratimit nga Këshilli i Ministrave.

4. Procesi parapërgatitor i shqyrtimit dhe përcaktimit të listave të shoqërive tregtare që do të futen në procesin e privatizimit, do të bëhet nga një grup ekspertësh të përcaktuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

5. Publikimi për shitje i pjesës shtetërore bëhet në organet e specializuara ndërkombëtare ose të vendit, sipas përcaktimit për çdo rast nga Këshilli i Ministrave.

6. Shlyerja e detyrimit nga blerësi i së drejtës shtetërore bëhet në lekë.

7. Ministria e Financave dhe AKP nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ndalohet e drejta e përfaqësuesve shtetërorë në shoqëritë e përbashkëta për të ndryshuar përqindjen e kapitalit shtetëror.

Të ndërpriten procedurat për prishjen e njëanshme të kontratave nga ana e partnerit shtetëror.

9. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.232, datë 24.5.1994 “Për privatizimin e së drejtës shtetërore në ndërmarrjet e përbashkëta” dhe pika 6 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.93, datë 28.2.1994 “Për bashkimin e së drejtës shtetërore në ndërmarrjet e përbashkëta me ortakë të tjerë”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.23, faqe 1019

VENDIM
Nr.23, datë 21.1.1999

**PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË
PRIVATIZOHEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 129, 214, 215 të ligjit nr.7638, datë 19.1.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shoqëritë tregtare, që privatizohen, të cilat janë në procesin e shitjes së paketës së aksioneve të tyre, dhe gjatë veprimtarisë rezultojnë të kenë rritur vlerën e kapitalit themeltar, e vazhdojnë të konkurrojnë në treg, punonjësit e tyre përfitojnë deri në 12 paga mujore nga fitimi neto, i realizuar, i vitit ushtrimor. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në shpërndarjen e fitimit neto të realizuar nga shoqëria tregtare, përcakton nga dividendi shumën që u takon punonjësve.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra-maj, faqe 77

VENDIM
Nr.150, datë 31.3.2000

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË
EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR**

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 167, pika 8, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël, të autorizuar, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.13, faqe 580

RREGULLA
PËR ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

KREU I
PËR ORGANIZIMIN DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT

KAPITULLI 1
ORGANIZIMI I PROFESIONIT

Neni 1

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Ekspert kontabël i autorizuar është ai profesionist i pavarur, i cili, duke qenë i regjistruar në listën e parashikuar në nenin 43 për këto rregulla, ushtron si profesion kryerjen e kontrollit të shoqërive tregtare, ndërmarrjeve apo organizatave të tjera, të cilat detyrohen nga ligji për këtë kontroll ose e kërkojnë vetë atë.

Eksperti kontabël i autorizuar kryen, gjithashtu, misionet e tjera të parashikuara për të në ligjin "Për shoqëritë tregtare" ose në ndonjë ligj tjetër të veçantë. Ai mund të kryejë si veprimtari dytësore çdo mision tjetër brenda fushës së profesionit, me përjashtim të atyre që bien në kundërshtim me pavarësinë e tij ose që me ligj i janë rezervuar një profesioni tjetër.

Neni 2

Organizmi profesional rreth të cilit grupohen ekspertët kontabël të autorizuar, ashtu sikurse përcaktohet në ligjin "Për shoqëritë tregtare", është Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, i krijuar në bazë të urdhëresës të Këshillit të Ministrave nr.1 datë 2.10.1995 dhe regjistruar me vendimin e Gjykatës të Rrethit Tiranë nr.3573, datë 16.10.1998.

- Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ose shkurt "IEKA" është person juridik me seli në Tiranë.

- Instituti ka për objekt të sigurojë mirëushtrimin e profesionit, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij, si dhe mbikëqyrjen e formimin profesional të tyre.

Administrimi i Institutit bëhet nëpërmjet organeve të veta, të krijuara a të zgjedhura nga anëtarët e tij, si dhe të organeve të tjera të krijuara pranë institutit, sipas kushteve të përcaktuara në këto rregulla.

Ai mund t'u paraqitë organeve dhe autoriteteve të pushtetit shtetëror çdo kërkesë lidhur me profesionin që përfaqëson, si dhe të thirret nga këto organe e autoritete për çështje që kanë të bëjnë me këtë profesion.

Neni 3

Shpenzimet për funksionimin administrativ të institutit përballohen me anë të kuotave të derdhura nga anëtarët e tij.

Funksionet në organet e zgjedhura të institutit nuk janë funksione të punësuarit. Megjithatë, me vendim të asamblesë së përgjithshme, anëtarëve të këtyre organeve mund t'u caktohet një shpërblim fiks për pjesëmarrje në veprimtarinë e secilit organ.

Anëtarët e komisioneve dhe të dhomave të apelit për regjistrimin dhe për disiplinën kanë të drejtën e një shpërblimi fiks për ditë të pjesëmarrjes në veprimtarinë e organit përkatës. Ky shpërblim caktohet nga Ministri i Financave, me propozimin e Këshillit të Drejtimit të Institutit.

Anëtarët e të gjitha organeve të institutit kanë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të kryera prej tyre për shërbime në interes të institutit, kundrejt paraqitjes së dokumenteve justifikues përkatës.

KAPITULLI 2 KUSHTET E PËRGJITHSHME TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT

Neni 4

(Shfuqizuar paragrafi i parë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001)

Ekspertët kontabël të autorizuar mund ta ushtrojnë profesionin e tyre ose në mënyrë të pavarur (individuale), ose të grupuar në shoqëri, apo si të punësuar tek një ekspert tjetër i pavarur ose tek një shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 5

Funksionet e ekspertit kontabël të autorizuar janë të papajtueshme me çdo angazhim ose akt të natyrës që dëmton drejtpërdrejtë a tërthorazi pavarësinë ose ndershmërinë e tij.

Përveç ndalimeve, kufizimeve dhe papajtueshmërive të përcaktuara nga ligji nr.7638, date 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” funksionet e ekspertit kontabël të autorizuar janë gjithashtu të papajtueshme me çdo post të punësuar, me çdo akt tregtie a ndërmjetësimi, me çdo mandat tregtar, madje edhe përfaqësimi gjyqësor në çështjet që interesojnë klientët e tij, me çdo punë kontrolli në një shoqëri, në të cilën ai ka drejtpërdrejt a tërthorazi interesa personale dhe me çdo veprimtari tjetër që tenton ta bëjë të varur.

Megjithatë eksperti kontabël i autorizuar mund të punojë si i punësuar te një anëtar tjetër i institutit, si dhe të japë mësim profesional në shkollë, qoftë edhe si rrogëtar.

Neni 6

Ekspertët kontabël të autorizuar i përmbahen me rreptësi sekretit profesional dhe i nënshtrohen rregullave të deontologjisë që përcaktohen në kapitullin 8 të këtyre rregullave.

Atyre u ndalohet çdo publicitet personal dhe çdo pazarllëk me qëllim konkurrence profesionale. Megjithatë ata mund të bëjnë të njohur titujt dhe diplomat e lëshuara nga:

- shteti
- një shkollë shtetërore ose private e njohur nga shteti

Instituti mund të bëjë ose të autorizojë çdo publikim kolektiv që ai e gjykon të dobishëm në interes të profesionit që përfaqëson.

Neni 7

Ushtrimi i paligjshëm i profesionit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar, si dhe përdorimi abuziv i këtij titulli, i emërtimeve të shoqërive të ekspertëve kontabël të autorizuar dhe i çfardo titujve të tjerë që synojnë të krijojnë një ngjashmëri ose një konfuzion me këta tituj a emërtime, përbëjnë një shkelje të ndëshkueshme nga ligjet dhe rregullat në fuqi, pa penguar veprimet ose sanksionet që mund të ndërmerren nga organet e Institutit.

Neni 8

Ekspertët kontabël të autorizuar krijojnë ndërmjet tyre një fond të përbashkët me kuota të caktuara për të financuar formimin profesional në fushën e kontrollit ligjor të llogarive, si dhe për të mbuluar pjesërisht përgjegjësitë personale.

Administrimi i këtij fondi është tërësisht i pavarur, i mëvetshëm dhe kryhet vetëm nga vetë anëtarët e Institutit.

KREU II FUNKSIONIMI I INSTITUTIT

KAPITULLI 3 ORGANET E DREJTIMIT DHE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË INSTITUTIT

Neni 9

Organet e drejtimit dhe të kontrollit të brendshëm të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar janë:

- asambleja e përgjithshme
- këshilli i drejtimit
- komiteti i kontrollit të brendshëm

Në rast se gjykohet e nevojshme, mund të krijohen edhe organe rajonale, sipas kushteve të përcaktuara në një rregullim të brendshëm të vetë Institutit.

SEKSIONI I ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Institutit. Ajo përbëhet nga të gjithë personat fizikë, anëtarë të Institutit. Çdo anëtar ka vetëm një mandat përfaqësimi në Asamblesën e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe orienton politikën e përgjithshme të Institutit. Ajo zgjedh dhe revokon anëtarët e këshillit të drejtimit dhe të komitetit të kontrollit të brendshëm, dëgjon raportet e tyre, vendos për llogaritë e këshillit të drejtimit, miraton rregullimet e brendshme, organigramën e Institutit dhe çdo rregullim tjetër lidhur me profesionin. Ajo vendos për ndryshimet statutore të institutit, voton për buxhetin e tij, cakton kuotat e anëtarësisë dhe përgjithësisht vendos për çdo çështje të shkruar në rendin e ditës.

Neni 11

Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit pasardhës, për të shqyrtuar e vendosur për veprimtarinë vjetore të këshillit të drejtimit dhe të komitetit të kontrollit të brendshëm. Ajo mbledhet gjithashtu sa herë që është e nevojshme për institutin, kur një gjë e tillë kërkohet nga kryetari i këshillit të drejtimit ose, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari, si dhe nga kryetari i komitetit të kontrollit të brendshëm, nga një e katërta e anëtarëve të Institutit dhe nga përfaqësuesi i mbikëqyrës.

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme caktohet nga autori i thirrjes, i cili duhet t'ua komunikojë gjithë anëtarëve me të gjitha mjetet e mundshme të informimit, të paktën një muaj përpara datës së mbledhjes. Ai tregon gjithashtu vendin e mbledhjes. Në rast urgjence ky afat mund të zbresë në dhjetë ditë.

Asambleja e Përgjithshme shqyrton vetëm çështjet e shkruara në rendin e ditës. Kryetari i këshillit të drejtimit është i detyruar të shkruajë në rendin e ditës çështjet që i janë paraqitur, të paktën 45 ditë para datës së mbledhjes, nga kryetari i komitetit të kontrollit të brendshëm, nga një e katërta e anëtarëve dhe nga përfaqësuesi mbikëqyrës.

Neni 12

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga një anëtar që nuk bën pjesë në organet e zgjedhura të Institutit, i cili zgjidhet me votim të fshehtë nga anëtarët e pranishëm në

seancën e mbajtur për këtë qëllim, mbi bazën e paraqitjes individuale të kandidaturës. Kryetari i mbledhjes zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave. Në rast votash të barabarta, zgjidhet më i moshuari.

Sekretaria e mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme sigurohet nga sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit të institutit.

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendim vetëm kur në mbledhjen e parë siguron një kuorum që përfaqëson të paktën gjysmën e anëtarëve dhe pas kësaj një numër çfarëdo të anëtarëve të pranishëm, me kusht që mbledhja e dytë të bëhet të paktën 15 ditë pas datës së mbledhjes së mëparshme të parashikuar dhe me të njëjtin rend dite.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shumicë absolute të votave të paraqitura dhe të përcaktuara me votim të fshehtë.

Neni 14

Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme dokumentohet me procesverbale të hartuara e të nënshkruara bashkërisht nga kryetari dhe sekretari i seancës që u komunikohet gjithë anëtarëve nga sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit të Institutit.

SEKSIONI 2 KËSHILLI I DREJTIMIT TË INSTITUTIT

Neni 15

Këshilli i Drejtimit siguron drejtimin e punës të institutit në pajtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, së cilës edhe i raporton për veprimtarinë e tij.

Këshilli i Drejtimit merr përsipër sidomos këto detyra:

1. Të sigurojë mbrojtjen e profesionit.
2. Të ndjekë respektimin e rregullave të deontologjisë dhe të bëjë plotësimin e tyre në rast se është nevoja.
3. Të marrë masat parashikuese të nevojshme për të mënjanuar çdo akt të natyrës që zhvleron profesionin.
4. Të vendosë për çdo çështje që intereson profesionin e ekspertizës kontabël dhe kontrollin ligjor të llogarive.
5. Të hartojë rregulloren e brendshme dhe organigramën e institutit si dhe të sigurojë administrimin e institutit e të pasurisë së tij.
6. Të sigurojë funksionimin e rregullt të Institutit dhe bashkërendimin e veprimtarisë së organeve të tij, si dhe kontrollin e cilësisë së punimeve të anëtarëve të Institutit.
7. Të pregatitë e të ndjekë zbatimin e buxhetit të institutit, si dhe të caktojë tabelat e tarifave orare të shpërbllimit të punëve normale të ekspertëve kontabël të autorizuar.
8. Të përfaqësojë Institutin pranë organeve të pushtetit shtetëror dhe t'u japë këtyre organeve, nëpërmjet autoritetit të mbikëqyrjes, mendimet për çështjet e kërkuara.
9. Të sigurojë, së bashku me Ministrinë e Arsimit, formimin profesional të anëtarëve të tij dhe atë të stazhierëve, organizimin dhe zhvillimin e provimeve profesionale, si dhe zbatimin e rregullave për stazhin e stazhierëve.
10. Të procedojë në kryerjen e çdo studimi që është në kompetencë të tij, të kërkuar nga organet ose autoritetet shtetërore.
11. Të ushtrojë përpara çdo gjykate të gjitha të drejtat e palës civile lidhur me faktet që i sjellin dëm drejtpërdrejt a tërthorazi interesave kolektive të profesionit.

12. Të arbitrojë dhe të zgjidhë me pajtim çdo konflikt ose mosmarrëveshje të karakterit profesional.

Neni 16

Këshilli i drejtimit përbëhet nga 6 deri në 8 anëtarë dhe strukturohet si vijon:

- kryetari;
- zëvendëskryetari;
- sekretar i përgjithshëm;
- financieri
- drejtues teknik të fushave të profesionit.

Anëtarët e këshillit të drejtimit zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një afat prej tre vjetësh. Ata mund të rizgjidhen, por jo më shumë se dy herë radhazi.

Zgjedhjet e anëtarëve të këshillit të drejtimit bëhen me votim të fshehtë, në bazë të paraqitjes individuale të kandidaturës. Kandidati që fiton numrin më të madh të votave, caktohet zyrtarisht kryetar i këshillit të drejtimit. Në rast mospranimi nga ana e tij, kryetar caktohet kandidati vijues për nga numri i votave të fituara e kështu me radhë. Në rast votash të barabarta, përparësi i jepet kandidatit më të moshuar. Funkcionet e tjera të drejtimit sipas paragrafit të parë caktohen nga kryetari i këshillit të drejtimit, në marrëveshje me anëtarët e tjerë të zgjedhur.

Neni 17

Këshilli i drejtimit mbledhet sa herë që është e nevojshme, por jo më rrallë se një herë në tre muaj.

Ai mund të marrë vendime kur janë të pranishëm, jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë absolute votash të anëtarëve të këshillit, nga të cilat njëra duhet të jetë e kryetarit ose, në mungesë të tij, e zëvendëskryetarit. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit ose, në mungesë të tij, e zëvendëskryetarit janë përcaktuese.

Neni 18

Në rast revokimi, vdekjeje ose pengimi të një anëtari të këshillit të drejtimit, ky këshill mund të kooptojë deri në kryerjen e zgjedhjeve të ardhshme, një anëtar tjetër ndër kandidatet jo të zgjedhur në zgjedhjet e fundit, i cili ka fituar numrin më të madh të votave. Megjithkëtë numri i anëtarëve të kooptuar nuk duhet të jetë më shumë se dy. Në rast se ky numër tejkalohet, Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet menjëherë për të caktuar anëtarët që mungojnë, duke përfshirë edhe anëtarët e kooptuar. Anëtarët e rinj të zgjedhur përfundojnë mandatin e anëtarëve të mëparshëm.

SEKSIONI 3 KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Neni 19

Komiteti i kontrollit të brendshëm ka për detyrë të verifikojë veprimtarinë financiare të institutit, pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara në llogari me buxhetin, si dhe rregullaritetin e sinqeritetin e llogarive vjetore të këshillit të drejtimit.

Për verifikimet e kryera dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, komiteti i kontrollit të brendshëm i paraqet një raport Asamblesë së Përgjithshme të Institutit.

Anëtarët e komitetit të kontrollit të brendshëm nënshkruajnë bashkërisht raportin. Në rast mosmarrëveshjeje, secili prej tyre paraqet veças mendimet dhe vlerësimet në asamblenë e përgjithshme, e cila vendos përfundimisht.

Neni 20

Komiteti i kontrollit të brendshëm përbëhet të paktën nga dy anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për tre vjet. Ata mund të rizgjidhen, por jo më shumë se një herë.

Zgjedhja e anëtarëve të kontrollit të brendshëm bëhet me votim të fshehtë dhe me paraqitje individuale të kandidaturës. Kryetar i komitetit të kontrollit të brendshëm caktohet ai që ka fituar numrin më të madh të votave. Në rast votash të barabarta, kryetar caktohet më i moshuari.

KAPITULLI 4 ORGANET E REGJISTRIMIT DHE TË DISIPLINËS

Neni 21

Organet e regjistrimit dhe të disiplinës që krijohen pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar janë:

- komisioni i regjistrimit;
- dhoma e apelit për regjistrimin;
- komisioni i disiplinës;
- dhoma e apelit për disiplinën;

Anëtarët e këtyre organeve caktohen për tre vjet, sipas kushteve të treguara në nenet 22-28 të këtyre rregullave. Ata mund të ricaktohen.

Për çdo anëtar titullar caktohet një anëtar plotësues sipas të njëjtave kushte. Anëtarët plotësues kanë për detyrë kryesore të kryejnë shqyrtimet paraprake të çështjeve, kërkimet e nevojshme lidhur me to dhe të përgatitin raportet përkatëse. Në rast mungese ose pengimi të anëtarëve titullarë, anëtarët plotësues i zëvendësojnë ata në të gjitha funksionet e tyre.

Në ushtrimin e funksioneve të tyre anëtarët e organeve të regjistrimit dhe të disiplinës i përmbahen ruajtjes të sekretit profesional.

SEKSIONI I KOMISIONI I REGJISTRIMIT

Neni 22

Komisioni i regjistrimit ka si objekt kryesor regjistrimin dhe çregjistrimin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar nga lista e institutit, si dhe hartimin e revizionimin vjetor të kësaj liste.

Komisioni i regjistrimit përbëhet nga pesë veta:

- një kryetar, jurist i caktuar nga Ministri i Tregtisë;
- një anëtar i caktuar nga Ministri i Financave;
- një anëtar i caktuar nga Ministri i Arsimit;
- një anëtar, pedagog në shkollën e lartë në fushën e së drejtës ose të ekonomisë, i caktuar nga Ministri i Arsimit;
- një anëtar, ekspert kontabël i autorizuar, i caktuar nga Keshilli i Drejtimit i Institutit.

Neni 23

Komisioni i regjistrimit mblidhet të paktën një herë në vit për të përditësuar listën e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe aq herë sa është e nevojshme, sipas kërkesës të kryetarit të këshillit të drejtimit të institutit.

Komisioni i regjistrimit merr vendim kur në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij, ndër të cilët dy anëtarë titullarë. Vendimet merren me shumicë absolute votash. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit të komisionit është përcaktuese.

Çdo vendim i komisionit të regjistrimit i njoftohet këshillit të drejtimit të institutit dhe të interesuarit.

Vendimet për hedhjen poshtë të kërkesave për t'u regjistruar në listën e institutit duhet të jenë të motivuara.

Vendimet e komisionit të regjistrimit janë të apelueshme pranë dhomës së apelit për regjistrimin.

SEKSIONI 2 DHOMA E APELIT PËR REGJISTRIMIN

Neni 24

Dhoma e apelit për regjistrimin shqyrton ankimet ndaj vendimeve të komisionit të regjistrimit.

Ajo përbëhet nga shtatë anëtarë:

- një kryetar, jurist i caktuar nga Ministri i Drejtësisë ndër punonjësit e kësaj ministrie;
- një përfaqësues i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit ose i një organi analog me të ;
- një përfaqësues i Ministrisë së Financave;
- një përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë;
- një dekan i Fakultetit të Drejtësisë ose i Fakultetit të Ekonomisë, i caktuar nga Ministri i

Arsimit;

- një anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i caktuar nga kryetari i këtij këshilli;
- një anëtar i Këshillit të Drejtimit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, i caktuar nga kryetari i këtij këshilli.

Anëtarët e dhomës së apelit për regjistrimin nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të regjistrimit.

Neni 25

Dhoma e apelit për regjistrimin mbledhet dhe procedon sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 41 të këtyre rregullave.

SEKSIONI 3 KOMISIONI I DISIPLINËS

Neni 26

Komisioni i disiplinës ka si objekt kryesor:

- të shqyrtojë çështjet disiplinore dhe shkeljet e rregullave të deontologjisë nga anëtarët e institutit;
- të mbikëqyrë mbrojtjen e interesave të të tretëve dhe të shtetit nga shkeljet e mësipërme.

Neni 27

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001)

Komisioni i disiplinës përbëhet nga pesë anëtarë:

- një kryetar jurist, i caktuar nga Ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë;
- një anëtar, i caktuar nga Ministri i Drejtësisë;
- një anëtar, i caktuar nga Ministri i Financave;
- një anëtar, profesionist i kualifikuar në fushën e drejtimit të sipërmarrjeve, i caktuar nga Kryetari i Dhomës së Tregtisë;
- një ekspert kontabël i autorizuar, i caktuar nga Këshilli i Drejtimit të Institutit.

Neni 28

Komisioni i disiplinës merr në shqyrtim ankesat e ngritura ndaj ekspertëve kontabël të autorizuar nga çdo person i interesuar dhe duhet të vendosë brenda një afati prej dy muajsh nga data e marrjes së ankesës.

Komisioni i disiplinës merr vendim kur janë të pranishëm gjithë anëtarët e tij, ndër të cilët të paktën dy anëtarë titullarë.

Vendimet e komisionit merren me shumicë absolute votash. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit është përcaktuese. Vendimet duhet të jenë në çdo rast të motivuara.

Vendimet e komisionit të disiplinës mund të apelojnë pranë dhomës së apelit për disiplinën.

SEKSIONI 4 DHOMA E APELIT PËR DISIPLINËN

Neni 29

Dhoma e apelit për disiplinën përbëhet nga shtatë anëtarë:

- një kryetar, jurist, i caktuar nga Ministri i Financave ndër punonjësit e kësaj ministrie;
 - një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
 - një anëtar i caktuar nga Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, ose i një organi tjetër analog;
 - një anëtar i caktuar nga Ministri i Financave;
 - një anëtar i caktuar nga Kryetari i Dhomës së Tregtisë;
 - një anëtar i caktuar nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit;
 - një anëtar, ekspert kontabël i autorizuar, i caktuar nga këshilli i drejtimit të institutit.
- Anëtarët e dhomës së apelit për disiplinën nuk mund të bëjnë pjesë në komisionin e disiplinës.

Neni 30

Dhoma e apelit për disiplinën mblidhet sa herë që është e nevojshme për të shqyrtuar e marrë vendim për çështjet që i janë paraqitur. Ajo duhet të vendosë brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës për apelim.

KAPITULLI 3 ORGANI I MBIKËQYRJES

Neni 31

Mbikëqyrja shtetërore mbi Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ushtrohet nga Ministri i Financave, i cili për këtë qëllim cakton një përfaqësues titullar dhe dy përfaqësues plotësues pranë këshillit të drejtimit të institutit.

Përfaqësuesi i caktuar mban titullin “Përfaqësuesi mbikëqyrës” dhe mund të delegojë, nën përgjegjësinë e tij dhe me pëlqimin paraprak të Ministrit të Financave, të gjitha ose një pjesë të funksioneve të tij përfaqësuesve plotësues.

Neni 32

Përfaqësuesi mbikëqyrës ka si detyra kryesore:

- të mbrojtë interesat e shtetit dhe ato të të tretëve që kanë marrëdhënie me anëtarët e institutit;
- të asistojë personalisht ose me anë të përfaqësuesve plotësues në mbledhjet e këshillit të drejtimit dhe në ato të organeve të tjera të vetë institutit; ai merr çdo informacion paraprak për këto mbledhje, si dhe dokumentet përkatës;

- të bëjë rekurse kundër vendimeve të institutit dhe të organeve të tij;
- të kryejë të gjitha kontrollet e nevojshme për mbarëvajtjen e institutit.

Neni 33

(Ndryshuar fjalia e parë e pragrafit të parë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001)

Vendimet e Këshillit të Drejtimit të Institutit, me përjashtim të vendimeve për standardet profesionale, për emërimet dhe për buxhetin, janë të zbatueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ana e "Përfaqësuesit të mbikëqyrjes". Ky miratim duhet të jepet brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit të dhënë. Në mbarim të këtij afati heshtja e përfaqësuesit mbikëqyrës do të thotë miratim. Kjo duhet të tregohet në tekstin e vendimit. Refuzimi i miratimit duhet të jetë i motivuar.

Refuzimi i përfaqësuesit mbikëqyrës mund të bëjë objekt të një rekursi nga ana e këshillit të drejtimit të institutit te Ministri i Financave, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e refuzimit.

KAPITULLI 6 MBI REGJISTRIMIN NË LISTËN E EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

SEKSIONI I PROCEDURAT DHE KUSHTET E REGJISTRIMIT

Neni 34

Kërkesa për t'u regjistruar në listën e ekspertëve kontabël të autorizuar i adresohet komisionit të regjistrimit nëpërmjet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit të institutit. Ajo dorëzohet dorazi kundrejt marrjes së nënshkrimit ose dërgohet me letër rekomande me kthim përgjigje për marrje në dorëzim.

Kërkesat e paraqitura regjistrohen kronologjikisht në një libër të posaçëm të numërtuar, nënshkruar e vulosur nga "Përfaqësuesi mbikëqyrës". Në libër shënohen emri, mbiemri dhe adresa e kandidatit ose, në rastin e një shoqërie, emërtimi dhe selia e saj, si dhe data e marrjes së kërkesës dhe indentifikimi i dokumenteve që i janë bashkëlidhur asaj.

Kur dosja është e plotësuar, ajo i dërgohet kryetarit të komisionit të regjistrimit brenda dhjetë ditëve, i cili cakton një raportues ndër anëtarët plotësues të komisionit, për të mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme dhe për t'i paraqitur komisionit të regjistrimit një raport përshkruar brenda një muaji nga data e caktimit të tij.

Neni 35

(Ndryshuar pika 6 me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001)

Për t'u regjistruar në listën e ekspertëve kontabël të autorizuar kandidati duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të jetë shtetas shqiptar prej më shume se pesë vjetesh.
2. Të gëzojë të drejtat civile.
3. Të mos ketë pësuar asnjë dënim penal ose plotësues të natyrës që cenon ndershmërinë e tij.
4. Të jetë i moshës mbi 25 vjeç.
5. Të jetë titullar i diplomës së kërkuar, niveli i së cilës të jetë i barasvlershëm të paktën me diplomën universitare të shkencave ekonomike.
6. Të ketë kryer stazhin profesional prej tre vjetësh pranë një eksperti apo një shoqërie ekspertësh kontabël të autorizuar.

7. Të ketë kaluar me sukses provimin e aftësive profesionale, të organizuar bashkërisht nga Ministria e Arsimit dhe Instituti.

8. Të paraqitë garancitë e moralitetit dhe të ndershmërisë të gjykuara të mjaftueshme nga komisioni i regjistrimit.

Kandidatët që kanë diplomë të ekspertizës kontabël, përjashtohen nga kushtet e pikave 5, 6 dhe 7 të këtij neni.

Deri në dhjetor 2000, mund të përjashtohen nga kushti për stazhin profesional të parashikuar nga pika 6 më sipër, personat të cilët justifikojnë se:

- Gjatë të paktën dy vjeteve kanë qenë të angazhuar në kontrollin e llogarive në kuadrin e zgjidhjeve tranzitore të bëra me vendime të këshillit të Ministrave ose, kanë qenë të punësuar, asistentë apo bashkëpunëtorë tek shoqëri audite të huaja që operojnë në Shqipëri apo tek ekspertë kontabël të autorizuar vendas.

- Gjatë 3 vjetëve, duke filluar nga 1 janari 1994, kanë ushtruar një veprimtari profesionale që u ka mundësuar të fitojnë një përvojë të mjaftueshme në fushat financiare, kontabël dhe të kontrollit të llogarive.

Neni 36

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001)

Auditues të huaj, persona fizikë, dhe shoqëri të huaja të auditimit, që dëshirojnë të kryejnë kontrollin ligjor të llogarive të shoqërive tregtare apo të organizatave ekonomike të tjera të vendosura në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen, paraprakisht, në listën e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Audituesit e huaj, persona fizikë, regjistrohen në qoftë se provojnë që e kanë fituar titullin e audituesit, sipas kushteve të njëjtave me ekspertët kontabël vendas, nuk janë të prekur nga ndonjë masë që u ndalon ushtrimin e profesionit, kanë kaluar me sukses një provim për të drejtën shqiptare në masën që i intereson profesionit dhe kur angazhohen se do të jenë të pranishëm në Shqipëri për kohën e kryerjes së misionit.

Shoqëritë e huaja të auditimit regjistrohen në qoftë se janë shoqëri profesionale, janë të themeluara në pajtim me legjislacionin e shtetit të origjinës dhe janë të autorizuar nga ky legjislacion për kontrollin ligjor të llogarive.

Shoqëritë e huaja të auditimit mund të veprojnë sipas njërës prej mënyrave të mëposhtme:

a) Duke siguruar, për kohën e kryerjes së misionit, praninë në Republikën e Shqipërisë të audituesve, persona fizikë;

b) duke pasur të vendosur në Republikën e Shqipërisë një degë, agjenci apo zyrë, që nuk ka statusin e një shoqërie filiale;

c) duke themeluar e regjistruar në Republikën e Shqipërisë një shoqëri-filiale të zotëruar 100 për qind nga një apo më shumë shoqëri auditimi të huaja.

Në çdo rast, kontrolli ligjor i llogarive të kryhet nga dhe/ose nën përgjegjësinë e audituesve, persona fizikë, që janë anëtarë ose të punësuar të shoqërisë së huaj të auditimit, pa përjashtuar përgjegjësinë e vetë shoqërisë.

Komisioni i regjistrimit përcakton dokumentet që shoqërojnë kërkesën për regjistrimin e audituesve të huaj, persona fizikë, dhe të shoqërive të huaja të auditimit, kur këto do të veprojnë sipas shkronjave "a" dhe "b" të përmendura më sipër; kur shoqëria e huaj e auditimit do të veprojë me anë të një shoqërie filiale sipas shkronjës "c" të përmendur më sipër, të zbatohen dispozitat e nenit 37 të këtyre rregullave.

Neni 37

Shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar regjistrohen vetëm nëse janë shoqëri profesionale dhe përmbushin kërkesat e parashikuara nga ligji nr.7953, datë 21.6.1995 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Çdo kërkesë për regjistrimin e një shoqërie të ekspertëve kontabël të autorizuar paraqitet kolektivisht nga ortakët e saj. Kërkesës i bashkëlidhen:

1. Një kopje e statutit.
2. Një kërkesë të çdo ortaku që kërkon regjistrimin e shoqërisë në listën e institutit.
3. Një vërtetim të gjykatës të regjistrimit për regjistrimin e shoqërisë.
4. Një listë të drejtuesve dhe të administratorëve të shoqërisë me adresat e tyre.

Regjistrimi i shoqërive të ekspertëve kontabël të autorizuar mund të refuzohet vetëm kur statuti nuk është në pajtim me dispozitat ligjore ose rregulluese në fuqi, ose kur dokumentet e parashikuara më sipër nuk i janë paraqitur komisionit të regjistrimit.

Ankimet kundër vendimeve të komisionit të regjistrimit bëhen sipas të njëjtave kushte si për ekspertët kontabël persona fizikë.

Neni 38

(Shtesë në paragrafin e katërt me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.625, datë 12.11.2001)

Komisioni i regjistrimit shqyrton dosjen e paraqitur nga raportuesi dhe vlerëson nëse kandidati i plotëson kërkesat e parashikuara për regjistrim. Po të jetë e nevojshme, ai mund të kërkojë edhe të dhëna të tjera plotësuese.

Komisioni i regjistrimit mund të thërrasë kandidatin për ta dëgjuar. Ky i fundit mund të asistohet nga një këshilltar i zgjedhur nga vete ai.

Komisioni i regjistrimit duhet të vendosë e shumta brenda muajit nga data e dorëzimit të raportit nga raportuesi. Në mbarim të këtij afati, regjistrimi i kandidatit në listën e institutit quhet i bërë.

Nëse në datën e pranimit kandidati gjendet në një nga rastet e papajtueshmërive të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, ai nuk mund të ushtrojë profesionin e tij, në qoftë se nuk justifikon pranë komisionit dhënien fund të papajtueshmërisë, i cili informon për këtë këshillin e drejtimit të institutit. Në rast të kundërt, pas një afati prej gjashtë muajsh, kandidati quhet se është tërhequr zyrtarisht dhe komisioni me kërkesë të kryetarit të këshillit të drejtimit, kryen reregjistrimin nga lista e institutit. Personi i quajtur i "tërhequr zyrtarisht" mund të kërkojë reregjistrimin në listë, në kushtet e nenit 47 të këtyre rregullave.

Neni 39

Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga komisioni i regjistrimit, sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit njofton kryetarin e këshillit të drejtimit dhe të interesuarin.

Apelimi i vendimeve të komisionit të regjistrimit bëhet brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Ai i adresohet kryetarit të dhomës së apelit për regjistrim nëpërmjet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit:

- nga kandidati kundër vendimit të komisionit, në rastin e refuzimit të kërkesës për regjistrim;
- nga kryetari i këshillit të drejtimit kundër çdo vendimi të regjistrimit të një kandidati në listë që nuk përmbush plotësisht kërkesat ligjore a morale.

Neni 40

Brenda tetë ditëve nga data e marrjes së kërkesës për apelim, sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit njofton personat përkatës dhe kryetarin e komisionit të regjistrimit. Njoftimi bëhet me çdo mjet komunikimi, por me kthim përgjigjeje të shkruar për marrjen e tij.

Neni 41

Dhoma e apelit për regjistrimin mbledhet në seancë plenare për të shqyrtuar kërkesën për apelim në një afat jo më shumë se dy muaj nga data e njoftimit të kërkesës nga sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit.

Vendimet e dhomës së apelit për regjistrimin mund të merren kur janë të pranishëm gjithë anëtarët titullarë, ose, në rast të pengimit të tyre, anëtarët plotësues. Vendimet merren me shumicë votash. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit të dhomës është përcaktuese.

Vendimet e dhomës së apelit për regjistrim janë të formës së prerë.

Sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit bën njoftimin e vendimit, për personat e interesuar, brenda tetë ditëve nga data e marrjes së tij. Njoftimi bëhet me letër rekomande e kthim përgjigjeje, ose me çdo mënyrë tjetër komunikimi ekuivalent.

SEKSIONI 2 BETIMI

Neni 42

Para se të hyjë në funksion çdo ekspert kontabël i autorizuar duhet të bëjë betimin përpara komisionit të disiplinës.

Betimi bëhet me shkrim sipas formulës “Betohem se do të ushtroj profesionin tim me ndërgjegje dhe bindje, se do të respektoj dhe do të kërkoj të respektohen ligjet në të gjitha punimet e mija.

SEKSIONI 3 HARTIMI I LISTËS SË INSTITUTIT

Neni 43

(Ndryshuar paragrafi i dytë me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Lista e anëtarëve të institutit, persona fizike ose shoqëri, hartohet nga komisioni i regjistrimit dhe i dërgohet këshillit të drejtimit.

Lista hartohet sipas rendit alfabetik me tregimin, për çdo ekspert kontabël të autorizuar, të vitit të regjistrimit fillestar. Ajo është e ndarë në tre seksione: seksioni i parë për personat fizikë, seksioni i dytë për shoqëritë vendase dhe seksioni i tretë për shoqëritë e huaja. Lista e dytë përmban përveç të tjerash, emrat e adresat e ortakëve apo të aksionerëve dhe anëtarëve të organeve të drejtimit e të mbikëqyrjes. Lista e tretë përmban, emërtimin dhe adresën e selisë së shoqërive audituese të huaja dhe në rastin e zyrës së përfaqësimit apo filialit të ngritur në Republikën e Shqipërisë, si dhe emrin e adresën e personave përgjegjës të shoqërisë, të zyrës së përfaqësimit apo filialit. Këto shoqëri paraqiten në listë të ndara në tre grupe, sipas mënyrës së kryerjes së misioneve, siç është trajtuar në nenin 36 të këtyre rregullave.

Lista e anëtarëve të institutit hartohet sipas rretheve, ku ekspertët kontabël të autorizuar ose shoqëritë e tyre kanë selinë, pavarësisht nga fakti që ata mund ta ushtrojnë profesionin e tyre në të gjitha rrethet e vendit.

Neni 44

Çdo vit komisioni i regjistrimit kryen revizionimin vjetor të listës së personave të regjistruar dhe përgatit listën e datës 1 janar.

Me rastin e revizionimit vjetor komisioni hedh në listë vendimet e regjistrimit të marra gjatë vitit, fshin emrat e atyre që kanë vdekur, që kanë dhënë dorëheqjen, që kanë qenë objekt i një mase për fshirjen nga lista, ose që nuk përmbushin kushtet ligjore a rregulluese për t'u mbajtur në listë.

Neni 45

Lista e hartuar çdo vit nga komisioni shpallet përpara datës 31 janar të çdo viti në ambientet e selisë së Këshillit drejtues të institutit të caktuar për këtë qëllim.

Në të njëjtën afat sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit u dërgon kopje të listës:

- prokurorit të çdo rrethi;
- gjykatave të shkallës së parë të çdo rrethi;
- gjykatës së apelit;
- Bashkive, që i shpallin në lokalet e selisë së tyre, si dhe i publikojnë në një gazetë lokale të njoftimeve zyrtare.

SEKSIONI 4 NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË DHE RIREGJISTRIMI

Neni 46

Çdo anëtar i institutit mund të kërkojë të tërhiqet përkohësisht nga instituti. Kërkesa i adresohet komisionit të regjistrimit dhe dorëzohet ose i dërgohet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit. Ajo duhet të jetë e motivuar dhe të tregojë sidomos veprimtarinë e re që do të ndërmarrë i interesuari, si dhe datën, në të cilën ai kërkon të tërhiqet nga instituti.

Këshilli i drejtimit duhet t'ia përcjellë kërkesën komisionit të regjistrimit brenda tetë ditëve. Ky i fundit vendos me procedurë normale brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës.

I interesuari ka të drejtë të nisë veprimtarinë e re përpara marrjes së vendimit nga komisioni i regjistrimit, me kusht që të informojë për këtë me shkrim kryetarin e këshillit të drejtimit të paktën dhjetë ditë më parë, të jetë në rregull me derdhjen e kuotave të tij dhe të ketë pushuar veprimtarinë e ekspertit kontabël të autorizuar.

Komisioni i regjistrimit e quan të drejtë kërkesën dhe e heq të interesuarin nga lista e institutit, në qoftë se çmon se veprimtaria e tij e re nuk është e natyrës që u sjell dëm interesave morale të institutit.

Nga data e njoftimit të vendimit që shpall heqjen nga lista, i interesuari nuk është më anëtar i institutit. Ai nuk mund të ushtrojë në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij profesionin e ekspertit kontabël të autorizuar dhe as të përdorë këtë titull.

Heqja nga lista e institutit e kërkuar nga vetë anëtari nuk ka efekt të shuajë veprimet disiplinore për shkelje të lejuar më parë.

Neni 47

Anëtari i tërhequr nga instituti mund të kërkojë riregjistrimin e tij. Në këtë rast kushtet e aftësisë profesionale çmohen në pajtim me dispozitat në fuqi në ditën e regjistrimit të parë, ose në datën e tërheqjes së përkohëshme.

KAPITULLI 7 PROVIMI AFTËSISË PROFESIONALE

Neni 48

Për t'u paraqitur në provimin e aftësisë profesionale, kandidatët duhet të plotësojnë paraprakisht të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 35 të këtyre rregullave.

Kërkesat e kandidaturave për provimin e aftësisë profesionale i adresohen këshillit të drejtimit të institutit me anë të dorëzimit të drejtpërdrejtë në sekretariatit e përgjithshëm, ose të dërgimit me letër rekomande e kthim përgjigjeje për marrjen në dorëzim.

Neni 49

(Shtuar paragrafi i fundit me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Provimi i aftësisë profesionale përmban të paktën pesë prova të detyrueshme dhe me shkrim që kanë të bëjnë me këto disiplina:

1. Kontabiliteti, analiza e llogarive dhe revizioni kontabël.
2. E drejta civile, tregtare e shoqërive, penale dhe e punës në masën që këto interesojnë kontrollin ligjor të llogarive.
3. Normat kontabël, juridike dhe profesionale.
4. Organizimi, administrimi dhe kontrolli i brendshëm i ndërmarrjeve, duke përfshirë sistemet e informacionit dhe të informatikës.
5. Tatimet.

Çdo njëra nga këto prova vlerësohet me një notë nga 0 deri 20. Mesatarja e përgjithshme e domosdoshme për t'u kualifikuar është nga 10 deri në 20. Megjithatë çdo notë e tri provave të para më e vogël se 10 është eliminuese.

Kohëzgjatja minimum e çdo prove është katër orë.

Provimet organizohen e mbikëqyren nga një juri e posaçme e caktuar sipas nenit 50 të këtyre rregullave. Kjo juri miraton edhe programet e disiplinave të përmendura më sipër.

Neni 50

Juria e provimit përbëhet nga pesë anëtarë të caktuar me vendim të Ministrit të Arsimit:

- | | |
|--------------------------------------------------------------------------|---------|
| - një përfaqësues i Ministrit të Arsimit | kryetar |
| - një përfaqësues i Ministrit të Financave | anëtar |
| - kryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit | anëtar |
| - një përfaqësues i Institutit të Eksperteve Kontabël | anëtar |
| - një profesor i arsimit të lartë në fushën e së drejtës civile e penale | anëtar |

KAPITULLI 8 RREGULLAT E DENTOLOGJISË

Neni 51

Sigurimi i ruajtjes së pavarësisë dhe të nderit të institutit dhe dhënia e autoritetit të duhur veprimtarisë së anëtarëve të tij kërkon nga këta të fundit

- kompetencë e ndërgjegje profesionale;
- bindje dhe dinjitet;
- pavarësi morale dhe materiale.

Çdo anëtar i institutit duhet të bëjë përpjekje për zhvillimin e cilësive të mësipërme dhe zbatimin e tyre në çdo rast, duke vepruar në pajtim me traditat e vendit, me etikën profesionale dhe me dispozitat ligjore e nënligjore.

Anëtari i institutit duhet të përpiqet të zgjidhë me pajtim çdo mosmarrëveshje me kolegët e tij, dhe, nëse nuk e arrin këtë, ai mund të verë në dijeni kryetarin e këshillit të drejtimit, i cili do të luajë rolin e arbitrit për një rregullim pajtues.

Neni 52

Një anëtar i institutit mund të përdorë në ushtrimin e profesionit deri në pesë punonjës të punësuar të caktuar për kontrollin ligjor të llogarive. Emrat e të punësuarve duhet t'i komunikohen paraprakisht dhe me shkrim kryetarit të këshillit të drejtimit të institutit. Stazhierët dhe të punësuarit për punë joprofesionale nuk përfshihen në numrin e mësipërm.

Në rastin e shoqërive të ekspertëve kontabël të autorizuar, numri i të punësuarve për punë profesionale është në varësi të numrit të ekspertëve kontabël të autorizuar, ortakë të shoqërisë në kufijtë e treguar më sipër.

Neni 53

Një anëtar i institutit nuk mund të bashkëpunojë me një ekspert kontabël të autorizuar, ndaj të cilit është marrë një masë disiplinore që përmban ndalimin e ushtrimit të profesionit ose pezullimin e përkohshëm gjatë kohës së vuajtjes së dënimit.

Neni 54

Veprimtaria e anëtarëve të institutit ose e shoqërive të njohura prej tij nuk mund t'i kushtohet në pjesën më të madhe një ndërmarrjeje të vetme, një grupi financiar ose vetëm një bashkësie interesash. Ky prag quhet i arritur kur shpërblimi që merret prej ekspertit ose shoqërisë se eksperteve, tejkalon 50 për qind të të ardhurave të përgjithshme vjetore.

Anëtari i institutit nuk mund të marrë pjesë në drejtim apo administrimin e më shumë se një shoqërie të ekspertëve kontabël të autorizuar të njohur nga instituti dhe që ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri.

Neni 55

Në kohën e emërimit dhe gjatë mandatit të ekspertit kontabël të autorizuar në një shoqëri, anëtari i institutit duhet të sigurohet që është i pavarur nga shoqëria dhe nga drejtuesit e saj dhe që asgjë nuk i sjell dëm pavarësisë dhe ndershmërisë së tij. Nëse ai çmon se është në një gjëndje që çënon pavarësinë dhe ndershmërinë e tij, duhet që t'i japë fund kësaj gjëndjeje ose duhet të japë dorëheqjen.

Neni 56

Përpara se të marrë në ngarkim një mision të ri, çdo ekspert kontabël i autorizuar duhet të informojë për këtë kryetarin e këshillit të drejtimit të institutit. Njoftimi bëhet me letër rekomande me kthim përgjigjeje. Në njoftim tregohet natyra e misionit, kushtet dhe normat e punës, kohëzgjatja e misionit, honoraret dhe mënyra e llogaritjes së tyre, si dhe emri i anëtarit të institutit që ka qenë më parë, kur ekziston një i tillë.

Mosrespektimi i këtij detyrimi sjell pezullimin e përkohshëm nga ushtrimi i profesionit. Pezullimi vendoset nga komisioni i disiplinës, duke u mbështetur në ankimin e paraqitur nga kryetari i këshillit të drejtimit të institutit.

Neni 57

Çdo ndryshim në veprimtarinë e anëtarëve të institutit duhet t'i bëhet i ditur këshillit të drejtimit brenda dhjetë ditëve, përndryshe anëtari i interesuar rrezikon të ndëshkohet nga ana disiplinore.

Neni 58

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Çdo anëtar i institutit duhet të krijojë për cdo çështje që ka në ngarkim një dosje të plotë që përmban identitetin e shoqërisë përkatëse, të drejtuesve të saj, si dhe të gjitha dokumentet e marra ose të përgatitura prej tij me rastin e ushtrimit të funksioneve të tij. Ai duhet të mbajë regjistrat profesionalë, në të cilët shënon punimet e ndryshme të kryera nga ai vetë ose nga të punësuarit e tij. Regjistrat profesionalë mbahen sipas shoqërive që ai kontrollon dhe përmbajnë të paktën datën, kohëzgjatjen dhe natyrën e punimeve të kryera, identitetin e bashkëpunëtorëve dhe të dhëna të tjera

që mundësojnë kontrollin e mëvonshëm të punimeve të kryera prej tij. Këshilli i Drejtimit organizon një herë në vit, në kohën dhe sipas modaliteteve të përcaktuara nga ai vetë, kontrollin për mbajtjen e regjistrave profesionale dhe të dosjeve nga ekspertët kontabël të autorizuar.

Mosmbajtja si duhet e dosjeve dhe e regjistrave profesionale nga ekspertët kontabël të autorizuar ndëshkohet me ndalim të përkohshëm të ushtrimit të profesionit për një periudhë kohe deri në gjashtë muaj. Kjo masë merret nga Këshilli i Drejtimit. Në rast përsëritjeje, çështja i përcillet komisionit të disiplinës, i cili vepron sipas procedurave të parashikuara në kapitullin 9 të këtyre rregullave.

Neni 59

Anëtari i institutit, i kërkuar nga një klient për të zëvendësuar një ekspert kontabël të autorizuar tjetër, mund ta pranojë misionin vetëm pasi të jetë informuar me shkrim nga ky i fundit dhe pasi të jetë siguruar që kërkesa nuk rrjedh nga dëshira e klientit për të shmangur efektet e kryerjes rigoroze të detyrave profesionale nga ana e paraardhësit, siç janë këmbëngulja për të nxjerrë në shesh të vërtetën, për të respektuar veten dhe për të kërkuar respektimin e ligjeve në punët e tij.

Ai duhet të mënjanojë çdo kritikë personale ndaj paraardhësit.

Para se të hyjë në funksion, ai duhet të ketë marrë një dokument që përlligj pagimin e honorareve paraardhësit të tij, kur kjo rezulton nga një marrëveshje qartësisht e përcaktuar, ose kur i përgjigjet tabelës së hartuar nga instituti për punimet e kryera dhe kur zbatimi i punimeve nga paraardhësi nuk është kundërshtuar nga klienti. Nëqoftëse nuk është kështu, ai mund të fillojë funksionin e tij, pasi t'ia ketë referuar çështjen kryetarit të këshillit të drejtimit dhe të ketë shfaqur rezervat e nevojshme pranë klientit të tij.

Neni 60

Anëtarëve të institutit u ndalohet të kërkojnë klientelë me anë të zbatimit të tarifave të ulëta, të akordimit klientëve ose të tretëve zbritje nga honoraret, të kryerjes së veprimeve me karakter pazarllëku në çfarëdo forme që të jetë, qoftë personalisht, qoftë nëpërmjet personave të tjerë, për llogari të tyre ose për llogari të të tretëve. Atyre u ndalohet gjithashtu të bëjnë konferenca që kanë karakter publikimi.

Neni 61

Anëtarët e institutit janë të pavarur nga administratat shtetërore, por duhet të kenë me to raporte mirësjelljeje dhe të veprojnë me ndershmëri të plotë në marrëdhëniet profesionale me përfaqësuesit e këtyre administratave.

Neni 62

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Anëtarët e institutit janë të detyruar të paguajnë një kuotë profesionale të caktuar nga asambleja e përgjithshme, e cila përcakton gjithashtu datën kufi të pagimit. Regjistrimi në listën e hartuar sipas nenit 45 përmban detyrimin për pagimin e kuotës për të gjithë vitin paraardhës. Për shoqëritë e huaja, kuota profesionale të caktohet nga Ministri i Financave, sipas të njëjtave kriteret të përcaktuara dhe për shoqëritë vendase.

Neni 63

Anëtarët e institutit janë përgjegjës për aktet e tyre profesionale. Përgjegjësia e shoqërive të ekspertëve kontabël të njohura nga instituti nuk zëvendëson përgjegjësinë personale të çdo eksperti kontabël ndaj institutit, për shkak të punimeve që ai kryen për llogari të shoqërive dhe që duhet të dalë nga nënshkrimi i tij personal, si dhe nga viza e nënshkrimi i shoqërisë.

Neni 64

Ekspertet kontabël të autorizuar duhet të kenë një qendër të përhershme vendosjeje, e cila të dihet nga këshilli i drejtimit të institutit dhe nga klientët.

Neni 65

Në rast vdekjeje të një anëtari të institutit, kryetari i këshillit të drejtimit mundet, me kërkesë të trashëgimtarëve të tij, të caktojë një anëtar të institutit që të administrojë përkohësisht kabinetin e tij, duke përcaktuar edhe kushtet e administrimit.

Neni 66

Çdo ekspert kontabël i autorizuar ose shoqëri e tyre që punëson personel të kualifikuar duhet të marrë në ngarkim stazhierë për ekspert kontabel, të sigurojë formimin e tyre profesional dhe t'i shpërblejë për punën që kryejnë.

Ekspertet kontabël stazhierë duhet të përmbushin detyrimet e stazhit dhe të punës, të thellojnë njohuritë profesionale, të jenë të bindur e të denjë për profesionin dhe t'i nënshtrohen çdo kontrolli nga ana e institutit për qëndrimin dhe punën e tyre.

Një ekspert kontabël stazhier nuk mund të pranojë një mision të propozuar nga një klient, me të cilin ka qenë në marrëdhënie me rastin e stazhit, nëse nuk kanë kaluar dy vjet nga mbarimi i stazhit, duke përjashtuar rastin kur këshilli i drejtimit është i një mendimi për një mision të tillë.

KAPITULLI 9

DISIPLINA PROFESIONALE, SANKSIONET DHE PROCEDURAT DISIPLINORE

SEKSIONI 1

DISIPLINA DHE SANKSIONET DISIPLINORE

Neni 67

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Çdo shkelje e ligjeve dhe akteve nënligjore, e statutit dhe e rregullave të brendshme të Institutit, e rregullave dhe e standardeve profesionale, çdo neglizhencë e rëndë e çdo fakti që bie në kundërshtim me bindjen ose nderin, të lejuara nga një ekspert kontabël i autorizuar, person fizik apo shoqëri, ose përbën një faj të ndëshkueshëm nga një masë disiplinore, ose penale dhe kur këto shkelje, neglizhenca apo akte nuk lidhen me ushtrimin e profesionit. Kur shkeljet përbëjnë vepër penale zbatohet neni 168 i Kodit Penal.

Neni 68

Masat disiplinore janë:

- këshillimi;

- qortimi;

- vërejtja me shënim në dosje;

- pezullim i përkohshëm për një kohë jo më shumë se pesë vjet;

- fshirja nga lista e institutit, e cila përmban ndalimin përgjithmonë të ushtrimit të profesionit.

Këshillimi, qortimi dhe vërejtja me shënim në dosje bëhen nga këshilli i drejtimit të institutit. Pezullimi i përkohshëm dhe fshirja nga lista e institutit vendosen nga komisioni i disiplinës. Pezullimi i përkohshëm mund të shoqërohet me ndëshkimin plotësues të moszgjedhjes në organet drejtuese të institutit. Pezullimi mund të jetë i përgjithshëm, ose i kufizuar në një a disa kategori shoqërisht.

Eksperti kontabël i autorizuar, objekt i një ndjekjeje disiplinore, mund të ngarkohet me shpenzimet e procedurës përkatëse.

Neni 69

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Ekspertët kontabël, të pezulluar ose të fshirë nga lista, duhet t'i kthejnë shoqërive që kontrollojnë dokumentet që ata mbanin për këto shoqëri, si dhe shumat e marra, të cilat nuk i përgjigjen një pune efektive të kryer apo shpenzimeve të rimbursueshme.

SEKSIONI 2 PROCEDURAT DISIPLINORE

Neni 70

Ankimet ndaj një anëtari të institutit merren nga këshilli i drejtimit, i cili brenda një muaji duhet t'i përcjellë përfaqësuesit mbikëqyrës dosjen e anëtarit bashkë me mendimin e këshillit. Përfaqësuesi mbikëqyrës studion çështjen nga ana e tij dhe, së bashku me vërejtjet e mendimet e tij, i rikthen dosjen këshillit të drejtimit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e marrjes.

Kryetari i këshillit të drejtimit ia kalon dosjen komisionit të disiplinës, së bashku me dokumentat në një afat e shumta prej tetë ditësh.

Neni 71

Kryetari i komisionit të disiplinës ngarkon një anëtar plotësues të bëjë kërkimet e verifikimit e duhura dhe mund t'i kërkojë të dhëna plotësuese.

Anëtari plotësues i ngarkuar mund t'u kërkojë shoqërive, në të cilat eksperti kontabël i autorizuar kryen funksionet e tij, dhe çdo personi tjetër shpjegime dhe justifikimet e nevojshme, me qëllim që të informojë komisionin e disiplinës.

Kërkimet dhe mbledhja e të dhënave të nevojshme duhet të përfundojnë e shumta për një muaj.

Neni 72

Për hapjen e një procedure disiplinore nga komisioni i disiplinës, kryetari i këtij komisioni njofton, nëpërmjet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit, kryetarin e këtij këshilli, përfaqësuesin mbikëqyrës, ekspertin kontabël të autorizuar objekt i procedurës disiplinore dhe autorin e ankesës.

Neni 73

Eksperti kontabël i autorizuar, objekt i ankesës për faj disiplinor, thirret për t'u paraqitur përpara komisionit të disiplinës nga kryetari i komisionit. Ai njoftohet të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së komisionit, me letër rekomande me kthim përgjigjeje për marrjen e njoftimit.

Në thirrje duhet të tregohen motivet, përndryshe ajo quhet e pavlefshme.

Thirrja për t'u dëgjuar nga komisioni i ekspertit kontabël u bëhet e njohur edhe personave të tjerë të përmendur në nenin 72.

Neni 74

Eksperti kontabël i autorizuar, i thirrur për t'u paraqitur përpara komisionit të disiplinës, mund të marrë dëgjimin për dosjen përkatëse. Për këtë qëllim ai mund të asistohet nga një këshilltar ose nga një avokat.

Neni 75

Kryetari i komisionit të disiplinës mund t'i kërkojë raportuesit për të paraqitur gojarisht në fillim të seancës së dëgjimit elementët e çështjes.

Komisioni i disiplinës dëgjon autorin e ankesës, nëse ky e kërkon një gjë të tillë. Ai mund të dëgjojë gjithashtu të gjithë dëshmitarët e tjerë dhe të urdhërojë kërkimin e të dhënave të tjera, nëse është e nevojshme.

Ekspertët kontabël të autorizuar, objekt i procedurës disiplinore, mund të paraqesin argumentet e tyre me shkrim ose me gojë.

Neni 76

Vendimet e komisionit të disiplinës u bëhen të njohura personave të përmendur në nenin 72, brenda 15 ditëve nga data e marrjes nëpërmjet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit.

Neni 77

Apelimi i vendimit të komisionit të disiplinës bëhet në dhomën e apelit për disiplinën, brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

Kërkesa për apelim drejtuar dhomës së apelit për disiplinën bëhet me shkrim. Ajo dorëzohet ose i dërgohet sekretarit të përgjithshëm me letër rekomande me kthim përgjigjeje për marrje.

Gjatë kohës së apelimit vendimi i komisionit mbetet pezull përveç rasteve kur komisioni i disiplinës ka vendosur masa urgjente dhe konservuese, të cilat zbatohen menjëherë.

Neni 78

Për shqyrtimin e fakteve dhoma e apelit për disiplinën ndjek të njejtat procedura si ato të parashikuara në nenet 71 deri 76 për komisionin e disiplinës.

Vendimi i dhomës së apelit për disiplinën u bëhet i njohur personave të interesuar në të njejtat kushte si ato të komisionit për disiplinën.

Kundër vendimit të dhomës së apelit për disiplinën mund të bëhet ankesë në gjykatë.

Neni 79

Sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit të institutit mban një regjistër të ekspertëve kontabël të autorizuar që kanë përbërë objekt të masave disiplinore.

Nën kujdesin e kryetarit të këshillit të drejtimit dhe me ndërmjetësinë e sekretarit të përgjithshëm, vendimet përfundimtare për pezullimin e përkohshëm ose fshirjen nga lista e institutit publikohen në një buletin zyrtar të njoftimeve civile e tregtare. Publikimi i vendimeve bëhet pa treguar motive.

Neni 80

Çdo akt ose marrëveshje që synojnë t'u japin mundësi të ushtrojnë profesionin e ekspertëve kontabël të autorizuar të pezulluar ose të fshirë nga lista e institutit, janë të pavlefshme.

KAPITULLI 10 PROGRAMI I PUNËS DHE SHPËRBLIMI

Neni 81

(Shtuar pargrafi i fundit me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Punimet e kryera nga anëtarët e institutit në ushtrimin e profesionit të tyre shpërblehen nga personat, ose shoqëritë e interesuara. Për këto punime lidhet një marrëveshje me shkrim që përcakton natyrën e misionit, punimet për t'u kryer dhe kushtet e shpërblimit.

Shpenzimet e veçanta për udhëtim e dieta, të kryera nga anëtarët e institutit për llogari të klientëve të tyre, paguhen nga këta të fundit jashtë honorareve.

Shuma e honorareve të anëtarëve të institutit vendoset në marrëveshje me klientët, por me respektimin e parashikimeve të nenit 85 të këtyre rregullave.

Shuma e honorareve duhet të jetë e arsyeshme dhe të përbëjë shpërblimin e drejtë të punës a të shërbimeve të kryera, si dhe të vështirësisë teknike të çështjeve për t'u zgjidhur, duke pasur parasysh cilësinë e tyre, titullin, emrin e mirë dhe përgjegjësinë morale e materiale të anëtarit të institutit.

Honoraret nuk mund të caktohen në asnjë rast në varësi nga rezultati financiar i klientit dhe ndërhyrjes së anëtarëve të institutit.

Honoraret paguhen në të holla dhe përjashtojnë çdo shpërblim tjetër.

Neni 82

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Këshilli i Drejtimit të Institutit duhet të mbikëqyrë, që përcaktimet për orët e punës dhe honoraret të zbatohen me korrektësi.

Kur orët e punës apo honoraret gjykohen të tepërta nga shoqëritë ose të pamjaftueshme nga eksperti, kur nuk bie dakord ndërmjet tyre, çështja i përcillet Këshillit të Drejtimit, i cili duhet të vendosë brenda një muaji.

Vendimi i Këshillit të Drejtimit mund të bëhet objekt kundërshtimi nga secila palë, pranë Komisionit të Disiplinës, i cili duhet të vendosë, gjithashtu, brenda një muaji.

Neni 83

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Për çdo mision të propozuar, eksperti ose ekspertët kontabël, të autorizuar, hartojnë një program të shkruar. Në programin e misionit përshkuhen punët verifikuese dhe punët apo veprimet e tjera të nevojshme për përmbushjen si duhet të qëllimit të misionit, përfshirë edhe ato për planifikimin, kontaktimet dhe raportimet për misionin.

Për çdo punë verifikuese dhe veprim tjetër, që përmban programi, caktohet numri i orëve të punës, i cili, kur është rasti, paraqitet edhe i ndarë sipas bashkëpunëtorëve që do të marrin pjesë në realizimin e programit. Ky program do të përmbajë edhe shumën e honorareve, si dhe shumën e parashikuar të shpenzimeve të rimbursueshme.

Programi i misionit vendoset dhe ruhet në dosjet e parashikuara nga neni 58 i këtyre rregullave.

Mungesa e programit të misionit ndëshkohet në pajtim me paragrafin e dytë të nenit 58 të këtyre rregullave.

Neni 84

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Numri i orëve të punës për kontrollin ligjor të llogarive gjatë një ushtrimi duhet të jetë normalisht sipas shifrave të treguara më poshtë:

Shuma totale e bilancit dhe e të ardhurave nga veprimtaria pa tatimin mbi vlerën e shtuar	Numri normal i orëve të punës
- Deri në 40 milionë lekë	20-35
- Nga 40 milionë deri në 100 milionë lekë	30-50
- Nga 100 milionë deri në 200 milionë lekë	40-60
- Nga 200 milionë deri në 400 milionë lekë	50-80
- Nga 400 milionë deri në 1 miliardë lekë	70-120
- Nga 1 miliardë deri në 2 miliardë lekë	100-200
- Nga 2 miliardë deri në 6 miliardë lekë	180-360
- Nga 6 miliardë deri në 16 miliardë lekë	300-700

Kufijtë që tregohen në këtë tabelë nuk janë të zbatueshme për:

1. personat juridikë, totali i shumës së bilancit dhe i të ardhurave pa TVSH-në i të cilëve është mbi 16 miliardë lekë;
2. shoqëritë që emetojnë letra me vlerë të regjistruara në kuotën zyrtare të bursës së letrave me vlerë;
3. bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet apo organizatat e ngjashme;
4. shoqëritë e sigurimeve dhe/ose risigurimeve;
5. fondet e investimeve dhe organizatat e ngjashme me to.

Për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, shuma e honorareve caktohet me marrëveshje ndërmjet ekspertit kontabël të autorizuar dhe personit juridik duke pasur parasysh rëndësinë efektive të punëve për përbushjen e misionit të kontrollit ligjor të llogarive.

Neni 85

(Ndryshuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Këshilli i Drejtimit të Institutit përcakton tarifën orare për punën normale të kontrollit ligjor të llogarive dhe ia paraqet këtë tarifë për miratim Ministrit të Financave. Kjo tarifë është e zbatueshme nga 1 janari i çdo viti.

Tarifa orare e miratuar si më sipër nuk është e detyrueshme për shoqëritë e huaja, por këto shoqëri nuk kanë të drejtë të zbatojnë një tarifë më të ulët.

Neni 86

Në rastet kur ekspertët kontabël të autorizuar do të kryejnë punime të tjera mbi ato të parashikuara në programin e caktuar fillimisht, sipas kërkesës së shoqërisë dhe të organeve gjyqësore, numri i orëve të punës mund të shtohet e shumta me një të tretën e orëve të vendosura fillimisht. Në këto raste tarifat orare të orëve suplementare caktohen lirisht ndërmjet ekspertit kontabël të autorizuar dhe kërkuarit.

Neni 87

Në rastet e ndryshimeve të indekseve ligjore të çmimeve, shpërblimi vjetor i ekspertëve kontabël të autorizuar që duhet të paguajë shoqëria për kontrollin ligjor të llogarive, ndryshon në të njëjtin përpjestim, duke nisur nga data e ndryshimit të indeksit.

Neni 88

(Shfuqizuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Neni 89

Kur eksperti kontabël i autorizuar i një shoqërie kryen në të njëjtën kohë kontrollin ligjor të

një a disa filialeve të shoqërisë, shuma e honorareve për çdo filial është e barabartë me shumën që del nga zbatimi i tabelës normale, e pakësuar me 30 për qind.

Neni 90

Në rast zëvendësimi gjatë ushtrimit ndarja e honorareve ndërmjet ekspertit kontabël të zëvendësuar dhe atij zëvendësues bëhet përpjestimisht me kohën e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre.

Neni 91

(Shfuqizuar me vendimin nr.625, datë 12.11.2001)

Neni 92

Këto rregullime hyjnë në fuqi menjëherë.

VENDIM

Nr.855, datë 17.12.2004

PËR ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE NGA SHITJA E AKTIVEVE TË QËNDRUESHME, TË TRUPËZUARA TË SHOQËRIVE ANONIME, ME KAPITAL THEMELTAR TËRËSISHT SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 22 e 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, veprimtarive të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, të nenit 10 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar dhe të nenit 164 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shitja e aktiveve të qëndrueshme, të trupëzuara të shoqërive anonime, me kapital themeltar tërësisht shtetëror, kur ato nuk i shërbejnë më veprimtarisë së tyre, të realizohet me ankand, në lekë, nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit:

a) Për pasuritë e luajtshme, miratimi i privatizimit të kryhet nga organi që i administron ato.

b) Për objektet ndërtimore, miratimi i privatizimit të bëhet nga Ministri i Ekonomisë. Ministri i Ekonomisë në urdhrin për privatizimin e objektit, pjesë e kapitalit të shoqërisë tregtare urdhëron kryerjen e veprimeve në regjistrin tregtar, për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë.

Procedura për kryerjen e veprimeve në regjistrin tregtar për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, për objektet ndërtimore, dosjet e vlerësimit të të cilave, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndodhen në Ministrinë e Ekonomisë dhe në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, të bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitjes.

2. Procedurat e vlerësimit dhe të shitjes të realizohen në përputhje me vendimin nr.159, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurat e shitjes”.

3. Të ardhurat e përfituara:

a) nga shitja e pasurive të luajtshme të ndahen si më poshtë vijon:

- 5 për qind për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;

- 95 për qind për llogari të shoqërisë anonime;

b) nga shitja e objekteve ndërtimore të shoqërive anonime me kapital themeltar tërësisht shtetëror të ndahen si më poshtë vijon:

- 5 për qind për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
- 10 për qind për llogari të Ministrisë së Ekonomisë; 85 për qind për llogari të Buxhetit të Shtetit.

4. Regjistrimet për shitjet e aktiveve të qëndrueshme, të trupëzuara, si veprim me efekt në rezultatin e shoqërisë anonime, të bëhen në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

5. Vendimi nr.417, datë 9.7.1998 i Këshillit të Ministrave “Për administrimin e të ardhurave nga shitja e aktiveve të qëndrueshme, të trupëzuara, të shoqërive anonime, me kapital themeltar tërësisht shtetëror”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.102, faqe 6806

UDHËZIM
Nr.114, datë 1.11.2005

PËR SHOQËRITË ANONIME “NË LIKUIDIM E SIPËR” ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR

Në zbatim të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës dhe ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, seksioni i V “Likuidimi”, ligji nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” i ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë,

UDHËZON:

1. Me hyrjen në fuqi të vendimit të shpalljes në likuidim të shoqërisë anonime, procedurat e likuidimit do të bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, kreu VI “Dispozita të përbashkëta për të gjitha format e shoqërive”, seksioni V “Likuidimi”.

2. Shoqëria është në likuidim nga momenti i daljes së urdhërit të zotëruesit të vetëm të kapitalit të shoqërisë. Operacionet e likuidimit kryhen nga likuidatori, i cili përfaqëson shoqërinë dhe ka për objekt mbylljen e llogarive (shkarkimin nga llogaritë të vlerave kontabël) dhe çregjistrimin e shoqërisë nga Regjistri Tregtar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

3. Me kalimin e shoqërisë në likuidim hartohet bilanci i likuidimit, i cili verifikohet dhe vërtetohet nga eksperti kontabël i autorizuar. Bilanci për efekt likuidimi miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shërben si pikënisje për operacionet e likuidimit.

4. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme do të shiten nga likuidatori i shoqërisë nëpërmjet ankandit, duke përdorur publikimin. Njoftimi për shitje publikohet në tri gazeta me qarkullim kombëtar. Periodiciteti i njoftimeve të jetë 3 herë brenda 15 ditëve.

Në çdo ankand për shitjen e pasurisë, pjesë e komisionit të tij të jetë përfaqësuesi i ministrisë (METE), si përfaqësues i pronarit shtet. Hartimi i procesverbalit të ankandit të evidentojë komisionin e ankandit, konkurruesit në ankand dhe shpalljen e fituesit. Me pagesën e plotë të vlerës së objektit në të cilën përfshihet dhe 20% i TVSH-së, lidhet kontrata e shitjes së objektit. Kontrata të përcaktojë qartë detyrimet e palëve, pagimin e taksave dhe aktin e dorëzimit të objektit. Pas çdo ankandi të raportohet në ministri, si përfaqësuese e pronarit të pronës shtetërore mbi realizimin e tij. Raporti të shoqërohet me dokumentacionin përkatës.

5. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e aktiveve të shoqërisë të jetë vlera kontabël e bilancit të shoqërisë në likuidim, e cila i përgjigjet kapitalit të nënshkruar në vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, dhe të regjistruar pranë Regjistrisë Tregtare, si dhe të gjitha vendimet për ndryshimet e kapitalit të marra nga Gjykata dhe që janë depozituar në Regjistrinë Tregtare.

Kur nuk realizohet shitja me vlerat e kontabilitetit procedohet me ekspertë vlerësues pasurie, për përcaktimin e vlerës së tregut të elementeve të pasurisë të shoqërisë. Ekspertët vlerësues të pasurisë emërohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Paguesa e tyre bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

6. Të ardhurat e realizuara nga likuidimi, si: shitja e asetëve; arkëtimi i debitorëve, të ardhura e fitime të tjera, do të shërbejnë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërisë sipas përcaktimeve në Kodin Civil.

7. Likuidatori nuk mund të lidhë kontrata dhe nuk mund të shesë me mirëkuptim, pa autorizim nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Në publikimin për shitje të pasurisë së shoqërisë në likuidim do të përfshihen edhe objektet e dhëna me qira, përpara datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

8. Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e zakonshme të parashikuara nga ligji nr.7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin”.

9. Çdo 3 muaj likuidatori raporton mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, duke dhënë llogari mbi ecurinë e operacioneve të likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tyre. Pjesë e raportimit të jenë:

- Shitjet e realizuara me vlerat sipas kontabilitetit dhe çmimeve të shitjes.
- Veças aktivet e qëndrueshme dhe veças aktivet qarkulluese, shoqëruar me kontratat e shitjes.

- Pagimin e kreditorëve (dokumente justifikuese).
- Arkëtimin e debitorëve (dokumente justifikuese).
- Situacionin e shpenzimeve të kryera (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative).
- Përcaktimin e rezultatit të likuidimit për periudhën përkatëse.

10. Kur operacionet e likuidimit kanë përfunduar, likuidatori harton bilancin financiar përfundimtar të likuidimit i cili do të shoqërohet me raportin e ekspertit kontabël të autorizuar për vërtetimin e llogarive përfundimtare të likuidimit.

11. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës vendos për llogaritë përfundimtare të likuidimit. Ai ngarkon likuidatorin për depozitim të llogarive pranë Regjistrisë Tregtare të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, dhe marrjen e vendimit për mbylljen e likuidimit dhe çregjistrimin e shoqërisë.

12. Anullohen të gjitha miratimet e privatizimit, për të cilat nuk ka filluar procedura e përgatitjes së dokumentacionit të vlerësimit, që kanë dalë para datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

13. Udhëzuesi nr.6279, datë 11.10.2004, dhe nr.7564, datë 8.12.2004 i Ministrisë së Ekonomisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli**

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.92, faqe 2965

LIGJ
Nr.8901, datë 23.5.2002

PËR FALIMENTIMIN
(Ndryshuar me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
PARIME TË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi.

Neni 2
Qëllimi i procedurës së falimentimit

1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose, në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.

Neni 3
Gjykata e rrethit gjyqësor në cilësinë e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit
(Shtuar pika 3 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 1)

1. Realizimi i procedurave të falimentimit është detyrë e seksioneve tregtare të gjykatës së rrethit (gjykata e falimentimit).

2. Shqyrtimi i çështjeve dhe marrja e vendimeve për procedurën e falimentimit bëhet nga një gjyqtar i vetëm.

3. Shqyrtimi i çështjeve duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga dorëzimi i kërkesës në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, seksioni tregtar.

Neni 4
Përgjegjësia territoriale

1. Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe gjykohet në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori, i cili është person juridik, ka vendbanimin ose selinë.

2. Nëse debitori e ka transferuar qendrën e veprimtarisë ekonomike të pavarur në një vend tjetër, përgjegjësia është vetëm e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku ndodhet qendra e re e veprimtarisë së debitorit.

3. Nëse debitori nuk ka seli ose vendbanim në Shqipëri, përgjegjësia i përket seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori ka një degë ose çdo pasuri tjetër.

4. Në rast se një procedurë falimentimi është deklaruar në përgjegjësi të disa seksioneve tregtare të gjykatave të rretheve, përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes e ka seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ku është paraqitur fillimisht kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit.

5. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, që ka përgjegjësi për të gjykuar një procedurë falimentimi, është gjykata e vetme përgjegjëse për të gjykuar paditë civile, që ngrihen për këtë procedurë falimentimi.

Neni 5

Zbatueshmëria e ligjeve të tjera

Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjeve të tjera janë të zbatueshme edhe për procedurën e falimentimit, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 6

Roli i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit heton, kryesisht, të gjitha rrethanat që kanë lidhje me procedurën e falimentimit.

2. Në mënyrë të veçantë, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të kërkojë dhe të dëgjojë për këtë qëllim dëshmitarë, specialistë dhe vetë debitorin.

Neni 7

Ankimi i veçantë

(Shtuar pika 6 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 2)

1. Vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit është menjëherë i ekzekutueshëm.

2. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit mund të bëhet ankimi i veçantë në raste dhe mënyrën e parashikuar në këtë ligj. Ankimi i veçantë, në asnjë rast, nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit.

3. Afati i ankimit të veçantë fillon nga data e shpalljes së vendimit, ose kur vendimi shpallet në mungesë të palëve, nga data kur palët marrin dijeni. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të vendosë për ankimin e veçantë.

4. Gjykata e apelit, kur çmohet prej saj, mund të urdhërojë ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit.

5. Kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda 30 ditëve.

Neni 8

Njoftimet

(Shtuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 3)

1. Njoftimet për procedurën e falimentimit bëhen kryesisht nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit me shërbim postar të shpejtë, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për njoftimet.

2. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, për kryerjen e njoftimit, mund të ngarkojë administratorin e falimentimit.

Neni 9
Shpallja publike

1. Shpalljet publike të vendimeve dhe akteve për fillimin dhe përfundimin e procedurës së falimentimit bëhen me publikimin e tyre në organet e informacionit të caktuar për njoftimet zyrtare të gjykatës.

Organet e informacionit dhe tarifa për publikimin e njoftimeve zyrtare caktohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kur çmohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, publikimi i akteve të procedurës së falimentimit mund të bëhet edhe i pjesshëm ose i shkurtuar.

3. Akti i publikuar duhet të përmbajë të dhënat e debitorit dhe, në mënyrë të veçantë, adresën dhe degën e shoqërisë ose të veprimtarisë së tij.

4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të urdhërojë publikime të tjera, madje dhe të përsëritura, të njoftimeve.

5. Shpallja publike, sipas dispozitave të këtij ligji, merret si njoftim i të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e falimentimit edhe sikur dispozita të veçanta të këtij ligji të kërkojnë njoftim të veçantë.

Neni 10
Dëgjimi i debitorit

1. Në rast se dispozita të këtij ligji parashikojnë thirrjen dhe dëgjimin para seksionit tregtar të gjykatës së rrethit të debitorit, që ka vendbanim në një shtet tjetër ose kur vendbanimi i debitorit nuk njihet, kjo gjykatë mund të vendosë të mos e kryejë këtë veprim, nëse çmon se shtyrja e seancës gjyqësore, për këto rrethana, do të shkaktonte vonesa të paarsyeshme në procedurën e falimentimit. Në këtë rast, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit thërret në seancë një përfaqësues të debitorit.

2. Kur debitori është person juridik zbatohen, sipas rastit, procedurat e thirrjes dhe të dëgjimit në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit të personave që kanë të drejtën e përfaqësimit të debitorit ose që mbajnë aksionet a pjesëmarrjet e tij.

PJESA E DYTË
HAPJA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT
SUBJEKTET PJESËMARRËSE DHE MASA E FALIMENTIMIT

KREU I
KUSHTET PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Neni 11
Pranueshmëria e hapjes së procedurës së falimentimit

1. Procedura e falimentimit mund të hapet për pasuritë e çdo personi, fizik ose juridik, si dhe për pasuritë e shoqërive të thjeshta.

2. Në rast se nuk është kryer ndarja e pasurisë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe pas prishjes ose shpërndarjes së një personi juridik ose të një shoqërie të thjeshtë.

Neni 12
Përfundime dhe dispozita të veçanta

1. Procedura e falimentimit nuk mund të hapet për pasurinë e :

- a) shtetit ose të një organi të tij;
- b) sektorëve të caktuar si strategjikë;
- c) Njësisve të qeverisjes vendore dhe organeve të tyre.

2. Procedurat e falimentimit të bankave dhe instituteve të tjera financiare rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 13

Shkaku i hapjes së procedurës së falimentimit

(Shtuar paragraf në fund të pikës 4 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 4)

1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.

2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat.

3. Nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga vetë debitori, paaftësia paguese në një të ardhme të afërt përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese në një të ardhme të afërt, kur nuk është në gjendje të paguajë ose të shlyejë detyrimet që ka në datën e maturimit.

4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë.

Procedurat për fillimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës.

5. Kriteret dhe mënyrat e përlllogaritjes së treguesve ekonomikë, mbi të cilët fillojnë procedurat e falimentimit, caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit

(Shtuar pikat 1/1 dhe 1/2 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 5)

1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë 3-vjeçare.

1/1. Autoritetet fiskale, nën juridiksionin e të cilave ndodhet debitori, brenda 30 ditëve nga konstatimi i paaftësisë paguese të debitorit, janë të detyruara të paraqesin kërkesën, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për hapjen e procedurës së falimentimit.

1/2. Organet tatimore përjashtohen nga pagimi i taksave gjyqësore. Për fillimin e procedurës së falimentimit organet tatimore paraqesin në gjykatë:

a) kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit;

b) dokumentacionin e shoqërisë (statutin, aktin e themelimit, numrin e NIPT-it);

c) bilancin me pasqyrat financiare të shoqërisë, për të cilën kërkohet fillimi i procedurës së falimentimit.

2. Kërkesa mund të tërhiqet në çdo kohë, derisa nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit nuk është dhënë vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit ose për rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit. Kur kërkesa tërhiqet, shpenzimet e bëra deri në atë kohë mbeten në ngarkim të personit që ka paraqitur kërkesën.

Neni 15

Kërkesa e debitorit

(Zëvendësuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 6/1;

zëvendësuar fjalët me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 6/2)

1. Drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit ose menjëherë pas dorëzimit të saj, duhet të paraqesë:

a) listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi, ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë;

b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga debitori duhet të përmbajë edhe një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.

3. Nëse debitori nuk i ka dorëzuar të gjitha deklaratat dhe dokumentet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit i kërkon atij plotësimin e tyre. Nëse debitori nuk e zbaton kërkesën e mësipërme brenda 15-ditëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit rrëzon kërkesën e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit.

Neni 16

E drejta dhe detyrimi i personave juridikë dhe shoqërive të thjeshta

(Shtuar paragraf në fund të pikës 1 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 7)

1. Të drejtën për të kërkuar hapjen e një procedure falimentimi për pasurinë e një personi juridik e gëzon çdo kreditor, anëtarët e organit drejtues ose edhe çdo ortak i thjeshtë ose likuidator, në rastin e shoqërive të thjeshta.

Kur ortakët ose aksionarët e shoqërisë kanë pasur gjatë veprimtarisë dijeni për paaftësinë paguese të shoqërisë dhe nuk kanë paraqitur në seksionin tregtar të gjykatës kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit, brenda një afati prej 3-mujsh, nga dita në të cilën ata kanë pasur dijeni, janë personalisht përgjegjës dhe dënohen nga autoritetet fiskale me gjobë nga 200 000 deri në 500 000 lekë.

2. Në rastin e një personi juridik, çdo anëtar i organit drejtues është i detyruar të kërkojë hapjen e menjëhershme të procedurës së falimentimit, por jo më vonë se 21 ditë nga data kur personi juridik është në gjendje paaftësie paguese, në kuptim të pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji. Këta persona janë personalisht përgjegjës për dëmshpërblimin e kreditorëve nëse kreditorët pësojnë humbje për shkak të mosparaqitjes së kërkesës brenda këtij afati 21 -ditor.

3. Nëse kërkesën nuk e paraqesin bashkërisht të gjithë anëtarët e organit drejtues, të gjithë ortakët e thjeshtë të shoqërisë së thjeshtë ose të gjithë likuidatorët, kërkesa pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit nëse janë të mjaftueshme dhe bindëse shkaqet e parashtruara për hapjen e procedurës së falimentimit. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, përpara se të marrë vendim, dëgjon anëtarët e tjerë të organit drejtues, ortakët e thjeshtë ose likuidatorët.

Neni 17

Kërkesa e kreditorit

(Shtuar fjalia pas fjalisë së parë të pikës 1 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 8)

1. Kërkesa e kreditorit pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, kur ai ka një interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit, kur paraqet kërkesën sipas ligjit dhe nëse gjykata çmon se shkaqet për hapjen e procedurës së falimentimit janë të mjaftueshme dhe bindëse për të. Vlerësohen se kanë interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit kreditori, i cili ka ndaj pasurisë së debitorit një interes me karakter pasuror dhe autoritetet fiskale. Shkaku për hapjen e procedurës së falimentimit prezumohet se ekziston nëse debitori, pavarësisht se nuk e ka kundërshtuar pretendimin, nuk e ka shlyer këtë detyrim tre muaj pas datës së maturimit të pagesës.

2. Nëse kërkesa e kreditorit pranohet, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit thërret dhe dëgjon pretendimet e debitorit.

Neni 18

Shqyrtimi i çështjes dhe dhënia e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit

(Zëvendësuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 9)

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të emërojë një specialist të veprorë si administrator i përkohshëm ose i ardhshëm i debitorit dhe i ngarkon atij këto detyra:

- a) të verifikojë nëse është real shkaku për hapjen e procedurës së falimentimit;
- b) të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit.
- c) të verifikojë nëse është e nevojshme të merren masa për sigurimin e pasurisë;
- ç) të verifikojë nëse është mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë nga debitori.

2. Gjatë shqyrtimit të çështjes, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, mund të vendosë masa sigurimi mbi pasurinë e debitorit, sipas nenit 21 të këtij ligji.

3. Shqyrtimi i çështjes nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit duhet të përfundojë në një kohë sa më të shkurtër dhe, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.

4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni, vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkakut ligjor për hapjen e procedurës së falimentimit.

b) rrëzimin e kërkesës për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit.

5. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit ose për rrëzimin e kësaj kërkesë, mund të bëhet ankim i veçantë nga debitori ose kërkuesi për hapjen e procedurës së falimentimit.

Neni 19

Rrëzimi i kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së mbetur

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit kur vërtetohet se pasuria e debitorit është e pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit, përveç kur kërkuesi parapaguan një shumë të mjaftueshme, sipas çmimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit.

2. Personi që ka bërë parapagimin, sipas pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë t'i kërkojë kthimin e shumës së parapaguar çdo personi, që në kundërshtim me detyrën dhe për faj të tij nuk ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit. Në rast se personi në fjalë kundërshton shkeljen për të cilën akuzohet dhe nuk pranon fajësinë, barra e provës i kalon atij. Pretendimi i ripagimit të shumës së parapaguar parashkruhet pas 5 vjetësh.

3. Personi juridik shpërndahet në datën kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë.

Neni 20

Detyrimi i dhënies së informacionit gjatë hapjes së procedurës së falimentimit

(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 6/1;

shtuar pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 në fund të nenit me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 10)

Kur seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos për hapjen e procedurës së falimentimit, drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit duhet t'i paraqesë kësaj gjykate të gjitha të dhënat e nevojshme, duke përmbytur detyrimet e parashikuara në nenin 15 pikat 1 dhe 2, si dhe në nenet 81, 82 dhe 85 të këtij ligji.

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtij ligji:

1. Seksioni tregtar i gjykatës mund të autorizojë, si pjesë e vendimit të fillimit të procedurës së falimentimit, administratorin e falimentimit, që të marrë hua në emër të debitorit, kur seksioni tregtar i gjykatës bindet se këto para kërkohen nga debitorit.

2. Pas nxjerrjes së vendimit të fillimit të procedurës së falimentimit, seksioni tregtar mund të autorizojë, me kërkesë të administratorit dhe me njoftimin e palëve, administratorin e falimentimit të marrë para hua në emër të debitorit dhe të deklarojë se çdo apo të gjitha pasuritë janë me barrë në favor të çdo personi që specifikohet në vendim, i cili ka rënë dakord t'i japë hua shoqërisë një shumë, e cila është miratuar nga gjykata siç është kërkuar nga shoqëria debitore.

3. Pas nxjerrjes së vendimit të fillimit të procedurës së falimentimit, sipas pikës 2 të këtij neni, çdo kreditor i shoqërisë debitore mund t'i kërkojë seksionit tregtar që ka dhënë vendimin, sipas pikës 1, ta ndryshojë atë, me kusht që kërkesa t'i njoftohet administratorit dhe kërkuesi mund të tregojë se është cenuar materialisht dhe në mënyrë të padrejtë nga vendimi i dhënë sipas pikës 1 dhe ky cenim i kapërcen përfitimet që mund të marrin të gjithë kreditorët e tjerë.

4. Në lidhje me çdo vendim të dhënë sipas pikës 2, seksioni tregtar i gjykatës mund të specifikojë në vendim se garancia ose barra radhitet mbi çdo garanci apo barrë të kreditorëve të siguruar. Në këtë rast siguria ose barra ka përparësi ndaj kreditorëve të tjerë të falimentimit.

5. Kur seksioni tregtar i gjykatës merr vendimin sipas pikave 1, 2 dhe 4, duhet të marrë parasysh ndër të tjera:

- a) periudhën gjatë së cilës shoqëria debitore pritet të deklarohet si e falimentuar;
- b) si do të drejtohet shoqëria gjatë procedurës së falimentimit;
- c) nëse administratori ka besimin e shumicës së kreditorëve;
- ç) nëse shoqëria ka mundësi që të ristrukturohet me sukses dhe nëse huaja do të rrisë gjasat e një ristrukturimi të zbatueshëm për shoqërinë;
- d) në rastin e vendimit, sipas pikave 2 dhe 4, nëse interesi i sigurisë që kërkohet është i vetmi mjet realist për shoqërinë debitore të marrë financimet e nevojshme për ristrukturim;
- dh) natyrën dhe vlerën e pasurisë; dhe
- e) nëse kreditori do të cenohet materialisht, si rezultat i vendimit të kërkuar dhe nëse ky cenim i kapërcen përfitimet që mund të marrin të gjithë kreditorët e tjerë.

6. Në vlerësimin e faktorëve të mësipërm, seksioni tregtar mund të marrë parasysh, gjithashtu, nëse çdo cenim i pësuar nga kreditori lehtësohet nga masat e sigurisë së dhënë kreditorëve, duke përfshirë:

- a) pagesat *cash* nga pasuria;
- b) dhënien e sigurisë shtesë;
- c) masa të tjera, siç mund të vendosin palët dhe gjykata.

7. Kur procedura e riorganizimit shndërrohet në likuidim, çdo përparësi e dhënë sipas paragrafit 4 në riorganizim duhet të vazhdojë të njihet në likuidim.

Neni 21

Vendosja e masave të sigurisë

(Shtuar fjalia në fund të pikës 4 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 11)

1. Derisa seksioni tregtar i gjykatës së rrethit të marrë vendim për kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit, ai vendos mbi pasuritë e debitorit çdo lloj mase, që e gjykon të nevojshme për të shmangur përkeqësimin e gjendjes financiare të debitorit në dëm të kreditorëve.

2. Në mënyrë të veçantë, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund:

- a) të vendosë ndaj debitorit kufizim të përgjithshëm disponimi ose pranimi të shlyerjes së detyrimeve ose të urdhërojë që çdo disponim i pasurisë së tij të kryhet vetëm me miratimin përfundimtar të administratorit të përkohshëm;
- b) të vendosë ndaj debitorit pezullim të përkohshëm të masave të sigurisë dhe të ekzekutimit të një të drejte të siguruar;
- c) të emërojë një administrator të përkohshëm falimentimi.

3. Masat e sigurisë mbi pasurinë e debitorit, sipas këtij neni, mund të vendosen nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit për një afat 30-ditor edhe në rastin e procedurave të ekzekutimit të një detyrimi mbi këtë pasuri nga kreditori i siguruar. Ky afat të zgjatet edhe për një afat tjetër 30-ditor, por vetëm në rast se:

a) seksioni tregtar i gjykatës së rrethit çmon se vlera e barrës siguroese është më e madhe se vlera e kredisë së siguruar dhe e shpenzimeve të ekzekutimit të këtij detyrimi të marra së bashku;

b) debitori, përpara përfundimit të afatit 30-ditor, paraqet para seksionit tregtar të gjykatës së rrethit prova të mjaftueshme për mundësinë e zbatimit të një plani riorganizimi, për realizimin e të cilit është thelbësor përdorimi i barrës siguroese.

4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos masat e sigurisë, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, jo më vonë se 15 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, masa e sigurisë mbi pasurinë e debitorit shuhet.

5. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për vendosjen e masës së sigurimit mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 22

Administratori i përkohshëm i falimentimit

(Shtuar fjalët në shkronjën "b" të pikës 1 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 12;

ndryshuar pika 4 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 13)

1. Në rast se seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi dhe i heq debitorit të drejtën e disponimit të pasurisë, e drejta e administrimit dhe e disponimit të pasurisë së debitorit i kalon administratorit të përkohshëm të falimentimit. Në këtë rast administratori i përkohshëm i falimentimit duhet:

a) të kujdeset për sigurimin dhe ruajtjen e pasurisë së debitorit;

b) të vazhdojë drejtimin e përditshëm të veprimtarinë e debitorit derisa seksioni tregtar i gjykatës së rrethit të vendosë për hapjen e procedurës së falimentimit, me përjashtim të rastit kur seksioni tregtar i gjykatës së rrethit miraton mbylljen e veprimtarisë për të shmangur humbje të mëtejshme të ndjeshme të pasurisë së debitorit;

c) të kryejë, si specialist, detyrat e caktuara në nenin 18 të këtij ligji.

2. Nëse seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi pa i hequr debitorit të drejtën e përgjithshme të disponimit, gjykata i përcakton këtij administratori edhe detyra të tilla si mbikëqyrjen e veprimeve të debitorit. Gjithashtu, i kërkon administratorit të përkohshëm të falimentimit të vërë në dijeni gjykatën nëse janë të nevojshme masa të mëtejshme.

3. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, administratori i përkohshëm i falimentimit ka të drejtën të hyjë në mjediset ku ushtron veprimtarinë debitori dhe të hetojë. Debitori duhet t'i lejojë administratorit të përkohshëm inspektimin e librave të llogarive dhe të dokumenteve të veprimtarisë dhe t'i japë atij të gjitha të dhënat e nevojshme.

4. Administratori i përkohshëm i falimentimit ka të drejtë t'u japë furnizuesve, si kreditorë të masës së falimentimit, përparësi në pagesë me mallra, shërbime ose kredi të nevojshme.

Për kryerjen e këtij veprimi, administratori i drejtohet për miratim gjykatës, e cila, kur bindet, e miraton atë nëse përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) veprimi është i vlefshëm për vazhdimin e funksionimit të një veprimtarie;

b) furnizimi me mallra, shërbime ose kredi është i pashmangshëm;

c) veprimi është i leverdishëm për rritjen e pasurisë së shoqërisë.

Në raste të ngutshme, kur miratimi i veprimit nga gjykata mund të vononte kryerjen e veprimit, administratori mund ta kryejë veprimin e sipërpërmendur edhe pa miratimin e gjykatës, me kusht që të përmbushen kriteret e paragrafit të dytë të kësaj pike.

5. Administratori i përkohshëm është përgjegjës për dëmet në të njëjtën shkallë si administratori i falimentimit, sipas nenit 47 të këtij ligji.

Neni 23

Shpallja publikisht e kufizimit të disponimit të pasurive

1. Vendimi për çdo lloj kufizimi të disponimit të pasurisë, të parashikuar në pikën 2 të nenit 21 të këtij ligji, si dhe për caktimin e një administratori të përkohshëm falimentimi, duhet të shpallet publikisht. Vendimi i njoftohet drejtpërdrejtë debitorit, çdo personi që ka pretendime ndaj debitorit dhe administratorit të përkohshëm të falimentimit. Njëkohësisht, debitorëve të debitorit u kërkohet të përmbushin detyrimet ndaj debitorit, sipas këtij vendimi.

2. Vendimi për çdo lloj kufizimi të disponimit të pasurisë u dërgohet, për të bërë shënimet përkatëse, të gjithë autoriteteve publike, të ngarkuara nga ligji, për regjistrimin e veprimtarisë së debitorit ose të një pjese a tërësisë së pasurive të tij.

Neni 24

Pasojat që rrjedhin nga kufizimi i disponimit të pasurisë

1. Janë të pavlefshme veprimet juridike të debitorit, në kundërshtim me kufizimet e disponimit të pasurisë, të parashikuara në nenin 21 të këtij ligji. Vlera e paguar i kthehet palës tjetër, në rast se pasuritë e marra vazhdojnë të përbëjnë begatim pa shkak të debitorit.

2. Nëse në kundërshtim me kufizimin e disponimit, vlerën e përfiton debitori në vend të administratorit të përkohshëm të falimentimit, paguesi shkarkohet nga detyrimi vetëm në rast se vërteton që, në kohën e pagimit të vlerës, nuk kishte dijeni për kufizimet e disponimit të debitorit.

Neni 25

Shfuqizimi i masave të sigurisë

1. Kur shfuqizohen masat e sigurisë, njoftimi dhe shpallja publike bëhen në të njëjtën mënyrë si në rastin e vendosjes së tyre.

2. Kur e drejta për disponimin e pasurisë së debitorit i ka kaluar administratorit të përkohshëm të falimentimit, ky i fundit, para mbarimit të mandatit të tij, ka për detyrë të shlyejë shpenzimet dhe detyrimet e lindura gjatë periudhës së administrimit të pasurisë prej tij.

3. Pika 2 e këtij neni zbatohet edhe për detyrimet e lindura nga kontratat nëse, në bazë të tyre, administratori i përkohshëm i falimentimit ka marrë një vlerë në favor të pasurisë së administruar prej tij.

Neni 26

Vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit

(Shtuar shkronja "d" në pikën 2 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 14)

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e tjera të parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit.

2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban :

a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave, ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personit juridik;

b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit;

c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit;

ç) të dhënat e parashikuara në nenet 27 dhe 29 të këtij ligji;

d) urdhërimin e detyrimit për publikimin e vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës.

3. Nëse vendimi nuk përcakton orën e saktë të hapjes së procedurës së falimentimit, atëherë si orë e saktë e hapjes së kësaj procedure merret ora dymbëdhjetë e ditës së shpalljes së vendimit.

4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit.

5. Rregullat e parashikuara në këtë nen nuk përjashtojnë zbatimin e detyrimeve të parashikuara në nenet 233 dhe 276 të këtij ligji.

Neni 27

Kërkesat ndaj kreditorëve dhe debitorëve

1. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit kreditorëve u kërkohet të paraqesin, brenda një afati të përcaktuar në të, tek administratori i falimentimit pretendimet e tyre, sipas nenit 141 të këtij ligji. Afati kohor për paraqitjen e pretendimeve nuk mund të jetë më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë.

2. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit, kreditorëve u kërkohet të njoftojnë menjëherë administratorin e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e siguruara që kanë mbi pasuritë e debitorit. Njoftimi i pretendimeve duhet të përmbajë të dhëna të hollësishme për sendin mbi të cilin pretendohet e drejta e siguruar, natyrën dhe shkakun e lindjes së të drejtës së siguruar dhe për pretendimet e siguruara. Kreditorët që për faj të tyre nuk japin të dhënat e kërkuara ose i japin ato me vonesë, janë përgjegjës për pasojat që vijnë nga dëmet e shkaktuara.

3. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit duhet të përcaktohet se personat që kanë detyrime ndaj debitorit duhet t'ia paguajnë dhe t'ia shlyejnë ato administratorit të falimentimit.

Neni 28

Caktimi i mbledhjeve

1. Në vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton afatet kohore për:

a) zhvillimin e mbledhjes së kreditorëve për raportim. Kjo mbledhje, që duhet të mbahet brenda 45 ditësh dhe, në çdo rast, jo më vonë se 90 ditë nga data e shpalljes së vendimit, në bazë të një raporti të administratorit të falimentimit, duhet të vendosë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së falimentimit;

b) zhvillimin e mbledhjes së kreditorëve për verifikim. Kjo mbledhje, që duhet të mbahet jo më parë se 10 ditë dhe jo më vonë se 60 ditë nga përfundimi i afatit për depozitim dhe pretendimeve, shqyrton dhe bën verifikimin e pretendimeve të depozituara.

2. Nëse kreditorët e shohin të arsyeshme, mbledhja për raportim dhe për verifikim mund të bëhet në të njëjtën kohë.

Neni 29

Shpallja publikisht e vendimit të hapjes së procedurës së falimentimit

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit shpall publikisht dhe pa vonesë vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji.

2. Ky vendim u dërgohet secilit prej kreditorëve, debitorit dhe debitorëve të debitorit.

3. Kur debitori është person fizik, me vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit atij i jepet e drejta dhe mundësia për t'u shkarkuar nga detyrimi i mbetur, në përputhje me parashikimet e neneve 249 e në vazhdim të këtij ligji.

Neni 30

Regjistri tregtar

(Zëvendësuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 15)

1. Nëse debitori është i regjistruar në regjistrin tregtar, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit i dërgon organit ku është regjistruar ku është kryer regjistrimi:

- a) një kopje të vendimit të hapjes së procedurës, nëse është hapur procedura e falimentimit;
- b) një kopje të vendimit, që hedh poshtë kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit në rast se kërkesa për hapjen e procedurës është hedhur poshtë për mungesë të shumës së mjaftueshme për falimentim.

Neni 31

Regjistri i Pasurive të Paluajtshme

1. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, duke bërë shënimet përkatëse:

- a) mbi çdo pasuri të paluajtshme, ku debitori është regjistruar si pronar;
- b) mbi të drejtat e tjera të regjistruara të debitorit mbi pasuri të paluajtshme ose të drejta të tjera të regjistruara.

2. Nëse seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ka dijeni për pasuri të paluajtshme, ku debitori është pronar ose gëzon të drejta të tjera të regjistrueshme, ai duhet të kërkojë, kryesisht, regjistrimin në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Edhe administratori i falimentimit mund të kërkojë regjistrim në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

3. Në qoftë se administratori i falimentimit tjetërson ose heq dorë nga pronësia mbi pasuri të paluajtshme ose nga të drejta të tjera të regjistruara të debitorit, mbi të cilat janë kryer veprimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ose administratori i përkohshëm i falimentimit i kërkon autoritetit përkatës përmbushjen e procedurave përkatëse në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

4. Procedurat e parashikuara në këtë nen zbatohen, sipas rastit, edhe për regjistrimin e vendimit të hapjes së procedurës së falimentimit dhe vendosjen e shënimeve përkatëse në regjistrat e tjerë, të mbajtur, sipas ligjit, nga autoritete të tjera publike, të ngarkuara me regjistrimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera të debitorit mbi sende që bëjnë pjesë në masën e falimentimit.

Neni 32

Pasojat e përfundimit të procedurës së falimentimit

1. Vendimi i gjykatës më të lartë që në bazë të ankimit të veçantë ka vendosur prishjen e vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për hapjen e procedurës së falimentimit dhe pushimin e çështjes, duhet të shpallet publikisht.

2. Përfundimi i procedurës së falimentimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk cenon pasojat juridike të veprimeve të kryera nga administratori i falimentimit ose palët e treta.

KREU II

MASA E FALIMENTIMIT. KLASIFIKIMI I KREDITORËVE

Neni 33

Kuptimi i masës së falimentimit

1. Procedura e falimentimit zbatohet mbi masën e falimentimit që përfshin të gjithë pasurinë dhe të drejtat e debitorit në datën e hapjes së procedurës së falimentimit dhe pasurinë që ai fiton gjatë zbatimit të kësaj procedure falimentimi.

2. Sendet që përjashtohen nga ekzekutimi i detyrueshëm, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, nuk përfshihen në masën e falimentimit.

3. Për mosmarrëveshjet ndërmjet debitorit dhe administratorit të falimentimit, për faktin nëse një send i përket masës së falimentimit, vendos seksioni tregtar i gjykatës së rrethit.

4. Në procedurën e falimentimit zbatohen kushtet e parashikuara në nenet 34 dhe 35 të këtij ligji, për sendet në pronësi të personave të tjerë ose sendet e ngarkuara me barrë siguroese.

Neni 34
E drejta e veçimit

1. Personi që pretendon veçimin e një sendi nga masa e falimentimit në bazë të një të drejte pronësie, mund të ushtrojë e të kërkojë njohjen dhe realizimin e së drejtës së veçimit të këtij sendi, sipas dispozitave të parashikuara jashtë procedurës së falimentimit.

2. Nëse para hapjes së procedurës së falimentimit, debitori e ka shitur sendin për të cilin pretendohet veçimi, pa marrë parasysh të drejtën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ose nëse sendin e ka shitur administratori i falimentimit pas hapjes së procedurës së falimentimit, çdo person, që ka të drejtën e veçimit, mund të kërkojë njohjen e së drejtës mbi vlerën e sendit për sa kohë që nuk është paguar vlera e tij. Pagimi i vlerës nga masa e falimentimit mund të kërkohej për aq kohë sa kjo vlerë vazhdon, në formë të dallueshme në masën e falimentimit.

Neni 35
Kreditorët e siguruar

1. Kreditorët, që nëpërmjet një veprimi juridik, kanë vendosur barrë siguroese mbi sendin ose në bazë të ligjit kanë fituar një të drejtë mbi sende të masës së falimentimit, si mjet sigurimi për pretendimet e tyre, kanë të drejtë të realizojnë shlyerjen e detyrimit nga kolaterali, në përputhje me dispozitat e zbatueshme jashtë procedurës së falimentimit, por duke iu nënshtruar përjashtimeve të pikës 2 të këtij neni dhe neneve 133 e në vazhdim të këtij ligji.

2. Në procedurën e falimentimit nuk mund të ngrihen pretendime për pengun ligjor të pronarit ose qiradhënësit për pagesë qiraje ose qiraje financiare, që mbulon një periudhë deri në dymbëdhjetë muaj, para hapjes së procedurës së falimentimit, si dhe për çdo lloj dëmshpërblimi që duhet paguar, për shkak se administratori i falimentimit ka zgjidhur këtë kontratë qiraje.

Neni 36
Kufizime për kreditorët për masën e falimentimit

1. Shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe shpenzimet e tjera administrative shlyhen nga masa e falimentimit para pretendimeve të kreditorëve të masës së falimentimit.

2. Kreditorët e masës së falimentimit duhet të ngrenë pretendimet e tyre ndaj administratorit të falimentimit dhe t'i përmbushin ato, sipas dispozitave të zbatueshme jashtë procedurës së falimentimit.

Neni 37
Shpenzimet e procedurës së falimentimit

Quhen shpenzime të procedurës së falimentimit:

- a) shpenzimet gjyqësore;
- b) shpërblimi dhe shpenzimet e administratorit të përkohshëm të falimentimit, të administratorit të falimentimit dhe të anëtarëve të komitetit të kreditorëve.

Neni 38
Shpenzimet e tjera administrative

Do të vlerësohen si shpenzime të tjera administrative shpenzimet e mëposhtme:

a) detyrimet që lindin si pasojë e veprimtarisë së administratorit të falimentimit ose në çdo mënyrë tjetër gjatë administrimit, disponimit dhe shpërndarjes së masës së falimentimit, por që nuk janë pjesë e shpenzimeve të procedurës së falimentimit;

b) detyrimet sipas kontratave, që pretendohet se duhet të paguhen në favor të masës së falimentimit ose që duhet të paguhen pas hapjes së procedurës së falimentimit;

c) detyrimet për kthimin e shumave në të holla në rastin e begatimit pa shkak të masës së falimentimit;

ç) detyrimet që lindin si pasojë e veprimtarisë së adminsitatorit të përkohshëm të falimentimit nëse ai, me miratimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, u ka dhënë përparësi në pagesë.

Neni 39

Përkufizimi i kreditorëve të falimentimit

1. Masa e falimentimit shërben për t'u paguar kreditorëve pretendimet pasurore që ata kanë ndaj debitorit në datën e hapjes së procedurës së falimentimit dhe që, në kuptim të këtij ligji, quhen kreditorë të falimentimit.

2. Pretendimet e kreditorëve të falimentimit llogariten sipas kritereve të parashikuara në nenin 40 të këtij ligji.

3. Kreditorët e falimentimit mund të ekzekutojnë pretendimet e tyre, sipas dispozitave të procedurës së falimentimit. Ata duhet të paraqesin pretendimet e tyre për verifikim, sipas neneve 141 dhe në vazhdim të këtij ligji, si dhe të marrin pjesë në shpërndarje, sipas neneve 150 e në vazhdim të këtij ligji.

Neni 40

Llogaritja e pretendimeve

1. Pretendimet e kreditorit për detyrime të pamaturuara, për efekt të procedurës së falimentimit, quhen si të maturuara. Nëse këto pretendime nuk mbartin interes, ato skontoohen, duke përdorur përqindjen e interesit ligjor, duke llogaritur që ato të reduktohen në masën që i përgjigjet shumës së plotë të këtyre pretendimeve, pasi të zbritet përqindja e interesit ligjor për periudhën nga hapja e procedurës së falimentimit deri në datën e maturimit.

2. Pretendimet që i nënshtrohen një kushti zgjidhës nuk quhen si pretendime me kusht zgjidhës në procedurën e falimentimit, përderisa kushti nuk është vërtetuar.

3. Në procedurën e falimentimit, kreditori që ka pretendime ndaj disa personave me përgjegjësi solidare mund të paraqesë një pretendim në shumën e plotë kundër secilit prej debitorëve derisa të realizojë plotësisht pretendimin në të njëjtën mënyrë, sikur të kishte pretendim për shumën e plotë në datën e hapjes së procedurës së falimentimit.

4. Pretendimi që nuk shprehet në monedhë paraqitet në një shumë, e cila vlerësohet duke u referuar në datën e hapjes së procedurës së falimentimit. Pretendimet e shprehura në monedhë të huaj ose në njësi matëse shprehen të të kthyer në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të zbatueshëm në vendin e pagesës, në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit.

5. Pretendimet për pagesa që përsëriten me shuma të caktuara dhe për periudha të caktuara paraqiten në shumën që shpreh tërësinë e të gjitha pagesave të mbetura, të cilat zbriten në mënyrën e përmendur në pikën 1 të këtij neni. Ky rregull zbatohet edhe në rastin kur periudha e këtyre pagesave është e pacaktuar.

Neni 41

Kreditorët e siguruar në rolin e kreditorëve të falimentimit

Kreditorët e siguruar gëzojnë të drejtë ripagimi të veçantë dhe quhen kreditorë falimentimi. Kreditorët e siguruar kanë të drejtë vote në mbledhjen e kreditorëve në rast se debitori personalisht duhet të shlyejë pretendimin e siguruar. Megjithatë, ata kanë të drejtën e ripagimit të pjesshëm të pretendimit të tyre nga masa e falimentimit, në zbatim të kushteve të nenit 150, vetëm në masën që nuk janë shlyer sipas të drejtës së ripagimit të veçantë ose kanë hequr dorë nga e drejta e ripagimit të veçantë.

Neni 42

Kreditorët e falimentimit të radhëve më të ulëta të preferimit

1. Pretendimet e përmendura më poshtë shlyhen pas pretendimeve të kreditorëve të falimentimit dhe në përputhje me sasinë e shumave, nëse kanë status të njëjtë:

a) interesat e fituara mbi shumat e pretendimeve të kreditorëve të falimentimit që nga koha e hapjes së procedurës së falimentimit;

b) shpenzimet e bëra nga kreditorët të veçantë të falimentimit, si rrjedhojë e pjesëmarrjes së tyre në procedurë;

c) gjopa ose pagesa që në bazë të dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Procedurave Administrative dhe Kodit Penal përbëjnë detyrime të debitorit;

ç) pretendime për kontribute pa shpërblim të debitorit.

2. Pretendimet mbi të cilat kreditori dhe debitori kanë rënë dakord të radhiten në radhët më të ulëta të preferimit përmbushen pas pretendimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, me kusht që në marrëveshjen ndërmjet tyre të mos jetë parashikuar ndryshe.

3. Interesat që fitohen në procedurën e falimentimit, mbi shumën e pretendimeve të kreditorëve të radhëve më të ulëta të preferimit, si dhe shpenzimet që bëjnë kreditorët si rrjedhojë e pjesëmarrjes në këtë procedurë, radhiten me të njëjtin status si pretendimet e këtyre kreditorëve.

KREU III

ADMINISTRATORI I FALIMENTIMIT.

ORGANET E PËRFAQËSIMIT TË KREDITORËVE

Neni 43

Caktimi i administratorit të falimentimit

(Shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 16)

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton si administrator falimentimi një person fizik të licencuar si ekspert në fushën ekonomike, i pavarur nga kreditorët dhe debitorët.

2. Administratori i falimentimit emërohet me vendimin për hapjen e procedurës së falimentimit. Në përfundim të detyrës, administratori i falimentimit duhet t'ia kthejë seksionit tregtar të gjykatës së rrethit dokumentin e emërimit.

3. Përveç parashikimeve të tjera në këtë ligj, mund të emërohet si administrator i falimentimit çdo person, i cili plotëson kriteret si më poshtë:

a) personat fizikë, të cilët kanë aftësi profesionale të përshtatshme dhe përvojë në biznes dhe janë të licencuar si ekonomistë, noterë dhe juristë, në përputhje me ligjet dhe rregullat shqiptare dhe kanë përfunduar arsimin profesional dhe provimin përkatës;

b) çdo person fizik i caktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave si administrator falimentimi në mënyrë të përkohshme për periudhën derisa numri i mjaftueshëm i administratorëve të falimentimit të përfundojnë arsimin profesional dhe provimin e parashikuar në shkronjën "a".

4. Përveç kriterëve të trajtuara në pikën 3, personat e mëposhtëm nuk mund të caktohen si administratorë falimentimi, sipas këtij ligji:

a) personat, të cilët kanë lidhje familjare ose biznesi me debitorët ose nëpunësit, drejtorët, punonjësit, aksionarët ose kreditorët e debitorit;

b) personat, të cilët kanë lidhje familjare ose biznesi me gjyqtarin kryesues;

c) personat, të cilët janë nëpunës, drejtorë, punonjës, aksionarë të konkurrentëve të drejtpërdrejtë të biznesit të debitorit;

ç) personat, të cilët kanë falimentuar në kohën e emërimit;

d) personat, të cilët, në përputhje me ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të emërohen si drejtorë të një shoqërie tregtare.

Neni 44

Zgjedhja e administratorit të falimentimit nga mbledhja e kreditorëve
(Shfuqizuar me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 17)

Neni 45

Mbikëqyrja nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit
(Shtuar paragraf në fund të pikës 1 me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 18)

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mbikëqyr veprimtarinë e administratorit të falimentimit dhe mund t'i kërkojë atij, në çdo kohë, të dhëna të veçanta ose raportime për ecurinë e procedurës së falimentimit dhe administrimin e masës së falimentimit.

Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit gjyqësor është i detyruar të kërkojë të paktën një raportim në 3 muaj.

2. Nëse çmon se administratori i falimentimit nuk i pëmbush detyrat e tij, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, pas një paralajmërimi, vendos ndaj tij një gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë. Kundër këtij vendimi administratori i falimentimit ka të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

3. Rregullat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni zbatohen edhe në rastin e mospërbushjes së detyrimit të administratorit të falimentimit për të dorëzuar pasuri në rastin kur ai shkarkohet nga detyra.

Neni 46

Shkarkimi i administratorit të falimentimit

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të shkarkojë nga detyra administratorin e falimentimit për arsye të motivuar. Shkarkimi mund të bëhet me kërkesën e vetë administratorit të falimentimit, me kërkesën e komitetit të kreditorëve ose të mbledhjes së kreditorëve. Përpara marrjes së vendimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit dëgjon shpjegimet e administratorit të falimentimit.

2. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për shkarkimin e tij, administratori i falimentimit ka të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

3. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për rrëzimin e kërkesës për shkarkimin e administratorit, kanë të drejtën e ankimit të veçantë administratori i falimentimit, komiteti i kreditorëve ose, kur propozimin për shkarkimin e tij e ka bërë mbledhja e kreditorëve, çdo kreditor falimentimi.

Neni 47

Përgjegjësitë e administratorit të falimentimit

1. Administratori i falimentimit ka për detyrë që, në ushtrimin e detyrave, të tregojë kujdes dhe të veprojë si një administrator i ndërgjegjshëm dhe i zellshëm.

2. Administratori i falimentimit është përgjegjës për dëmet që u shkaktohen palëve pjesëmarrëse në procedurën e falimentimit në rast se ai, me dashje, shkel ose nuk pëmbush detyrat që i ngarkohen nga ky ligj.

3. Nëse për përbushjen e detyrave, administratorit i duhet të angazhojë punonjësit e mëparshëm të debitorit, brenda pozicionit dhe rolit të punës që kanë pasur dhe, nëse këta punonjës vlerësohen të përshtatshëm, administratori i falimentimit nuk mban përgjegjësi për pakujdesinë e këtyre personave në ushtrimin e detyrës, por përgjigjet vetëm për mbikëqyrjen e tyre dhe për vendime të një rëndësie të veçantë.

Neni 48

Mospagimi i detyrimeve ndaj masës së falimentimit

1. Nëse pasuritë e masës së falimentimit nuk shlyejnë plotësisht një detyrim të masës së falimentimit që lind si pasojë e një veprimi juridik të administratorit të falimentimit, ky i fundit është i detyruar ta zhdëmtojë kreditorin e masës së falimentimit.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin kur administratori i falimentimit, gjatë lindjes së këtij detyrimi, nuk mund të kishte dijeni për pamjaftueshmërinë e mundshme të masës së falimentimit për të shlyer detyrimin e masës së falimentimit.

Neni 49

Parashkrimi

1. Padia për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga shkelje ose mospërmbushje të detyrimeve të administratorit të falimentimit parashkruhet pas tre vjetësh nga data kur pala e dëmtuar ka marrë dijeni për dëmin dhe për rrethanat që tregojnë përgjegjësinë e administratorit për dëmin e shkaktuar.

2. Afati i fundit për parashkrimin e padisë është tre vjet pas datës së përfundimit të procedurës së falimentimit ose pas hyrjes në fuqi të vendimit të formës së prerë të gjykatës për përfundimin e procedurës së falimentimit.

3. Pika 2 e këtij neni zbatohet për shkelje të detyrës, në kuadër të shpërndarjes së vonuar, sipas nenit 166 ose për mbikëqyrjen e zbatimit të planit, sipas nenit 223, me kushtin që mbyllja e procedurës së falimentimit të zëvendësohet, respektivisht, me ekzekutimin e shpërndarjes së vonuar dhe përfundimin e mbikëqyrjes.

Neni 50

Shpërblimi i administratorit të falimentimit

1. Administratori i falimentimit ka të drejtën e shpërblimit për punën e kryer dhe të rimbursimit për shpenzimet e bëra gjatë përmbushjes së detyrës.

2. Masa e zakonshme e shpërblimit llogaritet në bazë të vlerës së masës së falimentimit në kohën e përfundimit të procedurës së falimentimit.

3. Masa e zakonshme e shpërblimit rivlerësohet në varësi të vëllimit dhe të shkallës së vështirësisë gjatë ushtrimit të detyrës së administratorit të falimentimit.

Neni 51

Vendimet e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përcakton me vendim shpërblimin dhe shpenzimet që duhet t'i rimburohen administratorit të falimentimit.

2. Vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, me përjashtim të shumës së parashkuar, duhet të shpallet publikisht, si dhe i njoftohet personalisht administratorit të falimentimit, debitorit dhe anëtarëve të komitetit të kreditorëve, nëse është emëruar prej tyre. Në vendimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, të shpallur publikisht, duhet të vihet në dukje se teksti i plotë i këtij vendimi gjendet në sekretarinë e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit.

3. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, administratori i falimentimit, debitori dhe çdo kreditor falimentimi kanë të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 52

Rregullat e hollësishme për caktimin e shpërblimit të administratorit të falimentimit

Rregullat e hollësishme për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 53

Paraqitja e llogarive

1. Në përfundim të detyrës, administratori i falimentimit ka detyrim t'i paraqesë llogaritë në mbledhjen e kreditorëve.

2. Përpara zhvillimit të mbledhjes së kreditorëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit verifikon llogaritë përfundimtare, të përgatitura nga administratori i falimentimit, së bashku me dokumentacionin mbështetës, shoqëruar me një koment-vërejtje që tregon verifikimin e llogarive.

3. Në rastet kur është caktuar një komitet kreditorësh, llogarive përfundimtare të përgatitura nga administratori i falimentimit i bashkëlidhen edhe komentet e këtij komiteti, për përgatitjen e të cilave gjykata cakton edhe një afat kohor.

4. Periudha ndërmjet paraqitjes së dokumentacionit, sipas këtij neni dhe datës së mbajtjes së mbledhjes së kreditorëve duhet të jetë jo më e vogël se 10 ditë.

5. Mbledhja e kreditorëve mund t'i ngarkojë administratorit të falimentimit të paraqesë llogari ndërmjetëse, në data të caktuara, gjatë zbatimit të procedurës së falimentimit, duke zbatuar, sipas rastit, rregullat e parashikuara në këtë nen.

Neni 54

Caktimi i komitetit të kreditorëve

1. Para mbledhjes së parë të kreditorëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ka të drejtë të caktojë një komitet të kreditorëve.

2. Komiteti i kreditorëve duhet të përfaqësojë kreditorët e siguruar, kreditorët e falimentimit me pretendimet më të mëdha dhe kreditorët e shumave të vogla.

Në komitetin e kreditorëve duhet të marrë pjesë një përfaqësues i punonjësve të debitorit, kur këta janë kreditorë falimentimi me pretendime të ndjeshme.

3. Anëtarë të komitetit të kreditorëve mund të emërohen edhe persona që nuk janë kreditorë.

Neni 55

Zgjedhja e anëtarëve të ndryshëm të komitetit të kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve vendos nëse duhet të caktohet një komitet i kreditorëve. Në rast se komiteti i kreditorëve është caktuar nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përpara zhvillimit të mbledhjes së kreditorëve, ky i fundit mund të vendosë nëse komiteti i kreditorëve duhet të japë miratimin ose shpërndarjen e këtij komiteti.

2. Mbledhja e kreditorëve ka të drejtë të vendosë për heqjen e anëtarëve që ka caktuar seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ose për emërimin e anëtarëve të tjerë në komitetin e kreditorëve.

Neni 56

Detyrat e komitetit të kreditorëve

1. Anëtarët e komitetit të kreditorëve duhet të mbështesin dhe të mbikëqyrin veprimtarinë e administratorit të falimentimit.

2. Anëtarët e komitetit të kreditorëve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin të dhëna për ecurinë e punëve gjatë procesit të falimentimit, të kontrollojnë librat e llogarive dhe dokumentet e tjera, si dhe të verifikojnë veprimet monetare dhe gjendjen e arkës.

Neni 57

Shkarkimi i anëtarëve të komitetit të kreditorëve

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me shkak, ka të drejtë të shkarkojë nga detyra një anëtar të komitetit të kreditorëve.

2. Shkarkimi mund të bëhet, kryesisht, me kërkesë të anëtarëve të komitetit të kreditorëve ose me kërkesë të mbledhjes së kreditorëve. Para marrjes së vendimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit dëgjon anëtarin e komitetit të kreditorëve.

3. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, anëtari i shkarkuar i komitetit të kreditorëve ka të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 58

Përgjegjësia e anëtarëve të komitetit të kreditorëve

1. Anëtarët e komitetit të kreditorëve janë përgjegjës dhe detyrohen të dëmshpërblejnë kreditorët e siguarur dhe kreditorët e falimentimit në rast se, për faj të tyre, shkelin ose nuk përmbushin detyrat që u ngarkon ky ligj.

2. Në rastin e pikës 1 të këtij neni, janë të zbatueshme rregullat e parashkrimit të parashikuara në nenin 49 të këtij ligji.

Neni 59

Vendimet e komitetit të kreditorëve

Vendimet e komitetit të kreditorëve janë të vlefshme kur në vendimmarrje ka marrë pjesë shumica e anëtarëve të tij dhe vendimi është marrë me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës.

Neni 60

Shpërblimi i anëtarëve të komitetit të kreditorëve

Anëtarët e komitetit të kreditorëve kanë të drejtën të shpërblehen për punën dhe të rimbursohen për shpenzimet e arsyetuara. Në caktimin e shpërblimit merren parasysh koha dhe vëllimi i punës së anëtarit, si dhe zbatohen kërkesat e neneve 51 dhe 52 të këtij ligji.

Neni 61

Thirrja e mbledhjes së kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve thirret nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit. Të drejtën e pjesëmarrjes në mbledhje e kanë të gjithë kreditorët e siguarur, të gjithë kreditorët e falimentimit, administratori i falimentimit dhe debitori.

2. Koha, vendi dhe rendi i ditës i mbledhjes së kreditorëve duhet të shpallen publikisht. Mbledhja e kreditorëve mund të mos shpallet publikisht në qoftë se seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos shtyrjen e saj.

Neni 62

Kërkesa për thirrjen e mbledhjes së kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve thirret kur kërkohet nga:

a) administratori i falimentimit;
b) komiteti i kreditorëve;
c) kreditorët e falimentimit, pretendimet e të cilëve, të marra së bashku, sipas vlerësimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, përbëjnë të paktën një të pestën e shumës së pretendimeve të të gjithë kreditorëve të falimentimit.

2. Nga marrja e kërkesës deri në datën e mbledhjes së kreditorëve nuk duhet të kalojnë më shumë se 15 ditë.

3. Nëse seksioni tregtar i gjykatës së rrethit nuk pranon thirrjen e mbledhjes së kreditorëve, pala kërkuese ka të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 63

Vendimet e mbledhjes së kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve drejtohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit.

2. Vendimet e mbledhjes së kreditorëve janë të vlefshme nëse shumica e pretendimeve të kreditorëve në favor të vendimit është më e madhe se gjysma e shumës së përgjithshme të pretendimeve të kreditorëve me të drejtë vote. Për kreditorët e siguruar me të drejtë ripagimi të veçantë, kundrejt të cilëve debitori nuk është drejtpërdrejt përgjegjës, pretendimi zëvendësohet me vlerën e kësaj të drejte.

Neni 64

Përcaktimi i të drejtës së votës

1. E drejta e votës përcaktohet në bazë të pretendimeve të paraqitura nga kreditori dhe që nuk janë kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga ndonjë kreditor me të drejtë vote. Kreditorët e radhëve më të ulëta të preferimit nuk kanë të drejtë vote.

2. Kreditorët, pretendimet e të cilëve janë kundërshtuar, kanë të drejtë vote, me kusht që administratori dhe kreditorët pjesëmarrës, me të drejtë vote, të kenë rënë dakord për ta lejuar këtë të drejtë vote gjatë mbledhjes së kreditorëve. Në rast mosmarrëveshjeje të palëve, vendos seksioni tregtar i gjykatës së rrethit. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të ndryshojë vendimin e tij, me kërkesë të administratorit ose të një kreditori, pjesëmarrës në mbledhjen e kreditorëve.

3. Pika 2 e këtij neni zbatohet sipas rastit për:

- a) kreditorët me pretendim të kushtëzuar nga një kusht i mëparshëm;
- b) kreditorët e siguruar (me të drejtë ripagimi të veçantë).

Neni 65

Prishja e vendimit të marrë nga mbledhja e kreditorëve

1. Nëse një vendim i marrë nga mbledhja e kreditorëve vjen në kundërshtim me interesin e përbashkët të kreditorëve të falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit duhet të prishë vendimin, me kërkesë të një kreditori të siguruar falimentimi (me të drejtë ripagimi të veçantë), të një kreditori falimentimi ose të administratorit të falimentimit, në rast se kërkesa paraqitet në mbledhjen e kreditorëve. Këtë të drejtë nuk e gëzojnë kreditorët e radhëve më të ulëta të preferimit.

2. Vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve duhet të shpallet publikisht.

3. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve, çdo kreditor i siguruar (me të drejtë ripagimi të veçantë) dhe çdo kreditor falimentimi, që nuk bën pjesë në radhët më të ulëta të preferimit, kanë të drejtën e ankimit të veçantë. Këtë të drejtë e ka edhe pala kërkuese, në rastin kur seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ka vendosur rrëzimin e kërkesës për prishjen e vendimit të mbledhjes së kreditorëve.

Neni 66

Vënia në dijeni e mbledhjes së kreditorëve

1. Mbledhja e kreditorëve mund t'i kërkojë administratorit të falimentimit dhënien e njoftimeve të veçanta dhe një raport për ecurinë e procedurës së falimentimit dhe për administrimin e masës së falimentimit.

2. Nëse nuk është caktuar një komitet kreditorësh, mbledhja e kreditorëve mund të marrë vendime për ushtrimin e kontrolleve për veprimet monetare dhe gjendjen e të hollave të disponueshme.

PJESA E TRETË

PASOJAT E HAPJES SË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

KREU I

PASOJA TË PËRGJITHSHME

Neni 67

Kalimi i së drejtës së administrimit dhe disponimit

Me hapjen e procedurës së falimentimit, e drejta e debitorit për të administruar dhe disponuar pasurinë, që bën pjesë në masën e falimentimit, i kalon administratorit të falimentimit.

Neni 68

Disponimi nga debitori

1. Nëse pas hapjes së procedurës së falimentimit debitori tjetërson sende nga masa e falimentimit, këto veprime janë të pavlefshme. Vlera e përfituar nga tjetërsimi i kthehet palës tjetër, duke u nxjerrë nga masa e falimentimit, në rast se kjo masë është shtuar nga begatimi pa shkak.

2. Nëse debitori ka kryer veprimin në ditën e hapjes së procedurës së falimentimit, transferimi prezumohet të jetë kryer pas hapjes së procedurës së falimentimit.

Neni 69

Veprimet në favor të debitorit

1. Në rast se pas hapjes së procedurës së falimentimit është shlyer një detyrim në favor të debitorit, ndonëse ky detyrim duhej të shlyhej në favor të masës së falimentimit, pala vepruese shkarkohet nga detyrimi, nëse nuk ka qenë në dijeni të hapjes së procedurës së falimentimit në kohën e kryerjes së veprimit.

2. Nëse pala vepruese e ka shlyer detyrimin para shpalljes së vendimit për hapjen e procedurës, pala vepruese prezumohet se nuk ka pasur dijeni për këtë procedurë.

Neni 70

Likuidimi i një shoqërie të thjeshtë ose ortakërie

1. Në rast se ndërmjet debitorit dhe të tretëve është krijuar një ortakëri ose një shoqëri e thjeshtë, likuidimi i pjesës së debitorit kryhet në përputhje me dispozita të parashikuara jashtë procedurës së falimentimit.

2. Marrëveshja që mohon të drejtën e likuidimit të një ortakërie, përgjithmonë ose për një kohë të caktuar, është e pavlefshme për procedurën e falimentimit. Ky rregull zbatohet për klauzolën me të njëjtën përmbajtje në testamentin e personit që ka vdekur.

Neni 71

Pezullimi i padive të ngritura

1. Me hapjen e procedurës së falimentimit pezullohen të gjitha paditë civile ku debitori është palë.
2. Pezullimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet për paditë civile të ngritura, sipas ligjit, ku palë janë kreditorët e siguruar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 72

Vazhdimi i padive të ngritura, ku debitori është paditës

1. Paditë e lidhura me pasuritë e masës së falimentimit, ku debitori është paditës, rifillojnë në favor të masës së falimentimit, me kërkesë të administratorit të falimentimit.
2. Nëse administratori i falimentimit nuk e pranon këtë kërkesë, debitori dhe i padituri mund të vazhdojnë veprimet e tyre për padinë e ngritur.

Neni 73

Vazhdimi i padive të ngritura, ku debitori është i paditur

1. Paditë e ngritura kundër debitorit rifillojnë me kërkesë të administratorit të falimentimit ose të paditësit nëse ato kanë lidhje me:
 - a)veçimin e një sendi nga masa e falimentimit;
 - b)ripagimin e veçantë;
 - c)detyrimin ndaj masës së falimentimit.
2. Nëse administratori i falimentimit i njeh këto padi menjëherë, paditësi mund të kërkojë rimbursim të shpenzimeve për ngritjen e padive vetëm në cilësinë e kreditorit të falimentimit.

Neni 74

Ekzekutimi para hapjes së procedurës së falimentimit

1. Çdo urdhër ekzekutimi i detyrueshëm mbi pasurinë e debitorit është i pavlefshëm derisa plani i zyrës së përmbarimit për ndarjen e të ardhurave të marrë formë përfundimtare.
2. Pasuria e debitorit që konfiskohet nga përmbaruesi gjyqësor dhe shumat e fituara nga shitja e pasurive bëhen pjesë e masës së falimentimit dhe përmbaruesi gjyqësor duhet t'ia dorëzojë administratorit të falimentimit.

Neni 75

Ndalimi i ekzekutimit

1. Gjatë procedurës së falimentimit, kreditorë falimentimi të veçantë nuk mund të ekzekutojnë pasuritë e masës së falimentimit ose pasuri të tjera të debitorit.
2. Kreditorët që nuk gëzojnë statusin e kreditorëve të falimentimit nuk mund të kërkojnë ekzekutimin e detyrimit gjatë procedurës së falimentimit as për pretendime të ardhshme, për pagesa që rrjedhin nga një kontratë shërbimi.
3. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos për dëmshpërblimet e mundshme, gjatë ekzekutimeve të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 76

Ndalimi i ekzekutimit të detyrimeve të masës së falimentimit

1. Detyrimet e masës së falimentimit nuk mund të ekzekutohen për një periudhë 6-mujore nga data e hapjes së procedurës së falimentimit.

2. Bëjnë përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni detyrimet e mëposhtme:

- a) detyrimet që rrjedhin nga një kontratë, përmbushjen e së cilës e ka vendosur administratori;
- b) detyrime që rrjedhin nga një kontratë me zbatim periodik për periudhën pas ditës së parë kur administratori i falimentimit mund ta kishte prishur këtë kontratë;
- c) detyrime që rrjedhin nga një kontratë me zbatim periodik nëse administratorit të falimentimit i paguhet vlera në favor të masës së falimentimit;
- ç) detyrime që rrjedhin nga çdo veprim tjetër i administratorit.

Neni 77

Dëmi i përgjithshëm

1. Administratori i falimentimit është i vetmi person, i cili, gjatë procedurës së falimentimit, mund të pretendojë të drejtën për dëmshpërblim të kreditorëve të falimentimit për dëme që ata kanë pësuar bashkërisht, para ose pas hapjes së procedurave të falimentimit, për shkak të zvogëlimit të pasurive të masës së falimentimit.

2. Nëse padia e ngritur sipas pikës 1 të këtij neni drejtohet kundër administratorit të falimentimit, pretendimi ngrihet vetëm nga administratori tjetër i falimentimit, i emëruar pas tij.

Neni 78

Përgjegjësia e pakufizuar e ortakëve

Nëse procedura e falimentimit është hapur për pasuritë e një shoqërie të thjeshtë ose ortakërie, administratori i falimentimit mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë nga përgjegjësia e pakufizuar e një ortaku për detyrimet e shoqërisë gjatë procedurës së falimentimit.

Neni 79

Mbajtja e së drejtës për kompensim të ndërsjellë të pretendimeve

Në rast se, sipas ligjit ose një marrëveshjeje, në kohën e fillimit të procedurës së falimentimit një kreditor falimentimi ka të drejtën e kompensimit të ndërsjellë të pretendimeve në datën e hapjes së procedurës së falimentimit, kjo e drejtë nuk cenohet nga procedura e falimentimit.

Neni 80

Ndalimi i kompensimit të ndërsjellë

1. Kompensim i ndërsjellë nuk kryhet në rastet kur:

- a) detyrimet e një kreditori falimentimi ndaj masës së falimentimit kanë lindur vetëm pas hapjes së procedurës së falimentimit;
- b) një kreditor falimentimi e ka fituar të drejtën e kompensimit të ndërsjellë nga një kreditor tjetër vetëm pas hapjes së procedurës së falimentimit;
- c) një kreditor falimentimi e ka fituar të drejtën e kompensimit të ndërsjellë të pretendimit nëpërmjet një veprimi që duhet shmangur;
- ç) një kreditor, pretendimi i të cilit duhet të përmbushet nga pasuria e pangarkuar debitorit, ka një detyrim ndaj masës së falimentimit.

Neni 81

Detyrimi i debitorit për të paraqitur të dhëna dhe për të bashkëpunuar

(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 6/1)

1. Drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit ka detyrë të njoftojë për të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me procedurën e

falimentimit, seksionin tregtar të gjykatës së rrethit, administratorin e falimentimit, komitetin e kreditorëve dhe, nëse urdhërohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, mbledhjen e kreditorëve.

2. Debitori duhet të ndihmojë administratorin e falimentimit për kryerjen e detyrës.

3. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të urdhërojë që debitori të jetë i gatshëm, në çdo kohë, për të përmbushur detyrimet e tij për të dhënë të dhëna dhe për të bashkëpunuar. Debitorit i ndalohet të kryejë çfarëdo lloj veprimi, që pengon përmbushjen e këtyre detyrave.

Neni 82

Realizimi i detyrave të debitorit

(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 6/1)

1. Nëse është e nevojshme të paraqiten deklarata të vërtetuara, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit urdhëron drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit të paraqesë një deklaratë me shkrim, e cila vërteton se debitori ka paraqitur të dhëna të vërteta, të sakta dhe të plota për faktet e kërkuara.

2. Gjykata mund t'i kërkojë drejtorit, zyrtarit, ortakut apo aksionarëve të shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit të paraqiten me detyrim, si dhe të mos largohen nga vendbanimi ose selia, pas marrjes së tij në pyetje, në rastet kur:

a) drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit nuk pranon të japë të dhëna ose deklarata të betuara a të bashkëpunojë me administratorin e falimentimit gjatë kryerjes së detyrës;

b) drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit përpiqet të shmangë detyrimin për të paraqitur të dhëna ose për të bashkëpunuar, veçanërisht kur merr masa për t'u larguar;

c) nëse thirrja e detyruar dhe ndalimi janë të nevojshme për të shmangur veprime të debitorit që pengojnë zbatimin e detyrimit të tij për të paraqitur të dhëna dhe për të bashkëpunuar dhe, në mënyrë të veçantë, për të siguruar masën e falimentimit.

3. Masa e detyrimit për qëndrim hiqet kryesisht pasi të vërehet se nuk ka më kushte, në bazë të të cilave ishte vendosur kjo masë. Kundër vendimit për detyrimin e qëndrimit, si dhe kundër urdhrin që rrëzon kërkesën për heqjen e kësaj mase bëhet ankim i veçantë.

Neni 83

Kontrolli i postës së debitorit

1. Nëse është e nevojshme për të hetuar ose parandaluar veprimet e debitorit, që dëmtojnë kreditorët, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me kërkesë të administratorit të falimentimit ose, kryesisht, me vendim të arsyetuar, urdhëron që administratori të kontrollojë të gjithë ose një pjesë të korrespondencës së debitorit. Para shpalljes së këtij vendimi, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit kërkon dhe dëgjon debitorin, me përjashtim të rastit kur, për shkak të rrethanave të veçanta, një gjë e tillë rrezikon qëllimin e urdhërimit. Nëse debitori nuk dëgjohej paraprakisht, vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit duhet të shpjegojë arsyet për mospërmbushjen e këtij veprimi dhe seanca e dëgjimit të debitorit duhet të mbahet pa vonesë.

2. Administratori mund të hapë korrespondencën e debitorit. Korrespondenca, që nuk ka të bëjë me masën e falimentimit, i dorëzohet menjëherë debitorit. Debitori mund të inspektojë dërgesat e tjera postare.

3. Debitori mund të bëjë ankim të veçantë kundër vendimit për kontroll të korrespondencës së vet. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit pezullon zbatimin e vendimit për kontrollin e korrespondencës së debitorit pasi dëgjon më parë administratorin e falimentimit, në rast se nuk ekziston më shkak për ushtrimin e këtij kontrolli.

Neni 84

Pagesat për jetesën nga masa e falimentimit

1. Mbledhja e kreditorëve vendos nëse debitori dhe familja e tij duhet të marrin nga masa e falimentimit një shumë për jetesë dhe në çfarë mase.

2. Derisa mbledhja e kreditorëve të marrë vendim, administratori i falimentimit, me pëlqimin e komitetit të kreditorëve, mund t'i lejojë debitorit mjetet e nevojshme të jetesës, duke përmbushur nevojat e tij, të fëmijëve të mitur në ngarkim dhe të bashkëshortit.

Neni 85

Anëtarët e organit përfaqësues të debitorit. Punonjësit

(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 6/1)

1. Kur drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit nuk është person fizik, janë të zbatueshme parashikimet e neneve 81, 82 dhe 83 të këtij ligji, sipas rastit, për anëtarët e organit që përfaqëson ose mbikëqyr debitorin, si dhe për ortakët e përgjithshëm, me të drejtë përfaqësimi.

2. Nenet 81 pika 1 dhe 82 të këtij ligji janë të zbatueshme, sipas rastit, për persona që kanë jo më pak se dy vjet që janë larguar nga detyra e përmendur në pikën 1 të këtij neni, para se njëri nga këta persona të kërkonte hapjen e procedurës së falimentimit.

3. Neni 84 i këtij ligji është i zbatueshëm, sipas rastit, për ortakët e shoqërisë së thjeshtë të debitorit dhe për personat me të drejtë përfaqësimi të debitorit.

4. Pika 1 e neni 84 të këtij ligji është e zbatueshme, sipas rastit, për punonjësit e debitorit, dhe për punonjësit e mëparshëm të tij, me kusht që ata të kenë më shumë se dy vjet të larguar nga data e paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.

KREU II

PËRMBUSHJA E VEPRIMEVE LIGJORE

Neni 86

E drejta e zgjedhjes

1. Kur një kontratë, në kohën e fillimit të procedurës së falimentimit, nuk është zbatuar plotësisht, si nga debitori, ashtu edhe nga pala tjetër, detyrimet e papërmbushura vlerësohen të pazbatueshme. Megjithatë, administratori i falimentimit mund ta zbatojë këtë kontratë në vend të debitorit dhe të pretendojë nga pala tjetër pagesën e vlerës ose përmbushjen e detyrimit.

2. Në qoftë se administratori nuk pranon zbatimin e kësaj kontrate, pala tjetër ka të drejtë të ngrejë pretendim për moszbatim kontrate vetëm si kreditor falimentimi. Nëse pala tjetër i kërkon administratorit të ushtrojë të drejtën e zbatimit të kontratës, administratori duhet të deklarojë, pa vonesë, nëse do të kërkojë zbatimin e kontratës. Nëse administratori nuk bën një deklaram të tillë, ai humbet të drejtën për të kërkuar zbatimin e detyrimit ose përmbushjen e veprimit, sipas kontratës.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për dispozita dhe kontrata të veçanta, të parashikuara në nenet në vijim të këtij kreu.

Neni 87

Veprimet me data fikse. Titujt financiarë

1. Në qoftë se është rënë dakord që dorëzimi i mallrave të kryhet në një datë të caktuar ose brenda një periudhe kohe të caktuar dhe në rast se kjo datë ose periudhë kohore përfundon pasi është hapur procedura e falimentimit, nuk mund të kërkohet zbatimi i marrëveshjes, por mund të ngrihet vetëm pretendimi për moszbatim të detyrimit. Pala tjetër mund ta ngrejë këtë pretendim vetëm në cilësinë e kreditorit të falimentimit.

2. Pretendimi për moszbatim kontrate mbulon ndryshimin ndërmjet çmimit për të cilin është rënë dakord dhe çmimit të tregut ose bursës në ditën e dytë të punës pas hapjes së procedurës së falimentimit, në vendin e zbatimit të detyrimit.

3. Nëse është rënë dakord që zbatimi i një veprimi të natyrës financiare me çmim tregu ose burse të kryhet në një datë të caktuar ose brenda një periudhe të caktuar, dhe në rast se kjo datë ose ky afat kohor përfundon pas hapjes së procedurës së falimentimit zbatohen, sipas rastit, pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Quhen veprime me natyrë financiare veçanërisht:

a) furnizimi me metale të çmuara;

b) dorëzimi i letrave me vlerë ose i të drejtave të ngjashme, me kusht që të mos jetë si qëllim pjesëmarrja në një shoqëri ose veprimtari për vendosjen e një lidhjeje të vazhdueshme;

c) pagesat në lloj, shuma e të cilave caktohet drejtpërdrejt ose tërthorazi në monedhë të huaj ose njësi matëse sipas kursit të këmbimit të një monedhe të huaj ose të një njësie matëse, në bazë të shkallës së interesit mbizotërues për pretendimet ose në bazë të çmimit të mallrave a të shërbimeve;

ç) të drejta të tjera për furnizime ose zbatime kontrate në lloj në kuptimin e pikës 1 deri në pikën 4 të këtij neni.

4. Nëse veprimet e zbatueshme të natyrës financiare janë përmbledhur në një kontratë kuadër dhe është arritur marrëveshje, që në rast moszbatimi, kontrata mund të priset në mënyrë të njëjtë, tërësia e veprimeve vlerësohet si një kontratë e përbashkët, në kuptim të neneve 86 dhe 87 të këtij ligji.

Neni 88

Kontrata periodike

1. Nëse shërbimet kontraktore që përbëjnë detyrime ndaj palëve janë periodike, dhe nëse pala tjetër ka përmbushur një pjesë të shërbimeve në kohën kur është hapur procedura e falimentimit, kjo palë quhet kreditor falimentimi për shumën e pretendimit të saj, për vlerën që i përgjigjet pjesës së shërbimeve të kryera, edhe sikur administratori i falimentimit të pretendojë kryerjen e shërbimeve ende të papërmbushura.

2. Pala tjetër nuk mund të kërkojë kthimin e pjesës së shërbimeve që i ka kaluar pasurisë së debitorit para hapjes së procedurës së falimentimit, duke nxjerrë si shkak pretendimin për mospagim të detyrimit përkatës.

Neni 89

Rezerva e pronësisë

1. Dispozitat e mëposhtme zbatohen për një kontratë shitjeje, me rezervë pronësie, të kryer sipas Kodit Civil.

2. Nëse para hapjes së procedurës së falimentimit debitori ka shitur një send të luajtshtëm me rezervë pronësie, duke ia kaluar blerësit zotërimin e sendit, blerësi mund të pretendojë zbatimin e kontratës së shitjes. Kjo dispozitë zbatohet edhe sikur debitori të ketë marrë përsipër detyrime shtesë për blerjen dhe të mos i ketë përmbushur tërësisht ato.

3. Nëse para hapjes së procedurës së falimentimit debitori ka blerë një send të luajtshtëm, ku shitësi ushtron të drejtën e rezervës së pronësisë, ndërkohë që shitësi ose administratori i falimentimit i ka kaluar zotërimin debitorit, administratori i falimentimit, të cilit shitësi i ka kërkuar të ushrojë të drejtën e zgjedhjes, të zbatimit ose moszbatimit, nuk është i detyruar të paraqesë deklaratë, sipas pikës 2 të nenit 86, përpara ditës së mbledhjes së raportimit të kreditorëve. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur gjatë periudhës para mbledhjes së raportimit pritet një pakësim i ndjeshëm i vlerës së sendit dhe kreditori ia ka vënë në dukje këtë rrethanë administratorit të falimentimit.

Neni 90

Vazhdimësia e kontratave

1. Kontratat e lidhura ndërmjet debitorit, si qiradhënës ose qiramarrës, për qiranë e

objekteve të paluajtshme ose pjesëve të tyre dhe për shërbime që duhen kryer lidhur me to vazhdojnë të ekzistojnë në favor të masës së falimentimit.

2. Pretendimet e ngritura para hapjes së procedurës së falimentimit mund të ngrihen nga pala tjetër vetëm në cilësinë e kreditorit të falimentimit.

Neni 91

Debitori si qiramarrës

1. Administratori i falimentimit mund të zgjidhë një kontratë qiraje për objekte të paluajtshme ose kontrate qiraje për pjesë të tyre ku debitori është qiramarrës, duke njoftuar, brenda afatit ligjor, palën tjetër, pavarësisht nga periudha e njoftimit për të cilën është rënë dakord në marrëveshjen e palëve.

2. Nëse administratori zgjidh kontratën sipas pikës 1 të këtij neni, pala tjetër mund të pretendojë dëmshpërblim si kreditor falimentimi, për shkak të zgjidhjes së parakohshme e të kontratës.

3. Nëse debitori, në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit, nuk kishte fituar ende zotërimin e sendit të paluajtshëm, administratori dhe pala tjetër mund të tërhiqen nga kontrata. Kur tërhiqet administratori, pala tjetër mund të kërkojë dëmshpërblim për zgjidhje të parakohshme të kontratës, si kreditor falimentimi. Me kërkesë të palës, secila prej palëve duhet të deklarojë, brenda 15 ditësh, nëse ka synim të tërhiqet nga kontrata. Nëse njëra prej palëve nuk bën një deklaratë të tillë, ajo humbet të drejtën e tërheqjes nga kontrata.

Neni 92

Debitori në rolin e qiradhënësit

1. Në qoftë se para hapjes së procedurës së falimentimit debitori, si qiradhënës i një sendi të paluajtshëm, ia ka kaluar një pale të tretë të drejtën e ngritjes së pretendimit për pagesën e qirasë, ky kalim mbetet i vlefshëm vetëm për pagesën e qirasë së muajit në të cilin është hapur procedura e falimentimit. Në qoftë se procedura është hapur pas ditës së pesëmbëdhjetë të muajit, e drejta e pagesës mbetet e vlefshme edhe për muajin e ardhshëm.

2. Tërheqja e pagesës së qirasë quhet kalim në kuptim të pikës 1 të këtij neni. Kalimi i kryer me rrugë ekzekutimi është i barazvlershëm me kalim sipas kontratës.

3. Kundër pretendimit të pagesës së qirasë që mbulon periudhën e përmendur në pikën 1, qiramarrësi mund të bëjë dëmshpërblim të ndërsjellë për çdo pretendim kundrejt debitorit.

4. Në rastin e pikës 3 të këtij neni mbeten të zbatueshme parashikimet e nenit 79 të këtij ligji.

Neni 93

Shitja e pasurive të debitorit të dhëna me qira

Nëse administratori i falimentimit shet sende të paluajtshme, që debitori i ka dhënë me qira dhe nëse blerësi zëvendëson debitorin, si palë në marrëdhënien e qirasë blerësi mund të zgjidhë marrëdhënien e qirasë brenda afatit ligjor. Njoftimi mund të jepet vetëm për ditën e parë të periudhës ligjore të njoftimit.

Neni 94

Moszgjidhja e kontratës së qirasë

Kontratat e qirasë të lidhura mes debitorit si qiramarrës dhe një pale tjetër, nuk mund të zgjidhen nga kjo e dyta pasi të jetë kërkuar hapja e procedurës së falimentimit:

a) për mospagesë të qirasë para hapjes së procedurës së falimentimit;

b) për shkak të keqësimit të gjendjes pasurore të debitorit.

Neni 95

Zgjidhja e kontratës së shërbimit

1. Administratori i falimentimit dhe pala tjetër mund të zgjidhin një kontratë, ku shërbimet kryhen në favor të debitorit, duke dhënë njoftimin brenda afatit ligjor, pavarësisht nga një kohëzgjatje tjetër ose përjashtim me marrëveshje i së drejtës për zgjidhje kontrate, sipas rregullit të përgjithshëm, për të cilën është rënë dakord ndërmjet palëve.

2. Në rast se administratori i falimentimit zgjidh kontratën, pala tjetër mund të kërkojë dëmshpërblim, për shkak të zgjidhjes së parakohshme të kontratës, si kreditor falimentimi.

Neni 96

Pagesa nga kontrata e shërbimit

1. Në rast se para fillimit të procedurës së falimentimit debitori ka transferuar ose ka hequr dorë nga pretendimi për pagesa në favor të tij, në bazë të një kontrate shërbimi ose në rast se këto pagesa të ardhshme i kanë kaluar me rrugë ekzekutimi, ky veprim është i vlefshëm vetëm për pagesat, që debitori duhej të përfitonte për muajin e hapjes së procedurës.

2. Në rast se procedura e falimentimit është hapur pas ditës së pesëmbëdhjetë të muajit, veprimi i mësipërm mbulon edhe muajin pasardhës.

Neni 97

Mbarimi i mandatit

1. Mandati i caktuar nga debitori dhe që i referohet masës së falimentimit mbaron me hapjen e procedurës së falimentimit.

2. Nëse mbarimi i këtij mandati mund të shkaktojë dëme, i ngarkuari me mandat vazhdon të kryejë veprimet e caktuara, derisa administratori i falimentimit të ketë mundësinë të kujdeset vetë për këto veprime. Mandati quhet se vazhdon për këtë qëllim. I ngarkuari me mandat mund të pretendojë rimbursim të shpenzimeve të kryera për vazhdimin e punës, si kreditor i masës së falimentimit.

3. Nëse i ngarkuari me mandat nuk ka dijeni për hapjen e procedurës, jo për faj të tij, prezumohet se mandati vazhdon në favor të tij.

Neni 98

Shuarja e mandatit

1. Çdo mandat i dhënë nga debitori për masën e falimentimit shuhet me hapjen e procedurës së falimentimit.

2. Për sa kohë që një mandat ose kontratë administrimi vazhdon, sipas pikës 2 të nenit 97 të këtij ligji, fuqia e lidhur me të vlerësohet se vazhdon në të njëjtën mënyrë.

3. Për sa kohë personi i autorizuar nuk ka dijeni për hapjen e procedurës, jo për faj të tij, ai nuk është përgjegjës, sipas nenit 78 të Kodit Civil.

Neni 99

Pavlefshmëria e marrëveshjeve që bien ndesh me dispozitat e mësipërme

Është e pavlefshme çdo marrëveshje që kundërshton ose kufizon zbatimin e neneve nga 86 deri në 98 të këtij ligji.

KREU III
KUNDËRSHTIMI I VEPRIMEVE TË DEBITORIT
NË NJË PROCEDURË FALIMENTIMI

Neni 100
Parimi i përgjithshëm

1. Administratori i falimentimit mund të kundërshtojë veprimet e kryera përpara hapjes së procedurës së falimentimit dhe që dëmtojnë kreditorët e falimentimit, sipas neneve 101 deri të neni 115 të këtij ligji.
2. Në rastin e parashikuar në pikën 1, mosveprimi vlerësohet i barasvlerëshëm me veprimin.

Neni 101
Kundërshtimi i njëjtë

1. Çdo veprim që i garanton administratorit të falimentimit një mjet sigurimi ose ripagimi mund të kundërshtohet në rast se:
 - a) veprimi është kryer brenda 90 ditëve të fundit para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, nëse në kohën e veprimit debitori ka qenë në gjendjen e paaftësisë paguese dhe nëse kreditori në këtë kohë ka pasur dijeni për këtë;
 - b) veprimi është kryer pas kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit dhe nëse kreditori ka pasur dijeni për paaftësinë paguese të debitorit në kohën e veprimit ose të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.
2. Dijenia për rrethanat që çojnë drejtpërdrejt në paaftësi paguese ose drejt një kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit trajtohen në të njëjtën mënyrë si dijenia për paaftësi paguese ose dijenia për kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit.
3. Personi që ka lidhje të ngushtë me debitorin, në datën e këtij veprimi, sipas nenit 107 të këtij ligji, prezumohet se ka pasur dijeni për paaftësinë paguese ose për kërkesën e hapjes së procedurës së falimentimit.

Neni 102
Kundërshtimi jo i njëjtë

1. Çdo veprim që i garanton administratorit të falimentimit një mjet sigurimi ose ripagimi, ose që mundëson përfitimim e mjetit të sigurisë ose të ripagimit pa pasur të drejtën për këtë mjet sigurimi ose ripagimi, mund të kundërshtohet në rast se ky veprim është kryer:
 - a) në muajin e fundit, para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit ose pas paraqitjes së kësaj kërkesë në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit;
 - b) brenda muajit të dytë ose të tretë para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit dhe nëse debitori ka qenë në gjendjen e paaftësisë paguese në datën e veprimit;
 - c) brenda muajit të dytë ose të tretë, para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit dhe nëse debitori në kohën e veprimit ka pasur dijeni që veprimi dëmtonte kreditorët e falimentimit nga kryerja e veprimit në atë datë.
2. Në zbatim të shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, njohja e rrethanave që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me dëmtimin e kreditorëve të falimentimit vlerësohet e njëjtë më njohjen e dëmtimit të kreditorëve të falimentimit. Personi që ka lidhje të ngushtë më debitorin në kohën e këtij veprimi, sipas nenit 107 të këtij ligji, prezumohet se kishte dijeni për dëmtimin e kreditorëve të falimentimit.

Neni 103
Veprimet që dëmtojnë drejtpërdrejt kreditorët e falimentimit

1. Veprimet e debitorit që dëmtojnë drejtpërdrejt kreditorët e falimentimit mund të kundërshtohen nëse janë kryer:

a) gjatë tre muajve të fundit, para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, nëse debitori ka qenë në gjendjen e paaftësisë paguese në kohën e kryerjes së veprimit dhe nëse pala tjetër në këtë kohë ka pasur dijeni për paaftësinë paguese ose nuk ka pasur dijeni për shkak të pakujdesisë së saj;

b) pas kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit dhe nëse pala tjetër në kohën e veprimit ka pasur dijeni për paaftësinë paguese ose nuk ka pasur dijeni për shkak të pakujdesisë së saj ose për kërkesën e hapjes së procedurës së falimentimit.

2. Një veprim që dëmton drejtpërdrejt kreditorët e falimentimit vlerësohet i njëjtë me çdo veprim tjetër të debitorit që e zhvesh atë nga secila prej të drejtave të tij ose që pengon të drejtën e debitorit për ngritjen e një pretendimi në të ardhmen ose që ka një pretendim pronësie ndaj debitorit ose që e bën këtë pretendim të ekzekutueshëm ndaj debitorit.

3. Për parashikimet e këtij neni janë të zbatueshme pikat 2 dhe 3 të nenit 101 të këtij ligji.

Neni 104 **Dëmtimi i qëllimshëm**

1. Çdo veprim i kryer nga debitori gjatë dhjetë viteve të fundit para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit ose pas paraqitjes së kësaj kërkesë, për dëmtimin e kreditorëve të tij, mund të kundërshtohet nëse pala tjetër në kohën e veprimit ka pasur dijeni për qëllimin e debitorit. Kjo dijeni prezumohet kur pala tjetër dinte se debitori ka qenë në gjendjen e paaftësisë paguese dhe se veprimi dëmtonte kreditorët.

2. Mund të kundërshtohet çdo kontratë që përmban detyrime për kryerjen e pagesave, ndërmjet debitorit dhe një të afërmi të tij, sipas kushteve të nenit 107 të këtij ligji nëpërmjet të cilës dëmtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë kreditorët e falimentimit. Kundërshtimi nuk kryhet kur kontrata ose marrëveshja është lidhur dy vjet para kërkesës së hapjes së procedurës ose kur pala tjetër nuk kishte dijeni për qëllimet e debitorit për dëmtimin e kreditorëve në datën e lidhjes së kontratës.

Neni 105 **Kontributet falas**

1. Mund të kundërshtohet çdo kontribut falas i dhënë nga debitori, me përjashtim të rastit kur ai është kryer më shumë se katër vjet përpara kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.

2. Nëse kontributi falas përbën një dhuratë të zakonshme të rastit me vlerë të vogël, kjo dhuratë nuk është subjekt i kundërshtimit.

Neni 106 **Pagesat me çek dhe me kambiale**

1. Për pagesat me kambial, debitori nuk mund të pretendojë rikthimin nga ana e marrësit sipas nenit 101, të këtij ligji, në rast se dispozitat për kambialet parashikojnë, që marrësi humbet të drejtën e pretendimit për kambialin ndaj mbajtësve të tjerë, tërheqësit, ose kryerësit të tërheqjes së shumës nëse ai nuk pranon pagesën e debitorit.

2. Megjithatë, mbajtësi i fundit duhet të kthejë shumën e paguar me kambiale ose, në rast se ai e ka mbajtur kambialin për llogari të një të treti, ky i fundit duhet ta kthejë shumën nëse mbajtësi i fundit ose pala e tretë ka pasur dijeni për paaftësinë paguese të debitorit ose nuk ka pasur dijeni për shkak të pakujdesisë së tij, ose ka pasur dijeni për kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit kur ka mbajtur kambialin ose ia kanë kaluar kambialin. Në këto raste janë të zbatueshme pikat 2 dhe 3 të nenit 101 të këtij ligji.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen sipas rastit për pagesat e debitorit me çek.

Neni 107

Personat e lidhur me debitorin

1. Nëse debitori është person fizik, persona të lidhur me të janë:
 - a) bashkëshorti ose bashkëshortja e debitorit edhe kur martesë është lidhur vetëm pas kryerjes së veprimit juridik ose është zgjidhur ose anuluar në vitin e fundit përpara veprimit juridik;
 - b) paraardhësit ose pasardhësit e debitorit ose të bashkëshortit, sipas pikës 1 të këtij neni, motra dhe vëllezër me lidhje gjaku dhe të afërt të debitorit dhe të bashkëshortit, sipas pikës 1 të këtij neni dhe bashkëshortët e këtyre personave;
 - c) persona që jetojnë në banesën e debitorit ose kanë jetuar në këtë banesë në vitin e fundit para këtij veprimi.
2. Nëse debitori është person juridik ose shoqëri e thjeshtë, persona të lidhur me debitorin janë:
 - a) anëtarët e organit përfaqësues ose mbikëqyrës, ortakë të përgjithshëm, si dhe personat që zotërojnë më shumë se një të katërtën e kapitalit të debitorit;
 - b) një person ose një shoqëri, të cilët kanë dijeni për gjendjen financiare të debitorit për shkak të lidhjes me kreditorin, që është e krahasueshme me një shoqëri, sipas ligjit për shoqëritë ose për shkak të një kontrate shërbimesh;
 - c) personi i lidhur me një person të përmendur në pikën 1 të këtij neni. Kjo dispozitë nuk zbatohet nëse personat e përmendur në këtë pikë kanë detyrimin ligjor të ruajtjes së sekretit për punët e debitorit.

Neni 108

Llogaritja e afateve kohore para kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit

1. Periudha kohore e përcaktuar në nenet 101 deri 105 të këtij ligji, fillon nga data që i korrespondon sipas numrit datës kur seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ka marrë kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit. Në qoftë se një datë e tillë mungon gjatë muajit, afati nis nga data pasardhëse.
2. Në rast se janë marrë disa kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit, vlerësohet e vlefshme kërkesa e parë e pranueshme dhe që paraqet argumente për hapjen e procedurës së falimentimit, edhe sikur procedura të hapet mbi bazën e një kërkesë tjetër. Kur një kërkesë hidhet poshtë dhe vendimi merr formë të prerë, kërkesa merret parasysht vetëm në rast se hidhet poshtë për shkak të mungesës së pasurive të mjaftueshme.

Neni 109

Data e kryerjes së veprimit

1. Një veprim vlerësohet i kryer në datën kur sjell pasoja juridike.
2. Nëse sjellja e pasojave juridike të një veprimi kërkon regjistrim në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme ose në ndonjë regjistër tjetër publik, veprimi vlerësohet i kryer sapo të plotësohen kushtet e tjera, për sjelljen e pasojave të tij juridike, pasi shprehja e qëllimit të debitorit të bëhet e zbatueshme për të dhe pasi pala tjetër të ketë kërkuar regjistrim të këtij veprimi.
3. Plotësimi i kushtit nuk merret parasysht në rastin e një veprimi të kushtëzuar.

Neni 110

Titulli ekzekutiv

Veprimi juridik mund të kundërshtohet edhe sikur pala tjetër të ketë siguruar një titull ekzekutiv ose sikur ky veprim të kryhej me rrugë ekzekutimi.

Neni 111
Veprimet në të holla

Veprimi juridik i debitorit, me të cilin pasuria e tij ka përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një kundërvlerë e saj në të holla, mund të kundërshtohet vetëm sipas kushteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 104 të këtij ligji.

Neni 112
Pasojat ligjore

1. Pasuria e shitur e debitorit, pasuria e transferuar, pasuria e debitorit prej së cilës është hequr dorë sipas veprimit të kundërshtuar ose vlera e saj, duhet t'i kthehen masës së falimentimit.

2. Marrësi i një kontributi pa pagesë e kthen këtë përfitim vetëm në masën që ai është pasuruar prej tij. Ky detyrim nuk zbatohet për rastin kur marrësi ka dijeni ose sipas rrethanave duhet të dijë se kontributi pa shpërblim dëmton kreditorët e procedurës së falimentimit.

Neni 113
Pretendimet e palës në veprimin e kundërshtuar

1. Pretendimi i marrësit të kontributit rivendoset nëse ai kthen pasurinë e marrë sipas veprimit të kundërshtuar.

2. Çdo vlerë rimburohet nga masa e falimentimit, në masën që kjo vlerë është ende e dallueshme ndërmjet pasurive që përbëjnë masën e falimentimit ose për të cilën kjo masë është pasuruar prej saj. Marrësi i përfitimit mund të ngrejë çdo pretendim tjetër vetëm si kreditor falimentimi.

Neni 114
Kundërshtimi ndaj trashëgimtarëve ligjorë

1. Çdo veprim i kundërshtuar mund të ekzekutohet ndaj çdo trashëgimtari ligjor për gjithë pasurinë e marrë.

2. Veprimi i kundërshtueshëm mund të ekzekutohet ndaj çdo trashëgimtari tjetër ligjor kur trashëgimtari i së drejtës:

a) ka pasur dijeni për rrethanat që sollën begatimin pa shkak të paraardhësit të tij duke iu nënshtruar kundërshtimit në datën e begatimit;

b) ka pasur lidhje me personat e afërt të debitorit sipas nenit 107 të këtij ligji, në datën e begatimit, përveç rastit kur personi i afërt nuk ka pasur dijeni për rrethanat që sollën pasurimin e paraardhësit të tij dhe për faktin që i ishte nënshtruar kundërshtimit në atë datë;

c) ka fituar vlerën me anë të një kalimi falas.

Neni 115
Parashkrimi i pretendimit të kthimit

1. E drejta për kundërshtim të veprimit juridik parashkruhet dy vjet pas fillimit të procedurës së falimentimit.

2. Administratori i falimentimit mund të kundërshtojë përmbushjen e një detyrimi të dalë nga një veprim i kundërshtueshëm edhe pasi parashkrimi e bën të pavlefshëm pretendimin e kundërshtimit.

PJESA E KATËRT
ADMINISTRIMI DHE DISPONIMI I MASËS SË FALIMENTIMIT

KREU I
SIGURIMI I MASËS SË FALIMENTIMIT

Neni 116

Marrja në zotërim e masës së falimentimit

1. Pas hapjes së procedurës së falimentimit, administratori i falimentimit merr menjëherë në zotërim dhe administrim të gjithë pasurinë që formon masën e falimentimit.

2. Administratori kërkon marrjen e pasurive, që ndodhen në ruajtje të debitorit me rrugë ekzekutimi të vendimit, duke paraqitur një kopje të ekzekutueshme të vendimit të hapjes së procedurës së falimentimit. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit është gjykata përgjegjëse, sipas Kreut IX dhe X të Pjesës së Katërt, Titulli II të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 117

Sendet e çmuara

1. Komiteti i kreditorëve mund të vendosë për agjencinë dhe kushtet e depozitimit ose të investimit të parave, të letrave me vlerë dhe sendeve të çmuara.

2. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të vendosë, kryesisht, në rast se nuk është emëruar komiteti i kreditorëve ose nëse ky komitet nuk ka marrë vendim për këto çështje, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Kur është caktuar komiteti i kreditorëve, administratori i falimentimit ka të drejtë të depozitojë para, letra me vlerë ose sende të çmuara në agjencinë e depozitimit ose të investimit, vetëm në rast se një anëtar i këtij komiteti, së bashku me administratorin, nënshkruajnë faturën. Urdhrat e administratorit të falimentimit për këtë agjenci janë ligjrisht të vlefshme me bashkënenshkrimin e një anëtari të komitetit të kreditorëve.

4. Mbledhja e kreditorëve, për çështjet e përmendura më sipër, në këtë nen mund të vendosë ndryshe.

Neni 118

Vulosja

Administratori i falimentimit mund të kërkojë përdorimin e vulës nga përmbaruesi ose një person tjetër i autorizuar për sigurimin e sendeve që i përkasin masës së falimentimit. Administratori e depoziton dokumentin që vërteton vënien ose heqjen e vulave në regjistrin e gjykatës për t'u inspektuar nga palët.

Neni 119

Lista e pasurive të masës së falimentimit

1. Administratori i falimentimit përgatit një inventar të të gjithë pasurisë që përbën masën e falimentimit. Debitori bashkëpunon për hartimin e këtij inventari, kur bashkëpunimi nuk krijon vonesa të dëmshme për procedurën e falimentimit.

2. Vlera e çdo sendi duhet të jetë e përcaktuar. Në rast se vlera e sendit varet nga fakti nëse veprimtaria e debitorit do të vazhdojë ose do të mbyllet, duhet të paraqiten vlerat përkatëse alternative. Për përcaktimin e vlerës së sendeve, vlerësimi i të cilave paraqet vështirësi, mund të caktohet një specialist.

3. Me kërkesë të arsyetuar të administratorit të falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të mos kërkojë kryerjen e inventarit. Në rast se është caktuar komiteti i kreditorëve, administratori i falimentimit mund ta paraqesë kërkesën vetëm me miratimin e këtij komiteti.

Neni 120

Lista e kreditorëve

1. Administratori i falimentimit harton listën e të gjithë kreditorëve të debitorit, të cilët janë bërë të njohur nga librat e dokumentet e punës së debitorit, nëpërmjet njoftimit prej debitorit, me kërkesën e tyre ose me ndonjë mënyrë tjetër.

2. Lista e kreditorëve, me të drejtë ripagimi të veçantë dhe çdo kategorie të rangjeve më të ulëta të kreditorëve të falimentimit duhet të paraqitet e ndarë. Për çdo kreditor shënohet adresa, arsyeja dhe shuma e pretendimit të tij. Për kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë shënohet edhe sendi që është objekt pretendimi për ripagim të veçantë, si dhe shuma e mundshme e mospërbushjes. Fjalía e dytë e pikës 2 të nenit 119 të këtij ligji zbatohet sipas rastit.

3. Gjithashtu lista duhet të tregojë gjendjen që mundëson kompensimin e ndërsjellë të pretendimeve dhe shumën e detyrimeve ndaj masës së falimentimit në rastin e një shitjeje të shpejtë të pasurisë së debitorit.

Neni 121

Kontrolli i pasurisë

1. Prej datës së hapjes së procedurës së falimentimit, administratori i falimentimit kryen një kontroll të detajuar ku tregohen sendet e masës së falimentimit dhe detyrimet e debitorit. Për vlerësimin e objekteve zbatohet sipas rastit pika 2 e nenit 119 të këtij ligji.

2. Pas kryerjes së kontrollit të pasurisë, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me kërkesë të administratorit ose të një kreditori, mund t'i kërkojë debitorit një vërtetim të betuar për paraqitjen e plotë të të gjitha pasurive. Nenet 82 dhe 84 të këtij ligji zbatohen sipas rastit.

Neni 122

Depozitimi në regjistrin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit

Lista më sendet e masës së falimentimit, lista e kreditorëve dhe tabela e pasurisë depozitohen në regjistrin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për t'u inspektuar nga palët, jo më vonë se një javë para mbledhjes së raportimit të palëve.

Neni 123

Mbajtja e llogarive sipas dispozitave tregtare dhe legjislacionit tatimor

1. Detyrimet e debitorit, sipas së drejtës tregtare dhe të legjislacionit tatimor, për mbajtjen e llogarive dhe shlyerjet nuk cenohen. Administratori i falimentimit përcakton detyrimet për masën e falimentimit.

2. Me fillimin e procedurës së falimentimit fillon një vit i ri financiar.

KREU II

VENDIMI PËR DISPONIMIN

Neni 124

Mbledhja e raportimit

1. Në mbledhjen e raportimit, administratori i falimentimit raporton për gjendjen ekonomike të debitorit dhe shkaqet e falimentimit. Ai analizon çdo perspektivë të veprimtarisë së debitorit, tërësisht ose pjesërisht, tregon mundësitë e ekzistencës së një plani riorganizimi dhe përshkruan pasojat e secilës prej zgjidhjeve për ripagimin e kreditorëve.

2. Në mbledhjen e raportimit, debitori, komiteti i kreditorëve dhe organi përfaqësues i punonjësve paraqesin deklaratat e tyre për raportin e administratorit. Nëse debitori është tregtar,

artizan ose bujk, mund t'i jepet mundësia për ta shprehur mendimin edhe organit përfaqësues të autorizuar të industrisë, tregtisë, artizanatit ose bujqësisë.

Neni 125

Vendimmarrja për ecurinë e mëtejshme të procedurës

Vendoset gjatë mbledhjes së raportimit të kredive, nëse veprimtaria e debitorit duhet të mbyllet ose të vazhdojë në kushtet e përkohshme. Mbledhja mund të ngarkojë administratorin për përpunimin e planit të riorganizimit duke përcaktuar objektivat e planit. Mbledhja mund të ndryshojë vendimet e veta në mbledhjet e mëvonshme.

Neni 126

Masat e marra para vendimit

1. Nëse administratori synon të mbyllë ndërmarrjen para mbledhjes së raportimit, ai duhet të marrë miratimin e komitetit të kreditorëve kur ai ekziston.

2. Përpara se komiteti i kreditorëve të marrë vendim ose kur komiteti nuk është caktuar, administratori duhet të njoftojë debitorin para mbylljes së ndërmarrjes. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me kërkesë të debitorit dhe pasi dëgjon administratorin, nuk pranon mbylljen e ndërmarrjes, kur mbyllja mund të pezullohet, deri në mbledhjen e raportimit, pa pakësuar ndjeshëm pasuritë e masës së falimentimit.

Neni 127

Disponimi i pasurive të masës së falimentimit

Pas mbledhjes së raportimit, administratori i falimentimit duhet të likuidojë pa vonesë pasuritë e masës së falimentimit, përveç rastit kur diçka e tillë bie ndesh me vendimet e mbledhjes së kreditorëve.

Neni 128

Veprimet veçanërisht të rëndësishme

1. Administratori i falimentimit duhet të marrë miratimin e komitetit të kreditorëve për kryerjen e veprimeve me rëndësi të veçantë për procedurën e falimentimit. Në qoftë se nuk është caktuar komiteti i kreditorëve, duhet të merret miratimi i mbledhjes së kreditorëve.

2. Miratimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet veçanërisht kur:

a) synimi është të shitet veprimtaria, ndërmarrja, mallrat në tërësi, çdo pjesë e një sendi të paluajtshëm që shitet privatisht, aksionet ose pjesët e debitorit, një shoqërie tjetër, nëse këto aksione ose pjesë të këtyre aksioneve kanë për qëllim të krijojnë një lidhje të përhershme me ndërmarrjen tjetër ose t'i japin të drejtën e përfitimit të të ardhurave të përsëritshme;

b) veprimi ka për qëllim krijimin e një kontrate huaje, e cila do të rëndonte në mënyrë të ndjeshme masën e falimentimit;

c) ky veprim ka qëllim ngritjen e një padie ose marrjen pjesë në një padi për një vlerë të konsiderueshme që është objekt padie, të mos pranojë ngritjen e kësaj padie ose hyrjen në marrëveshje për një zgjidhje jashtëgjyqësore ose shmangie të padisë.

Neni 129

Ndalimi i përkohshëm i veprimit

Në secilin prej rasteve të parashikuara në nenin 128 të këtij ligji, administratori i falimentimit njofton debitorin përpara marrjes së vendimit të komitetit të kreditorëve ose mbledhjes së kreditorëve, kur ky njoftim nuk e vonon procedurën e falimentimit dhe sjell pasoja dëmtuese. Nëse mbledhja e kreditorëve nuk jep miratimin, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me kërkesë të

debitorit ose të një shumice kreditorësh, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 62 të këtij ligji dhe pasi dëgjon administratorin, mund të vendosë ndalimin e përkohshëm të kryerjes së veprimit dhe organizon një mbledhje të kreditorëve, e cila vendos për veprimin.

Neni 130

Shitja e shoqërisë personave me interes të veçantë

1. Shitja e ndërmarrjes ose fabrikës kryhet me miratimin e mbledhjes së kreditorëve, nëse blerësi a personi që zotëron të paktën një të pestën e kuotave të kapitalit:

a) bën pjesë në personat e lidhur më debitorin, sipas nenit 107 të këtij ligji;

b) është kreditor me të drejtë ripagimi të veçantë ose nuk bën pjesë në kreditorët e rangjeve më të ulëta, dhe kur e drejta e ripagimit të veçantë ose pretendimeve të marra së bashku vlerësohen nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit se arrijnë një të pestën e vlerës së përgjithshme të të gjitha pretendimeve me të drejtë ripagimi të veçantë dhe të vlerës së pretendimeve të të gjithë kreditorëve të procedurës së falimentimit.

2. Një person mban pjesë ose aksione të blerësit, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse shoqëria e kontrolluar nga personi ose një i tretë mban aksione të shitësit për llogari të personit ose të ndërmarrjes së kontrolluar.

Neni 131

Shitja e ndërmarrjes nën vlerë

1. Me kërkesë të debitorit ose të një shumice kreditorësh sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 62 dhe pasi dëgjon administratorin e falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të urdhërojë që shitja e parashikuar e shoqërisë ose e fabrikës të kryhet me pëlqimin e mbledhjes së kreditorëve, nëse kërkuesi provon në mënyrë bindëse për gjykatën se shitja të një blerës tjetër do të ishte e favorshme për masën e falimentimit.

2. Nëse pala kërkuese ka kryer shpenzime për kërkesën, ajo kërkon që, me urdhër të gjykatës, t'i paguhet shpenzimet nga masa e falimentimit.

Neni 132

Vlefshmëria e veprimit

Vlefshmëria e veprimit të administratorit nuk cenohet në rast të shkeljeve të parashikuara nga neni 128 deri në nenin 131 të këtij ligji.

KREU III

SENDE QË I NËNSHTROHEN TË DREJTËS SË RIPAGIMIT TË VEÇANTË

Neni 133

E drejta e disponimit

1. Administratori i falimentimit mund të disponojë pa kufizim një send, i cili i nënshtrohet të drejtës së ripagimit të veçantë, në rast se ai zotëron sendin ose kur sendi është i paluajtshëm.

2. Administratori i falimentimit mund të marrë ose disponojë në mënyrë tjetër një pretendim që debitorin ka përdorur për sigurimin e një detyrimi.

3. Administratori i falimentimit nuk ushtron përgjegjësitë e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, në rast se vlera e kolateralit është më e vogël ose e barabartë me vlerën e kredisë së pretenduar nga kreditori i siguar dhe ajo e shpenzimeve për ekzekutimin e saj, të marra së bashku. Në këtë rast, administratori i falimentimit vendos lejimin e kreditorit të siguar për veprimet e tij në përputhje me parashikimet e nenit 70 të këtij ligji.

Neni 134
Njoftimi i kreditorit

1. Në qoftë se administratori i falimentimit ka të drejtën të disponojë një send, sipas pikës 1 të nenit 133 të këtij ligji, ai njofton për gjendjen e pasurisë kreditorin me të drejtë ripagimi të veçantë, me kërkesë të këtij të fundit. Në vend të njoftimit administratori mund t'i lejojë kreditorit inspektimin e sendit.

2. Në qoftë se administratori ka të drejtën e marrjes së një pretendimi, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 133 të këtij ligji, ai njofton për pretendimin kreditorin me të drejtë ripagimi të veçantë me kërkesë të këtij të fundit. Në vend të njoftimit administratori mund t'i lejojë kreditorit inspektimin e librave të llogarisë dhe të dokumenteve të veprimtarisë së debitorit.

Neni 135
Njoftimi i shitjes së parashikuar

1. Përpara se administratori i falimentimit t'i shesë të tretit një send që disponon, sipas dispozitave të nenit 133 të këtij ligji, ai njofton kreditorin me të drejtë ripagimi të veçantë për kryerjen e kësaj shitjeje të parashikuar. Ai i jep kreditorit mundësinë e propozimit të një alternative për shitjen e sendit, brenda një jave, nëse kjo shitje mund të jetë më e favorshme për kreditorin.

2. Në qoftë se ky njoftim bëhet, brenda një jave ose brenda një afati kohor të mjaftueshëm, para shitjes, administratori e përdor këtë mundësi ose kompenson kreditorin si në rastin kur do ta kishte përdorur këtë mundësi.

3. Një mundësi tjetër shitjeje është shitja e sendit vetë kreditorit. Vlerësohet e favorshme shitja që kryhet me më pak shpenzime.

Neni 136
Mbrojtja e kreditorit nga shitja e vonuar

1. Në rast se nuk është shitur sendi për të cilin, administratori i falimentimit ka të drejtën e disponimit, sipas nenit 133 të këtij ligji, kreditorit i paguhet nga masa e falimentimit interesi i fituar që nga data e mbledhjes së raportimit. Në qoftë se seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ka nxjerrë një vendim sipas nenit 21, ku ndalon kreditorin të shesë sendin para hapjes së procedurës së falimentimit, interesat e mbetur paguhen jo më vonë se tre muaj pas vendimit të gjykatës. Dy fjalitë e para të kësaj pike nuk zbatohen për sa kohë shuma e pretendimeve të kreditorit, vlera dhe detyrimet e tjera, me të cilat është i ngarkuar sendi, nuk mund të mbulohen nga e ardhura e marrë prej shitjes për ripagimin e kreditorëve.

2. Pas përfundimit të afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kreditorët e siguar mund t'i kërkojnë seksionit tregtar të gjykatës së rrethit heqjen e kufizimeve të parashikuara nga neni 133 i këtij ligji. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit duhet të japë miratimin pasi njofton dhe dëgjon administratorin e falimentimit, me përjashtim të rastit kur ky i fundit paraqet prova të mjaftueshme se kolaterali është i nevojshëm si pjesë e veprimtarisë ose e objektit ku kryhet kjo veprimtari.

3. Në çdo kohë, brenda afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, gjykata duhet të heqë kufizimet e përmendura në nenin 133 të këtij ligji dhe të urdhërojë masa të tjera sigurimi, nëse kreditorët e siguar provojnë në mënyrë të mjaftueshme se administratori i falimentimit nuk e mbron në mënyrë të duhur kolateralin ose kolaterali po pëson humbje në vlerë.

Neni 137
Shpërndarja e të ardhurave

1. Në rastin e shitjes së një sendi ose të pretendimeve nga administratori i falimentimit, shpenzimet e përcaktimit dhe shpenzimet e shitjes së sendit i zbriten që më parë masës së falimentimit. Shuma e mbetur përdoret për ripagimin e kreditorëve, me të drejtë ripagimi të veçantë.

2. Në qoftë se administratori i falimentimit i kalon kreditorit një send mbi të cilin ka të drejtën e shitjes, sipas nenit 133 të këtij ligji, kreditori parapaguan një shumë, e cila mbulon shpenzimet e përcaktimit duke përdorur të ardhurat që ka fituar.

Neni 138

Llogaritja e kontributit ndaj shpenzimeve

1. Shpenzimet e përcaktimit përfshijnë shpenzimet e identifikimit konkret të sendit dhe ato të përcaktimit të të drejtave me të cilat është i rënduar ky objekt. Kjo pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të procedurës llogaritet si shumë e fiksuar në katër për qind të të ardhurave.

2. Vlerësohen shpenzime mbajtjeje vetëm shpenzimet që janë kryer faktikisht nga masa e falimentimit dhe që ishin të nevojshme për mbajtjen e sendit ose për përmirësimin e nevojshëm në interes të kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë.

Neni 139

Përdorimet e tjera të sendeve

1. Administratori i falimentimit mund të përdorë për masën e falimentimit një send mbi të cilin ka të drejtë disponimi, kur humbja e vlerës së shkaktuar nga ky përdorim kompensohet me pagesat që u bëhen kreditorëve me hapjen e procedurës së falimentimit. Ky detyrim për pagesa kompensuese ekziston vetëm në masën në të cilën humbja e vlerës nga përdorimi cenon sigurimin e kreditorit me të drejtë ripagimi të veçantë.

2. Administratori ka të drejtë të bashkojë, përpunojë dhe përziejë sendin me pasuri të tjera me kusht që ky ndryshim i gjendjes së sendit të mos cenojë sigurimin e kreditorit me të drejtë ripagimi të veçantë. Në qoftë se e drejta e kreditorit kalon mbi një send tjetër, kreditori ia kalon këtë të drejtë të re sigurimi administratorit që vlera e saj të tejkalojë vlerën e mëparshme.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk janë të zbatueshme për kolateralin e barrëdhënësit.

Neni 140

Disponimi nga kreditori

1. Nëse administratori i falimentimit nuk ka të drejtën e disponimit të një sendi të luajtshëm ose të një pretendimi që i nënshtrohet të drejtës së ripagimit të veçantë, e drejta e kreditorit për disponimin e sendit nuk cenohet.

2. Me kërkesë të administratorit dhe pasi dëgjon kreditorin, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të caktojë një afat kohor brenda të cilit kreditori duhet ta shesë sendin. Pas mbarimit të këtij afati, administratori ka të drejtën e disponimit të sendit.

PJESA E PESTË RIPAGIMI I KREDITORËVE TË FALIMENTIMIT NDËRPRERJA E PROCEDURËS

KREU I PËRCAKTIMI I PRETENDIMEVE

Neni 141

Depozitimi i pretendimeve

1. Kreditorët e falimentimit duhet t'ia paraqesin me shkrim pretendimet e tyre administratorit të falimentimit. Njoftimit duhet t'i bashkëlidhet një kopje e dokumenteve që provojnë pretendimin.

2. Kërkesa duhet të përfshijë arsyen, shumën e pretendimit, si dhe të përmendë radhën, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

3. Kreditorët e rangjeve më të ulëta paraqesin pretendimin e tyre vetëm nëse seksioni tregtar i gjykatës së rrethit e kërkon posaçërisht këtë gjë.

Neni 142

Tabela

Administratori i falimentimit regjistron të gjitha pretendimet me të dhënat, sipas pikës 2 të nenit 141 të këtij ligji. Tabela e pretendimeve depozitohet në zyrën e gjykatës bashkë me aplikimet dhe vërtetimet e bashkëlidhura për inspektimin e bërë nga palët brenda një periudhe kohore sa një e treta e kohës ndërmjet ditës së fundit të afatit të depozitimit dhe mbledhjes për verifikimin e pretendimeve.

Neni 143

Procedimi i mbledhjes së verifikimit

Në mbledhjen e verifikimit shqyrtohen pretendimet e paraqitura për shumën dhe statusin e tyre. Pretendimet që kundërshtohen nga administratori i falimentimit, debitori ose nga një kreditor falimentimi u nënshtrohen një diskutimi të hollësishëm e të veçantë.

Neni 144

Depozitimet e vonuara

1. Gjatë mbledhjes së verifikimit shqyrtohen edhe pretendimet e paraqitura pas përfundimit të afatit për depozitim. Në qoftë se verifikimi i këtyre pretendimeve kundërshtohet nga administratori i falimentimit ose një kreditor falimentimi, ose në qoftë se pretendimi depozitohet pas mbledhjes së verifikimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me shpenzimet e të vonuarit, cakton një mbledhje të posaçme verifikimi ose urdhëron verifikimin në procedurë me shkrim. Për ndryshime të mëvonshme të pretendimeve të depozituara zbatohen, sipas rastit, dy fjalitë e para të kësaj pike.

2. Afati i mbledhjes së posaçme të verifikimit bëhet i njohur publikisht. Kreditorët e falimentimit, që kanë depozituar pretendimet, administratori i falimentimit dhe debitori duhet të marrin njoftim individual për thirrjen e kësaj mbledhjeje.

Neni 145

Kushtet dhe pasojat e vërtetimit të pretendimeve

1. Një pretendim vlerësohet i vërtetuar nëse në mbledhjen e verifikimit ose gjatë procedurës me shkrim nuk është kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga kreditorët e falimentimit, sipas nenit 144 të këtij ligji, ose kur është hedhur poshtë ndonjë kundërshtim i paraqitur. Kundërshtimi i debitorit nuk pengon vërtetimin e pretendimit.

2. Për çdo pretendim të depozituar, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit shënon në tabelë në çfarë mase është vërtetuar shuma dhe statusi, ose cila prej palëve ka kundërshtuar vërtetimin. Në tabelë regjistrohen edhe kundërshtimet e debitorit. Nëpunësi i regjistrimit të gjykatës shënon vërtetimin në kambiale dhe instrumente të tjera borxhi.

3. Për pretendimet e vërtetuara për shumën dhe statusin e tyre, regjistrimi në tabelë ka pasojën juridike të një vendimi të formës së prerë për administratorin e falimentimit dhe për të gjithë kreditorët e falimentimit.

Neni 146

Kërkesat e kundërshtuara

1. Në qoftë se një kërkesë është kundërshtuar nga administratori i falimentimit ose nga një kreditor falimentimi, kreditori duhet të fillojë procedurën për vërtetimin e këtij pretendimi ndaj palës kundërshtuese.

2. Në qoftë se një pretendim i tillë bazohet në një urdhër ekzekutimi ose vendim të formës së prerë, pala kundërshtuese duhet të kërkojë fillimin e procedurës për kundërshtimin e pretendimit.

3. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit i jep kreditorit, kërkesa e të cilit është kundërshtuar, një kopje të shkurtuar të tabelës së vërtetuar nga gjykata. Një kopje e tillë i jepet edhe palës kundërshtuese, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 147

Përgjegjësia e gjykatave për vërtetimin e pretendimeve

1. Padia për vërtetimin e pretendimeve ngrihet sipas dispozitave të procedurës së zakonshme civile.

2. Në qoftë se në kohën e hapjes së procedurës së falimentimit ishte ngritur një padi për këto pretendime, vërtetimi i pretendimit i bashkëlidhet kësaj padie.

Neni 148

Pasojat juridike të vërtetimit me rrugë gjyqësore

1. Vendimi i formës së prerë, që vërteton një pretendim ose që pranon një kundërshtim, është detyrues për administratorin e falimentimit dhe për të gjithë kreditorët e falimentimit.

2. Pala fituese i kërkon seksionit tregtar të gjykatës së rrethit korrigjimin e tabelës.

3. Në qoftë se padinë e kanë ngritur vetëm kreditorë të veçantë, por jo administratori i falimentimit, këta kreditorë mund të kërkojnë nga masa e falimentimit kthimin e shpenzimeve të kryera në sasinë që masa e falimentimit ka përfituar nga vendimi gjyqësor.

Neni 149

Padi për të zbatuar pretendimin e kundërshtuar nga debitori

Në qoftë se debitori ka kundërshtuar një pretendim gjatë mbledhjes së verifikimit ose gjatë procedurës me shkrim, sipas nenit 144 të këtij ligji, kreditori mund të ngrijë padi për vërtetimin e këtij pretendimi. Në qoftë se në kohën e fillimit të procedurës së falimentimit ekzistonte një padi e ngritur për këtë pretendim, kreditori mund ta vazhdojë këtë padi kundër debitorit.

**KREU II
SHPËRNDARJA**

Neni 150

Ripagimi i kreditorëve të falimentimit

1. Ripagimi i kreditorëve të falimentimit mund të fillojë vetëm pas mbledhjes së verifikimit të përgjithshëm.

2. Fondet mund t'u shpërndahen kreditorëve të falimentimit sapo masa e falimentimit të ketë likuiditet të mjaftueshëm. Kreditorët e rangjeve më të ulëta nuk duhet të merren parasysh në shpërndarjen e parë.

3. Shpërndarjet bëhen nga administratori i falimentimit sipas renditjes së parashikuar në nenin 605 të Kodit Civil. Para çdo shpërndarjeje, ai duhet të marrë miratimin e komitetit të kreditorëve, nëse është caktuar një i tillë.

Neni 151
Lista e shpërndarjes

Para çdo shpërndarjeje, administratori i falimentimit harton një listë të pretendimeve që përfitojnë nga shpërndarja. Lista depozitohet pranë regjistrit të gjykatës për t'u inspektuar nga palët. Administratori i falimentimit shpall publikisht shumën e përgjithshme të pretendimeve dhe shumën e disponueshme për shpërndarje në masën e falimentimit.

Neni 152
Fondet e mbajtura për të ripaguar pretendimet e kundërshtuara

1. Një kreditor falimentimi, pretendimi i të cilit nuk është vërtetuar dhe nuk është bazuar në një titull ekzekutiv ose vendim të formës së prerë, duhet t'i provojë administratorit në mënyrë bindëse, jo më vonë se dy javë pas shpalljes publike të administratorit, se për çfarë shumë është bërë padia e vërtetimit të pretendimit ose ka vazhduar padia e ngritur më parë.

2. Në qoftë se kreditori ia vërteton këto fakte administratorit në mënyrë bindëse dhe në kohën e duhur, pjesa që i përgjigjet shumës së pretendimit mbahet gjatë shpërndarjes për gjithë kohëzgjatjen e procesit të padisë.

3. Në qoftë se kreditori nuk ia vërteton këto fakte administratorit, në mënyrë bindëse dhe në kohën e duhur, pretendimi nuk merret parasysh gjatë shpërndarjes.

Neni 153
Fondet e mbajtura për të ripaguar kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë

1. Një kreditor me të drejtë ripagimi të veçantë duhet t'i provojë administratorit të falimentimit, në mënyrë bindëse, jo më vonë se afati i parashikuar në pikën 1 të nenit 152 të këtij ligji, se për çfarë shume ka hequr dorë nga e drejta e ripagimit të veçantë ose për çfarë shume nuk është shlyer ripagimi i veçantë. Në qoftë se kreditori nuk ia vërteton këto fakte administratorit, në mënyrë bindëse në kohën e duhur, pretendimi nuk merret parasysh gjatë shpërndarjes.

2. Kreditori quhet se ka përmbushur detyrimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni për të marrë pjesën në shpërndarjen e parë, nëse ai i provon administratorit të falimentimit, në mënyrë bindëse dhe jo më vonë se periudha kohore e përcaktuar, që shitja e sendit që i nënshtrohet të drejtës së ripagimit të veçantë ka filluar dhe cila pjesë e shumës së pretendimit të tij mbetet e pashlyer. Në këtë rast, pjesa që i përgjigjet pretendimit të tij mbahet gjatë shpërndarjes. Në qoftë se kushtet e pikës 1 të këtij neni nuk janë plotësuar, pjesa e rezervuar zhbllkohet në shpërndarjen përfundimtare dhe lejohet të përdoret gjatë kësaj shpërndarjeje.

3. Në qoftë se të drejtën e disponimit të sendit, që i nënshtrohet së drejtës për ripagim të veçantë e ka vetëm administratori i falimentimit, pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen. Gjatë shpërndarjes së parë, administratori që nuk ka shitur ende sendin duhet të vlerësojë çfarë humbje ka pësuar kreditori dhe të mbajë pjesën që shërben për të shlyer këtë shumë.

Neni 154
Fondet e mbajtura për ripagimin e pretendimeve me kusht

1. Pretendimi me kusht merret parasysh në vlerën e tij të plotë gjatë shpërndarjes së parë. Pjesa që i përgjigjet pretendimit nuk paguhet gjatë shpërndarjes dhe ruhet.

2. Pretendimi me kusht nuk merret parasysh gjatë shpërndarjes së fundit, nëse mundësia e plotësimit të kushtit është aq e largët sa që pretendimi humbet vlerën në kohën e shpërndarjes. Në këtë rast, pjesa e mbajtur, sipas fjalisë së dytë të pikës 1 të këtij neni, shpërndahet gjatë shpërndarjes së fundit.

Neni 155
Ripagimi i mëvonshëm

Kreditorët, pretendimet e të cilëve nuk janë marrë parasysh gjatë një shpërndarjeje të parë dhe që plotësojnë kushtet e neneve 152 dhe 153 të këtij ligji, marrin nga masa e falimentimit një shumë që i vë në kushte të barabarta me kreditorët e parë. Kjo shumë merret gjatë shpërndarjes në një datë të mëvonshme.

Neni 156
Ndryshimi i listës së shpërndarjes

Administratori i falimentimit shton në listën e shpërndarjes çdo ndryshim sipas neneve 152 deri 154 të këtij ligji, brenda tri ditësh nga mbarimi i afatit të përjashtimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 152 të këtij ligji.

Neni 157
Vërejtjet ndaj listës së shpërndarjes

1. Gjatë shpërndarjes së parë, një kreditor i paraqet seksionit tregtar të gjykatës së rrethit vërejtjet e veta ndaj listës, brenda një jave pas mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 152 të këtij ligji.

2. Çdo vendim i gjykatës që hedh poshtë këtë vërejtje duhet t'u dërgohet kreditorit dhe administratorit të falimentimit. Kreditori ka të drejtën e ankimit të veçantë ndaj këtij vendimi.

3. Vendimi i gjykatës që urdhëron një ndryshim në listë, u njoftohet kreditorit dhe administratorit dhe depozitohet në regjistrin e gjykatës për t'u inspektuar nga palët. Administratori dhe kreditorët e falimentimit kanë të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit. Afati i ankimit fillon nga data kur vendimi është depozituar në regjistrin e gjykatës.

Neni 158
Përcaktimi i pjesëve të pretendimit

1. Me propozimin e administratorit të falimentimit, komiteti i kreditorëve përcakton pjesën e pretendimit që do të paguhet gjatë shpërndarjes së parë. Në qoftë se nuk është caktuar një komitet kreditorësh, pjesën e përcakton administratori.

2. Administratori ua komunikon pjesën e pretendimit që do t'u paguhet kreditorëve që janë marrë parasysh.

Neni 159
Shpërndarja e fundit

1. Shpërndarja e fundit bëhet sapo të përfundojë shitja e masës së falimentimit.
2. Shpërndarja e fundit bëhet vetëm me miratimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit.

Neni 160
Mbledhja përfundimtare

1. Kur jep pëlqimin për shpërndarjen përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përcakton edhe afatin për një mbledhje përfundimtare të kreditorëve. Gjatë mbledhjes:

- a) diskutohen llogaritë e paraqitura nga administratori i falimentimit;
- b) paraqiten vërejtje ndaj listës përfundimtare;
- c) vendosin për sendet që janë pjesë e masës së falimentimit dhe të papërshtatshme për shitje.

2. Periudha kohore ndërmjet shpalljes së datës së mbledhjes dhe mbledhjes nuk mund të jetë më pak se tri javë dhe jo më shumë se një muaj.

3. Për vendimet e gjykatës për vërejtjet e një kreditori zbatohen, sipas rastit, parashikimet e pikave 2 dhe 3 të nenit 157 të këtij ligji.

Neni 161

Depozitimi i shumave të mbajtura

Shumat që janë mbajtur gjatë shpërndarjes përfundimtare depozitohen pranë një agjencie të përshtatshme, me miratimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, për llogari të palëve pjesëmarrëse.

Neni 162

Tepricat pas shpërndarjes përfundimtare

Në qoftë se pretendimet e të gjithë kreditorëve të procedurës së falimentimit mund të ripaguhen gjatë shpërndarjes së fundit, administratori i falimentimit ia kalon tepricën debitorit. Kur debitori nuk është person fizik, administratori ia ndan pjesën e tepricës çdo personi që mban pjesë të kapitaleve të debitorit, gjatë një procedure likuidimi jashtë procedurës së falimentimit.

Neni 163

Përfundimi i procedurës së falimentimit

1. Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit.

2. Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht.

Neni 164

Të drejtat e kreditorëve të falimentimit pas mbylljes së procedurës së falimentimit

1. Pas mbylljes së procedurës së falimentimit, kreditorët e falimentimit mund të kërkojnë pa kufizim plotësimin e pretendimeve të mbetura ndaj debitorit.

2. Kreditorët e falimentimit, që kanë ngritur pretendime të vërtetuara, të cilat nuk janë kundërshtuar nga debitori gjatë mbledhjes së verifikimit, mund të përmbushin këto pretendime ndaj debitorit me rrugë ekzekutimi ligjor, duke u bazuar në regjistrimin në tabelë, që ka të njëjtën vlerë si një vendim i ekzekutueshëm. Pretendimi i pakundërshtuar barazohet me një pretendim ndaj të cilit kundërshtimi është hedhur poshtë.

3. Dispozitat për shkarkimin nga detyrimet e mbetura nuk cenohen.

Neni 165

Përgjegjësitë e veprimeve për ekzekutimin ndaj debitorit

Gjykata e rrethit, ku është hapur ose kërkon të hapet procedura e falimentimit, vlerësohet si gjykata përgjegjëse, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, për vendimet e nevojshme për t'u ekzekutuar ndaj debitorit pas mbylljes së procedurës së falimentimit.

Neni 166

Vendimi i gjykatës për shpërndarje të vonuar

1. Me kërkesë të administratorit të falimentimit ose të një kreditori falimentimi, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit urdhëron një shpërndarje të vonuar kur:

a)zhbllokohen për shpërndarje fonde të mbajtura;

b)kthehen shumat që janë paguar nga masa e falimentimit;

c)identifikohen, pas mbledhjes përfundimtare, sende të masës së falimentimit.

2. Mbyllja e procedurës së falimentimit nuk pengon vendimin e gjykatës për kryerjen e shpërndarjes së vonuar.

3. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit duke pasur parasysh vlerën e lartë ose të ulët të shumës ose të sendit dhe shpenzimet e një shpërndarjeje të vonuar, nëse e sheh të arsyeshme mund të heqë dorë nga vendimi dhe t'i kalojë debitorit shumën e disponueshme ose sendin e identifikuar. Vendimi mund të kushtëzohet nga parapagimi i një shume të paracaktuar për mbulimin e shpenzimeve të shpërndarjes së mëvonshme.

Neni 167

Ankimi

1. Vendimi i gjykatës, që refuzon shpërndarjen e vonuar, i dërgohet palës kërkuese. Pala kërkuese mund të paraqesë ankim të veçantë ndaj vendimit.

2. Vendimi i gjykatës, që urdhëron një shpërndarje të vonuar u dorëzohet administratorit të falimentimit, debitorit dhe kreditorit që kanë bërë kërkesën për shpërndarje të vonuar. Debitori ka të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit.

Neni 168

Kryerja e shpërndarjes së mëvonshme

Me dhënien e vendimit për shpërndarje të mëvonshme, administratori i falimentimit shpërndan shumën e vënë në dispozicion ose të ardhurat e marra nga shitja e sendit të identifikuar në bazë të listës përfundimtare. Ai i jep llogari për këtë shpërndarje seksionit tregtar të gjykatës së rrethit.

Neni 169

Përfundimi i kreditorëve të masës së falimentimit

1. Kreditorët e masës së falimentimit, pretendimet e të cilëve i janë bërë të njohura administratorit, përfundohen vetëm:

a) pas caktimit të pjesës gjatë shpërndarjes së parë;

b) pas mbledhjes përfundimtare gjatë shpërndarjes së fundit;

c) pas shpalljes nëse vendoset shpërndarje e vonuar. Kreditorët mund të pretendojnë ripagimin vetëm nga fondet e mbetura në masën e falimentimit.

KREU III

NDËRPRERJA E PROCEDURËS

Neni 170

Ndërprerja për mungesë të pasurive në masën e falimentimit

1. Në qoftë se pas fillimit të procedurës së falimentimit rezulton se masa e falimentimit nuk mjafton për mbulimin e shpenzimeve të procedurës, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit e ndërpret procedurën. Ndërprerja nuk bëhet kur parapaguhet një shumë e mjaftueshme.

2. Përpara vendimit për ndërprerje të procedurës së falimentimit dëgjohe mbledhja e kreditorëve, administratori dhe kreditorët e masës së falimentimit.

3. Administratori përdor çdo shumë në të holla, që gjendet në masën e falimentimit, për shlyerjen e shpenzimeve të procedurës. Së pari, paguhen shpenzimet në përpjesëtim me shumën përkatëse para ndërprerjes së procedurës. Administratori nuk mban përgjegjësi të mëtejshme për disponimin e sendeve të masës së falimentimit.

Neni 171

Njoftimi për pasuri të pamjaftueshme të masës së falimentimit

1. Nëse mbulohen shpenzimet e procedurës së falimentimit, por pasuritë nuk mjaftojnë për të përmbushur detyrime të tjera, të maturuara, të masës së falimentimit, administratori i falimentimit njofton seksionin tregtar të gjykatës së rrethit për pamjaftueshmërinë e pasurive. E njëjta gjë vlen kur pasuritë parashikohen të jenë të pamjaftueshme për plotësimin e detyrimeve të tjera ekzistuese të masës së falimentimit në datën e maturimit.

2. Gjykata shpall publikisht njoftimin për pamjaftueshmëri të pasurive në masën e falimentimit. Njoftimi u bëhet individualisht kreditorëve të masës së falimentimit.

3. Detyra e administratorit për administrimin dhe përdorimin e pasurive të masës së falimentimit vazhdon edhe pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive.

Neni 172

Ripagimi i kreditorëve të masës së falimentimit

1. Administratori i falimentimit duhet të ripaguajë detyrimet e masës së falimentimit sipas radhës së mëposhtme. Detyrimet e rangut të njëjtë paguhën sipas raportit të shumave:

- a) shpenzime të procedurës së falimentimit;
- b) detyrime të masës së falimentimit për procedurën e falimentimit, të cilat janë bërë ligjërisht të kërkueshme pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive, por që nuk bëjnë pjesë në shpenzimet e procedurës;
- c) detyrime të tjera të masës së falimentimit ku përfshihen në fund edhe shpenzimet për jetesë sipas neneve 84 dhe 85, fjalia e tretë, pika 1 të këtij ligji.

2. Vlerësohen si detyrime të masës së falimentimit sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni:

- a) detyrimet sipas një kontrate të ndërsjellë, të cilën administratori ka zgjedhur ta zbatojë pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive të masës së falimentimit;
- b) detyrimet sipas një kontrate të ndashme për periudhën kohore pas datës së parë kur administratori mund ta përfundontë këtë kontratë pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive të masës së falimentimit;
- c) sipas një kontrate periodike, nëse administratori ka pretenduar vlerën në favor të masës së falimentimit pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive.

Neni 173

Ndalimi i ekzekutimit

Është i palejueshëm ekzekutimi i një detyrimi të masës së falimentimit sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 172 pasi administratori i falimentimit ka njoftuar për pamjaftueshmërinë e pasurive në masën e falimentimit.

Neni 174

Ndërprerja pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive në masën e falimentimit

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ndërpret procedurën e falimentimit pasi administratori i falimentimit ta ketë shpërndarë masën e falimentimit sipas nenit 172 të këtij ligji. Administratori paraqet llogari të veçanta për veprimtarinë e vet pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive në masën e falimentimit.

2. Në qoftë se pas ndërprerjes së procedurës gjenden sende që formojnë pjesë të masës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me kërkesë të administratorit ose të një kreditori të masës, urdhëron shpërndarje të vonuar. Nenet 166 pika 3, 167 dhe 168 të këtij ligji zbatohen sipas rastit.

Neni 175

Ndërprerja për shkak të zhdukjes së mëvonshme të shkakut për hapjen e procedurës së falimentimit

Me kërkesë të debitorit, procedura e falimentimit ndërpritet kur ai është në gjendje ta sigurojë gjykatën se pas ndërprejes nuk do të jetë më i kërcënuar nga gjendja e paaftësisë paguese ose falimentimi në rast se procedura e falimentimit është hapur për shkak të paaftësisë paguese. Një kërkesë e tillë pranohet nëse debitori tregon në gjykatë, në mënyrë bindëse, se nuk ka shkak për hapjen e procedurës së falimentimit.

Neni 176

Ndërprerja me miratimin e kreditorëve

1. Procedura e falimentimit ndërpritet me kërkesën e debitorit, kur ky, pasi përfundon periudha e njoftimit, paraqet një deklaratë miratimi të të gjithë kreditorëve të falimentimit, që kanë depozituar pretendime për ndërprerjen e kësaj procedure. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, sipas diskrecionit të saj, vendos për kreditorët, kërkesat e të cilëve janë kundërshtuar nga debitori ose administratori i falimentimit dhe për kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, lidhur me kërkesat e miratimit të kreditorëve ose të mjeteve të sigurisë që ata duhet të paraqesin.

2. Procedura e falimentimit mund të ndërpritet me kërkesën e debitorit edhe përpara mbarimit të afatit të depozitimit nëse gjykata nuk njeh kreditorë të tjerë përveç kreditorëve për të cilët debitori ka paraqitur deklaratat e miratimit prej tyre.

Neni 177

Procedura e ndërprerjes

1. Kërkesa për ndërprerjen e procedurës së falimentimit sipas neneve 175 ose 176 të këtij ligji duhet të shpallet publikisht. Ajo depozitohet në regjistrin e gjykatës për inspektim të palëve. Në rastin e parashikuar në nenin 179 kërkesa shoqërohet edhe nga deklarata e miratimit të kreditorëve. Brenda një jave pas shpalljes publike, kreditorët e falimentimit kanë mundësinë ta kundërshtojnë me shkrim këtë kërkesë ose të regjistrojnë kundërshtimin në protokollin e regjistrit të gjykatës.

2. Para se të vendosë për ndërprerjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit dëgjon palën kërkuese, administratorin e falimentimit dhe komitetin e kreditorëve, kur një i tillë është caktuar. Në rastin e kundërshtimit prej një kreditori, dëgjohej edhe kreditori i kundërshtuar.

3. Përpara ndërprerjes, administratori paguan detyrimet e pakundërshtuara të masës së falimentimit dhe jep mjete sigurie për pretendimet e kundërshtuara.

Neni 178

Shpallja publikisht dhe pasojat ligjore të ndërprerjes

1. Vendimi për ndërprerjen e procedurës së falimentimit sipas neneve 170, 174, 175 dhe 176 të këtij ligji, dhe shkakut për këtë ndërprerje shpallen publikisht. Debitori, administratori i falimentimit dhe anëtarët e komitetit të kreditorëve njoftohen më parë për datën e hyrjes në fuqi të ndërprerjes.

2. Me ndërprerjen e procedurës së falimentimit debitori rifiton të drejtën të disponojë lirisht për pasuritë e masës së falimentimit. Nenet 164 dhe 165 të këtij ligji zbatohen sipas rastit.

Neni 179

Ankimi

1. Në qoftë se procedura e falimentimit ndërpritet, sipas neneve 170, 175 dhe 176 të këtij ligji, çdo kreditor falimentimi ka të drejtën e ankimit të veçantë. Debitori mund të paraqesë ankim të veçantë nëse procedura e falimentimit është ndërprerë, sipas neni 170 të këtij ligji.

2. Debitori ka të drejtën e ankimit të veçantë kundër vendimit të gjykatës, që refuzon kërkesën sipas neneve 175 dhe 176 të këtij ligji.

PJESA E GJASHTË PLANI I RIORGANIZIMIT

KREU I HARTIMI I PLANIT TË RIORGANIZIMIT

Neni 180

Politika e planit

Ripagimi i kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë dhe i kreditorëve të falimentimit, disponimi i pasurive të masës së falimentimit dhe shpërndarja e tyre te palët, si dhe përgjegjësia e debitorit që shtrihet edhe pas përfundimit të procedurës së falimentimit mund të rregullohen me një plan riorganizimi, që ndryshon nga parashikimet e këtij ligji.

Neni 181

Paraqitja e planit të riorganizimit

1. Të drejtën për paraqitjen e një plani riorganizimi përpara seksionit tregtar të gjykatës së rrethit e kanë administratori i falimentimit dhe debitori. Paraqitja e këtij plani nga debitori mund t'i bashkohet kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit. Planin i paraqitur në gjykatë pas mbledhjes përfundimtare të kreditorëve nuk merret parasysh.

2. Në qoftë se mbledhja e kreditorëve i ka ngarkuar administratorit hartimin e një plani falimentimi, administratori ia paraqet planin gjykatës brenda një afati kohor të arsyeshëm.

3. Gjatë hartimit të planit nga administratori, paraqesin komente komiteti i kreditorëve, kur ka një të tillë, si dhe organi përfaqësues i punonjësve dhe debitori, si këshilltarë.

Neni 182

Hollësitë e planit

Planin i riorganizimit përbëhet nga pjesa paraqitëse dhe analiza e hollësishme. Këtyre u shtohen edhe shtojcat e përmendura në nenet 229 dhe 230 të këtij ligji.

Neni 183

Pjesa paraqitëse

1. Në pjesën paraqitëse të planit të riorganizimit përshkruhen masat e marra pas fillimit të procedurës së falimentimit, për të krijuar bazat për tjetërsimin e të drejtave të palëve të përfshira.

2. Pjesa paraqitëse duhet të përmbajë të gjitha të dhënat e tjera, si dhe pasojat e planit, të cilat janë të rëndësishme për vendimin e kreditorëve për ta pranuar planin, si dhe për miratimin e tij nga gjykata.

Neni 184
Pjesa arsyetuese

Në pjesën arsyetuese të planit të riorganizimit përcaktohet si do të tjetërsohen, nëpërmjet planit, të drejtat e palëve të përfshira.

Neni 185
Krijimi i grupeve

1. Gjatë përcaktimit të të drejtave të pjesëmarrësve në planin e riorganizimit formohen grupe kreditorësh, me të drejta dhe interesa të ndryshëm ekonomikë. Duhet të bëhet dallim ndërmjet:
 - a) kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë, nëse të drejtat e tyre preken nga plani;
 - b) secilit rang të kreditorëve të falimentimit;
 - c) secilit rang të kreditorëve të rangjeve më të ulëta, përveç rastiit kur pretendimet e tyre nuk merren parasysh, sipas nenit 225 të këtij ligji.
2. Kreditorët me të drejta të barabarta mund të formojnë grupe, ku përmbliohen kreditorë me interesa të njëjtë ekonomikë. Grupet duhet të ndahen nga njeri-tjetri në mënyrë të duhur. Kriteret e ndarjes paraqiten në plan.

Neni 186
Të drejtat e kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë

1. Kur në planin e riorganizimit nuk është përcaktuar ndryshe, plani nuk cenon të drejtën e kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë, detyrimi i të cilëve shlyhet prej sendeve që u nënshtrohen të drejtës së ripagimit të veçantë.
2. Nëse në plan vendoset një rregullim i ndryshëm për kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, pjesa analizuese e planit tregon masën në të cilën pakësohen pretendimet e tyre, jepet me hollësi periudha e shtyrjes së pretendimeve ose parashikohen rregullime të tjera, të cilave duhet t'u nënshtrohen këta kreditorë.

Neni 187
Të drejtat e kreditorëve të falimentimit

Pjesa analizuese e planit të falimentimit tregon sasinë në të cilën është zvogëluar pretendimi i kreditorëve të falimentimit, jepet me hollësi periudha e shtyrjes së pretendimeve, shpallen mjetet e sigurimit për ta ose parashikohen rregullime të tjera, të cilave duhet t'u nënshtrohen këta kreditorë.

Neni 188
Të drejtat e kreditorëve të rangjeve me të ulëta

1. Pretendimet e kreditorëve të rangjeve më të ulëta vlerësohen të përjashtuara, kur në planin e riorganizimit nuk përcaktohet ndryshe.
2. Nëse plani i riorganizimit vendos ndryshe, në pjesën e analizës duhet të jepen të dhënat e përshkruara në nenin 187 të këtij ligji, për çdo grup të kreditorëve të rangjeve më të ulëta.
3. Planin e riorganizimit nuk përjashton ose kufizon përgjegjësinë e debitorit për pagesa e detyrime të natyrës civile ose penale, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 42 të këtij ligji, që shtrihet edhe pas përfundimit të procedurës së falimentimit.

Neni 189
Trajtimi i barabartë i të gjithë pjesëmarrësve

1. Të gjitha palët brenda grupit kanë të drejta të barabarta.

2. Trajtimi i ndryshëm i pjesëtarëve të një grupi lejohet vetëm me miratimin e të gjithë pjesëtarëve. Në këtë rast planit të riorganizimit duhet t'i shtohet deklarata miratuese e secilës prej palëve.

3. Është e pavlefshme çdo marrëveshje e arritur midis administratorit të falimentimit, debitorit ose e personave të tjerë dhe pjesëtarëve të veçantë, nëpërmjet së cilës parashikohen përfitime të paparashikuara në plan për shkak të pranisë së këtyre palëve në një votim, ose në përgjithësi, në lidhje me procedurën e falimentimit.

Neni 190

Përgjegjësia e debitorit

1. Nëse në planin e riorganizimit nuk është përcaktuar ndryshe, debitori shkarkohet nga detyrimet e mbetura ndaj kreditorëve të falimentimit, pasi këta kreditorë janë shlyer në mënyrën e parashikuar në pjesën analizuese të planit.

2. Kur debitori është një shoqëri e thjeshtë, pika 1 e këtij neni zbatohet sipas rastit për ortakët më përgjegjësi të pakufizuar.

Neni 191

Ndryshimi i gjendjes së pasurisë

Nëse duhet të krijohen, ndryshohen, kalohen ose anulohen të drejta juridike mbi sende, deklaratat juridike të nevojshme për të krijuar pasoja juridike të transferimit ndërmjet palëve mund të përfshihen në pjesën arsyetuese të planit të riorganizimit. Në qoftë se bëhet fjalë për të drejta të regjistruara mbi pasuri të paluajtshme ose të drejta të tjera të regjistruara, këto të drejta përcaktohen duke marrë parasysh dispozitat përkatëse. Fjalja e dytë e këtij paragrafi zbatohet sipas rastit për të drejta që janë regjistruar në një regjistër tjetër pronësie.

Neni 192

Mbikëqyrja e pasurisë. Të ardhurat dhe plani financiar

Në qoftë se kreditorët ripaguhën nga të ardhurat e një veprimtarie, që vazhdon të funksionojë nën drejtimin e debitorit ose të një të treti, planit të riorganizimit i bashkëngjitet një inventar i veprimtarisë së debitorit. Gjithashtu, plani tregon çfarë shpenzimesh dhe të ardhurash priten për periudhën gjatë së cilës duhet të ripaguhën kreditorët dhe në çfarë renditjeje shpenzimesh dhe fitimesh funksionon veprimtaria gjatë kësaj periudhe kohe.

Neni 193

Shtojca të tjera

1. Në qoftë se në planin e riorganizimit është parashikuar që debitori të vazhdojë mbajtjen e veprimtarisë dhe debitori është person fizik, planit duhet t'i bashkëlidhet deklarata e debitorit, e cila vërteton gatishmërinë e tij për vazhdimin e mbajtjes së veprimtarisë mbi bazën e planit. Kur debitori është shoqëri e thjeshtë, planit i bashkëlidhet një deklaratë e ngjashme e anëtarëve të shoqërisë me përgjegjësi personale. Deklarata e debitorit, sipas fjalisë së parë, nuk kërkohet kur planin e ka parashtruar vetë debitori.

2. Në qoftë se kreditorët parashikojnë të përfitojnë pjesë ose aksione, të drejta anëtarësimi ose të drejta të tjera në një shoqëri ose shoqëri të thjeshtë, planit i bashkëlidhet deklarata miratuese e secilit prej këtyre kreditorëve.

3. Në qoftë se një palë e tretë ka marrë përsipër detyrime ndaj kreditorëve në rastin kur plani është miratuar, planit i bashkëlidhet deklarata e të tredit.

Neni 194
Mospranimi i planit

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me nismën e tij, vendos mospranimin e planit të riorganizimit, në rastet kur:

a) dispozitat e këtij ligji mbi të drejtën për paraqitjen dhe përmbajtjen e planit nuk janë respektuar dhe parashtruesi nuk është në gjendje të korrigjojë gabimin ose nuk e korrigjon atë brenda një afati të arsyeshëm, të caktuar nga gjykata;

b) plani i riorganizimit i parashtruar nga debitori përmban të dhëna të mjaftueshme për të çmuar se nuk ka perspektivë për t'u pranuar nga kreditorët ose për t'u miratuar nga gjykata;

c) ka të dhëna të mjaftueshme se pretendimet e palëve sipas pjesës analizuese të planit të hartuar prej debitorit nuk mund të plotësohen;

ç) plani i riorganizimit kundërshtohet nga shumica e kreditorëve të falimentimit, që i përkasin një grupimi të caktuar të tyre;

d) plani i riorganizimit kundërshtohet nga kreditorët e falimentimit që i përkasin një grupimi të caktuar, pretendimet e të cilëve përbëjnë së paku gjysmën e shumës së përgjithshme të pretendimeve pasurore mbi masën e falimentimit;

dh) plani i riorganizimit kundërshtohet me shkrim nga shumica e kreditorëve të siguruar;

e) plani i riorganizimit kundërshtohet me shkrim nga kreditorët e siguruar, pretendimet e të cilëve përbëjnë së paku gjysmën e shumës së përgjithshme të pretendimeve pasurore mbi masën e falimentimit dhe që u përkasin kreditorëve të siguruar.

2. Kur debitori ka paraqitur tashmë në procedurën e falimentimit një plan i cili nuk është pranuar nga kreditorët, nuk është miratuar nga gjykata ose është tërhequr nga vetë debitori pas shpalljes publikisht të datës së mbledhjes për diskutim, gjykata nuk pranon një plan të ri të debitorit kur këtë mospranim e kërkon administratori i falimentimit më miratimin e komitetit të kreditorëve, kur është caktuar një i tillë.

3. Kundër vendimit të mospranimit të planit të riorganizimit, paraqitësi i tij ka të drejtën e ankimit të veçantë.

4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të vendosë përjashtimin e një kreditori të siguruar ose të një grupimi të tyre nga zbatimi i planit të riorganizimit.

Neni 195
Komente për planin

1. Kur plani i riorganizimit pranohet, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ia kalon atë për mendim:

a) komitetit të kreditorëve, kur ka një të tillë, si organi i përfaqësimit të punonjësve;

c) debitorit kur planin e ka paraqitur administratori i falimentimit;

d) administratorit të falimentimit kur planin e ka paraqitur debitori.

2. Gjykata mund t'u japë rastin të shprehen edhe organeve zyrtare të përfaqësuesve profesionalë të debitorit për industrinë, tregtinë, artizanatin ose bujqësinë.

3. Gjykata cakton një afat për dorëzimin e mendimeve.

Neni 196
Pezullimi i disponimit dhe shpërndarjes

Derisa vazhdimi i disponimit dhe shpërndarjes së pasurive të një mase falimentimi pengon zbatimin e planit të paraqitur të riorganizimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, me kërkesë të debitorit ose të administratorit të falimentimit, urdhëron pezullimin e disponimit dhe të shpërndarjes. Gjykata anulon ose ndalon pezullimin, nëse ai sjell rrezik me dëme të ndjeshme për masën e falimentimit ose kur administratori, me miratimin e komitetit të kreditorëve ose mbledhjes së kreditorëve, kërkon vazhdimin e disponimit dhe të shpërndarjes.

Neni 197
Paraqitja e planit

Plani i riorganizimit me shtojcat dhe komentet e marra depozitohet në zyrën e regjistrit të gjykatës për inspektim nga palët.

KREU II
PRANIMI DHE MIRATIMI I PLANIT TË FALIMENTIMIT

Neni 198
Diskutimet dhe mbledhja për votim

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton një afat për mbledhjen e diskutimit të planit të riorganizimit dhe të së drejtës së votës të kreditorëve për votimin e planit të riorganizimit. Mbledhja caktohet jo më vonë se një muaj.

2. Data e mbledhjes së diskutimit dhe e votimit shpallet publikisht. Shpallja publikisht vë në dukje që plani me gjithë komentet mund të inspektohet në regjistrin e gjykatës.

3. Kreditorët e falimentimit që kanë paraqitur pretendime, kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë, administratori i falimentimit, debitori dhe organi i përfaqësimit të punonjësve njoftohen individualisht. Me ftesën dërgohet edhe një kopje e planit ose një përmbledhje e tij.

Neni 199
Mbledhja për verifikim

Mbledhja për diskutim dhe votim nuk duhet të mbahet përpara mbledhjes për verifikim. Megjithatë, data e mbajtjes së dy mbledhjeve mund të përkojë.

Neni 200
E drejta e votës së kreditorëve të falimentimit

1. Për të drejtën e votimit të kreditorëve të falimentimit që votojnë në planin e riorganizimit zbatohen, sipas rastit, parashikimet e pikave 1, fjalia e parë, 2 dhe 3 shkronja “a” të nenit 64 të këtij ligji. Kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë kanë të drejtën e votimit vetëm si kreditorë falimentimi në rastin kur mund të pretendojnë që debitori të përgjigjet edhe personalisht dhe nëse heqin dorë nga ripagimi i veçantë ose nuk janë ripaguar plotësisht në këtë mënyrë; për sa kohë mosripagimi i tyre nuk është vërtetuar, ata merren parasysh për vlerën e mundshme të pjesës që nuk është ripaguar.

2. Kreditorët, pretendimet e të cilëve nuk dëmtohen nga plani, nuk kanë të drejtë vote.

Neni 201
E drejta e votës së kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë

1. Nëse në planin e riorganizimit rregullohet edhe statusi ligjor i kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë, gjatë mbledhjes shqyrtohen veçmas edhe të drejtat e këtyre kreditorëve. E drejta e votës lind nga të drejtat e ripagimit të veçantë, që nuk kundërshtohen nga administratori i falimentimit dhe as nga kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë ose nga kreditorët e falimentimit. Për të drejtën e votës që lidhet me një të drejtë të kundërshtuar, të pezulluar ose të pamaturuar, zbatohen, sipas rastit, neni 40 dhe pikat 2 dhe 3 shkronja “a” të nenit 64 të këtij ligji.

2. Pika 2 e nenit 200 të këtij ligji zbatohet sipas rastit.

Neni 202
Lista e votimit

Nëpunësi i regjistrit të gjykatës shënon në një listë kreditorët që rezultojnë me të drejtë vote pas përfundimit të mbledhjes.

Neni 203
Ndryshimi i planit

Pala kërkuese ka të drejtë të ndryshojë përmbajtjen e dispozitave të veçanta të planit të riorganizimit në përputhje me përfundimet e mbledhjes së verifikimit. Për planin e ndryshuar mund të votohet në të njëjtën mbledhje.

Neni 204
Mbledhja e veçantë për votim

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të caktojë një mbledhje të veçantë për votimin e planit të riorganizimit. Në këtë rast periudha kohore ndërmjet mbledhjes për diskutim dhe mbledhjes për votim nuk duhet të jetë më shumë se një muaj.

2. Në mbledhjen për votim ftohen kreditorët me të drejtë vote dhe debitori. Në rast se plani ndryshohet, ndryshimi duhet të vihet në dukje në mënyrë të veçantë.

Neni 205
Votimi me shkrim

1. Kur është caktuar një mbledhje e veçantë, e drejta e votimit mund të ushtrohet me shkrim.

2. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit u dërgon fletën e votimit të gjithë kreditorëve me të drejtë vote pas mbledhjes së diskutimit dhe i njofton në të njëjtën mbledhje për të drejtën e tyre të votës. Dhënia e votës me shkrim merret parasysh vetëm kur ka arritur në gjykatë jo më vonë se dita para votimit. Kjo gjë duhet të vihet në dukje gjatë dorëzimit të fletëvotimit.

Neni 206
Votimi në grupe

Çdo grup i kreditorëve me të drejtë vote, voton veças për planin e riorganizimit.

Neni 207
Shumica e nevojshme

1. Për pranimin e planit të riorganizimit nga kreditorët kërkohet që në çdo grup:
a) shumica e kreditorëve me të drejtë vote të votojë pro planit;
b) shumica e pretendimeve të kreditorëve pro të jetë më shumë se gjysma e shumës së pretendimeve të kreditorëve me të drejtë vote.

2. Kreditorët që gëzojnë një të drejtë bashkërisht ose të drejtat e të cilëve përbëjnë një të drejtë të përbashkët deri në shfaqjen e arsyes për hapjen e procedurës së falimentimit, llogariten gjatë votimit si një kreditor. I njëjti rregull vlen nëse mbi një të drejtë ekziston një e drejtë pengu ose uzufukti.

Neni 208
Ndalimi i bllokimit

1. Edhe kur nuk arrihen shumicat e kërkuara, një grup votuesish vlerësohen se kanë dhënë miratimin nëse:

a) kreditorët e këtij grupi nuk dëmtohen nga plani i falimentimit, krahasuar me gjendjen e tyre sikur të mos kishte plan ;

b) kreditorët e këtij grupi përfitojnë pjesë në masë të arsyeshme në vlerën ekonomike që do t'u shkojë pjesëtarëve në bazë të planit;

c) shumica e grupeve votuese ka votuar pro planit me shumicën e nevojshme.

2. Sipas planit ka pjesëmarrje të arsyeshme të kreditorëve të një grupi në kuptimin e shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni kur:

a) asnjë kreditor tjetër nuk përfiton vlerë ekonomike që tejkalon shumën e plotë të pretendimit të tij;

b) nuk përfiton vlerë ekonomike kreditori i cili në mungesë të planit do të ripaguhej si pjesëtar i një rangu më të ulët krahasuar me kreditorët e tjerë të grupit, debitori dhe asnjë person tjetër me pretendime mbi pasuritë ose aksionet e debitorit;

c) asnjë kreditor, i cili në mungesë të planit do të ripaguhej si pjesëtar i një rangu të njëjtë me kreditorët e grupit, nuk ka përfitim më të madh sesa këta kreditorë.

Neni 209
Miratimi i kreditorëve të falimentimit të rangjeve më të ulëta

1. Për pranimin e planit të riorganizimit nga kreditorët e rangjeve më të ulëta zbatohen këto dispozita shtesë:

a) grupet që renditen sipas shkronjave “a” ose “b” të pikës 1 të nenit 42 të këtij ligji quhen se kanë dhënë miratimin kur ata heqin dorë nga pretendimet përkatëse për interesat ose shpenzimet sipas planit ose quhet se është hequr dorë sipas pikës 1 të nenit 188 të këtij ligji, edhe sikur pretendimet për shumat kryesore të kreditorëve të falimentimit të mos ripaguheshin plotësisht sipas planit.

b) grupet me një rang më të ulët se shkronja “c” e pikës 1 të nenit 42 të këtij ligji quhen se kanë dhënë miratimin kur asnjëri prej kreditorëve të falimentimit nuk përfiton më shumë se kreditorët e këtij grupi sipas planit.

2. Nëse në votim nuk merr pjesë asnjë kreditor i një grupi, miratimi i grupit merret i dhënë.

Neni 210
Miratimi i debitorit

1. Miratimi i debitorit për planin vlerësohet i dhënë kur ai, jo më vonë se datat e mbledhjes për votim, nuk e kundërshton planin me shkrim ose në regjistrin e gjykatës. Nëse debitori nuk është person fizik, mendimi kundërshtues i një ose disa personave, që kanë shumicën e pjesëve ose aksioneve të debitorit quhet i njëjtë me mendimin kundërshtues të debitorit.

2. Kundërshtimi sipas pikës 1 të këtij neni quhet i pavlefshëm kur:

a) debitori nëpërmjet planit nuk shkakton një gjendje më të keqe sesa sikur të mos kishte plan;

b) asnjë kreditor nuk përfiton një vlerë ekonomike më të lartë sesa pretendimi i tij.

Neni 211
Vërtetimi nga gjykata

1. Pas pranimit të planit të riorganizimit prej kreditorëve, sipas parashikimeve të neneve 207 dhe 209 të këtij ligji dhe pasi debitori jep pëlqimin, plani duhet miratuar nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit.

2. Para marrjes së vendimit për miratim, gjykata dëgjon administratorin e falimentimit, komitetin e kreditorëve, nëse ka një të tillë, dhe debitorin.

Neni 212

Plani i kushtëzuar

Nëse në planin e riorganizimit është parashikuar që para miratimit të plotësohen kushte të caktuara ose të zbatohen masa të tjera, plani nuk mund të miratohet derisa të jenë përmbushur këto kushte. Miratimi nuk jepet, kryesisht, nëse këto kushte nuk janë përmbushur edhe pas mbarimit të një afati të arsyeshëm, të vendosur nga gjykata.

Neni 213

Shkelja e dispozitave procedurale

Miratimi nuk jepet:

a) kur nuk janë marrë parasysh dispozitat për përmbajtjen dhe aspektet procedurale të planit të riorganizimit, si dhe pranimi nga kreditorët dhe miratimi nga debitori, për një çështje thelbësore dhe e meta nuk mund të korrigjohet;

b) kur pranimi i planit është bërë me mjete të papërshtatshme, veçanërisht duke sjellë përfitim për një kreditor të caktuar.

Neni 214

Mbrojtja e pakicave

1. Me kërkesë të një kreditori, miratimi i planit nuk pranohet kur një kreditor:

a) kundërshton planin me shkrim ose në regjistrin e gjykatës brenda datës së mbledhjes për votim;

b) shkakton një gjendje më të keqe se sa po të mos kishte plan.

2. Kreditori me kërkesë duhet të provojë, në mënyrë bindëse, për gjykatën se plani shkakton një gjendje më të keqe.

Neni 215

Shpallja e vendimit

1. Vendimi me anë të të cilit plani i riorganizimit miratohet ose hidhet poshtë duhet të shpallet në mbledhjen për votim ose në një mbledhje të veçantë, që duhet të caktohet në afatin më të afërt.

2. Kur plani miratohet, kreditorëve të falimentimit, që kanë depozituar pretendime dhe kreditorëve me të drejtë ripagimi të veçantë u dërgohet një kopje e planit ose një përmbledhje thelbësore e tij, duke vënë në dukje faktin e miratimit.

Neni 216

Ankimi

Kreditorët dhe debitori mund të paraqesin ankim të veçantë sipas Kodit të Procedurës Civile kundër vendimit që miraton ose nuk e miraton planin e falimentimit.

PJESA E SHTATË
PASOJA TË PLANIT TË MIRATUAR.
MBIKËQYRJA E PËRMBUSHJES SË PLANIT

KREU I

Neni 217

Pasojat e përgjithshme të planit

1. Sapo vendimi që miraton planin e riorganizimit merr formë të prerë, pasojat e tij të pjesës së analizës janë të vlefshme dhe sjellin pasoja mbi të gjithë pjesëtarët. Nëse pjesa analizuese kërkon lindjen, ndryshimin, kalimin ose heqjen dorë nga të drejtat mbi sendet ose nëse një pjesë e veprimtarisë së një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar duhet të mbyllet, deklaratat e vullnetit të palëve të përfshira në plan quhen se janë ekzekutuar në formën e kërkuar nga ligji. I njëjti rregull vlen edhe për detyrime të marra përsipër, që bazohen në lindjen, ndryshimin, kalimin ose anulimin e të drejtave mbi sende ose heqjen dorë nga pjesët ose aksionet. Dy fjalitë e para të kësaj pike zbatohen edhe për kreditorët e falimentimit, që nuk i kanë depozituar pretendimet e tyre, si dhe për palët që kanë kundërshtuar planin.

2. Plani nuk cenon të drejtat e kreditorëve të falimentimit kundrejt bashkëdebitorëve të debitorit ose garantëve të debitorit, si dhe të drejtat e këtyre kreditorëve mbi sende që nuk i përkasin masës së falimentimit ose që burojnë nga një njoftim përparësie në radhën e pagesës për këto sende. Megjithatë, nëpërmjet planit, debitori shkarkohet kundrejt bashkëdebitorëve, garantëve ose palëve të tjera që kanë pretendime ndaj tij në të njëjtën mënyrë siç shkarkohet kundrejt kreditorëve të falimentimit.

3. Nëse një kreditor është ripaguar më shumë se pjesa që i takonte sipas planit, nuk i kërkohet të kthejë pjesën e tepërt.

Neni 218

Klauzola e ringritjes së padisë

1. Nëse në bazë të pjesës analizuese të planit të riorganizimit, pretendimet e kreditorëve të falimentimit janë pezulluar ose janë anuluar pjesërisht, pezullimi ose anulimi nuk ka pasoja mbi kreditorin, pretendimet e të cilit debitori nuk i përmbush në një masë të ndjeshme gjatë zbatimit të planit të falimentimit. Mospërmbushja në masë të ndjeshme quhet e tillë vetëm nëse debitori nuk ka paguar në afat detyrimin e maturuar edhe pas njoftimit me shkrim të kreditorit dhe pasi i është lënë një afat pagese prej të paktën dy javësh.

2. Nëse hapet një procedurë e re falimentimi mbi pasuritë e debitorit para zbatimit të plotë të planit, pezullimi ose heqja dorë nga pretendimet nuk është më e vlefshme për kreditorët e falimentimit.

3. Plani mund të parashikojë ndryshe nga sa më sipër. Megjithatë, plani nuk mund të shmangë zbatimin e pikës 1 të këtij neni, në dëm të debitorit.

Neni 219

Pretendimet e kundërshtueshme. Pretendimet me zëvendësim

1. Nëse një pretendim është kundërshtuar në mbledhjen e verifikimit ose shuma e pretendimit zëvendësues të ngritur nga kreditori i falimentimit me të drejtë ripagimi të veçantë nuk është verifikuar ende, nuk vërtetohet rasti i mospërmbushjes së detyrimit në zbatim të planit të riorganizimit në përputhje me pikën 1 të nenit 218 të këtij ligji, me kusht që debitori të marrë parasysh pretendimin derisa të bëhet verifikimi i shumës së kërkuar në masën që i përgjigjet vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit mbi të drejtën e votës së këtij kreditori për votimin për planin e riorganizimit. Në qoftë se gjykata nuk merr vendim për të drejtën e votimit, me kërkesë

të debitorit ose të kreditorit, ajo merr një vendim të mëvonshëm për shumën e pretendimit, që debitori duhet të marrë parasysh në periudhën e kushteve të përkohshme.

2. Në qoftë se ky verifikim përfundimtar tregon se debitori ka paguar në mënyrë të pamjaftueshme, atëherë paguhet shuma e prapambetur. Quket mospërmbushje e zbatimit të planit në masë të ndjeshme vetëm rasti kur debitori nuk paguan shumën e prapambetur, megjithëse kreditori ka njoftuar me shkrim dhe i ka lejuar një afat prej jo më pak se dy javësh.

3. Në qoftë se përcaktimi përfundimtar tregon se debitori ka mbipaguar, ai mund të kërkojë kthimin e shumës së mbipaguar vetëm për sasinë që tejkalon shumën e pamaturuar të pretendimit të kreditorit sipas planit të riorganizimit.

Neni 220

Zbatimet e planit

1. Kreditorët e falimentimit, pretendimet e të cilëve janë verifikuar dhe janë të pakundërshtuara nga debitori, mund të kërkojnë ekzekutimin e pretendimeve ndaj debitorit në mbledhjen e verifikimit në të njëjtën mënyrë sikur të ishte një vendim i formës së prerë, në bazë të planit të miratuar të falimentimit. Pretendimi i pakundërshtuar barazohet me një pretendim të cilit i është hedhur poshtë kundërshtimi i ngritur. Neni 165 i këtij ligji zbatohet sipas rastit.

2. I njëjti rregull vlen edhe për ekzekutimin e detyrueshëm të debitorit ndaj një të treti, i cili garanton përmbushjen e detyrimeve sipas planit me anë të një deklaratë me shkrim të dorëzuar në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit pa rezervën e kundërshtimit.

3. Në qoftë se një kreditor pretendon të drejtën që i takon në rastin e moszbatimit të planit të falimentimit nga debitori në një masë të ndjeshme, kreditori, për të përdorur klauzolën e ekzekutimit për këto të drejta dhe me qëllim që të fillojë ekzekutimin, duhet t'i provojë gjykatës, në mënyrë bindëse, pjesën e papaguar dhe mbarimin e periudhës së njoftimit, por nuk duhet të provojë fakte të tjera për mospërmbushjen e detyrimit nga debitori.

Neni 221

Mbyllja e procedurës së falimentimit

1. Sapo vendimi që miraton planin e riorganizimit merr formë të prerë, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit.

2. Para mbylljes, administratori korrigjon pretendimet e pakundërshtueshme ndaj masës së falimentimit dhe jep mjete sigurimi për pretendimet e kundërshtueshme.

3. Ky vendim dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht. Debitori, administratori i falimentimit dhe anëtarë të komitetit të kreditorëve njoftohen që më parë për datën kur hyn në fuqi mbyllja e procedurës. Pika 2 e nenit 200 të këtij ligji zbatohet sipas rastit.

Neni 222

Pasojat e mbylljes

1. Me mbylljen e procedurës së falimentimit mbarojnë edhe të gjitha funksionet e administratorit të falimentimit dhe të anëtarëve të komitetit të kreditorëve. Debitorit i kthehet e drejta të disponojë lirisht masën e falimentimit.

2. Dispozitat për mbikëqyrjen e zbatimit të planit nuk cenohen.

3. Çdo padë e ngritur për të kundërshtuar veprimet e debitorit në procedurën e falimentimit mund të vazhdohet nga administratori edhe pas mbylljes së procedurës, nëse kjo është parashikuar në pjesën analizuese të planit. Në këtë rast, padia vazhdohet për llogari të debitorit nëse në plan nuk është parashikuar ndryshe.

Neni 223

Mbikëqyrja e zbatimit të planit

1. Mbikëqyrja e zbatimit të planit mund të parashikohet në pjesën analizuese të planit të riorganizimit.

2. Pas mbylljes së procedurës së falimentimit, në rastin e pikës 1 të këtij neni, mbikëqyrjet përmbushja e pretendimeve që u takojnë kreditorëve ndaj debitorit, sipas pjesës trajtuese të planit të riorganizimit.

3. Kur kjo gjendje është parashikuar në pjesën analizuese, mbikëqyrja përfshin përmbushjen e pretendimeve të kreditorëve, që sipas pjesës analizuese, ngrihen kundër një personi juridik ose një shoqërie të thjeshtë, të krijuar pas hapjes së procedurës për t'u bashkuar me veprimtarinë ose për ta vazhduar atë ose ndërmarrjen e debitorit (shoqëria e bashkuar).

Neni 224

Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të falimentimit

1. Mbikëqyrja është detyrë e administratorit të falimentimit. Detyrat e administratorit të falimentimit dhe të anëtarëve të komitetit të kreditorëve dhe mbikëqyrja e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit vazhdojnë të ekzistojnë.

2. Gjatë kohës së mbikëqyrjes, administratori ka për detyrë t'i raportojë, çdo vit, komitetit të kreditorëve, kur është caktuar një i tillë dhe gjykatës për gjendjen dhe perspektivën e mëtejshme të realizimit të planit të riorganizimit. E drejta e komitetit të kreditorëve dhe e gjykatës për të kërkuar në çdo kohë të dhëna të veçanta ose një raport ndërmjetës, mbetet e pacenuar.

Neni 225

Detyrimi i administratorit të falimentimit për të njoftuar

Nëse administratori vëren se pretendimet, shlyerja e të cilave mbikëqyrjet, nuk paguhen ose nuk mund të paguhen, ai ia bën të njohur këtë fakt, pa vonesë, komitetit të kreditorëve dhe seksionit tregtar të gjykatës së rrethit. Nëse nuk është caktuar komitet kreditorësh, administratori në vend të tij njofton të gjithë kreditorët, të cilëve, sipas pjesës analizuese të planit të riorganizimit, u takon ripagimi i pretendimeve kundër debitorit ose shoqërisë në të cilën është shndërruar shoqëria ekzistuese, sipas pjesës analizuese të planit të riorganizimit.

Neni 226

Veprimet që kërkojnë pëlqim

Në pjesën analizuese të planit të riorganizimit mund të parashikohet që veprime të debitorit ose të shoqërisë së bashkuar janë të vlefshme kur jepet pëlqimi i administratorit të falimentimit. Nenet 68 pika 1 dhe 69 të këtij ligji zbatohen sipas rastit.

Neni 227

Kufiri i kredisë

1. Në pjesën analizuese të planit të riorganizimit mund të parashikohet që kreditorët e falimentimit me rang më të ulët në krahasim me kreditorët, pretendimet e të cilëve rrjedhin prej një huaje ose kredie tjetër ku debitori ose shoqëria e bashkuar është bërë palë gjatë kohës së mbikëqyrjes, duhet të vazhdojnë të ruajnë statusin e tyre të kreditorit të rangut më të ulët edhe në periudhën e mbikëqyrjes. Në këtë rast, duhet të caktohet një kufi maksimal për kreditë e këtij lloji. Ky nuk duhet të tejkalojë vlerën e sendeve të paraqitura në pasqyrën e mbikëqyrjes së pasurive, pjesë e planit, sipas nenit 192 të këtij ligji.

2. Kreditorët e falimentimit radhiten në rang më të ulët, sipas pikës 1, vetëm në krahasim me kreditorët të cilët arrijnë në marrëveshje se çfarë mase e pretendimit kryesor, e interesave dhe e shpenzimeve të huasë të dhëna prej tyre nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të huasë dhe për të cilat merret një miratim i shkruar nga administratori i falimentimit.

Shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 42 nuk cenohet nga parashikimet e këtij neni.

Neni 228

Rangjet më të ulëta të kreditorëve të rinj

Kreditorët, të drejtat e të cilëve rrjedhin nga kredi të dhëna ose të hapura sipas nenit 227 të këtij ligji, kanë pretendime të një rangu më të ulët sesa kreditorët me pretendime të tjera kontraktore që lindin gjatë periudhës së mbikëqyrjes. Këto pretendime vlerësohen të njëjta me ato që lindin në bazë të një kontrate të ndashme, e lidhur para fillimit të mbikëqyrjes, për periudhën kohore pas datës së parë kur kreditori mund të zgjidhte kontratën pas fillimit të mbikëqyrjes.

Neni 229

Marrja parasysh e statusit të rangut më të ulët

1. Çdo lloj rangu më i ulët i kreditorëve të falimentimit dhe i kreditorëve të përcaktuar në nenin 228 të këtij ligji, merret parasysh vetëm nëse procedura e falimentimit hapet para përfundimit të mbikëqyrjes.

2. Në këtë procedurë të re falimentimi, këta kreditorë kanë përparësi mbi kreditorët e tjerë të rangjeve më të ulëta.

Neni 230

Njoftimi i mbikëqyrjes

1. Nëse zbatimi i planit të riorganizimit mbikëqyret, ky fakt shpallet publikisht bashkë me vendimin për mbylljen e procedurës së falimentimit.

2. Shpallja publike duhet të përfshijë:

a) në rastin e pikës 3 të nenit 223 të këtij ligji, shtrirjen e mbikëqyrjes edhe mbi shoqërinë e bashkuar;

b) në rastin e nenit 226 të këtij ligji, kriteret e veprimeve që kërkojnë miratimin e administratorit të falimentimit;

c) në rastin e nenit 227 të këtij ligji shumën e kufirit maksimal të huasë.

3. Neni 30 i këtij ligji zbatohet sipas rastit. Nëse në rastin e nenit 226 të këtij ligji kufizohet e drejta për kalim të një pasurie të paluajtshme ose një të drejte tjetër të regjistruar në një regjistër pasurie, zbatohet sipas rastit neni 31 i këtij ligji.

Neni 231

Përfundimi i mbikëqyrjes

Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos përfundimin e mbikëqyrjes:

a) kur pretendimet, shlyerja e të cilave mbikëqyret, janë përmbushur ose përmbushja e tyre është siguruar;

b) kur kanë kaluar tre vjet nga përfundimi i procedurës së falimentimit dhe nuk është paraqitur kërkesë për fillimin e një procedurë të re falimentimi.

Vendimi shpallet publikisht. Pika 3 e nenit 230 të këtij ligji zbatohet sipas rastit.

Neni 232
Shpenzimet e mbikëqyrjes

Debitori paguan shpenzimet e mbikëqyrjes. Në rastin e pikës 3 të nenit 223 shpenzimet për mbikëqyrjen i paguan shoqëria e bashkuar.

PJESA E TETË
ADMINISTRIMI NGA VETË DEBITORI

KREU I

Neni 233
Kushtet

1. Debitori mund të administrojë ose disponojë mbi pasuritë e masës së falimentimit nën kontrollin e një mbikëqyrësi nëse seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos vetadministrimin në vendimin për hapjen e procedurës së falimentimit. Kjo procedurë u nënshtrohet dispozitave të përgjithshme, përveç rastit kur në këtë pjesë parashikohet ndryshe.

2. Vendimi i gjykatës për administrimin nga vetë debitori përmban:

- a) kërkesën e debitorit;
- b) miratimin e kreditorit, që kërkon hapjen e procedurës së falimentimit për kërkesën e debitorit;
- c) në përputhje me rrethanat, duhet që mendimi i gjykatës të mos sjellë një shtytje të procedurës ose të sjellë dëme për kreditorët.

3. Në rastin e pikës 1 të këtij neni, vendoset mbikëqyrës në vend të një administratori të falimentimit. Pretendimet e kreditorëve të falimentimit depozitohen te mbikëqyrësi. Në këtë rast nuk zbatohen parashikimet e nenit 31 të këtij ligji.

Neni 234
Urdhri i mëvonshëm

Në qoftë se seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ka hedhur poshtë kërkesën e debitorit për vetadministrim, por mbledhja e kreditorëve kërkon vetadministrimin e debitorit nën kontrollin e një mbikëqyrësi, gjykata urdhëron vetadministrimin. Administratori i mëparshëm mund të caktohet si mbikëqyrës.

Neni 235
Anulimi i urdhrit të gjykatës për administrim nga vetë debitori nën mbikëqyrje

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit anulon urdhrin për administrim nga vetë debitori nën mbikëqyrjen e një mbikëqyrësi, nëse diçka e tillë kërkohet:

- a) nga mbledhja e kreditorëve;
- b) nga një kreditor me të drejtë ripagimi të veçantë ose nga kreditori i falimentimit edhe nëse nuk ekzistojnë me kushtet e parashikuara nga shkronja “c” e nenit 233 të këtij ligji;
- c) nga debitori.

2. Kërkesa e një kreditori është e pranueshme nëse i vërteton gjykatës, në mënyrë bindëse, se nuk ekzistojnë me kushtet. Përpara se të vendosë për kërkesën, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit dëgjon debitorin. Kundër vendimit kreditori dhe debitori kanë të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

3. Mbikëqyrësi i deriatëhershëm mund të caktohet si administrator falimentimi.

Neni 236
Shpallja publike

Vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, me të cilin urdhërohet administrimi nga vetë debitori pas fillimit të procedurës së falimentimit ose me të cilin anulohet ky urdhër, shpallet publikisht.

Neni 237
Statusi i mbikëqyrësit

1. Zbatohen sipas rastit neni 37 shkronja “b”, nenet 43 deri në 47 dhe nenet 48 deri në 51 të këtij ligji për caktimin e mbikëqyrësit, për mbikëqyrjen e tij nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, përgjegjësi dhe të shpërblimeve të mbikëqyrësit.

2. Mbikëqyrësi verifikon gjendjen ekonomike të debitorit dhe monitoron administrimin e biznesit dhe shpenzimet për përballimin e jetesës.

3. Kur mbikëqyrësi vëren rrethana që sugjerojnë se vazhdimi i vetadministrimit do të dëmtonte kreditorët, ai ua bën të ditur këtë rrethanë, pa vonesë, komitetit të kreditorëve dhe seksionit tregtar të gjykatës së rrethit. Kur nuk është caktuar komitet kreditorësh, mbikëqyrësi njofton kreditorët e falimentimit, që kanë depozituar pretendimet e tyre dhe kreditorët me të drejtë ripagimi të veçantë.

Neni 238
Kërkesa për miratimin e mbikëqyrësit

1. Debitori mund të marrë përsipër detyrime që nuk kanë të bëjnë me ushtrimin e zakonshëm të veprimtarisë, vetëm me pëlqimin e mbikëqyrësit. Debitori nuk mund të marrë përsipër detyrimet që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë, kur mbikëqyrësi e kundërshton këtë veprim.

2. Mbikëqyrësi mund t'i kërkojë debitorit t'i lejojë atij mbledhjen dhe kryerjen e të gjitha pagesave.

Neni 239
Kërkesa për pëlqimin e komitetit të kreditorëve

Debitori duhet të marrë pëlqimin e komitetit të kreditorëve për çdo veprim juridik të një rëndësie të veçantë për procedurën e falimentimit. Nenet 128 pika 2, 129 dhe neni 132 të këtij ligji zbatohen sipas rastit.

Neni 240
Urdhri i gjykatës për miratim

1. Me kërkesë të mbledhjes së kreditorëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit urdhëron që veprime juridike të caktuara të debitorit të jenë të vlefshme vetëm me miratimin e mbikëqyrësit. Nenet 68 dhe 69 të këtij ligji zbatohen sipas rastit. Në qoftë se mbikëqyrësi miraton një veprim, që krijon një detyrim ndaj masës së falimentimit, neni 47 zbatohet sipas rastit.

2. Urdhri mund të lëshohet me kërkesë të një kreditori me të drejtë ripagimi të veçantë ose të një kreditori të masës së falimentimit kur kërkesa është urgjente, me qëllim që të shmangë dëmtimin e kreditorëve. Urdhri lëshohet kur pala kërkuese i vërteton gjykatës, në mënyrë bindëse, se janë kushtet për një urdhër të tillë.

3. Urdhri shpallet publikisht. Neni 30 i këtij ligji zbatohet sipas rastit. Nëse e drejta për tjetërsim të një pasurie të paluajtshme ose një e drejtë tjetër e regjistruar në një regjistër pronësie kërkojnë dhënien e miratimit, zbatohet sipas rastit neni 31 i këtij ligji.

Neni 241

Fondet për debitorin për përballimin e jetesës

1. Debitori mund të marrë nga masa e falimentimit një shumë të caktuar për vete dhe për anëtarët e familjes, siç përcaktohet në të pikën 2 të nenit 84 të këtij ligji, e cila i lejon atij kushte modeste jetese.

2. Nëse debitori nuk është person fizik, zbatohet pika 1 e këtij neni, sipas rastit, për anëtarët e organit që përfaqëson debitorin dhe që veprojnë në të njëjtën mënyrë si ortakët e përgjithshëm të debitorit.

Neni 242

Kontratat

Dispozitat e këtij ligji për përmbushjen e veprimeve juridike, të parashikuara në nenet 86 deri 89 të këtij ligji zbatohen me kusht që debitori të zëvendësojë administratorin e falimentimit. Debitori ushtron të drejta, sipas këtyre dispozitave, me miratimin e mbikëqyrësit.

Neni 243

Detyrimet ndaj masës së falimentimit. Kundërshtimi i veprimeve

Vetëm mbikëqyrësi mund të pretendojë detyrimet në favor të masës së falimentimit sipas neneve 77 dhe 78 të këtij ligji, si dhe të kundërshtojë veprime sipas neneve 100 deri 115 të këtij ligji.

Neni 244

Njoftimi i kreditorëve

1. Debitori përcakton listën e sendeve të masës së falimentimit, listën e kreditorëve dhe tabelën e pasurive, sipas neneve 119 deri 121 të këtij ligji. Mbikëqyrësi duhet të verifikojë listat dhe tabelën e pasurive dhe të japë shpjegime me shkrim për secilën prej tyre, duke treguar nëse rezultatet e verifikimit lënë vend për vërejtje.

2. Debitori raporton në mbledhjen e raportimit. Mbikëqyrësi komenton raportimin.

3. Debitori ka për detyrë të paraqesë llogaritë, sipas neneve 53 dhe 123 të këtij ligji.

Neni 245

Zotërimi i kolateralit

1. Debitori ushtron të drejtën e administratorit të falimentimit për të zotëruar mbi sende, të cilat i nënshtrohen të drejtës së ripagimit të veçantë. Megjithatë nuk paguhen shpenzimet e përcaktimit të sendeve dhe të të drejtave mbi këto sende. Si shpenzime zotërimi mund të caktohen vetëm shpenzimet për zotërimin e sendit dhe detyrimi tatimor i mundshëm.

2. Debitori ushtron të drejtën e vet për zotërim me miratimin e mbikëqyrësit.

Neni 246

Ripagimi i kreditorëve të falimentimit

1. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve, debitori dhe mbikëqyrësi mund të kundërshtojnë pretendimet e depozituara, përveç kreditorëve të falimentimit. Pretendimi i kundërshtuar nga një kreditor falimentimi, nga debitori ose nga mbikëqyrësi quhet i pavërtetuar.

2. Debitori kryen shpërndarjen. Mbikëqyrësi verifikon të gjitha listat e shpërndarjes dhe deklaron me shkrim, për secilin rast, nëse ka vërejtje për rezultatet e verifikimit.

Neni 247

Plani i riorganizimit

1. Mbikëqyrësi ose debitori merr përsipër detyrën e mbledhjes së kreditorëve për hartimin e planit të riorganizimit. Kur detyra i ngarkohet debitorit, mbikëqyrësi bashkëpunon si këshilltar në hartimin e këtij plani.
2. Mbikëqyrësi kontrollon aspektet e ndryshme të zbatimit të planit.

Neni 248

Pamjaftueshmëria e pasurive në masën e falimentimit

Mbikëqyrësi njofton gjykatën për pamjaftueshmërinë e pasurive në masën e falimentimit.

PJESA E NËNTË

SHKARKIMI NGA PJESA E MBETUR E DETYRIMIT

KREU I

Neni 249

Parimi

Kur debitori është person fizik, ai shkarkohet nga detyrimet e pashlyera ndaj kreditorëve të falimentimit gjatë procedurës së falimentimit, sipas dispozitave të parashikuara në nenet 250 deri në 266 të këtij ligji.

Neni 250

Kërkesa e debitorit

1. Shkarkimi nga detyrimet e mbetura bëhet me kërkesë të debitorit. Kërkesa me shkrim depozitohet në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit ose regjistrohet në regjistrin e gjykatës. Kjo kërkesë mund t'i bashkohet kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.
2. Kërkesës i bashkëlidhet deklarata, që vërteton vullnetin e debitorit për t'ia kaluar një kujdestari, të cilin e cakton gjykata, shumat e tepërta që duhet t'i paguhen atij e që burojnë nga një kontratë shërbimi. Kujdestari caktohet për një periudhë prej tre vjetësh pas mbylljes së procedurës së falimentimit. Në qoftë se debitori ia ka kaluar ose ia ka dhënë peng një të treti këto pretendime përpara kërkesës, ky fakt shënohet në deklaratë.
3. Janë të pavlefshme marrëveshjet që përjashtojnë, kushtëzojnë ose, në mënyra të tjera, kufizojnë debitorin të heqë dorë prej pretendimeve për të përfituar pagesa që burojnë nga një marrëdhënie shërbimi ose pagesa aktuale në vend të tyre, në rastin kur këto marrëveshje pengojnë ose dëmtojnë deklaratën për heqje dorë sipas fjalisë së parë të pikës 2 të këtij neni.

Neni 251

E drejta e propozimit

Debitori dhe kreditorët mund t'i propozojnë seksionit tregtar të gjykatës së rrethit një individ të përshtatshëm për të vepruar si i besuar në rastin konkret.

Neni 252

Vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit

1. Kreditorët e falimentimit ose administratori i falimentimit dëgjohen në mbledhjen përfundimtare me kërkesë të debitorit.

2. Kundër këtij vendimi mund të paraqesë ankim të veçantë debitori dhe çdo kreditor falimentimi, që nuk ka pranuar shkarkimin nga detyrimet e mbetura në mbledhjen përfundimtare. Procedura e falimentimit përfundon pasi vendimi të marrë formë të prerë. Vendimi i formës së prerë shpallet publikisht bashkë me vendimin për mbylljen e procedurës së falimentimit.

Neni 253

Refuzimi për shkarkimin nga detyrimi i mbetur

1. Vendimi nuk pranon shkarkimin nga detyrimi i mbetur kur mospranimi është kërkuar nga një kreditor i falimentimit në mbledhjen përfundimtare dhe kur:

a) debitori është dënuar me vendim të formës së prerë për një vepër penale, sipas dispozitave të Kodit Penal;

b) debitori, në tri vitet e fundit para kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas paraqitjes së kësaj kërkesë, me qëllim ose për shkak të pakujdesisë ka dhënë deklaratë, me shkrim, false ose të paplotë, për gjendjen e tij ekonomike, me anë të së cilës debitori ka zbatuar për një kredi, për grante nga fonde publike ose ka shmangur pagesa në favor të fondeve publike;

c) debitori është shkarkuar nga detyrimet e mbetura në dhjetë vitet e fundit përpara kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit ose pas kërkesës, ose nëse kjo kërkesë është hedhur poshtë sipas neneve 259 ose 260 të këtij ligji;

ç) debitori, në vitin e fundit përpara kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit ose pas kësaj kërkesë, me qëllim ose nga pakujdesia, ka penguar ripagimin e kreditorëve të falimentimit, duke krijuar detyrime të panevojshme, duke shpërdoruar pasuritë ose duke vonuar hapjen e procedurës së falimentimit ose të perspektivës për përmirësimin e gjendjes së tij ekonomike;

d) gjatë procedurës së falimentimit, debitori me qëllim ose nga pakujdesia ka shkelur detyrimin për të dhënë të dhëna ose për të bashkëpunuar;

dh) debitori ka dhënë deklaratë false ose të paplota, me qëllim ose nga pakujdesia, në listat e detyrueshme për t'u paraqitur për pasurinë dhe të ardhurat e tij, të kreditorëve të tij dhe të pretendimeve të ngritura ndaj tij.

2. Kërkesa e kreditorit për mospranim shoqërohet me një letërshpjeguese të shkaqeve për të cilat nuk duhet pranuar shkarkimi nga detyrimi i mbetur.

Neni 254

Dhënia me kusht e shkarkimit nga detyrimi i mbetur

1. Përveç rastit kur ekziston njëri nga kushtet e nenit 253 të këtij ligji, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit deklaron në vendimin e vet nëse debitori fiton shkarkimin nga detyrimi i mbetur.

2. Gjykata cakton me të njëjtin vendim të besuarin, të cilit i kalojnë të ardhurat e tepërta të debitorit, sipas deklaratës që bën debitori për këtë qëllim, sipas pikës 2 të nenit 250 të këtij ligji.

Neni 255

Statusi juridik i kujdestarit

1. Kujdestari ka detyrë t'i njoftojë statusin e vet personit të detyruar për të kryer pagesën. Kujdestari ndan nga pasuritë e tij shumat e marra në bazë të këtij statusi, së bashku me pagesa të tjera të kryera nga debitori ose palë të treta dhe ua shpërndan ato çdo vit kreditorëve mbi bazën e listës përfundimtare.

2. Mbledhja e kreditorëve mund t'i ngarkojë, gjithashtu, kujdestarit detyrën e mbikëqyrjes së debitorit për përmbushjen e detyrave të tij. Në këtë rast, kujdestari njofton pa vonesë kreditorët kur vëren shkelje për këto detyrime. Kujdestari është i detyruar të mbikëqyrë vetëm nëse është paguar ose parapaguar pagesa shtesë për këtë detyrë.

3. Kujdestari, në përfundim të detyrës së vet, duhet t'i raportojë seksionit tregtar të gjykatës

së rrethit. Nenet 45 dhe 46 të këtij ligji zbatohen sipas rastit, ndërsa neni 46 i këtij ligji zbatohet me kushtet që secili prej kreditorëve të falimentimit mund të kërkojë shkarkimin e kujdestarit dhe çdo kreditor falimentimi mund të paraqesë ankim të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 256

Shpërblimi i kujdestarit

1. Kujdestari ka të drejtën e shpërblimit për punën e vet dhe për pagimin e shpenzimeve të arsyeshme. Në shpërblim përfshihen koha e shpenzuar nga kujdestari dhe vëllimi i punës së tij.
2. Nenet 51 dhe 52 të këtij ligji zbatohen sipas rastit.

Neni 257

Trajtimi i barabartë i kreditorëve

1. Nuk mund të kryhen ekzekutime të detyrueshme mbi pasuritë e debitorit në favor të kreditorëve të veçantë të falimentimit gjatë periudhës kur debitori ia ka kaluar kujdestarit të drejtën e veprimit.
2. Është e pavlefshme çdo marrëveshje e debitorit ose e personave të tjerë me kreditorë të veçantë falimentimi, që parashikon përfitime për këta të fundit.
3. Personi i ngarkuar për të kryer pagesa që mbulohen nga veprimet e kujdestarit mund të bëjë një kompensim të ndërsjellë për pretendimet kundër debitorit, që ka të drejtën e kompensimit, sipas pikës 2 të nenit 96 të këtij ligji, në rast se procedura e falimentimit vazhdon.

Neni 258

Detyrimet e debitorit

1. Debitori gjatë kohëzgjatjes së kalimit të të drejtave kujdestarit ka detyrë të zbatojë rregullat e mëposhtme:
 - a) të zhvillojë një veprimtari të përshtatshme fitimprurëse ose të kërkojë punësim dhe të mos refuzojë një punë të arsyeshme kur është i papunë;
 - b) t'i transferojë kujdestarit gjysmën e vlerës së pasurisë që ka fituar me rrugë trashëgimie ose në lidhje me një të drejtë trashëgimie të ardhshme;
 - c) të njoftojë seksionin tregtar të gjykatës së rrethit dhe kujdestarin, pa vonesë, për çdo ndryshim të vendbanimit ose të vendit të punës, të mos fshehë të ardhura ose çdo pasuri tjetër sipas pikës 2 të këtij neni, që përfshihen në aktin e kalimit të të drejtave kujdestarit dhe të njoftojë gjykatën dhe kujdestarin, me kërkesën e tyre, për të ardhurat nga punësimi ose për përpjekjet për të gjetur punësim, si dhe për të ardhurat dhe pasurinë e tij;
 - ç) t'u kryejë pagesat kreditorëve të falimentimit vetëm nëpërmjet kujdestarit dhe të mos sjellë përfitime të veçanta për asnjë kreditor falimentimi.
2. Në rast se debitori ushtron një veprimtari të pavaruar, ai ripaguan kreditorët nëpërmjet kujdestarit, në të njëjtën mënyrë sikur të kishte hyrë në një kontratë të rregullt shërbimi.

Neni 259

Shkeljet e detyrimeve

1. Me kërkesë të një kreditori falimentimi, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit hedh poshtë shkarkimin nga detyrimet e mbetura kur debitori, gjatë kohëzgjatjes së aktit për veprim të kujdestarit, shkel një prej detyrimeve të tij dhe, për pasojë, pengon shlyerjen e kreditorëve të falimentimit. Ky rregull zbatohet vetëm kur debitori vepron me dashje. Kjo kërkesë mund të paraqitet vetëm brenda një viti nga koha kur kreditori ka marrë dijeni për shkeljen e një detyrimi. Kërkesa pranohet nëse kushtet e sipërpërmendura vërtetohen në mënyrë bindëse për gjykatën.

2. Para marrjes së vendimit për kërkesën, gjykata dëgjon kujdestarin, debitorin dhe kreditorët e falimentimit. Debitori duhet të japë të dhëna mbi detyrimet e veta në këtë mbledhje dhe, kur e kërkon kreditori, të sigurojë vërtetësinë e të dhënave duke dhënë një deklaratë të betuar. Kur debitori nuk i jep të dhënat ose deklaratën e betuar brenda afatit të caktuar, pa ndonjë justifikim të arsyeshëm, ose kur nuk paraqitet në mbledhjen e caktuar nga gjykata për dhënien e të dhënave a deklaratës së betuar, edhe pse i është dërguar njoftim i rregullt dhe nuk ka justifikim të arsyeshëm, shkarkimi nga detyrimi i mbetur refuzohet.

3. Kundër vendimit, kërkuesi dhe debitori mund të paraqesin ankim të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile. Refuzimi i shkarkimit nga detyrimi i mbetur shpallet publikisht.

Neni 260

Vepra penale në lidhje me falimentimin

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit hedh poshtë shkarkimin nga detyrimi i mbetur me kërkesë të një kreditori falimentimi kur debitori është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, sipas dispozitave të Kodit Penal, në periudhën ndërmjet mbledhjes përfundimtare dhe mbylljes së procedurës së falimentimit ose gjatë periudhës së aktit të veprimit të kujdestarit.

2. Fjalja e dytë dhe e tretë e pikës 1 të nenit 259 të këtij ligji zbatohen sipas rastit.

Neni 261

Shpërblimi minimal i kujdestarit

1. Me kërkesë të kujdestarit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit hedh poshtë shkarkimin nga detyrimi i mbetur në rast se shumat e marra për vitin e kaluar të veprimtarisë nuk kanë mbuluar shpërblimin minimal të tij dhe nëse debitori nuk e ka paguar shumën e pambuluar, megjithëse kujdestari i ka kërkuar me shkrim pagesën brenda një afati të paktën dyjavor, ku ka vënë në dukje mundësinë e refuzimit të shkarkimit nga detyrimi i mbetur brenda dy javësh.

2. Përpara marrjes së vendimit, gjykata dëgjon debitorin. Gjykata nuk e hedh poshtë shkarkimin kur debitori, me kërkesë të gjykatës, paguan shumën e mbetur brenda dy javësh.

3. Pika 3 e nenit 259 të këtij ligji zbatohet sipas rastit.

Neni 262

Përfundimi i parakohshëm

Në qoftë se shkarkimi nga detyrimi i mbetur hidhet poshtë, sipas neneve 259, 260 dhe 261 të këtij ligji, akti i veprimit të kujdestarit, detyra e kujdestarit dhe kufizimi i të drejtave të kreditorëve bëhen të pavlefshme, sapo vendimi i gjykatës merr formë të prerë.

Neni 263

Vendimi për shkarkimin nga detyrimi i mbetur

1. Në qoftë se ka përfunduar periudha e veprimit të kujdestarit dhe nuk ka përfundim të parakohshëm, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos për shkarkimin nga detyrimi i mbetur pasi dëgjon kreditorët e falimentimit, kujdestarin dhe debitorin.

2. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit hedh poshtë shkarkimin nga detyrimi i mbetur me kërkesën e një kreditori falimentimi, sipas kushteve të pikave 1 dhe 2 fjalja e tretë të nenit 259 ose të nenit 260, ose me kërkesë të kujdestarit kur ekzistojnë kushtet e nenit 261 të këtij ligji.

3. Vendimi shpallet publikisht. Debitori dhe çdo kreditor falimentimi, i cili gjatë seancës ka kërkuar refuzimin e shkarkimit nga detyrimi i mbetur, sipas pikës 1 të këtij neni, kanë të drejtën e ankimit të veçantë kundër vendimit, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 264

Pasoja e shkarkimit nga detyrimi i mbetur

1. Kur miratohet shkarkimi nga detyrimi i mbetur, ai është i vlefshëm për të gjithë kreditorët e falimentimit. Kjo vlefshmëri zbatohet edhe për kreditorët që nuk i kanë depozituar pretendimet e tyre.

2. Nuk cenohen nga shkarkimi prej detyrimit të mbetur të drejtat e kreditorëve të falimentimit kundrejt debitorëve të debitorit dhe garantëve, si dhe të drejtat e tyre që burojnë nga një njoftim i regjistruar përparësie në pagesë, me të cilën sigurohen këta kreditorë ose që buron nga një e drejtë për ripagim të veçantë në procedurën e falimentimit. Megjithatë, debitori shkarkohet kundrejt kreditorëve, bashkëdebitorëve, garantëve ose personave të tjerë me pretendime ndaj tij në të njëjtën mënyrë që shkarkohet nga detyrimet e kreditorëve të falimentimit.

3. Në qoftë se një kreditor pa të drejtë ripagimi, ripaguhet si pasojë e shkarkimit nga detyrimi i mbetur, ky kreditor nuk është i detyruar të kthejë shumën e marrë.

Neni 265

Pretendimet e përjashtuara

1. Shkarkimi nga detyrimi i mbetur nuk cenon:

a) detyrime të debitorit të shkaktuara nga dëme të kryera me dashje;

b) detyrime si pasojë e shkeljeve civile dhe penale, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 42 të këtij ligji.

Neni 266

Prapësimi i shkarkimit nga detyrimi i mbetur

1. Me kërkesë të administratorit të falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit hedh poshtë shkarkimin nga detyrimi i mbetur, kur më vonë vërtetohet që debitori ka shkelur me dashje një nga detyrimet e tij dhe, si pasojë, ka dëmtuar në mënyrë të ndjeshme shlyerjen e kreditorëve të falimentimit.

2. Kërkesa e kreditorit pranohet vetëm nëse depozitohet brenda një viti nga shpallja e vendimit të formës së prerë për shkarkimin nga detyrimi i mbetur dhe nëse vërtetohet që ekzistojnë kushtet e pikës 1 të këtij neni dhe nëse vërtetohet që kreditori nuk ka pasur dijeni për to, deri në kohën kur vendimi ka marrë formë të prerë.

3. Para marrjes së vendimit duhet të dëgjohen debitori dhe kujdestari. Kërkuesi dhe debitori kanë të drejtën e ankimit të veçantë kundër vendimit, sipas Kodit të Procedurës Civile.

PJESA E DHJETË

PROCEDURA E FALIMENTIMIT PËR KONSUMATORËT DHE PROCEDURA TË TJERA MË PAK TË RËNDËSISHME

KREU I

FUSHA E ZBATIMIT

Neni 267

Parimi

1. Në qoftë se debitori është person fizik pa veprimtari ekonomike ose ushtron një veprimtari ekonomike të vogël të pavarur, vlejnë dispozitat e përgjithshme, me kusht që në këtë pjesë të mos jetë parashikuar ndryshe.

2. Një veprimtari e pavarur ekonomike është e formës së vogël në kuptimin e pikës 1 të këtij neni, sidomos kur për nga lloji dhe madhësia nuk kërkon një strukturë biznesi nga pikëpamja tregtare.

KREU II PLANI I SHLYERJES SË DETYRIMEVE

Neni 268

Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit

Me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit debitori mund të paraqesë një plan për shlyerjen e detyrimeve. Ky plan mund të përmbajë të gjitha dispozitat e përshtatshme për të çuar në një shlyerje të duhur të detyrimeve ku merren parasysh interesat e kreditorëve dhe pasuria e debitorit, si dhe të ardhurat dhe rrethanat familjare. Plani parashikon masën, prekjën e garancive, pengjet dhe forma të tjera sigurimi të kreditorëve.

Neni 269

Pezullimi i procedurës

1. Kur debitori paraqet një plan për shlyerjen e detyrimeve, procedura për kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit pezullohet deri në marrjen e një vendimi mbi planin. Kjo periudhë kohore nuk duhet të jetë më shumë se tre muaj.

2. Pika 1 e këtij neni nuk cenon urdhrin e vendosjes së masave të sigurisë.

3. Kur një kreditor kërkon hapjen e procedurës, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit duhet t'i japë mundësinë debitorit të paraqesë kërkesë para se të marrë vendim për hapjen e procedurës. Në qoftë se debitori bën kërkesë dhe dorëzon brenda një muaji një plan për shlyerjen e detyrimeve, pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për kërkesën e debitorit.

Neni 270

Shërbimi ndaj kreditorëve

1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit u jep kreditorëve të përmendur nga debitori listën e pasurive dhe listën e kreditorëve, sipas nenit 15 të këtij ligji, si dhe planin e shlyerjes së detyrimeve, dhe njëkohësisht i fton kreditorët, që brenda një periudhe njëmuajore, të paraqesin komentet e tyre ndaj listave dhe planit të shlyerjes së detyrimeve. Duke iu referuar shprehimisht pasojave ligjore të fjalisë së dytë të pikës 3 të nenit 271 të këtij ligji, çdo kreditori i jepet mundësia të shqyrtojë të dhënat për pretendimin e tij në listën e pretendimeve, brenda afatit të paraqitur në fjalinë e parë dhe, kur është e nevojshme, të bëjë plotësime.

2. Nëse komentet e kreditorit, sipas fjalisë së parë të pikës 1 të këtij neni, nuk arrijnë brenda afatit të caktuar, atëherë vlerësohet se plani i shlyerjes së detyrimeve është pranuar. Kjo duhet të vihet në dukje në kërkesën për komente.

3. Pasi ka përfunduar afati, sipas fjalisë së parë të pikës 1 të këtij neni, debitorit duhet t'i jepet mundësia, që brenda një afati të caktuar nga gjykata, të ndryshojë ose të plotësojë planin për shlyerjen e detyrimeve, kur kjo është e nevojshme mbi bazën e komenteve të njerit prej kreditorëve ose kur kjo duket e arsyeshme pasi është në interes të shlyerjes me marrëveshje të detyrimit të mbetur. Kreditorët duhet të njoftohen për ndryshimet ose plotësimet nëse kjo është e nevojshme. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen sipas rastit.

Neni 271

Pranimi i planit të shlyerjes së detyrimeve

1. Në qoftë se asnjë kreditor nuk ka paraqitur vërejtje ndaj planit të shlyerjes së detyrimeve ose në qoftë se pranimi zëvendësohet, sipas nenit 272 të këtij ligji, plani i shlyerjes së detyrimeve vlerësohet i pranuar. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit e përcakton këtë në vendim. Plani i shlyerjes së detyrimeve ka fuqinë dhe pasojat e një titulli ekzekutiv, sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile. Një kopje e planit të shlyerjes së detyrimeve dhe e vendimit, sipas fjalisë së parë, u dorëzohet kreditorëve dhe debitorit.

2. Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit dhe e lëshimit të urdhrit për shkarkimin nga detyrimi i mbetur vlerësohet e tërhequr.

3. Nëse në listën e debitorit nuk figurojnë pretendimet dhe kur ato nuk janë përmendur gjatë përgatitjes së planit të shlyerjes së detyrimeve të mbetura, kreditorët mund të kërkojnë përmbushjen e detyrimit prej debitorit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur kreditori nuk ka plotësuar, brenda afatit të caktuar, të dhënat për pretendimin e tij në listën e pretendimeve që i është dërguar nga gjykata, sipas pikës 1 të nenit 270 të këtij ligji, edhe pse pretendimi mund të kishte lindur përpara mbarimit të afatit. Në këtë rast pretendimi bëhet i pavlefshëm.

Neni 272

Zëvendësimi i miratimit

1. Në qoftë se plani i shlyerjes së detyrimeve miratohet nga më shumë se gjysma e kreditorëve të regjistruar dhe nëse shuma e pretendimeve të kreditorëve në favor përbën më shumë se gjysmën e pretendimeve të kreditorëve të regjistruar, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit zëvendëson me një vendim miratimin e kreditorëve kundër planit të shlyerjes së detyrimit të mbetur. Kjo nuk zbatohet kur:

a) kreditori që ka paraqitur kundërshtimin nuk përfshihet në masën e duhur në krahasim me kreditorët e tjerë;

b) ky kreditor nëpërmjet planit të likuidimit të detyrimeve dëmtohet ekonomikisht më shumë sesa në rastin e zbatimit të procedurës për hapjen e procedurës së falimentimit dhe shkarkimit nga detyrimi i mbetur. Në rast dyshimi, gjatë procedurës merren për bazë të ardhurat, pasuria dhe gjendja familjare e debitorit në kohën e paraqitjes së kërkesës.

2. Para marrjes së vendimit dëgjohet kreditori. Ai duhet të paraqesë shkaqe të besueshme lidhur me arsyet që, sipas pikës 1 të këtij neni, pengojnë zëvendësimin e vërejtjeve të tij me miratim. Kundër vendimit, kërkuesi dhe kreditori, miratimi i të cilëve zëvendësohet, kanë të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

3. Kur kreditori jep shkaqe të besueshme për fakte që krijojnë dyshime bindëse se një pretendim i deklaruar nga debitori ekziston ose i përgjigjet një shume më të madhe ose më të vogël se ajo që është deklaruar, dhe nëse prej kësaj varet fakti që kreditori është përfshirë në mënyrë të përshtatshme në krahasim me kreditorët e tjerë, miratimi i kreditorit, sipas fjalisë së dytë të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të zëvendësohet.

Neni 273

Shpenzimet

Kreditorët nuk mund të ngrenë ndaj debitorit pretendime për pagimin e shpenzimeve që lindin në lidhje me planin e shlyerjes së detyrimeve.

KREU III

PROCEDURË FALIMENTIMI E THJESHTUAR

Neni 274

Fillimi i punës për hapjen e procedurës së falimentimit

Në qoftë se plani i shlyerjes së detyrimeve kundërshtohet dhe këto kundërshtime nuk zëvendohen nga një miratim i gjykatës, sipas nenit 272 të këtij ligji, procedura për hapjen e procedurës së falimentimit fillon përsëri, kryesisht.

Neni 275

Thjeshtimet e përgjithshme të procedurës

1. Kur hapet procedura e falimentimit në kundërshtim me nenin 28 të këtij ligji, caktohet vetëm një mbledhje verifikimi.

2. Në qoftë se rrethanat pasurore të debitorit janë të qarta dhe numri i kreditorëve ose masa e detyrimeve është e vogël, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit mund të urdhërojë që procedura ose një pjesë e saj të bëhen me shkrim. Gjykata mund të anulojë ose të ndryshojë këtë urdhër në çdo kohë.

3. Dispozitat për planin e riorganizimit, sipas neneve 180 deri në 230 të këtij ligji, dhe për vetadministrimin, sipas neneve 233 deri në 248 të këtij ligji, nuk zbatohen.

Neni 276

Kujdestari

1. Detyrat e administratorit të falimentimit i kalojnë kujdestarit të zgjedhur, sipas nenit 255 të këtij ligji. Kujdestari caktohet në fillim të procedurës së falimentimit. Nenet 43 deri në 47 të këtij ligji zbatohen sipas rastit.

2. Kujdestari nuk ka të drejtën e shfrytëzimit të sendeve të vëna peng ose të caktuara si sende për të drejtë ripagimi të veçantë. Të drejtat e kreditorëve të siguruar mbeten të paprekura.

Neni 277

Shpërndarja e thjeshtuar

1. Me kërkesë të kujdestarit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit urdhëron heqjen dorë krejtësisht ose pjesërisht nga likuidimi i masës së falimentimit. Në këtë rast ajo udhëzon debitorin t'i paguajë kujdestarit një shumë shtesë, brenda një afati që e cakton gjykata, shumë e cila i përgjigjet vlerës së pasurive që do t'u shpërndahej kreditorëve të procedurës së falimentimit. Ky urdhër nuk zbatohet kur shlyerja e masës së falimentimit duket tepër e nevojshme, veçanërisht në dobi të kreditorëve.

2. Para marrjes së vendimit dëgjohen kreditorët e falimentimit.

3. Vendimi për kërkesën e debitorit për shkarkimin nga detyrimi i mbetur, sipas neneve 252 deri në 254 të këtij ligji, nuk merret deri në mbarimin e afatit të përcaktuar, sipas fjalisë së dytë të pikës 1 të këtij neni. Me kërkesë të njërit prej kreditorëve të falimentimit, gjykata hedh poshtë shkarkimin nga detyrimi i mbetur kur nuk është paguar shuma që duhej paguar, sipas fjalisë së dytë të pikës 1 të këtij neni, edhe pas përfundimit të një afati tjetër prej dy javësh të caktuar nga gjykata, i cili i referohet mundësisë së mosdhënies së shkarkimit nga detyrimi i mbetur. Para marrjes së vendimit dëgjohet debitori.

KREU III/a

PROCEDURA TË TJERA TË THJESHTUARA

Neni 277/a

Procedura e thjeshtuar për shoqëritë tregtare të biznesit të vogël

(Shtuar neni me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 19)

Kërkuesi i hapjes së procedurës së falimentimit të thjeshtuar duhet të paraqesë:

1. Për shoqëritë tregtare, që kanë një xhiro vjetore deri 1 000 000 lekë, kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit të thjeshtuar mund të bëhet nga çdo kreditor, që ka një interes të ligjshëm.

Kreditori, që kërkon fillimin e procedurës së falimentimit të thjeshtuar, duhet të paraqesë në seksionin tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë:

- a) kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit;
- b) kopje të dokumentit, që vërteton detyrimin e tij pasuror;
- c) listën paraprake të pasurive të debitorit;
- ç) deklaratën, që vërteton se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.

2. Seksioni tregtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, pasi dëgjon pretendimet e debitorit dhe të kreditorit, mund të vendosë që procedura e falimentimit të bëhet në mënyrë të thjeshtuar. Në këtë rast zbatohen rregullat e parashikuara nga nenet 26, 27 e 29 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.

3. Kur gjykata vendos për procedurën e falimentimit të thjeshtuar, miraton, në një seancë gjyqësore, planin e shlyerjes së detyrimeve, të hartuar nga administratori i falimentimit dhe kreditorët, në përputhje me interesat e kreditorëve, pasurinë dhe të ardhurat e debitorit, si dhe me fjalinë e tretë të nenit 268 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”. Në këtë rast nuk zbatohen dispozitat e parashikuara për planin e riorganizimit.

4. Administratori likuidon pasuritë e debitorit dhe i shpërndan të ardhurat e realizuara, në përputhje me planin e shlyerjes së detyrimeve.

5. Administratori i paraqet gjykatës një raport për përfundimin e procedurës së falimentimit. E drejta e kreditorëve për të kundërshtuar veprimet e administratorit për procedurën e thjeshtuar mbetet e paprekur.

6. Gjykata, pas shqyrtimit të raportit të administratorit, kur bindet se procedura është zhvilluar në përputhje me planin e shlyerjes së detyrimeve dhe kreditorët nuk paraqesin kundërshtime, merr vendim për mbylljen e procedurës së falimentimit.

PJESA E NJËMBËDHJETË PROCEDURA E FALIMENTIMIT E LIDHUR ME SHTETE TË TJERA

KREU I

Neni 278

Përfshirja në procedurën e falimentimit

1. Procedura e falimentimit e hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, mbulon gjithë pasuritë e debitorit në çdo shtet që ato ndodhen.

2. Nëse debitori nuk ka seli ose vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë, por ka një degë të veprimtarisë së vet në këtë territor ose ushtron aty një tjetër veprimtari ekonomike, mund të hapet një procedurë falimentimi (procedurë e veçantë), e cila mbulon vetëm pasuritë e debitorit të cilat ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në të cilat marrin pjesë vetëm ata kreditorë falimentimi, pretendimet e të cilëve lindin për këtë veprimtari, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ose vendbanimi i të cilëve është në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 279

Njohja e një procedure të huaj falimentimi

1. Një procedurë falimentimi e hapur në një shtet të huaj njihet në Shqipëri nëse:

- a) debitori ka vendbanim ose seli në këtë shtet;
- b) procedura e falimentimit nuk cenon parimet themelore të legjislacionit shqiptar dhe sidomos dispozitat kushtetuese.

Neni 280

Pasojat e njohjes

1. Pasojat e hapjes së procedurës së falimentimit diktohen nga e drejta e shtetit të huaj, përveç rasteve kur:

- a) nuk është pezulluar padia e ngritur në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) nuk cenohen të drejtat e pronësisë mbi pasuri të luajtshme e të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) kontratat për pasuri të paluajtshme brenda Shqipërisë ose çdo kontratë punësimi i nënshtrohet vetëm së drejtës shqiptare.

2. Vendimet e një gjykate të huaj ose të një përfaqësuesi të huaj, për shmangie të veprimeve ligjore, njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm nëse këto veprime ligjore janë shmangie edhe sipas ligjit shqiptar.

Neni 281

Procedurat dytësore

1. Njohja e një procedure të huaj falimentimi nuk parandalon hapjen e një procedure të veçantë, si procedurë dytësore e procedurës kryesore, në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas pikës 2 të nenit 278 të këtij ligji.

2. Përveç debitorit dhe kreditorëve, administratori ose përfaqësuesi të tjerë të emëruar të pasurive të debitorit në procedurën e huaj të falimentimit kanë të drejtën të paraqesin kërkesë për hapjen e procedurës dytësore.

3. Procedura dytësore hapet pa qenë nevoja të tregohet shkak, sipas nenit 13 të këtij ligji.

Neni 282

Bashkëpunimi

1. Kur hapen dhe zhvillohen, njëkohësisht, procedura e huaj dhe procedura sipas këtij ligji për të njëjtin debitor, gjykata dhe administratori bashkëpunojnë në shkallën më të lartë me gjykatën e huaj ose përfaqësuesit e huaj.

2. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ka të drejtë të komunikojë drejtpërdrejt ose të kërkojë të dhëna ose asistencë nga gjykata e huaj ose përfaqësuesit e huaj.

PJESA E DYMBËDHJETË

AGJENCIA MBIKËQYRJES SË FALIMENTIMIT

Neni 282/1

Agjencia Mbikëqyrjes së Falimentimit

(Shtuar neni me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 20)

Kjo pjesë rregullon krijimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit (më poshtë Agjencia).

Neni 282/2

Statusi i Agjencisë

(Shtuar neni me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 20)

1. Agjencia është person juridik publik, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e së cilës janë të përcaktuara në ligj.

2. Agjencia vepron në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

3. Agjencia ka selinë e vet në Tiranë.

4. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 282/3

Përgjegjësitë e Agjencisë

(Shtuar neni me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 20)

Agjencia ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) të japë, të heqë ose të rinovojë licenca për administratorët e falimentimit, në përputhje me parashikimet e bëra në ligj;
- b) të organizojë dhe të zhvillojë provimin për administratorët e falimentimit;
- c) të mbajë regjistrin e administratorëve të licencuar të falimentimit;
- ç) të mbikëqyrë veprimtarinë e administratorëve të falimentimit dhe të monitorojë ecurinë (zhvillimin) e profesionit;
- d) të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave që rregullojnë procedurat e falimentimit;
- dh) të mbledhë dhe të përpunojë të dhënat statistikore dhe të dhëna të tjera që lidhen me zbatimin e procedurave të falimentimit;
- e) të propozojë standarde kombëtare për administrimin e masës së falimentimit, si dhe Kodin e Etikës, të dyja të miratuara me parashikimet e këtij ligji;
- ë) të kryejë çdo detyrë tjetër të dhënë nga ky ligj.

Neni 282/4

Veprimtaria mbikëqyrëse e Agjencisë

(Shtuar neni me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 20)

1. Agjencia, gjatë ushtrimit të veprimtarisë të saj mbikëqyrëse, inspekton nëse administratori i falimentimit kryen detyrat e tij në përputhje me këtë ligj, me standardet kombëtare të administrimit të masës së falimentimit, si dhe me Kodin e Etikës, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave.

2. Agjencia kryen veprimtari mbikëqyrëse të parashikuara në pikën 1 nëpërmjet vlerësimit raporteve të shkruara, të paraqitura nga administratori dhe gjyqtari i falimentimit, si dhe në bazë të dokumenteve të tjera të mbajtura në kuadër të veprimeve të administratorit në procedurat e falimentimit.

Neni 282/5

Ekspertiza e huaj

(Shtuar neni me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 20)

Për ushtrimin e detyrave të caktuara, të cilat kanë nevojë për ekspertizë të veçantë, Agjencia mund të kontrakttojë persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj.

Neni 282/6

Burimet e financimi të Agjencisë

(Shtuar neni me ligjin nr.9919, datë 19.5.2008 neni 20)

Burimet financiare për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga tarifat e realizuara nga veprimtaria e saj.

Neni 283

Ligji nr.8017, datë 25.10.1995 “Për procedurat e falimentimit”, shfuqizohet.

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2002.

Ligj nr.8901, datë 23.5.2002 shpallur me dekretin nr.3383, datë 26.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare 31, faqe 955

Ligji nr.9919, datë 19.5.2008 shpallur me dekretin nr.5748, datë 9.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

Botuar në Fletoren Zyrtare 83, faqe 3659

**VENDIM
Nr.197, datë 13.4.2007**

PËR KUSHTET DHE KRITERET E PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT DHE TË RIMBURSIMIT TË SHPENZIMEVE TË ADMINISTRATORIT TË FALIMENTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 52 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimi i administratorit të falimentimit përcaktohet nga gjykata, në përputhje me nenet 50 e 51 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.

2. Në përcaktimin e shpërblimit sipas pikës 1 të këtij vendimi, gjykata merr parasysh punën e kryer, rezultatet e arritura, rëndësinë e falimentimit dhe kujdesin e treguar nga administratori i falimentimit, në përmbushjen e detyrave të tij.

3. Shpërblimi i administratorit të falimentimit përbëhet nga pagimi një përqindjeje të shumës së aktivitetit të grumbulluar (masa e falimentimit në përfundim të procedurës së falimentimit), sipas këtyre kufijve:

a) nga 12 për qind në 14 për qind, kur aktivi nuk është më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

b) nga 10 për qind në 12 për qind, kur aktivi është mbi 1 000 000 (një milion) deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë;

c) nga 8.50 për qind në 9.50 për qind, kur aktivi është mbi 3 000 000 (tre milionë) deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

ç) nga 7 për qind në 8 për qind, kur aktivi është mbi 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

d) nga 5.5 për qind në 6.5 për qind, kur aktivi është mbi 10 000 000 (dhjetë milionë) deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

dh) nga 4 për qind në 5 për qind, kur aktivi është mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) deri në 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;

e) deri në 1.80 për qind, kur aktivi është mbi 100 000 000 (njëqind milionë) deri në 200 000 000 (dyqind milionë) lekë;

h) deri në 0.90 për qind, kur tejkalon 200 000 000 (dyqind milionë) lekë.

4. Administratorit të falimentimit i paguhet, gjithashtu, mbi shumën e pasivit të falimentimit, një shpërblim shtesë nga 0,15 deri në 0,75 për qind për shumën deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë dhe nga 0.05 deri në 0.37 për qind për shumën mbi 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

5. Në rast të pushimit të veprimtarisë së administratorit, para përfundimit të procedurës së falimentimit, përfiton shpërblim në raport me punën e kryer.

6. Kur gjykata autorizon vazhdimin e veprimtarisë ekonomike, nëpërmjet riorganizimit, administratorit i jepet, përveç shpërblimit sipas pikave 3 e 4 të këtij vendimi edhe një shpërblim shtesë, prej 0.25 për qind të shumës së fitimit bruto dhe prej 0.50 për qind mbi të ardhurat bruto, të arritura gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.

7. Në çdo rast, shpërblimi i administratorit të falimentimit nuk mund të jetë më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

8. Administratorit të falimentimit i rimbursohen shpenzimet e bëra, të provuara me dokumente dhe të autorizuar nga gjykata.

9. Shpërblimi i administratorit përballohet nga masa e falimentimit. Me vendim të gjykatës, shuma e shpërblimit dhe rimbursimi i shpenzimeve, në përputhje me këtë vendim, mund t'i parapaguhet administratorit të falimentimit.

10. Administratori i përkohshëm i falimentimit, i caktuar nga gjykata, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", shpërblehet me një shumë fikse prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh në muaj, e cila përballohet nga masa e falimentimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, faqe 1323

UDHËZIM
Nr.22, datë 29.7.2008

PËR CAKTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË PËRKOSSHËM TË FALIMENTIMIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës "b", të nenit 16 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë,

UDHËZOJNË:

1. Asnjë person fizik nuk mund të ushtrojë profesionin e administratorit të përkohshëm të falimentimit në rast se nuk përmbush kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, dhe kriteret e përcaktuara në pikën 4 të nenit 16 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002.

2. Mund të ushtrojë profesionin e administratorit të përkohshëm të falimentimit, personi fizik që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë kryer studimet në shkencat ekonomike (ekonomi, financë, kontabilitet);
- c) të jetë i licencuar si ekspert kontabël i autorizuar;
- d) të ketë një eksperiencë pune si ekspert kontabël i autorizuar jo më pak se 5 vjet;
- e) të mos jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale.

3. Gjkata, duhet të caktojë si administrator falimentimi vetëm ata persona fizikë që përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim dhe që janë të regjistruar në listën e ekspertëve të gjykatës.

4. Ky udhëzim zbatohet deri në momentin e plotësimit të numrit të mjaftueshëm të administratorëve të falimentimit sipas kriterëve, për arsimin profesional dhe provimin e parashikuar në nenin 43 të ligjit "Për falimentimin".

5. Personat e zgjedhur nga gjykata sipas këtij udhëzimi, edhe pas plotësimit të numrit të administratorëve të falimentit sipas pikës 4, vazhdojnë detyrën deri në përfundimin e procedurës së falimentimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Enkelejd Alibeaj

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.129, faqe 5708

LIGJ
Nr.7926, datë 20.4.1995

PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE
(Ndryshuar me dekretin nr.1195, datë 14.8.1995; me ligjin nr.8067, datë 15.2.1996; nr.8099, datë 28.3.1996; me dekretin nr.1615, datë 20.9.1996; me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996; me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997; nr.8333, datë 23.4.1998; nr.8482, datë 10.5.1999; nr.8885, datë 22.4.2002; me ligjin nr.10 264, datë 8.4.2010)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare.

Neni 2

Për efekt të këtij ligji, me termat vijuese:

a) “Ndërmarrje shtetërore”, që më poshtë do të quhen “ndërmarrje”, kuptohen gjithë personat juridikë publikë të themeluar sipas ligjit nr.7582, datë 13.7.1993 “Për ndërmarrjet shtetërore”.

b) “Shoqëri shtetërore”, që më poshtë do të quhen “shoqëri”, kuptohen gjithë personat juridikë publikë, të cilët do të krijohen si pasojë e transformimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe që do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 3

Të gjitha ndërmarrjet shtetërore do të transformohen në shoqëri anonime ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Çdo ndërmarrje mund të transformohet në një ose disa shoqëri anonime ose me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar do të krijonë këshill mbikëqyrës.

Neni 4

(Ndryshuar me dekretin nr.1615, datë 20.9.1996 neni 1)

(Ndryshuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996, neni 1)

(Ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997, neni 2)

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.8482, datë 10.5.1999, neni 1)

Ministria e Ekonomisë është përfaqësuese e pronarit për pronën shtetërore.

Këshilli i Ministrave mund t'ia kalojë këtë të drejtë edhe organeve të qeverisjes vendore.

Ministria e Ekonomisë, përveç të drejtave që rrjedhin nga të qenët përfaqësues i pronarit shtetëror, kryen transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare dhe privatizimin e tyre, drejton punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve, nënshkruan kapitalin themeltar dhe autorizon regjistrimin e tyre.

Ministritë, departamentet, drejtoritë a institucionet e tjera që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit lokal, përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore që kanë në varësi.

Prona shtetërore në shoqëritë me kapital të përbashkët administrohet nga organi që ka bërë nënshkrimin e pjesës shtetërore të kapitalit, ose, kur kjo nuk është kryer, administrohet nga dikasteri a organi i pushtetit lokal, nga i cili ka pasur varësinë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Transferimi i së drejtës së ortakut shtetëror në këto shoqëri (si kapitali i pjesës shtetërore etj.) bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave".

Neni 5

(Shfuqizuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996, neni 2)

Neni 6

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.8099, datë 28.3.1996, neni 1)

(Ndryshuar me dekretin nr.1615, datë 20.9.1996 neni 2)

(Ndryshuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996, neni 3)

Ministria e Privatizimeve drejton punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve dhe autorizon regjistrimin e tyre.

Neni 7

(Ndryshuar paragrafi i parë nr.8067, datë 15.2.1996, neni 1)

(Ndryshuar me dekretin nr.1615, datë 20.9.1996 neni 3)

(Ndryshuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996, neni 4)

Ministri i Privatizimeve ka të drejtë të marrë masa disiplinore deri në largimin nga detyra për çdo drejtues të ndërmarrjes shtetërore, i cili ka penguar transformimin dhe regjistrimin e ndërmarrjes shtetërore në shoqëri tregtare.

Neni 8

(Shtesë në paragrafin e dytë me dekretin nr.1195, datë 14.8.1995, neni 1)
(Ndryshuar paragrafi i fundit nr.8067, datë 15.2.1996, neni 1)
(Shtuar paragraf me ligjin nr.8099, datë 28.3.1996, neni 1)
(Ndryshuar me dekretin nr.1615, datë 20.9.1996 neni 4)
(Ndryshuar me dekretin nr.1631, datë 1.11.1996, neni 5)
(Ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997, neni 3)
(Ndryshuar pjesërisht me ligjin nr.8333, datë 23.4.1998, neni 1)
(Ndryshuar me ligjin nr.8885, datë 22.4.2002 neni 2)
(Ndryshuar paragrafi i katërt me ligjin nr.10 264, datë 8.4.2010 neni 1)

Organet drejtuese të shoqërive anonime janë:

- Këshilli mbikëqyrës

- Drejtoria

Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3-9 anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga Ministri i Ekonomisë, por 2/3 e anëtarëve të Këshillit propozohen nga ministritë dhe institucionet përkatëse që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit vendor”.

Anëtarët e këshillave mbikëqyrëse të shoqërive aksionare shtetërore i propozohen Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës si më poshtë:

a) 1/3 e anëtarëve propozohet nga Ministri i Financave;

b) 1/3 e anëtarëve caktohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës;

c) 1/3 e numrit të anëtarëve propozohet nga ministria e linjës administrative apo nga organi i qeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin për shoqërinë shtetërore përkatëse.

Mënyra e propozimit dhe e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse të shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve bëhet në përputhje me statutin e tyre.

Shpërblimi i veçantë për pjesëmarrje në këshillin mbikëqyrës dhe shpërblimet e jashtëzakonshme për shërbimet a detyrat që u besohen anëtarëve të këshillit, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 109 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" nuk zbatohet për aq kohë sa shteti do të jetë aksionar i vetëm".

Neni 9

Shoqëria që krijohet si pasojë e transformimit të ndërmarrjes, merr përsipër të gjitha detyrimet që ndërmarrja ka pasur përpara transformimit dhe përgjigjet ndaj të tretëve me pasurinë e saj.

Të gjitha kontratat e lidhura me të tretët nga ndërmarrja përpara transformimit mbeten në fuqi edhe për shoqërinë që krijohet.

Neni 10

(Shfuqizim në paragrafin e parë me ligjin nr.8333, datë 23.4.1998, neni 2)

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe për sa kohë që shteti do të jetë i vetmi aksionar ose ortak i shoqërive, organet drejtuese të ndërmarrjeve a shoqërive nuk kanë të drejtë të autorizojnë ose të kryejnë shitje të pasurive të paluajtshme dhe të makinerive e pajisjeve, të marrin hua dhe kredi, si dhe të krijojnë shoqëri të përbashkëta.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për ndërmarrjet që janë parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 3 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

Neni 11

Këshilli i Ministrave miraton statusin tip, aktet e tjera tip të themelimit si dhe kriteret e vlerësimit të kapitalit themeltar të shoqërive që do të krijohen si pasojë e transformimit të ndërmarrjeve.

Neni 12

Shpenzimet për procesin e transformimit të ndërmarrjeve në shoqëri, si dhe regjistrimi i tyre sipas dispozitave në fuqi, përballohen nga vetë ndërmarrja.

Neni 13

Neni 191 dhe pika 4 e nenit 297 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregare”, nuk zbatohen për shoqëritë shtetërore.

Neni 14

Nenet 94 dhe 95 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” shfuqizohen.

Neni 15

Ligji nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, do të ketë fuqi për sa kohë që ndërmarrjet nuk janë transformuar në shoqëri, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj është parashikuar ndryshe.

Neni 16

Ky ligj nuk zbatohet për bankat shtetërore të nivelit të dytë dhe për institutet e sigurimeve shtetërore.

Neni 17

Të gjitha ndërmarrjet ekonomike me kapital tërësisht shtetëror që do të krijohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të themelohen e regjistrohen si shoqëri.

Neni 18

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

Dispozitë e shtuar dekretin nr.1631, datë 1.11.1996 i miratuar me ligjin nr.8158, datë 7.11.1996.

Prona shtetërore që ka filluar procesin e privatizimit para hyrjes në fuqi të këtij dekreti vazhdon privatizimin pa ripërsëritur etapat e privatizimit që i ka kryer sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në atë kohë.

Për shoqëritë tregtare të regjistruara në gjykatë në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, përfaqësues i pronarit për aksionet dhe pjesët e kapitalit shtetëror do të jetë Ministria e Ekonomisë, sipas përcaktimit të nenit 1.

Dispozitë e shtuar me ligjin nr.10 264, datë 8.4.2010 neni 2, e miratuar dekretin nr.6522, datë 28.4.2010

Ngarkohen titullarët e ministrive që preken nga ky ligj që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e tij, të bëjnë ndryshimet në këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi më 15 maj 1995.

Shpallur me dekretin nr.1090, datë 4.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, faqe 458

Ligji nr.10 264, datë 8.4.2010 shpallur me dekretin nr.6522, datë 28.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.51, faqe 1860

VENDIM

Nr.194, datë 20.3.1998

PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRIVE SHTETËRORE QË DO TË KRIJOHEN NGA SHDËRRIMI I NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE

Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimi i kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore pas datës 31.1.1998 do të bëhet duke u mbështetur në gjendjen e pasurisë së ndërmarrjes në mbyllje të ushtrimit financiar vjetor.

2. Kapitalit themeltar të ndërmarrjes shtetërore, në datën e transformimit në shoqëri tregtare, do t'i bashkohen :

- a) shuma e rezervës së zhvillimit;
 - b) shuma e rezervës së shpërblimit suplementar që mbetet pas heqjes së pjesës së caktuar ose të dhënë punonjësve për ushtrimin e fondit financiar të mbyllur.
 - c) shuma e rezervës për ndihma të menjëhershme që tejkalon 5% të fondit të pagave për periudhën që mbetet deri në mbylljen e ushtrimit;
 - d) shuma e rezervave të tjera, me përjashtim të rezervave për ndërtimin e banesave për punonjësit, kur këto gjenden në ndërtim e sipër;
 - e) shuma që përfaqëson 85% të diferencave nga rivlerësimi të përcaktuar sipas pikës 5 të këtij vendimi;
 - f) vlera e truallit sipas aktvlerësimit të lëshuar nga seksioni i financës dhe urbanistikës të bashkisë a këshillit të rrethit;
 - g) kapitalit themeltar të ndërmarrjes shtetërore, në datën e transformimit në shoqëri, do t'i zbriten humbjet e pësura deri në këtë datë, si dhe shpenzimet për t'u shpërndarë në disa ushtrime që nuk janë të mbuluara nga një provizion, dhe shpenzimet për asistencë.
3. Kërkesat debitoare dhe detyrimet kreditore ndërmjet ndërmarrjeve shtetërore me njëra-

tjetrën do të inventarizohen dhe do të paraqiten në bilancin e riformuar të shoqërisë shtetërore që do të krijohet nga transformimi i ndërmarrjes.

Ndërmarrjet shtetërore ose shoqëritë shtetërore mund të kryejnë kompensimin e detyrimeve të ndërsjella ndërmjet tyre.

Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit mund të urdhërojë një ndërmarrje a shoqëri shtetërore të heqë dorë nga kërkimi i detyrimit mbi një ndërmarrje ose shoqëri shtetërore tjetër, kur një gjë e tillë nuk sjell për kreditorin pakësimin e kapitalit nën kufijtë e përcaktuar nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

4. Kërkesat debitoare të ndërmarrjes mbi buxhetin e shtetit dhe mbi institucionet e tjera buxhetore, qendrore dhe lokale, si dhe detyrimet kreditore të ndërmarrjes ndaj këtyre të fundit, do të inventarizohen veçmas dhe do të paraqiten më vete në bilancin e riformuar të shoqërisë që do të krijohet nga transformimi i ndërmarrjes. Sistemimi i këtyre kërkesave dhe detyrimeve mund të bëhet vetëm me ligj të veçantë.

5. Vlera kontabël e mbetur e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara aktuale të rivlerësohen sipas kriterëve të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes”.

6. Elementet e pasurisë pa vlerë, përdorimi ose të zhvlerësuara të trajtohen, në nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit ose në uljen e vlerës, në pajtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993. Ulja e vlerës do të kryhet nga komisioni i vlerësimit dhe me pjesëmarrjen e dy a më shumë ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë.

7. Bilanci i çeljes së shoqërisë së krijuar nga transformimi i ndërmarrjes shtetërore do të jetë bilanci i riformuar.

8. Përcaktimi i kapitalit të shoqërive shtetërore do të bëhet nga një komision i ngritur pranë çdo ndërmarrjeje me urdhër të titullarit të saj.

9. Bilanci i çeljes së shoqërisë do të verifikohet dhe vërtetohet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i zgjedhur sipas listës së dërguar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël, të autorizuar dhe miratuar nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

10. Madhësia e kapitalit themeltar të nevojshëm për shoqëritë që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, vendoset nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka të drejtë të caktojë (kur ndërmarrja ka gjendje të shëndoshë financiare) një shumë kapitali më të vogël se shuma që del nga llogaritjet e bëra sipas këtij vendimi dhe të urdhërojë tërheqjen e diferencës në një llogari të posaçme të fondit rezervë të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

11. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të hartojë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

12. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.311, datë 12.6.1995 “Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.85, datë 2.2.1996 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.311, datë 12.6.1995”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.Ekstra VII, faqe 20

VENDIM
Nr.271, datë 9.5.1998

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TIP TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.526, datë 21.8.1998)
(I përditësuar)

Në zbatim të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7296, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore që i bashkëngjitet këtij vendimi, të cilat do të krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri anonime.

2. Për shoqëritë anonime që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në sektorë me rëndësi të veçantë të ekonomisë, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka kompetencë t’a ndryshojë këtë statut në përputhje me ligjin për shoqërinë tregtare.

Sektorët me rëndësi të veçantë janë sektorët e përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 3 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura private dhe privatizimit”.

3. Për shoqëritë anonime të regjistruara duhet të kryhet depozitimi në regjistrin tregtar i ndryshimit të statutit sipas përcaktimeve të statutit tip të miratuar në këtë vendim.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.356, datë 12.6.1995 “Për miratimin e akteve tip të themelimit të shoqërive shtetërore”, si dhe vendimi nr.519, datë 25.9.1995 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.356, datë 12.6.1995 “Për miratimin e akteve tip të themelimit të shoqërive shtetërore” shfuqizohen.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ky vendim hyn në fyqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUT I SHOQËRISË ANONIME

Neni 1

Emërtimi dhe selia

Shoqëria anonime krijohet nga transformimi i ndërmarrjes shtetërore _____.

Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet sh.a. _____.

Selia e shoqërisë është në adresë _____.

Neni 2

Objekti i shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është _____. Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 3
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është _____ lekë.
Nga kjo vlera e truallit është _____ lekë. Numri i aksioneve është _____.
Vlera nominale e aksionit është 1000 lekë.

Neni 4
Transferimi i aksioneve në rast privatizimi

Transferimi i aksioneve në rastin e privatizimit do të kryhet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në bazë të legjislacionit në fuqi për privatizimin.

Neni 5
Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Këshilli mbikëqyrës;
2. Drejtori.

Neni 6
Këshilli mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga ____ (_____) anëtarë. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës emërohen nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Kohëzgjatja e funksionit të tyre është 4 (katër) vjet. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë të gjithë të rizgjedhshëm. Ata mund të revokohen nga titullari i organit që i ka emëruar për shkak të përligjura.

3. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.

4. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës mbeten bosh, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj. Anëtari i këshillit mbikëqyrës i emëruar me zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

5. Shfuqizuar.

6. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të moshës mbi 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç nuk mund të jenë më shumë se 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të këshillit mbikëqyrës. Nëse ky raport tejkalohet, anëtari më i moshuar do të konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

Neni 7
Kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një anëtar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata zgjidhen për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm.

Këshilli mbikëqyrës mund të ngarkojë një person si sekretar edhe jashtë anëtarëve të tij.

Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e këshillit mbikëqyrës drejtohen nga zëvendëskryetari.

Neni 8

Vendimet e këshillit mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës mbledhet sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e kryetarit, ose në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e këshillit mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, kur drejtoria ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët mund të thërrasin mbledhjen e këshillit mbikëqyrës, duke i përcaktuar rendin e ditës. Në parim thirrja duhet të bëhet 3 (tre) ditë përpara, me letër, telegram, teleks ose faks. Por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe me gojë dhe pa afat, nëse anëtarët e këshillit mbikëqyrës do ta pranojnë atë. Çdo thirrje duhet të përcaktojë rendin e ditës.

Mbledhja e këshillit mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në thirrje. Këshilli mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm ose jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, në rast barazimi votash, ajo e kryetarit është përcaktuese. Këshilli mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhjen e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet e këshillit mbikëqyrës evidentohen, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi nga kryetari dhe një anëtar i këshillit ose në mungesë të tij, nga dy anëtarë të këshillit mbikëqyrës.

Kopjet e vendimeve vërtetohen nga kryetari ose zëvendëskryetari i këshillit mbikëqyrës.

Neni 9

Kompetencat e këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga drejtoria dhe i jep kësaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që *nuk* mund të kryhen nga drejtoria pa autorizimin e këshillit mbikëqyrës.

2. Këshilli mbikëqyrës emëron drejtorinë. Këshilli mbikëqyrës cakton njërin prej anëtarëve të drejtorisë me cilësinë e drejtorit.

3. Me emërimin e anëtarëve të drejtorisë, këshilli mbikëqyrës lidh kontrata me ta për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

4. Këshilli mbikëqyrës, autorizon drejtorinë që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenet 12 dhe 13 të statutit.

5. Këshilli mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole, që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

6. Drejtoria i paraqet raport këshillit mbikëqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, drejtoria duhet t'i paraqesë këshillit mbikëqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

7. Këshilli mbikëqyrës i propozon Ministrinë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit lidhur me këtë çështje:

a) përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë;

b) kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;

c) hapjen e veprimtarive ose njërive të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë;

d) shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë;

e) krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera;

f) marrjen e huave afatmesme, afatgjata;

g) si dhe për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës do të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Drejtoria

1. Shoqëria administrohet nga drejtoria, e cila mund të përbëhet nga një ose disa anëtarë. Numri i anëtarëve të drejtorisë caktohet nga këshilli mbikëqyrës me një vendim të tij.

2. Drejtoria emërohet nga këshilli mbikëqyrës kur për të janë dakord jo më pak se 2/3 (dy të tretat) e gjithë anëtarëve të këtij këshilli.

3. Anëtarët e drejtorisë janë persona fizikë, në të kundërt emërimi i tyre është i pavlefshëm. Ata mund të zgjidhen edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Nëse një anëtar i këshillit mbikëqyrës emërohet anëtar i drejtorisë, mandati i tij në këshillin mbikëqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet anëtar drejtorie ose drejtor në më shumë se një shoqëri. Anëtarët e drejtorisë mund të shkarkohen nga këshilli mbikëqyrës për shkaqe të përligjura. Në rastin kur i interesuari ka lidhur kontratë punësimi me shoqërinë, shkarkimi i tij nga funksioni i anëtarit të drejtorisë nuk është shkak për zgjidhjen e kontratës.

4. Anëtarët e drejtorisë emërohen për një periudhë kohe prej 4 (katër) vjetësh. Në rastet e pushimeve dhe mungesave të zgjatura, këshilli mbikëqyrës bën zëvendësimin e tyre.

Anëtarët e drejtorisë janë të riemërueshëm. Ata nuk mund të jenë mbi moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç. Anëtari i drejtorisë që mbush moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

5. Paga e anëtarëve të drejtorisë caktohet nga këshilli mbikëqyrës në aktin e emërimit të tyre.

Neni 12

Kompetencat e drejtorisë

1. Drejtoria ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.

2. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorisë të nënshkuara nga anëtari me cilësinë e drejtorit, edhe kur këto e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit, kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i drejtorisë kapërcente objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund të injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

3. Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve duhet të nënshkruhen nga anëtari me cilësinë e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.

4. Drejtoria merr vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, kur janë prezent jo më pak se gjysma e anëtarëve të saj. Në rast barazimi votash, vota e anëtarit të caktuar me cilësinë e drejtorit është përcaktuese.

5. Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlerë mbi 2 (dy) milionë lekë bëhet me autorizim të këshillit mbikëqyrës.

6. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga këshilli mbikëqyrës.

7. Drejtoria bën strukturën e organizimit të shoqërisë, të cilën e miraton këshilli mbikëqyrës.

Neni 13

Marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe drejtorisë ose të një anëtari të këshillit mbikëqyrës

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe anëtarëve të drejtorisë ose një anëtari të këshillit mbikëqyrës, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të këshillit mbikëqyrës. Përcaktimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur një anëtar i këshillit mbikëqyrës është dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës të një shoqërie tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshje. Kjo nuk është e zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhëse të shoqërisë që kryhet në kushte normale. Anëtari i drejtorisë ose i këshillit mbikëqyrës i interesuar duhet të njoftojë këshillin mbikëqyrës për një marrëveshje për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statutit. Anëtari i interesuar i këshillit mbikëqyrës nuk merr pjesë në votimin për dhënien e autorizimit.

Neni 14

Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga (_____) ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga aksionmbajtësi i vetëm dhe që kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 15

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Përrjashtimisht ushtrimi i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar deri më 31 dhjetor.

Neni 16

Inventari – llogari vjetore

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbylljen e ushtrimit drejtoria harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar. Drejtoria përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

Neni 17

Rezultati ushtrimor dhe përcaktimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm. Nga fitimet e ushtrimit, të pakësuara kur është rasti me humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5% (pesë për qind) për të krijuar rezervën e domosdoshme. Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme nuk është e detyrueshme, kur kjo rezervë arrin 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon për një arsye çfarëdo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit.

Përdorimi i fitimit pas zbritjes së rezervës ligjore bëhet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Neni 18

Emërimi i anëtarëve të parë të këshillit mbikëqyrës

Si anëtarë të parë të këshillit mbikëqyrës emërohen:

1. _____
2. _____
3. _____

Neni 19
Emërimi i ekspertit kontabël të parë të autorizuar

Ekspert i (të) parë kontabël i (të) autorizuar emërohet(n):

1. _____
2. _____
3. _____

Neni 20
Asambleja e përgjithshme

Të gjitha kompetencat e asamblesë së përgjithshme të parashikuara nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, që nuk janë shprehur në këtë statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit me cilësinë e aksionerit të vetëm.

Neni 21
Dispozita e fundit

Në një afat prej 6 (gjashtë) muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, drejtor i shoqërisë do të jetë drejtori i ish – ndërmarrjes shtetërore. Gjatë këtij afati ai mund të shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit veç për shkaqe të përligjura.

Neni 22

Për çfarë nuk është shprehur në këtë statut, i referohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

VENDIM
Nr.553, datë 28.8.1998

**PËR REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË SHOQËRIVE TREGTARE,
TË KRIJUARA NGA TRANSFORMIMI I NDËRMARRJEVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 2 të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me dekretin nr.1195, datë 14.8.1995, ligjin nr.8099, datë 28.3.1996, dekretin nr.1631, datë 1.11.1996”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasuritë e paluajtshme, pronë shtetërore, të vendosura si kontribut në natyrë në kapital themeltar të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, në bazë të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të regjistrohesh në regjistrin e pasurive të paluajtshme si pasuri e këtyre shoqërive.

2. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme të bëhet në bazë të urdhrit të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit. Ky urdhër, si rregull, duhet të përmbajë të dhënat për vlerën, kufijtë, sipërfaqen dhe vendndodhjen e pasurisë së paluajtshme, për të cilën kërkohet regjistrimi.

3. Bashkëlidhur urdhrit të lartpërmendur, të paraqiten për regjistrim në regjistrin e pasurive të paluajtshme, vendimi i gjykatës për regjistrimin në regjistrin tregtar, bashkë me aktet me të cilat krijohet shoqëria tregtare, si dhe planrilevimi i pasurisë së paluajtshme për të cilën kërkohet regjistrimi.

4. Kur një shoqëri tregtare disponon pasuri të paluajtshme në zona të ndryshme të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, regjistrimi i tyre bëhet pranë zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, për të cilën kërkohet regjistrimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.Ekstra XII, faqe 9

VENDIM
Nr.642, datë 11.10.2005

PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 18 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore, që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, të jetë:

- a) Për shoqëritë jostrategjike, të vogla e të mesme, tre anëtarë;
- b) Për shoqëritë e sektorëve strategjikë, me rëndësi të veçantë, deri në gjashtë anëtarë.

2. Anëtarët e këtyre këshillave propozohen si më poshtë:

- 2/3 e numrit nga kandidaturat e propozuara nga ministrinë e linjës administrative ose organet e qeverisjes vendore;

- 1/3 e numrit nga kandidaturat e propozuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Anëtarët e këshillave mbikëqyrës miratohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dhe i njëjti person nuk mund të marrë pjesë në më shumë se 2 këshilla mbikëqyrës.

4. Në përbërje të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime mund të përzgjidhen:

a) nëpunës të institucioneve shtetërore, kur legjislacioni në fuqi nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera;

b) specialistë të institucioneve kërkimore e shkencore, të universiteteve, me vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet, dhe personat që gëzojnë autoritet profesional në fusha të caktuara.

Njëri nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të jetë specialist në fushën e ekonomisë dhe të financës.

5. Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës punonjës të organeve qendrore a vendore, që kryejnë funksione kontroll-revizioni, punonjës të emëruar në drejtorinë e shoqërive tregtare ose drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare, si dhe kushdo tjetër, që ka konflikt interesash në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

6. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës si më poshtë vijon:

a) Në shoqëritë anonime shtetërore strategjike, për kryetarin, në masën 30 për qind të pagës mujore të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ndërsa për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page.

b) Në shoqëritë anonime shtetërore jostrategjike kombëtare, për kryetarin, në masën 30 për qind e pagës mujore të drejtorit të Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page.

c) Në shoqëritë anonime shtetërore jostrategjike vendore, për kryetarin, në masën 30 për qind të pagës mujore të sekretarit të përgjithshëm të prefekturës dhe për anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, 20 për qind të kësaj page.

ç) Për shoqëritë anonime shtetërore, që e kanë dhënë pasurinë tërësisht me qira apo emfiteozë, kryetari i këshillit mbikëqyrës shpërblehet në masën 7 për qind dhe anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës, në masën 5 për qind, sipas përcaktimeve të mësipërme.

Kur personi merr pjesë në një këshill të dytë mbikëqyrës, ai merr një shpërblim të dytë në masën 75 për qind të shumës së përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi.

Në funksion të realizimit të detyrave të ngarkuara nga këshilli mbikëqyrës, anëtarit i rimbursohet vlera e shpenzimeve të kryera.

7. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime.

Në mbledhjen e tij të parë, këshilli mbikëqyrës cakton sekretarin dhe masën e shpërblimit të tij.

8. Këshilli mbikëqyrës mblidhet jo më pak se katër herë në vit dhe i raporton, për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, ministrit të linjës dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e përfaqësuesit të pronës shtetërore, jo më pak se 4 herë në vit.

9. Vendimi nr.289, datë 24.4.2003 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe përbërjen e këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

10. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.73, faqe 2482

LIGJ
Nr.7582, datë 13.7.1992

PËR NDËRMARRJET SHTETËRORE

(Ndryshuar me ligjin nr.7670, datë 9.2.1993)
(Ndryshuar me ligjin nr.7743, datë 26.7.1993)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton regjimin juridik të ndërmarrjeve shtetërore të cilat, në përputhje me objektin e parashikuar në aktin e krijimit të tyre, ushtrojnë veprimtari prodhimi, tregtie, apo shërbimi duke pasur si qëllim realizimin e fitimit dhe shtimin e pasurisë.

Neni 2

Ndërmarrjet shtetërore janë njësi ekonomike dhe kanë personalitet juridik. Shteti është zotërues i vetëm i kapitalit të këtyre ndërmarrjeve dhe, për rrjedhojë, ushtron të drejtat e tij si pronar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij ligji.

Neni 3

1. Ndërmarrjet shtetërore krijohen me vendim të organeve të administratës shtetërore, qendrore ose lokale.

2. Ndërmarrjet shtetërore e fitojnë personalitetin juridik pas regjistrimit në gjykatë dhe në organin financiar të juridiksionit ku kanë qendrën e tyre, sipas rregullave të përgjithshme.

Neni 4

Ndërmarrjet shtetërore mund të krijojnë filiale të cilat kanë personalitet juridik dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën kontrollin e ndërmarrjes.

Neni 5

Ndërmarrjet shtetërore, përveç rasteve kur me dispozita të veçanta parashikohet ndryshe, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtat kushte, si dhe ndërmarrjet e tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe me dispozitat e këtij ligji. Ato veprojnë në kushtet e konkurrencës së lirë e të ligjshme dhe nuk gëzojnë asnjë privilegj ose të drejtë që prish kushtet e kësaj konkurrence.

Neni 6

(Shtuar me ligjin nr. 7670, datë 9.2.1993, neni 1)

1. Ndërmarrjet shtetërore përcaktojnë vetë programin ekonomik e financiar dhe marrin vendime për realizimin e tij duke respektuar legjislacionin në fuqi.

2. Ndërmarrjet shtetërore përcaktojnë lirisht çmimet e mallrave apo shërbimeve, në bazë të kërkesës e ofertës me përjashtim të atyre rasteve që përcaktohen me dispozita të veçanta.

3. Ndërmarrjet shtetërore sigurojnë nëpërmjet veprimtarisë së tyre ekuilibrin financiar duke i shitur prodhimet, mallrat apo shërbimet në tregun e brendshëm apo të jashtëm.

4. Ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë shtetërorë jobuxhetorë lejohen të marrin e t'i japin kredi subjekteve shtetërore a privatë për blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve të tyre.

5. Këshilli i Ministrave rregullon me dispozita të veçanta kushtet dhe afatet specifike të këtyre kredive.

Neni 7

Ndërmarrjet shtetërore, që venë në shfrytëzim pasuri kombëtare të një rëndësie të veçantë, marrin parasysh në programet e tyre ekonomike e financiare edhe detyrat që rrjedhin nga programet e përgjithshme të shtetit për zhvillimin e ekonomisë apo të degëve të veçanta të saj. Këshilli i Ministrave mund të parashikojë për këto ndërmarrje forma të tjera organizimi, përfshirë edhe bashkësi ekonomike, si dhe statuse të posaçme, por pa prishur kushtet e përgjithshme të këtij ligji.

Neni 8

Ndërmarrjet shtetërore mbajnë kontabilitet, përgatitin e paraqesin llogaritë vjetore dhe raportojnë periodikisht treguesit dhe të dhënat statistikore, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 9

1. Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve shtetërore verifikohen dhe vërtetohen nga një ose disa kontrollorë të jashtëm, kushtet profesionale dhe personale të të cilëve parashikohen me dispozita të veçanta. Ky kontroll është i pavarur nga kontrollet e parashikuara me dispozita ligjore të tjera dhe nuk i zëvendëson ata.

2. Kontrollorët e llogarive caktohen për një periudhë 4 vjeçare nga organi i administratës shtetërore, i cili emëron edhe këshillin drejtues të ndërmarrjes.

Neni 10

1. Drejtori i ndërmarrjes paraqit periodikisht dhe detyrimisht në mbyllje të çdo viti, raport për veprimtarinë ekonomike e financiare të ndërmarrjes.

2. Raporti vjetor i veprimtarisë pasi miratohet nga Këshilli Drejtues i ndërmarrjes, i dërgohet organit të administratës shtetërore përkatëse, bashkë me llogaritë vjetore të vërtetuara sipas kritereve të caktuara në nenin 9 të këtij ligji.

3. Raporti vjetor i veprimtarisë ekonomike e financiare të ndërmarrjes u bëhet i njohur, nëpërmjet përfaqësuesve të sindikatave, edhe punonjësve të ndërmarrjes.

Neni 11

1. Ndërmarrjet shtetërore e përdorin shumën e fitimit vjetor të realizuar, pas zbritjes të tatimit, për qëllimet dhe sipas rradhës që vijon:

- për krijimin e rezervës të kapitalit,
- për krijimin e rezervës për zhvillim,

- për krijimin e rezervës për ndihma sociale,
- për krijimin e rezervës për shpërblim suplementar të punonjësve,
- për krijimin e rezervave të tjera.

2. Shteti nuk tërheq nga ndërmarrja shtetërore pjesë të fitimit, përveç detyrimit që rrjedh nga legjislacioni tatimor.

Neni 12

Rezerva e kapitalit në ndërmarrjet shtetërore krijohet çdo vit deri sa shuma e saj të arrijë jo më pak se një e dhjeta e shumës së kapitalit. Ajo llogaritet jo më pak se 5 për qind mbi shumën e fitimit vjetor, që mbetet pas zbritjes të humbjeve të mbartura nga viti ose vitet pasardhës, nëse ka të tilla humbje.

Neni 13

1. Rezerva për shpërblime suplementare të punonjësve llogaritet mbi të njëjtën shumë të fitimeve si në nenin 12 dhe jo më shumë se 15 për qind.

2. Ndërmarrjet shtetërore mund të shpërndajnë shpërblime suplementare për punonjësit vetëm kur disponojnë rezervën përkatëse dhe jo më shumë se 2 paga mujore në vit për secilin punonjës.

Neni 14

1. Ndërmarrjet i përballojnë humbjet e pësuar, gjatë ushtrimit të veprimtarisë vjetore, me anë të rezervës së kapitalit. Nëse kjo rezervë mungon ose është e pamjaftueshme, shuma e humbjes të pambuluar mbartet në vitin pasardhës.

2. Shteti nuk financon humbjet e ndërmarrjes shtetërore, përveç se me ligj, me përjashtim të rasteve të veçanta kur kjo ka të bëjë me subvencionimin e çmimeve të kontrolluara sipas miratimit të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

1. Ndërmarrja shtetërore garanton dhe përgjigjet me pasurinë e saj për të gjitha detyrimet ndaj të tretëve.

2. Shteti nuk përgjigjet për detyrimet e ndërmarrjes shtetërore ndaj të tretëve.

Neni 16

Ndërmarrjet shtetërore i nënshtrohen procedurës së falimentimit në rastet dhe në mënyrën e parashikimit nga legjislacioni përkatës.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 17

Ndërmarrja shtetërore organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 18

1. Organi drejtues i ndërmarrjes shtetërore është Këshilli Drejtues.

2. Këshilli Drejtues është organ kolegjal që realizon drejtimin e veprimtarisë së ndërmarrjes shtetërore.

Neni 19

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë dhe jo më shumë se 7 anëtarë.
2. Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe midis tyre, drejtori emërohet për një periudhë katërvjeçare nga ministri, drejtuesi i institucionit tjetër qendror ose nga organi i pushtetit lokal, të cilët kanë edhe të drejtën e shkarkimit me një vendim të motivuar. Ata mund të rrimërohen.
3. Anëtarët e Këshillit Drejtues si rregull ushtrojnë edhe funksionet drejtuese teknike në ndërmarrje.
4. Pagat dhe modalitetet për shpërblimet suplementare të anëtarëve të Këshillit Drejtues përcaktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Këshilli Drejtues ka të gjitha atributet për të vepruar në emër dhe për llogari të ndërmarrjes. Ai ushtron të drejtat e tij duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 21

1. Këshilli Drejtues mbliidhet sa herë e kërkon interesi i ndërmarrjes, por si rregull jo më pak se një herë në muaj.
2. Të drejtën e thirrjes së mbledhjes së Këshillit Drejtues e ka drejtori i tij, ose me kërkesën e shumicës së anëtarëve të këshillit.
3. Mënyrat e thirrjes së Këshillit Drejtues, si dhe procedurat e mbledhjes përfshihen në rregulloren e ndërmarrjes shtetërore.

Neni 22

Këshilli Drejtues shqyrton probleme të ndryshme vetëm në rastet kur është e pranishme jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Ai i merr vendimet me shumicë votash të anëtarëve që e përbëjnë. Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e drejtorit është përcaktuese. Këshilli Drejtues mban librin e vendimeve dhe procesverbal, të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e tij.

Neni 23

Këshilli Drejtues i ndërmarrjes shtetërore merr vendime kolegjiale, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për këto çështje kryesore:

1. Për krijimin ose shkrirjen, bashkimin ose ndarjen e filialeve.
2. Për pjesëmarrjen e ndërmarrjes shtetërore në kapitalin e ndërmarrjeve dhe të shoqërive të tjera, vendase a të huaja.
3. Për pëcaktimin e pagave të punës, rritjen e tyre dhe shpërblimin suplementar të punonjësve.
4. Për pëcaktimin e kriterëve të përgjithshme të marrjes në punë dhe të largimit nga puna të punonjësve.
5. Për shkarkimin nga funksionet teknike të një anëtari të Këshillit Drejtues me propozim vetëm të drejtorit të ndërmarrjes.
6. Për shitjen dhe dhënien me qira të mjeteve kryesore të saj.
7. Për lidhjen e kontratave të huadhënies.
8. Për lidhjen e kontratave të huamarrjes në tregun kombëtar ose në tregje ndërkombëtare.

9. Për rregulloren e brendshme të funksionimit të ndërmarrjes dhe problemet sociale që lidhen me kushtet e përgjithshme të punës.

10. Për miratimin e llogarive vjetore dhe të raportit vjetor të veprimtarisë ekonomike e financiare të ndërmarrjes.

Neni 24

1. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore përfaqëson ndërmarrjen në të gjitha marrëdhëniet e saj juridike dhe administrative. Ai nënshkruan, nën përgjegjësinë e tij, veç të tjerave, edhe kontratat që lidhen nga ndërmarrja.

2. Drejtori i ndërmarrjes ka të drejtën të japë urdhëra dhe udhëzime dhe të vendosë sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Drejtori i ndërmarrjes mund t'ia kalojë të drejtën e nënshkrimit njërit prej anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kjo e drejtë mund të revokohet në çdo kohë.

Neni 25

Çdo kontratë a marrëveshje ndërmjet ndërmarrjes nga njëra anë dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues ose punonjësve të tjerë të ndërmarrjes nga ana tjetër është e ndaluar, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj.

Neni 26

Drejtori i ndërmarrjes dhe anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues, sipas rastit, janë përgjegjës individualisht ose bashkërisht ndaj shtetit, ndaj ndërmarrjes dhe ndaj çdo personi të tretë për çdo shkelje që ata i bëjnë legjislacionit në fuqi, dispozitave të këtij ligji, si dhe për dëmet që mund t'i sjellin ndërmarrjes si pasojë e drejtimit nga ana e tyre.

Neni 27

Punonjësit e ndërmarrjes përfaqësohen në Këshillin Drejtues nga një i deleguar i cili zgjidhet nga sindikata që ka numrin më të madh të anëtarëve në ndërmarrje. Ai merr pjesë gjatë shqyrtimit të problemeve nga Këshilli Drejtues. Ai nuk ka të drejtë vote.

Neni 28

Këshilli Drejtues i ndërmarrjes shtetërore nuk mund të marrë një vendim, pa u konsultuar më parë me përfaqësuesit e sindikatave në ndërmarrje, për çështjet e parashikuara në pikat 3, 4 dhe 9 të nenit 23 të këtij ligji.

KREU III BASHKIMI, NDARJA DHE LIKUIDIMI I NDËRMARRJES

Neni 29

Shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri aksionare ose në forma të tjera shoqërisht bëhet sipas legjislacionit e rregullave në fuqi.

Neni 30

Organi shtetëror i cili emëron Këshillin Drejtues të ndërmarrjes mund të vendosë, me propozimin e Këshillit Drejtues ose pas konsultave me të, ndarjen e ndërmarrjes apo shkrirjen e pjesëshme ose tërësore të saj, duke e bashkuar me një a disa ndërmarrje të tjera shtetërore.

Neni 31

Në rast falimentimi likuidimi i ndërmarrjes shtetërore bëhet në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi. Pas kryerjes së likuidimit, teprica e mbetur i kthehet shtetit.

Neni 31/a

(Shtuar me ligjin nr.7743, datë 26.7.1993, neni 1)

Personat përgjegjës në ndërmarrjet shtetërore, për kryerjen e pagesave me lekë në dorë mbi limitin ditor të arkës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë deri në 5 mijë lekë. Të drejtën e gjobës e kanë punonjësit e seksionit të financës të rrethit dhe bashkisë për Tiranën.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë të dhënë nga punonjësit e seksionit të financës të rrethit dhe të bashkisë për Tiranën ankimi bëhet në përputhje me procedurën e caktuar nga ligji nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32

Ky ligj zbatohet për të gjitha ndërmarrjet shtetërore që e kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse janë krijuar para apo pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 33

Këshilli i Ministrave cakton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 34

Ligji nr.7523, datë 6.11.1991 "Për ndërmarrjet shtetërore" dhe nr.7565, datë 20.5.1992 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7523, datë 6.11.1991 "Për ndërmarrjet shtetërore", si dhe çdo akt që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi një muaj pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr.252, datë 17.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

Ky ligj do të jetë në fuqi deri në transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri me përrjashtëm të rasteve kur në këtë ligj është parashikuar ndryshe

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.4, faqe 189

VENDIM
Nr.350, datë 10.8.1992

**PËR MËNYRËN E KLASIFIKIMIT TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË
KOMBËTARE OSE LOKALE**

Në zbatim të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet shtetërore klasifikohen në ndërmarrje kombëtare ose lokale në varësi nga madhësia e tyre, rëndësia e veprimtarisë ekonomiko-financiare që kryejnë, vendndodhja e shtrirja territoriale, destinacioni i mallrave të prodhuara, burimet kryesore të furnizimit dhe ndonjë treguesi tjetër specifik.

2. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore bëjnë zbërthimin konkret të treguesve sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe, brenda datës 17 gusht 1992, bëjnë ndarjen e ndërmarrjeve ekzistuese në vartësi të tyre dhe të organeve të pushtetit lokal. Këto ndarje kanë karakter detyrues për organet e pushtetit lokal.

Gjithashtu ndryshimi i klasifikimit të ndërmarrjeve shtetërore nga kombëtare në lokale e anasjelltas dhe klasifikimi i ndërmarrjeve të reja shtetërore miratohen nga ministria ose institucioni tjetër qendror.

Mosmarrëveshjet ndërmjet Ministrisë, institucionit tjetër qendror dhe organit përkatës të pushtetit lokal, për klasifikimin e ndërmarrjeve shtetërore zgjidhen nga Kryesia e Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, faqe 264

UDHËZIM
Nr.6, datë 3.9.1992

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7582, DATË 13.7.1992 "PËR NDËRMARRJET
SHTETËRORE"**

Në zbatim të nenit 33 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave nxjerr këtë

UDHËZIM:

I. Fusha e zbatimit të ligjit

a) Ligji "Për ndërmarrjet shtetërore" do të zbatohet për të gjitha njësitë ekonomike që janë njohur si persona juridikë, të cilat produktet e prodhuara prej tyre, mallrat e blera me qëllim rishitjeje dhe punimet e shërbimet e kryera i shesin në të tretë kundrejt çmimeve që synojnë mbulimin e kostove dhe realizimin e një fitimi.

Në këtë kuptim dispozitat e këtij ligji do të zbatohen:

- Nga ndërmarrjet shtetërore të industrisë së ndërtimit, të bujqësisë, të tregtisë me shumicë a me pakicë, të transportit, të postëtelekomunikacioneve, të artizanatit dhe të punimeve e shërbimeve të tjera të caktuara për treg.

- Nga institutet, institucionet dhe njësitë e tjera jobuxhetore të cilat, për shkak të veprimtarisë ekonomike që ushtrojnë, janë të organizuara ose organizohen, në pikëpamje financiare, sipas parimit të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat dhe funksionojnë kështu si ndërmarrje.

b) Një ndërmarrje a njësi tjetër ekonomike do të vazhdojë t'i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, sa kohë që funksionon mbi bazën e një kapitali tërësisht shtetëror. Shndërrimi i tyre në shoqëri të formave të ndryshme sjell detyrimisht ndryshimin e regjimit juridik, edhe kur kapitali shtetëror përbën shumicën e kapitalit të saj. Në këto raste ndërmarrja ose njësia tjetër do t'i nënshtrohen dispozitave ligjore të veçanta.

c) Ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", nuk i nënshtrohen bankat, instituti ose shoqëritë e sigurimeve për rreziqe dhe njësi të tjera që ushtrojnë veprimtari financiare.

II. Krijimi, bashkimi ose ndarja e ndërmarrjeve shtetërore

Ndërmarrjet shtetërore klasifikohen në kombëtare ose lokale. Ndërmarrjet kombëtare krijohen me urdhër të ministrit ose të drejtuesit të institucionit tjetër qendror, kurse ndërmarrjet lokale krijohen me vendim të organeve të pushtetit lokal përkatës, ku ka vendndodhjen (selinë) ndërmarrja.

Urdhri ose vendimi i krijimit duhet të përmbajë:

- a) emrin e plotë dhe të shkurtuar të ndërmarrjes;
- b) shumën e kapitalit fillestar;
- c) objektin e veprimtarisë;
- ç) qendrën (selinë) e ndërmarrjes.

Regjistrimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe i njërive të tjera që barazohen me to, nga gjykata dhe seksionet e financës të rretheve bëhet në bazë të aktit të krijimit.

Ndërmarrjet ekzistuese, në procesin e riorganizimit sipas ligjit mund të kthejnë në filiale të tyre fabrika, uzina, reparte ose njësi të tjera, të cilat sot për sot janë të organizuara me një autonomi teknike e administrative të caktuar, nëse nuk parashikohet që këto të fundit të dalin si ndërmarrje të veçanta. Filialet, duke pasur personalitet juridik, do të kenë gjithashtu këshillin drejtues të tyre, anëtarët e të cilit emërohen nga këshilli drejtues i ndërmarrjes. Kompetencat e filialeve përcaktohen nga këshilli drejtues i ndërmarrjes shtetërore.

Bashkimi i një ndërmarrje shtetërore me një ndërmarrje shtetërore tjetër, si dhe ndarja e një ndërmarrje shtetërore në dy a më shumë ndërmarrje shtetërore të tjera bëhet sipas rregullave të njëjta me ato të krijimit të parashikuara në pikën II të këtij udhëzimi.

Regjistrimi i ndërmarrjeve bëhet brenda 10 ditëve nga data e krijimit, ndarjes ose bashkimit me ndërmarrje të tjera shtetërore, pasi merret vendimi i organeve përkatëse dhe për ndërmarrjet ekzistuese me hyrjen në fuqi të ligjit "Për ndërmarrjet shtetërore".

Organi që bën regjistrimin i lëshon ndërmarrjes vërtetimin përkatës.

Dokumentet për regjistrimin e ndërmarrjes shtetërore në organet përkatëse i paraqet drejtori i saj.

III. Emërimi i anëtarëve të këshillit drejtues të ndërmarrjes shtetërore, caktimi i kontrollorit të llogarive

Ligji "Për ndërmarrjet shtetërore" parashikon që anëtarët e këshillit drejtues të ndërmarrjes do të kryejnë njëherazi edhe funksione teknike a administrative.

Në këtë kuptim, përveç drejtorit, në këshillin drejtues të ndërmarrjes duhet të emërohen edhe persona që kryejnë ose që do të ngarkohen të kryejnë funksione të rëndësishme teknike, organizative ose administrative. Në varësi nga natyra e veprimtarisë së ndërmarrjes këta mund të jenë, si rregull, kryetar të degëve të ndryshme teknikë, ekonomikë, financiarë etj.). Drejtori është njëherazi edhe kryetari i këshillit drejtues.

Karakterit kolegjal i këshillit drejtues të ndërmarrjes në marrjen e vendimeve themelore për ecurinë e veprimtarisë së saj parakupton detyrimisht përbërjen e tij nga persona të pajisur me cilësitë e duhura profesionale dhe personale.

Nuk mund të emërohen antëarë të një këshilli drejtues persona që kanë lidhje gjinie dhe që nuk janë në marrëdhënie pune me ndërmarrjen.

Numri i anëtarëve të këshillit drejtues të ndërmarrjeve shtetërore caktohet si më poshtë:

- deri në 1 000 punonjës 5 anëtarë;

- mbi 1 000 punonjës 7 anëtarë.

Kontrollori i llogarive do të caktohet duke filluar nga ushtrimi financiar 1993. Ai do të jetë një person jashtë ndërmarrjes, i pajisur me dëshminë përkatëse dhe që figuron në listën e posaçme të miratuar nga ministri i financave dhe i Ekonomisë.

Kontrollori i llogarive do të paguhet nga ndërmarrja, llogaritë e të cilës ai i kontrollon, sipas vëllimit të punës që parashikohet të kryejë. Shpërblimi caktohet në marrëveshjen që lidhet midis kontrollorit të llogarive dhe ministrisë ose institucionit qendror për ndërmarrjet kombëtare, dhe organeve të pushtetit lokal për ndërmarrjet lokale.

IV. Rregullimet financiare

Ligji "Për ndërmarrjet shtetërore" vendos këto ndërmarrje dhe njësitë e tjera të bazuara me to në kushtet e një pavarësie të plotë financiare. Në ligj nuk është parashikuar që shteti të tërheqë nga ndërmarrja pjesë të fitimit në formë dividendi, por vetëm tatimin, ashtu siç vepron edhe me ndërmarrjet private. Kjo me qëllim që t'u jepet mundësi ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të rivendosin aftësitë e duhura financiare dhe të rrijnë burime për ripërtëritje e zhvillim.

Në funksion të këtij qëllimi është bërë rregullimi i përdorimit të fitimit të realizuar sipas neneve 11, 12, 13 e 14 të ligjit "Për ndërmarrjet shtetërore". Zbatimi i dispozitave të neneve të mësipërme të këtij ligji do të fillojë me ushtrimin financiar në vijim, d.m.th. me mbylljen e llogarive për vitin 1992. Megjithatë për ndërmarrjet ekzistuese të cilat trashëgojnë humbje të mbartura nga viti 1991 e më parë, këto humbje nuk do të merren në llogari as për krijimin e rezervës së kapitalit, as për rezervën e shpërblimit suplementar të punonjësve. Ndërmarrjet që kanë shpërndarë shpërblime për punonjësit para hyrjes në fuqi të ligjit të ri për ndërmarrjet shtetërore, llogaritjet do t'i bëjnë vetëm për 6-mujorin e dytë të vitit 1992.

Pas mbylljes së bilanceve për vitin 1992 ministritë e institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit lokal, së bashku me Minsrinë e Financave dhe të Ekonomisë, do të përcaktojnë mënyrat e rregullimit të borxheve e të humbjeve të mbartura të ndërmarrjeve shtetërore, si dhe procedurat për rikuperimin ose mbylljen e këtyre borxheve.

Për vitin financiar që fillon më 1 janar 1993 e më pas, rregullimi i përdorimit të fitimeve të ndërmarrjes shtetërore ose i mbulimit të humbjes së pësuar gjatë vitit do të bëhet në pajtim të plotë me dispozitat e ligjit.

Norma e vendosur në nenin 13 të ligjit për krijimin e rezervës për shpërblimin suplementar të punonjësve është një kufi maksimal i lejueshëm. Ndërmarrja mund të zbatojë një normë më të ulët se 15 për qind, duke e kaluar shumë tjetër të fitimit në rezervat për zhvillim.

Rezerva për shpërblimin suplementar është e trashëguar nga njëri vit në tjetrin, kështu që edhe nëse për një vit të dhënë ndërmarrja nuk realizon fitim, ose fitimi i realizuar nuk mjafton për të krijuar rezervën vjetor, ajo mund t'u japë punonjësve shpërblim suplementar, kur disponon rezervë të mbetur nga viti i mëparshëm. Ky shpërblim suplementar është në thelb një pagë që mund t'u jepet punonjësve në mënyrë të shkallëzuar ose të menjëhershme (p.sh. kur marrin lejen e zakonshme), sipas marrëveshjes me kolektivin punonjës.

Ndërmarrja nuk mund të japë shpërblime suplementare kur nuk ka rezervën e caktuar për këtë qëllim dhe as paradhënie për llogari të rezervës që parashikon të krijojë në të ardhmen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.153, datë 3.4.1993

PËR KALIMIN E OBJEKTEVE TË MJETEVE Kryesore TË NDËRMARRJEVE DHE
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.454, datë 16.9.1993, nr.625, datë 29.12.1993)
(I përditësuar)

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjitike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe këshillat e rretheve, bashkive e komunave, në raste të veçanta dhe pasi të kenë marrë pëlqimin e këshillave drejtues të ndërmarrjeve e institucioneve, bëjnë kalimin kapital (pa pagesë) të objekteve e të mjeteve kryesore, *me përjashtim të objekteve dhe të mjeteve kryesore të institucioneve dhe ndërmarrjeve të sistemit të kulturës, rinisë e sporteve që nuk janë në vartësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.*

2. Ky kalim bëhet:

a) Me urdhër të titullarit të ministrisë e institucionit tjetër qendror për ndërmarrjet e institucionet e varësisë.

b) Me urdhër të përbashkët të titullarëve të ministrive e institucioneve të tjera qendrore, ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë.

c) Me urdhër të titullarit të ministrisë e institucionit tjetër qendror nga ndërmarrjet e institucionet e vartësisë, në ndërmarrjet e institucionet e tjera, brenda dhe jashtë sistemit, që janë në vartësi të organeve të pushtetit lokal.

ç) Me vendim të këshillit të rrethit, të bashkisë e të komunës për ndërmarrjet dhe institucionet që kanë në vartësi.

d) Me vendim të përbashkët të këshillit të rrethit dhe të bashkisë ose të komunës, ndërmjet ndërmarrjeve e institucioneve që kanë në vartësi.

dh) Me vendim të këshillit të rrethit, të bashkisë e të komunës, nga ndërmarrjet e institucionet që kanë në vartësi, në ndërmarrjet e institucionet e tjera, brenda dhe jashtë sistemit, që janë në vartësi të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.

e) *Me urdhër të titullarit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nga institucionet e ndërmarrjet që ka në vartësi në institucionet e tjera e ndërmarrjet brenda sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve.*

3. *Mjetet kryesore të konfiskuara nga Policia Financiare ose nga organe të tjera të caktuara me ligj, të cilat me një vendim të formës së prerë të marrë nga gjykatat ose me një mënyrë tjetër ligjore kanë kaluar në pronësi të shtetit, u shtiten personave juridikë e fizikë sipas rregullave të miratuara të prokurimit.*

Përjashtimisht dhe me autorizim të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë ato u kalohen pa pagesë vetëm institucioneve buxhetore, qendrore ose lokale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.6, faqe 376

VENDIM
Nr.198, datë 4.5.1993

PËR KRIJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

(Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.40, datë 26.1.2001, nr.724, datë 5.11.2004)
(I përditësuar)

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Entit Kombëtar të Banesave si person juridik me qendër në Tiranë, në bazë të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet". Enti është në vartësi të Ministrisë së Ndërtimit të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Objekt i veprimtarisë së Entit Kombëtar të Banesave është financimi, ndërtimi dhe shitja e banesave në kushtet e konkurrencës së lirë, për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimin e veprimtarisë, për mbështetjen e politikave sociale të strehimit dhe për sigurimin e banesave me kosto të ulët, në përputhje me ligjin nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet e strehimit të banorëve të zonave urbane.

2. Enti Kombëtar i Banesave ka këto detyra e të drejta:

a) financimi dhe lidhja e kontratave për ndërtimin, përfundimin dhe shitjen e banesave;

b) përcaktimi dhe zbatimi i kushteve për ndërtimin dhe përfundimin e banesave;

b/1. bën studime dhe projektme të plota në fushën e banesave, përfshirë dhe urbanizimin e shesheve të ndërtimit;

c) zbatimi i procedurave të konkurrimit për përzgjedhjen e ndërmarrjeve, me të cilat do të lidhen kontratat për ndërtimin dhe përfundimin e banesave, në përputhje me dispozitat përkatëse;

ç) zhvillimi i bisedimeve dhe lidhja e marrëveshjeve për kërkim fondesh për realizimin e veprimtarisë, me kushtet e përcaktuara nga këshilli drejtues;

d) zgjidh problemet e huave për blerësit, duke përfshirë edhe individët privatë, për banesa të përfunduara me fondet e siguruara nga Enti;

dh) bashkëpunimi me rrethet, bashkitë e komunat, si dhe me organizma të tjerë të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit për plotësimin e detyrimeve të tyre në sektorin e banesave;

e) përfaqësimi i shtetit në marrëdhëniet e bashkëpronësisë në banesa, në rastet kur shteti do të vazhdojë të jetë pronar i tyre;

ë) zbaton normativat e strehimit që miratohen nga Këshilli i Ministrave për ndërtimin e banesave;

f) blerje trojesh nga subjekte publike apo private, për ndërtimin e banesave të paracaktuara për t'u shitur në tregun e lirë;

g) blerje dhe shitje banesash, në tregun e lirë, për kategorinë e të pastrehëve dhe të qytetarëve, me status të veçantë, të përcaktuar me aktet, ligjore e nënligjore;

h) dhënie me qira të banesave, deri në shitjen e tyre;

i) hyn në marrëveshje bashkëpunimi me subjekte publike apo private për realizimin e projekteve me interes të përbashkët;

j) ndërton banesa me kosto të ulët dhe i shet ato me kredi, me kushte lehtësuese, për familjet, që kanë nevojë për strehim, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore në fuqi;

k) në rastet kur, sipas lejes së dhënë nga organet përkatëse, parashikohet ndërtimi i mjediseve për zyra ose shërbime, në katet e para të objekteve të banimit kryen shitjen e tyre në tregun e lirë.

3. Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë, dhe konkretisht:

- Përfaqësues nga aprati i Këshillit të Ministrave 1
- Përfaqësues nga Ministria e Punëve Publike 4
- Përfaqësues nga Ministria e Financave 1
- Përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Lokal 1

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues propozohen nga ministria përkatëse dhe emërohen nga ministri i Punëve Publike.

Këshilli drejtues gëzon të drejtën e shpërblimit, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit zgjedh drejtorin e përgjithshëm midis të paktën 2 kandidaturave të paraqitura nga këshilli drejtues.

Këshilli drejtues, përveç kompetencave të njohura nga ligji nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", të ndryshuar, dhe ato të përcaktuara në statutin e tij, ka edhe këto kompetenca:

a) I propozon Ministrin të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit kandidaturën e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Entit Kombëtar të Banesave;

b) Miraton marrëveshjet sipas shkronjës "i" të pikës 2 të vendimit;

c) Miraton përdorimin e të ardhurave të siguruara nga veprimtaria e Entit Kombëtar të Banesave në tregun e lirë, për programet sociale të banesave me kosto të ulët, sipas akteve ligjore në fuqi dhe në bazë të analizave ekonomiko-financiare të hartuara nga ky ent;

ç) Miraton kriteret e përcaktimit të punonjësve, që përfitojnë strehim, nëpërmjet të ardhurave të Entit Kombëtar të Banesave, në njërin nga format e mëposhtme:

- kredi për strehim;

- shitje të pronës me rezervë për blerje banese nga tregu;

- banesë me vlerën e kostos, në objektet e banimit, që ndërton Enti Kombëtar i Banesave, për t'i shitur në tregun e lirë.

Drejtori i përgjithshëm do të zbatojë të drejtat dhe detyrimet e Entit, si dhe do të kryejë fuunksionet administrative të tij. Në bazë të propozimeve të drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues zgjedh drejtorët e drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme, drejtorët dhe kryetarët rajonalë ndërmjet të paktën 2 kandidaturave.

Vendimet e këshillit drejtues janë të detyrueshme për drejtorin e përgjithshëm dhe administratën e Entit Kombëtar të Banesave.

4. Për plotësimin e detyrave dhe të drejtave të tij, Enti mund të sigurojë dhe investojë fonde nga këto burime:

a) të ardhura që i caktohen Entit nga buxheti shtetëror dhe lokal;

b) të ardhura nga huatë dhe kreditë e institucioneve financiare vendase e të huaja;

c) të ardhura nga donatorë vendas ose të huaj;

ç) të ardhura të realizuara nga investimi i fondeve të vetë Entit;

d) të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore;

dh) të ardhura nga shitja e banesave;

e) të ardhura të tjera dhe pasuri të luajtshme e të paluajtshme që mund të sigurojë Enti.

4/1 Për rastin e banesave të ndërtuara me fonde shtetërore, nëpërmjet EKB-së, ky i fundit vepron si agjent-shitës dhe pronar me të drejta të plota mbi banesë, deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare që qytetarët do të kenë për këto banesa.

5. Kapitali fillestar i Entit Kombëtar të Banesave është 5 milionë lekë nga fondi rezervë i caktuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 1992.

6. Llogaritë vjetore të Entit do të kontrollohen e vërtetohen nga specialistë kontabël të pavarur, në përputhje me ligjin "Për ndërmarrjet".

Llogaritë vjetore të kontrolluara dhe relacioni për veprimtarinë financiare vjetore, i miratuar nga këshilli drejtues, i dërgohet Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë.

Ky dokument do t'i dërgohet edhe institucioneve vendase e të huaja që i kanë akorduar hua, kredi ose donacione Entit Kombëtar të Banesave, me kërkesën e tyre.

7. Statuti dhe akte të tjera që rregullojnë funksionimin e Entit Kombëtar të Banesave dhe të degëve të tij, miratohen nga ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.431, datë 12.10.1992, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, faqe 475

VENDIM
Nr.206, datë 16.4.1993

**PËR KUSHTET DHE AFATET E KREDIVE TREGTARE TË KONTRAKTUARA NGA
NDËRMARRJET SHTETËRORE**

Në zbatim të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", ndryshuar me ligjin nr.7670, datë 10.2.1993 "Për një shtesë në ligjin "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet shtetërore autorizohen që, në marrëveshje me klientët dhe furnizuesit e tyre, privatë ose shtetërorë, të vendosin lirisht dhe pa kufizim kushtet financiare dhe afatet e ripagimit të kredive tregtare për blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve të tyre me afat nën 30 ditë.

2. Kreditë tregtare për blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve të tyre me afat mbi 30 ditë që jepen nga një ndërmarrje shtetërore, duhet të mbajnë një përqindje interesi jo më të ulët se përqindja minimale e interesit mbi depozitat me afat me kohëzgjatje të njëjtë, që njoftohet nga ana e Bankës së Shqipërisë dhe që është e detyrueshme për zbatim nga bankat tregtare të nivelit të dytë plus 5 për qind.

3. Ndalohet dhënia dhe marrja nga ndërmarrjet shtetërore e kredive tregtare me afat mbi 90 ditë.

4. Ndërmarrjet shtetërore janë të detyruara të kërkojnë kthimin në afat të detyrimeve financiare prej ndërmarrjeve, si dhe çdo personi tjetër juridik a fizik, shtetëror ose privat, të cilët janë debitorë ndaj tyre.

Në rast moskthimi në afat të detyrimeve financiare që lindin në procesin e shitblerjes së mallrave, kryerjes së shërbimeve dhe të përdorimit të kredive tregtare, ndërmarrjet furnitore kanë të drejtë të ndërpresin furnizimin e mëtejshëm me mallra dhe kryerjen e shërbimeve, duke e parashikuar një gjë të tillë në kontratat dypalëshe. Për energjinë elektrike dhe avullin teknologjik ndërprerja e furnizimit të bëhet pas kalimit të afatit prej 60 ditësh të paralajmërimit për institucionet shëndetësore, çerdhet, kopshtet, shkollat, repartet ushtarake dhe ato të rendit publik dhe prej 15 ditësh të paralajmërimit për të gjithë ndërmarrjet e tjera.

Në rast moskthimi në afat të detyrimeve financiare nga ana e debitorëve të tyre, ndërmarrjet shtetërore duhet të ndërmarrin hapat e përcaktuar sipas dispozitave në fuqi.

5. Çdo ndërmarrje shtetërore që nuk fillon procedurat e parashikuara ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët e saj, do të jetë subjekt i këtyre penalteteve:

- Në rast se procedurat ligjore nuk fillohen nga ndërmarrjet brenda një afati prej 30 ditësh nga data e skadimit të afatit të pagimit të çdo detyrimi, 5 për qind e vleftës së këtij detyrimi do t'i kalojë Buxhetit të Shtetit.

- Në rast se procedurat ligjore nuk fillohen nga ndërmarrjet brenda një afati prej 60 ditësh nga data e skadimit të afatit të pagimit të çdo detyrimi, 10 për qind e vleftës së këtij detyrimi do t'i kalojë buxhetit të shtetit.

- Në rast se procedurat ligjore nuk fillohen nga ndërmarrjet brenda një afati prej 90 ditësh nga data e skadimit të afatit të pagimit të çdo detyrimi, 15 për qind e vleftës së këtij detyrimi do t'i kalojë Buxhetit të Shtetit.

6. Në rast mosrespektimi nga ndërmarrjet shtetërore të kufizimeve të përcaktuara sipas pikave 2 dhe 3, si dhe në rastet e moszbatimit të kërkesave të pikës 4 të këtij vendimi, ndaj drejtorit të ndërmarrjes dhe shefit të degës së financës, ose personave të ngarkuar me kryerjen e këtyre funksioneve, do të zbatohen gjoba deri në 2 rroga mujore, si dhe do të merren masa administrative deri në shkarkimin e tyre.

7. Penalitetet sipas pikës 5 të këtij vendimi dhe gjobat sipas pikës 6 të këtij vendimi merren nga organet e policisë financiare, kurse masat administrative ndaj drejtuesve të ndërmarrjes sipas pikës 6 të këtij vendimi merren nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore ose organet e pushtetit lokal, nga të cilat varet ndërmarrja shtetërore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, faqe 478

VENDIM
Nr.244, datë 27.5.1993

PËR SPONSORIZIMIN NGA NDËRMARRJET SHETETËRORE TË SUBJEKTEVE
TË NDRYSHME

Në zbatim të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet shtetërore kanë të drejtë të sponsorizojnë veprimtari të ndryshme artistike, sociale e publike, kulturore e sportive që kryejnë subjektet juridike e fizike dhe nëpërmjet tij të realizojë njëkohësisht edhe qëllimin për reklamën e prodhimeve, të mallrave dhe të shërbimeve të tyre.

2. Mjetet financiare për sponsorizimin programohen në programin ekonomik e financiar dhe përballohen nga fitimi i vetë ndërmarrjes. Për këtë qëllim ato kanë të drejtë të përdorin deri në 0,5 për qind të shumës së fitimit vjetor të realizuar, pas zbritjes së tatimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, faqe 511

VENDIM
Nr.290 datë 14.6.1993

PËR LIMITIN E ARKËS NË NDËRMARRJET SHETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet shtetërore, si rregull, të gjitha veprimet për arkëtimet e pagesat në procesin e zhvillimit të veprimtarisë së tyre kryejnë nëpërmjet bankës ku ato kanë llogaritë.
2. Në raste të veçanta, për nevoja të domosdoshme, mund të kryejnë pagesa me lekë në dorë deri në limitin ditor të arkës.
3. Limiti ditor i arkës caktohet:
 - Për ndërmarrjet kombëtare 100 mijë lekë
 - Për ndërmarrjet lokale 50 mijë lekë
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen seksionet e financave të rretheve dhe të Bashkisë për Tiranën.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.9, faqe 601

VENDIM
Nr.364, datë 21.7.1993

PËR PËRDORIMIN E FITIMIT TË NDËRMARRJEVE JOBUXHETORE PËR FINANCIM
NË FUSHËN E NDËRTIMEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 11 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërmarrjet shtetërore, nacionale dhe lokale, kanë të drejtë të financojnë veprimtari të përbashkëta në fushën e ndërtimeve publike, që ndërmerren nga organet e pushtetit lokal të juridiksionit ku kanë qendrën ndërmarrjet. Financimi mund të kryhet vetëm për objekte të natyrës ndërtimore dhe kur për këto objekte ka projekte dhe preventiva të miratuara rregullisht.
2. Ndërmarrjet shtetërore përdorin si burim financimi "Rezervat e tjera", të cilat krijohen nga fitimi neto në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore".
3. Për pjesëmarrjen në financimin e veprimeve të përbashkëta të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të drejtën e marrjes së vendimit e ka këshilli drejtues i ndërmarrjes shtetërore. Për ndërmarrjet nacionale duhet të merret edhe miratimi i titullarit të ministrisë apo i institucionit tjetër qëndror.
4. Për kontributin në financimin e veprimtarive të përbashkëta të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, ndërmjet organit të pushtetit lokal dhe ndërmarrjeve lidhet aktmarrëveshje.
Në aktmarrëveshje specifikohet projekti përkatës, kontributi i ndërmarrjes, afatet e derdhjes së tij dhe kushtet e tjera të nevojshme.

5. Derdhja e kontributit të ndërmarrjes do të bëhet në llogarinë e të ardhurave të buxhetit të çelur në emër të Degës së Thesarit të rrethit përkatës, e cila kryen financimin vetëm në bazë të situacioneve faktike për punimet e kryera për secilin projekt. Për raste të veçanta dhe me autorizim të titullarit të organit të pushtetit lokal që ndjek zbatimin e projektit ose të punonjësit të ngarkuar prej tij, ndërmarrjes që kryen punimet i jepet avancë deri në 20 për qind të vlerës gjithsej të projektit.

6. Financim i drejtpërdrejtë nga ndërmarrja kontribuese nuk mund të bëhet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, faqe 709

VENDIM
Nr.840, datë 17.12.2004

PËR VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik (DSHTD) është person juridik, publik, në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme, që ushtron veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjen shtetërore”.

2. Objekti i veprimtarisë së DSHTD-së është:

a) Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajshme e të paluajshme, pronë shtetërore, të cilat janë në përdorim për trajtimin e trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë;

b) Administrimi dhe mirëmbajtja e pasurive, të luajshme e të paluajshme, pronë e shtetit shqiptar në shtete të tjera, të cilat shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

3. Të njëjtat shërbime, që DSHTD-ja kryen për trupin diplomatik, mund t’ua ofrojë edhe subjekteve, shtetërore ose private, shqiptare, si veprimtari dytësore, por që i shërbejnë objektit kryesor të veprimtarisë së saj. Në çdo rast, ushtrimi i këtyre veprimtarive në favor të këtyre subjekteve nuk duhet të pengojë apo cenojë shërbimin ndaj trupit diplomatik.

4. Për të krijuar, garantuar dhe përmirësuar kushtet e qëndrimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë për Trupin Diplomantik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe për përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituara në shtete të tjera, DSHTD-ja përdor burimet e veta financiare. Gjithashtu, DSHTD-ja përballon, tërësisht apo pjesërisht, edhe shpenzimet e nevojshme për ndërtimin apo blerjen e objekteve të reja.

5. Burimet financiare të DSHTD-së janë:

a) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për trupin diplomatik të huaj të akredituar në Republikën e Shqipërisë, si dhe shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;

b) Të ardhurat nga qiratë e objekteve të vëna në dispozicion për subjekte të tjera, si dhe nga shërbime të tjera, të kryera në favor të tyre;

c) Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera dytësore;

ç) Donacionet, vendase ose të huaja, të dhëna me miratimin paraprak të Ministrit të Punëve të Jashtme, të cilat përdoren vetëm në funksion të veprimtarisë kryesore të DSHTD-së.

6. Kapitali themeltar i DSHTD-së është 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, i cili përballohet nga të ardhurat e veprimtarisë së kësaj drejtorie.

7. Veprimtaria ekonomiko-financiare e DSHTD-së kontrollohet nga organet përkatëse, të ngarkuara me ligj. Po ashtu edhe Ministri i Punëve të Jashtme ka të drejtë të udhërojë ushtrimin e kontrolleve, të plota ose të pjesshme, për veprimtarinë e DSHTD-së, nëpërmjet strukturave të specializuara.

8. Tarifat dhe çmimet e shërbimeve, që DSHTD-ja realizon për trupin diplomatik, përcaktohen duke respektuar të drejtat e përfaqësive diplomatike, që burojnë nga konventat apo traktatet ndërkombëtare, marrëveshjet dypalëshe dhe nga parimet e reciprocitetit. Këto tarifa i bëhen të njohura edhe trupit diplomatik, të akredituar në Republikën e Shqipërisë. Tarifat dysheme të qirasë, të diferencuara sipas destinacionit të përdorimit të objektit, si dhe çmimet e shërbimeve, që kryehen për subjekte të tjera, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Financave.

9. Ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe Bashkia e Tiranës, nëpërmjet strukturave dhe ndërmarjeve të tyre vartëse, sigurojnë me përparësi shërbime cilësore për mjediset që administrojnë DSHTD-ja, veçanërisht për furnizimin me energji elektrike, ujë, ndërlidhje telefonike, pastrim etj., në funksionin të plotësimit të nevojave dhe kërkesave të trupit diplomatik të huaj, të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

10. Mënyra e organizimit dhe e ushtrimit të veprimtarisë së DSHTD-së, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre, përcaktohen në statutin, që miratohet nga Ministri i Punëve të Jashtme.

11. Vendimi nr.113, datë 26.2.1993 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shfuqizohet.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe institucionet e përmendura në pikën 9 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, faqe 6786

LIGJ
Nr.8957, datë 17.10.2002

PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME
(Ndryshuar me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V ENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon masat dhe politikat shtetërore për klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nëpërmjet krijimit të një kuadri institucional, rregullator dhe financiar.

Neni 3

(Ndryshuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 1)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- “Ndërmarrje” quhet çdo subjekt, që ushtron një veprimtari ekonomike, pavarësisht formës së tij ligjore. Këtu përfshihen personat e vetëpunësuar, bizneset familjare, që merren me artizanat ose veprimtari të tjera, si dhe shoqëritë e shoqatat, që kryejnë, në mënyrë të rregullt, veprimtari ekonomike.

- “Shifër afarizmi” nënkupton shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë një viti, që i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tretëve.

- “Shoqëri kapitali” janë shoqëritë aksionare, që kanë për objekt investimin e kapitalit në ndërmarrjet e vogla e të mesme.

- “Investimi i kapitalit të përbashkët” është investimi i kapitalit të përbashkët në ndërmarrjet e vogla e të mesme, në çastin e krijimit të tyre ose në fazën e tyre fillestare të zhvillimit.

- “Fonde të zhvillimit rajonal” janë ato fonde, që sigurojnë mbështetje financiare për zhvillimin e rajoneve në fusha të caktuara, si: investimet në kapacitetet e prodhimit, ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës, investimet në fushën e kujdesit shëndetësor dhe të edukimit etj.

- “Ndërmarrje të vogla e të mesme të reja” vlerësohen ato ndërmarrje të vogla e të mesme, të cilat janë regjistruar në QKR prej jo më shumë se 12 muajsh.

- “Biznese të pakuotuar” (“*business angels*”) janë ato sipërmarrje individuale që u ofrojnë kapital në shuma të vogla bizneseve, aty ku bankat apo fondet financiare nuk kanë interes të futen dhe këtë e ofrojnë në këmbim të një pjese të aksioneve të kompanisë.

- “Treg i lidhur” (“*adjacent market*”) është tregu i produkteve apo shërbimeve në diversifikim, të vendosura direkt sipër ose poshtë tregut përkatës.

Neni 4

(Ndryshuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 2)

1. Ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.

2. Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.

3. Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.

4. Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.

5. Për qëllime statistikore ndërmarrjet do të klasifikohen në:

a) mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona, ku brenda këtij grupimi të detajohen në 0-1 persona dhe 2-9 persona;

b) ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona;

c) ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona.

Neni 4/1

(Shtuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 3)

1. “Ndërmarrje autonome” quhet ajo ndërmarrje që:

a) është totalisht e pavarur dhe që nuk ka asnjë pjesëmarrje në kapitalin ose të drejtat e votës në një ndërmarrje tjetër dhe anasjelltas;

b) mund të ketë disa investitorë, të cilët zotërojnë secili më pak se 25 për qind të kapitalit apo të të drejtave të votës, por me kusht që të mos jenë të lidhur në kuptim të nenit 4/3 të këtij ligji;

c) nuk klasifikohet si ndërmarrje partnere, në bazë të kuptimit të nenit 4/2 ose si ndërmarrje e lidhur, në bazë të neneve 4/1 pika 2 dhe 4/3 të këtij ligji.

2. Një ndërmarrje mund të vlerësohet autonome edhe në rastet kur nuk ka asnjë ndërmarrje partnere, megjithëse pragu i 25 për qind të kapitalit ose të të drejtave të votës arrihet apo tejkalohet nga investitorët e mëposhtëm, me kusht që këta investitorë të mos jenë të lidhur, në kuptim të nenit 4/3 të këtij ligji:

a) personat juridikë publikë, shoqëritë e kapitalit dhe individë apo grupe individësh me një veprimtari të rregullt investimi kapital, që investojnë aksione në biznese të pakuotuarra (“*business angels*”), me kushtin që totali i investimeve të këtyre bizneseve të pakuotuarra (“*business angels*”), në të njëjtën ndërmarrje, të jetë më pak se 30 milionë lekë;

b) universitetet dhe qendrat kërkimore jofitimprurëse;

c) investitorët institucionalë, përfshirë fondet e zhvillimit rajonal;

ç) autoritetet vendore me buxhet vjetor më të ulët se 50 milionë lekë dhe me më pak se 5 000 banorë.

Në çdo rast, pragu nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e kapitalit ose e të drejtave të votës, me kushtin që investitorët e mësipërm të mos jenë të lidhur, individualisht ose bashkërisht, me ndërmarrjen në fjalë.

Neni 4/2

(Shtuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 3)

“Ndërmarrje partnere” janë të gjitha ndërmarrjet, që nuk klasifikohen si ndërmarrje të lidhura dhe ndërmjet të cilave ekziston marrëdhënia si më poshtë:

- Një ndërmarrje zotëron vetëm ose bashkë me një apo më shumë ndërmarrje të lidhura 25 për qind apo më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës, por, në çdo rast, jo më shumë se 50 për qind të kapitalit ose të të drejtave të votës në një ndërmarrje tjetër.

Neni 4/3

(Shtuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 3)

“Ndërmarrje të lidhura” janë ato ndërmarrje, të cilat kanë një ose disa prej marrëdhënieve të mëposhtme me njëra-tjetrën:

a) një ndërmarrje zotëron pjesën më të madhe të aksioneve ose të të drejtave të votës në një ndërmarrje tjetër;

b) një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose të shkarkojë pjesën më të madhe të anëtarëve të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të një ndërmarrjeje tjetër;

c) një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrojë ndikim dominues mbi një ndërmarrje tjetër, sipas kontratës, që ka lidhur me atë ndërmarrje, ose sipas një dispozite në statusin e shoqërisë;

ç) një ndërmarrje, e cila si aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër, kontrollon e vetme, sipas një marrëveshjeje me aksionarët ose anëtarët e tjerë të asaj ndërmarrjeje, shumicën e të drejtave të votës mbi bazë aksionesh ose anëtarësh në atë ndërmarrje.

Neni 4/4

(Shtuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 3)

1. Presumohet se nuk ekziston asnjë ndikim dominues, nëse investitorët e listuar në pikën 2 të nenit 4/1 këtij ligji nuk përfshihen vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në

menaxhimin e ndërmarrjes në fjalë, pa paragjykim për të drejtat e tyre si aksionarë.

2. Ndërmarrje të lidhura janë edhe ato, që kanë ndonjërin nga marrëdhëniet e përshkruara në nenin 4/3, nëpërmjet një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera apo ndonjë nga investitorëve, të përmendur në pikën 2 të nenit 4/1 të këtij ligji.

3. Ndërmarrjet, që i lidhin një ose disa marrëdhënie të tilla me një person fizik ose grup personash fizikë, që veprojnë bashkërisht, vlerësohen, gjithashtu, ndërmarrje të lidhura, në qoftë se veprimtarinë e tyre ose një pjesë të saj e ushtrojnë në të njëjtin treg përkatës ose në tregun e lidhur (“adjacent market”).

4. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 4/1 të këtij ligji, një ndërmarrje nuk mund të vlerësohet si ndërmarrje e vogël apo e mesme, nëse 25 për qind ose më shumë e kapitalit apo e të drejtave të votës kontrollohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, bashkërisht ose individualisht, nga një ose më shumë organe publike.

5. Ndërmarrjet mund të deklarojnë statusin e tyre, si ndërmarrje autonome, ndërmarrje partnere ose ndërmarrje e lidhur, përfshirë të dhënat, që lidhen me tavanet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. Deklarata mund të bëhet edhe në rastet kur kapitali është i shpërndarë në atë mënyrë që nuk është e mundur të përcaktohet se nga kush zotërohet. Në këtë rast, ndërmarrja mund të deklarojë, në mirëbesim, se nga asnjë ndërmarrje e vetme ose nga ndërmarrje të lidhura me njëra-tjetrën bashkërisht nuk zotërohet 25 për qind apo më shumë e kapitalit.

6. Mënyra e deklarimit të statusit të ndërmarrjeve, sipas pikës 5 të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 4/5

(Shtuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 3)

1. Të dhënat, që zbatohen për numrin e të punësuarve dhe shumat financiare janë ato, që lidhen me periudhën e fundit të llogarive të miratuara dhe që llogariten në baza vjetore. Ato merren parasysh nga data e mbylljes së llogarive. Shuma e caktuar për të ardhurat llogaritet duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksat e tjera indirekte.

2. Kur në datën e mbylljes së llogarive ndërmarrja zbulon se, në bazë vjetore, ka tejkalluar ose ka rënë poshtë numrit të të punësuarve apo tavanit financiar, të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, ajo nuk e përfton ose e humb statusin e ndërmarrjes së vogël, ndërmarrjes së mesme apo të mikrondërmarrjes, me përjashtim të rastit kur këto tavane tejkallohen për dy periudha llogaritjeje të njëpasnjëshme.

3. Në rastin e ndërmarrjeve të reja, llogaritë e të cilave nuk janë miratuar ende, të dhënat për t'u zbatuar duhet të përftohen nga një vlerësim, në mirëbesim, i bërë gjatë vitit financiar në vazhdim.

Neni 4/6

(Shtuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 3)

1. Numri i të punësuarve korrespondon me numrin e njësive vjetore të punës me kohë të plotë.

2. Puna e personave, të cilët nuk kanë punuar gjatë të gjithë vitit, puna e atyre, që kanë punuar me kohë të pjesshme, pavarësisht kohëzgjatjes dhe puna e të punësuarve sezonalë llogariten si fraksione të njësive vjetore të punës me kohë të plotë.

3. Staf i përbëhet nga:

a) punëmarrësit;

b) punëdhënësit;

c) partnerët, që angazhohen në një veprimtari të rregullt në ndërmarrje dhe që përfitojnë nga përparësitë financiare të ndërmarrjes;

ç) menaxherët – pronarë.

4. Punëtorët në stazh, femrat, para ose pas periudhës së shtatëzanisë, si dhe studentët, që angazhohen në trajnime profesionale me kontratë, nuk përfshihen në staf.

Neni 4/7

(Shtuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 3)

1. Në ndërmarrjet autonome, të dhënat, përfshirë edhe ato për numrin e të punësuarve, përcaktohen ekskluzivisht, në bazë të llogaritjeve të ndërmarrjes.

2. Duke përfshirë edhe numrin e të punësuarve, të dhënat e një ndërmarrjeje, që ka ndërmarrje partnere ose ndërmarrje të lidhura, përcaktohen në bazë të llogaritjeve dhe të të dhënave të tjera të ndërmarrjes ose, aty ku ato ekzistojnë, në bazë të llogarive të konsoliduara të ndërmarrjes, ose të llogarive të konsoliduara, në të cilat ndërmarrja është përfshirë, nëpërmjet bashkimit.

3. Mënyra e llogaritjeve të ndërmarrjeve, sipas këtij neni, përcaktohet me udhëzim të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 4/8

(Shtuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 3)

1. Të dhënave të referuara në pikën 2 të nenit 4/7 të këtij ligji u shtohen të dhënat e çdo ndërmarrjeje partnere të ndërmarrjes në fjalë. Mbledhja bëhet proporcionalisht me përqindjen në kapital ose të drejtat e votës, cilado qoftë më e lartë. Në rast kryqëzimi aksionesh, zbatohet përqindja më e lartë.

2. Të dhënave të parashikuara në pikën 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe në pikën 1 të këtij neni, u shtohen 100 për qind e të dhënave të çdo ndërmarrjeje, e cila është e lidhur, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me ndërmarrjen në fjalë, kur këto të dhëna nuk janë përfshirë, nëpërmjet bashkimit të llogarive.

3. Për zbatimin e pikës 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe pikave 1 dhe 2 të këtij neni, të dhënat e ndërmarrjes partnere të ndërmarrjes në fjalë përftohen nga llogaritë e tyre dhe të dhënat e tjera të tyre të konsoliduara, nëse ekzistojnë. Këtyre u shtohet 100 për qind e të dhënave të ndërmarrjeve, të cilat janë të lidhura me ato ndërmarrje partnere, përveç kur të dhënat e llogarive të tyre përfshihen nëpërmjet konsolidimit.

4. Për zbatimin e pikës 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe pikave 1 e 2 të këtij neni, të dhënat e ndërmarrjeve, që janë të lidhura me ndërmarrjen në fjalë, duhet të përftohen nga llogaritë dhe të dhënat e tjera të tyre, të konsoliduara, nëse ekzistojnë. Këtyre u shtohen proporcionalisht të dhënat për çdo ndërmarrje të mundshme, partnere të asaj ndërmarrjeje të lidhur, përveçse kur ajo është përfshirë në llogaritë e konsoliduara, me të paktën një përqindje proporcionale me përqindjen e përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

5. Kur në llogaritë e konsoliduara nuk shfaqen të dhënat për numrin e të punësuarve për një ndërmarrje të caktuar, numri i të punësuarve llogaritet duke bashkuar proporcionalisht të dhënat nga ndërmarrjet e saj partnere dhe duke shtuar të dhënat nga ndërmarrjet, me të cilat ndërmarrja në fjalë është e lidhur.

6. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr udhëzim në zbatim të këtij neni.

KREU II

MASAT PËR NXITJEN E KRIJIMIT DHE TË ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 5

Këshilli i Ministrave mbështet krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet:

a) sigurimit të programeve dhe projekteve të ndryshme të mbështetjes financiare;

- b) garantimit të një pjese të riskut të kreditimit;
- c) zhvillimit dhe zbatimit të programeve e projekteve të asistencës teknike;
- ç) shërbimeve të informacionit dhe këshillimit;
- d) arsimimit, trajnimit për kualifikimin profesional, si dhe ngritjes së aftësive sipërmarrëse;
- dh) programeve të nxitjes së punësimit;
- e) dhënies me qira të pasurive të paluajtshme me pronësi shtetërore;
- ë) ngritjes së infrastrukturës në mbështetje të këtyre ndërmarrjeve dhe nxitjes së bashkëveprimit ndërmjet tyre;
- f) ngritjes së parqeve industriale dhe inkubatorëve të biznesit për zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve;
- g) veprimtarive dhe masave të tjera në përfitim të tyre, të përcaktuara me ligj.

Neni 6

1. Në kuptim të nenit 5 të këtij ligji, mbështeten me përparësi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat:

- a) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorët prodhues dhe të shërbimit;
- b) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e industrisë;
- c) krijojnë vende të reja pune;
- ç) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në prodhimin për eksport;
- d) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e turizmit;
- dh) zhvillojnë veprimtaritë në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;
- e) ushtrojnë veprimtaritë e tyre në procesin e agropërpunimit;
- ë) zhvillojnë veprimtarinë në sektorin e artizanatit.

2. Gëzojnë të drejtën e mbështetjes me përparësi të gjitha bizneset, të cilat janë në fillim të veprimtarisë së tyre dhe që zhvillojnë veprimtari në fushat e përcaktuara sipas këtij neni.

KREU III

FUSHAT E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NXITJEN E VEPRIMTARISË SË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 7

1. Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare, siguron fonde:

- a) për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve dhe të programeve;
- b) për organizimin e kurseve të trajnimit dhe të seminareve;
- c) për shërbimet e informacionit dhe këshillimit, nëpërmjet botimit të materialeve të ndryshme informative.

2. Fondet e përmendura në pikën 1 të këtij neni administrohen nga Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, e cila parashikohet në kreun V të këtij ligji.

Neni 8

Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me donatorët, institucionet financiare, të vendit ose të huaja, të përmirësojë sistemin e kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke ndërmarrë nisma të "mekanizmave financiarë" në këto drejtime:

- a) në krijimin e fondit të garantimit të kredive;
- b) në nxitjen e zgjerimit të mikrokreditimit dhe të kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

c) në krijimin e instrumenteve të tjera financiare, duke zgjeruar rrjetin bankar në të gjithë vendin.

KREU IV PROGRAMET PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 9

Ministritë dhe institucionet përkatëse parashikojnë në programet e tyre dhe zbatojnë masa në drejtim:

- a) të krijimit të vendeve të reja të punës;
- b) të zgjerimit të veprimtarive eksportuese dhe të rritjes së konkurrencës ndërmjet tyre;
- c) të nxitjes së investimeve;
- ç) të përmirësimit të shërbimeve të të dhënave dhe të këshillimit;
- d) të rritjes dhe forcimit të kualifikimit profesional dhe të aftësive sipërmarrëse;
- dh) të mbështetjes dhe zgjerimit të numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat zbatojnë teknologji të përparuara;
- e) të mbështetjes së ndërmarrjeve, të cilat janë potencial për zbatimin e standardeve të cilësisë (ISO);
- ë) të mbështetjes së ndërmarrjeve që zbatojnë forma të reja programesh trajnimi e punësimi pranë vendit të punës.

Neni 10

1. Institucionet qendrore dhe ato të pushtetit vendor, brenda kompetencave të tyre, zhvillojnë programe:

- a) afatmesme dhe afatgjata për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territoret e tyre përkatëse;
- b) për trajnimin dhe përmirësimin e nivelit të kualifikimit të menaxherëve dhe të punonjësve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në bashkëpunim me organizatat e biznesit dhe institucionet publike, dhomat e tregtisë dhe industrisë, agjencitë rajonale të zhvillimit të biznesit, Shërbimit Kombëtar të Punësimin, si dhe me organizatat e tjera.

2. Veprimtaritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni të bashkërendohen nga Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Neni 11

(Ndryshuar neni me ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 neni 4)

Ministri përgjegjës për ekonominë përcakton kriteret për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në këto programe, sipas neneve 9 e 10 të këtij ligji.

KREU V KRIJIMI I AGJENCISË SË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 12

(Shfuqizuar me ligjin nr.9497, datë 20.3.2006)

Për zbatimin e politikave dhe të strategjive, si dhe për zhvillimin e programeve dhe projekteve në mbështetje të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, krijohet Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, e cila më poshtë do të quhet Agjencia.

Neni 13

(Shfuqizuar me ligjin nr.9497, datë 20.3.2006)

Detyrat, organizimi, buxheti dhe varësia e Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Instituti i Statistikave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe institucionet në varësi të tyre, sipas përkatësisë, mbledhin dhe përpunojnë informacionin dhe të dhënat për veprimtarinë ekonomike dhe financiare, sipas përcaktimeve në nenin 4 të këtij ligji.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe institucionet përkatëse të nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe për rregullimin e marrëdhënieve të parashikuara në nenet 8, 11, 13 dhe 14 të këtij ligji.

Dispozitë e shtuar me ligjin 10 042, datë 22.12.2008 neni 5, e miratuar me dekretin nr.6000, datë 12.1.2009

Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 4/4, 4/7 e 4/8 të këtij ligji.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3547, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.73, faqe 2043

Ligji 10 042, datë 22.12.2008 shpallur me dekretin nr.6000, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.199, faqe 10840

LIGJ
Nr.9497, datë 20.3.2006

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Objekt i këtij ligji është krijimi i Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve, përcaktimi i fushës së veprimtarisë dhe i parimeve e rregullave të përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e kësaj Agjencie.

2. Funksionimi dhe veprimtaria e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve përcaktohen në statut, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Neni 2

Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (ASHBI), që më poshtë në ligj do të quhet thjesht "Alb-Invest", është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me seli në Tiranë dhe e ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Objekte të veprimtarisë së Alb-Invest-it janë:

a) zbatimi i politikave dhe strategjive, zhvillimi i programeve dhe projekteve, në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat;

b) studimi, kërkimi, analizat dhe konkluzionet për klimën e biznesit;

c) nxitja, tërheqja dhe mbështetja e investimeve të huaja, në përputhje me përparësitë e politikës së Qeverisë;

ç) identifikimi i mundësive për investime në Shqipëri dhe promovimi i tyre;

d) nxitja e prodhimit vendas dhe e produkteve për eksport për në tregjet e huaja;

dh) nxitja dhe mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

e) zhvillimi i veprimtarive të promocionit, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë;

ë) dhënia e asistencës për lehtësimin e investimeve, vendase dhe të huaja, për shoqëritë eksportuese dhe sigurimi i të dhënave dhe i shërbimeve mbështetëse për investitorët dhe eksportuesit;

f) bashkëpunimi me institucionet publike, financiare, organizatat e biznesit, të vendit dhe të huaja, për identifikimin e barrierave të zhvillimit të biznesit;

g) botimi i të dhënave zyrtare për investimet, eksportet dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

gj) dhënia e ekspertizës organeve të pushtetit qendror, vendor dhe investitorëve të huaj për fizibilitetin e investimeve.

Neni 4

Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, janë të detyruara të bashkëpunojnë me Alb-Invest-in, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë, për përmbushjen e qëllimeve dhe të funksioneve të veprimtarisë së tij.

Neni 5

1. Alb-Invest-i, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të realizojë të ardhura nëpërmjet shërbimeve që kryen, në funksion të qëllimit dhe fushës së veprimtarisë së vet.

2. Alb-Invest-i nuk lejohet të ushtrojë veprimtari fitimprurëse.

3. Alb-Invest-i përgjigjet me mjetet e veta për detyrimet ndaj të tretëve.

KREU II ORGANET DREJTUESE TË ALB-INVEST-IT

Neni 6

1. Organet drejtuese të Alb-Invest-it janë:

a) Këshilli Drejtues;

b) Drejtori Ekzekutiv.

2. Këshilli Drejtues ka për detyrë të përcaktojë strategjinë, fushat dhe programin e veprimtarive të Alb-Invest-it, të shqyrtojë dhe të miratojë aktet më të rëndësishme për administrimin, organizimin, çështjet financiare dhe buxhetin e tij, mbikëqyrjen dhe kontrollin në vazhdimësi të realizimit të tyre, si dhe të vendosë për çështje të tjera, të parashikuara në ligj ose në statut.

3. Përbërja e Këshillit Drejtues të Alb-Invest-it, mënyra dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të tij caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

1. Drejtimi i veprimtarisë së përditshme dhe përfaqësimi i Alb-Invest-it në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të statutit të tij, bëhen nga Drejtori Ekzekutiv.

2. Drejtori Ekzekutiv emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

KREU III FINANCAT E ALB-INVEST-IT

Neni 8

1. Burimet e financimit të Alb-Invest-it janë:

a) Buxheti i Shtetit, në përputhje me situatën financiare;

b) donatorë të ndryshëm;

c) të ardhurat nga shërbimet dhe projektet e realizuara nga vetë ai.

2. Llogaritë e Alb-Invest-it kontrollohen nga ekspertë kontabël të autorizuar.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Në ligjin nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, fjalët “Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme” zëvendësohen me fjalët “Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve”.

Neni 10

Ligji nr.8877, datë 4.4.2002 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja”, ligji nr.9023, datë 6.3.2003 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve”, si dhe nenet 12 e 13 të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, shfuqizohen.

Neni 11

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe për rregullimin e marrëdhënieve të parashikuara në nenet 1, 6 e 8 të këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ligj nr.9497, datë 20.3.2006 shpallur me dekretin nr.4825, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu
Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, faqe 869

VENDIM
Nr. 509, datë 19.7.2006

**PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT
DHE INVESTIMEVE DHE PËR MËNYRËN E MASËN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE
TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9497, datë 20.3.2006 “Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli drejtues i Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve kryesohet nga Ministri i Ekonomisë dhe Energjetikës dhe ka në përbërje:

- Zëvendësministrin e Financave;
- Zëvendësministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
- Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave;
- Tre përfaqësues nga organizatat e biznesit.

2. Përfaqësuesit e organizatave të biznesit miratohen nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve bëhet në bazë të pjesëmarrjes në mbledhje dhe përballohet nga buxheti i kësaj Agjencie.

Masa e shpërblimit të tyre është 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje.

4. Vendimi nr.344, datë 11.7.2002 i Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e këshillit mbikëqyrës të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja e për mënyrën dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të tij”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.79, faqe 2292

VENDIM
Nr.514, datë 26.7.2006

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË SHQIPTARE TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 1 të ligjit nr.9497, datë 20.3.2006 “Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve.

2. Vendimet nr.542, datë 3.10.2002 “Për miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja”, nr.74, datë 6.2.2003 “Për miratimin e statutit të Agjencisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme”, dhe nr.392, datë 12.6.2003 “Për miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha